



RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMI (TEMATIK)

“BASHKIA LIBRAZHD”

(Për pasqyrat pasqyrave financiare 2023)

Tiranë, Tetor 2024

Nr.	Përmbajtja	Faqe
I.	PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	4 - 7
1.	Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit....	
2.	Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve.....	
3.	Konkluzioni i përgjithshëm dhe Opinioni i auditimit.....	
II.	HYRJA	7 - 12
1.	Objektivat dhe qëllimi	
2.	Identifikimi i çështjes.....	
3.	Përgjegjësitë e strukturave drejtuese	
4.	Përgjegjësitë e audituesve.....	
5.	Kriteret e vlerësimit.....	
5.	Standardet e auditimit.....	
7.	Metodat e auditimit.....	
8.	Dokumentimi i auditimit.....	
III	PËRSHKRIMI AUDITIMIT	12 – 22
1.	Informacion i përgjithshëm mbi subjektin	12 – 13
2.	Përshkrimi i auditimit, sipas drejtimeve të auditimit	13 – 22
2.1	<i>Auditim mbi vlerësimin e raportimit financiar, për të arritur në opinionin në se pasqyrat financiare për vitin 2023, japin një paraqitje të vërtetë e të drejtë të pozicionit financiar, performancës financiare dhe fluksit të parasë, bazuar në kuadrin rregullator në fuqi.</i>	13 – 22
IV	GJETJE DHE REKOMANDIME	22-25
V	ANEKSE	25-28

SHKURTIME

KLSH	Kontrolli i Lartë i Shtetit.
MFK	Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli.
NA	Nëpunës Autorizues.
NZ	Nëpunës Zbatues.
GSM	Grupi i Menaxhimit Strategjik.
AQT	Aktive të Qëndrueshme të Trupëzuara.
UMF	Udhëzim i Ministrisë së Financave
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave.
VKB	Vendim i Këshillit Bashkiak.
ISSAI	Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit.
INOTSAI	Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve Supreme të Auditimit.
ISA	Standardet Ndërkombëtare të Auditimit
IFAC	Federatës Ndërkombëtarë të Kontabilistëve
IPSAS	Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit të Sektorit Publik
NJA	Njësi Administrative.

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

a. Përshkrim i shkurtër për subjektin nën auditim.

Bashkia Librazhd, si të gjitha njësitë e tjera të vetëqeverisjes vendore ka kuadrin legjislativ dhe operues, bazë e të cilave janë ligji nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” dhe ligji nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” i ndryshuar, krahas akteve të tjera ligjore, nënligjore dhe rregullatorë.

Rëndësia e auditimit financiar të Bashkisë Librazhd për periudhën e aktivitetit 2023, krahas detyrimit kushtetues dhe ligjor që konsiston në kontrollin e përdorimit dhe mbrojtjes së fondeve shtetërore nga organet e pushtetit vendor, pra njësitë e vetëqeverisjes vendore janë subjekt i kontrollit nga Kontrolli i Lartë i Shtetit, sipas legjislacionit në fuqi, qëndron në të bërit sa më transparente të veprimtarisë menaxhuese dhe administruese, për të rritur përgjegjshmërinë dhe llogaridhënien e të zgjedhurve dhe administratës publike, në funksion të rritjes së mirëqenies së qytetarëve.

Buxheti i Bashkisë Librazhd si të gjithë njësitë e qeverisjes vendore financohet nga të ardhurat e veta të krijuara në mënyrë të pavarur, nga transfertat e pakushtëzuar e akorduar nga buxheti i shtetit për realizimin e funksioneve të veta dhe të përbashkëta, nga transfertat e kushtëzuara të akorduara nga buxheti i shtetit për realizimin e funksioneve të deleguara, nga transfertat specifike për realizimin e funksioneve të reja, nga ndarja e taksave ndërkombëtare, donacione e burime të tjera të parashikuara në ligj.

b. Rëndësia e institucionit dhe auditimit të tij.

Auditimi i këtij institucioni çdo vit është detyrim ligjor në bazë të ligjit nr. 68/2017 datë 27.04.2017 “Për financat e qeverisjes vendore” nenit 50 “Auditi i jashtëm” pikat 1 dhe 2 në të cilat përcaktohet: “1. Veprimtaria financiare dhe zbatimi i buxhetit vjetor të njësisve të vetëqeverisjes vendore u nënshtrohen çdo vit auditimit të jashtëm. 2. Auditimi i jashtëm realizohet nga Kontrolli i Lartë i Shtetit ose auditues të tjerë ligjorë”. Gjithashtu ky auditim merr rëndësi të veçantë për arsye se, Bashkia Librazhd si çdo njësi vendore administron, menaxhon dhe shpenzon fonde publike, pjesë e buxhetit të Bashkisë të miratuar nga Këshilli Bashkiak me burim financimi nga të ardhurat e realizuara nga taksapaguesit qytetarë dhe fondet e transferuara nga Buxheti i Shtetit.

c. Qëllimi i auditimit.

Qëllimi i këtij auditimi është dhënia e opinionit mbi pasqyrat financiare, për periudhën 01.01.2023 - 31.12.2023. Për të gjitha problematikat e konstatuara janë dhënë rekomandime për përmirësime me synim ndërmarrjen e masave dhe veprimeve korrigjuese nga Bashkia Librazhd. Në përmbushje të qëllimit të auditimit, janë shqyrtuar çështjet:

-Mbi vlerësimin e raportimit financiar, për të arritur në opinionin në se pasqyrat financiare për vitin 2023, japin një paraqitje të vërtetë e të drejtë të pozicionit financiar, performancës financiare dhe fluksit të parasë, bazuar në kuadrin rregullator në fuqi.

d. Metodologjia e përdorur dhe metodat e mbledhjes dhe analizimit të të dhënave.

Metodologjia e përdorur për kryerjen e këtij auditimi është mikse, sasiore dhe cilësore. Auditimi është kryer mbi bazë risku. Grupi i auditimit ka audituar transaksionet e likuidimeve nëpërmjet bankës dhe auditimin e blerjeve dhe investimeve për procedurat, ku vlera e investimit apo e blerjes është e konsiderueshme dhe paraqitja e tyre në pasqyrat financiare. Metodot e auditimit janë bazuar tek kombinimi i testeve të ndryshme të auditimit. Në varësi të çështjeve të auditimit dhe vlerësimit të audituesve, janë përdorur veçmas ose të kombinuara metodat dhe teknikat e mëposhtme verifikimi i transaksioneve, shqyrtimi i raporteve dhe dokumentacionit mbi kontabilizimin e veprimeve në llogarit përkatëse.

e. Nr. i gjetjeve dhe rekomandimeve. Në raportin përfundimtar janë formuluar 7 gjetje dhe rekomandime për masa organizative, 1 gjetje dhe rekomandime mungesë të ardhurash në shumën 2,206 mijë lekë dhe 1 gjetje dhe rekomandime për arkëtim debitorësh në vlerën 115,544 mijë lekë.

f. Paraqitja e gjetjeve kryesore. Disa nga problematikat e konstatuara lidhen me:

-Pasqyrimin e llogarive në pasqyrat financiare.

- Llogaritë inventariale janë pasqyruar për vlerën kontabël pa u krahasuar me inventarin fizik.
- Nga auditimi ka rezultuar se llogaria 212 “Ndërtesa Konstruksione” dhe llogaria 213 “Rrugë rrjete vepra ujore”, shtesat për rikonstruksionin e tyre nuk i janë bashkuar vlerës fillestare të objektit.
- Llogaria 468 “Debitorë të ndryshëm” është nënvlerësuar për vlerën 2,206,200 lekë, pasi në fund të vitit nuk janë kontabilizuar detyrimet e papaguara për qira shfrytëzimi të fondit pyjor dhe kullosor.
- Nga auditimi ka rezultuar se gjendja e llogarisë 4342 “Të tjera operacione me shtetin (të drejta)”, nuk kuadron me Llogarinë 7206 “Financim i pritshëm nga buxheti” për vlerën 42,577,112 lekë.
- Nga 603 objekte inventari të pasurive të paluajtshme në vlerën 4,468,754,552 lekë, të pasqyruara në kontabilitet 19 objekte janë pajisur me titull pronësie dhe për 584 objekte inventari, nuk posedon titull pronësie.
- Nga auditimi ka rezultuar se në llogarinë 211 “Pyje, Plantacione” është kontabilizuar gabim 1 artikull kontabël në vlerën 4,662,464 lekë, që nuk i përket klasifikimit të kësaj llogarie kontabël, por i përket klasifikimit kontabël të llogarisë 202 “Studime e kërkime”.

h. Paraqitja e rekomandimeve kryesore.

-Në hartimin e pasqyrave financiare:

- Drejtorja e Financës, Bashkia Librazhd, të kontabilizojë vlerën prej 2,206,200 lekë si e ardhur e munguar për detyrimet që kanë subjektet për qira për shfrytëzim të fondit pyjor dhe kullosor, si dhe të ndjekë të gjitha rrugët administrative dhe ligjore për saktësimin dhe arkëtimin e debitorëve, në vlerën 115,544,560 lekë.
- Bashkia Librazhd, Drejtorja e Financës të marrë masa të kryej inventarin fizik në fund të periudhës me qëllim krahasimin e gjendjes kontabël me gjendjen fizike dhe për diferencat e konstatuara të bëjë sistemimet në kontabilitet dhe të nxjerrë përgjegjësitë për mungesat e konstatuara.
- Drejtorja e Financës, Bashkia Librazhd, bazuar në dokumentet financiare e ligjore të saktësojë aktivet e hyra në vite për të verifikuar, saktësuar e analizuar vlerat e paraqitura në pasqyrat financiare dhe të bëjë sistemimet përkatëse në llogaritë 211 “Pyje, Plantacione” dhe llogarinë 202 “Studime e kërkime”.
- Drejtorja e Financës, Bashkia Librazhd, të marrë masa për saktësimin e inventarit kontabël të llogarive 212 “Ndërtesa konstruksione” dhe 213 “Rrugë rrjete vepra ujore”, të saktësojë vlerat e këtyre objekteve duke shtuar shpenzime për rikonstruksionin dhe mirëmbajtjen e tyre në vite.
- Bashkia Librazhd, të marrë masa të menjëhershme, që nëpërmjet strukturave të saj, të përgatisë dosjet me dokumentacionin e duhur për regjistrim në ASHK dhe nëpërmjet Drejtorisë së Financës të përlllogaritë kostot për kryerjen e këtij shërbimi, buxhetimin dhe burimet e financimit, me qëllim pajisjen sa më parë të pasurive të paluajtshme me titull pronësie.
- Bashkia Librazhd të marrë masa të menjëhershme, për kryerjen e procedurave ligjore për rivlerësimin e aktiveve, pasqyrimin e tyre në kontabilitet me vlerë reale (referuar tregut), si dhe kryerjen e veprimeve kontabël referuar rezultatit (rritje apo ulje nga rivlerësimi), respektivisht në llogaritë përkatëse 21 “Aktive afatgjata materiale” dhe llogarisë 109 “Diferenca nga rivlerësimi”.

I.1. KONKLZIONI DHE OPINIONI I AUDITIMIT

a. Opinioni i auditimit mbi pasqyrat financiare:

Grupi i auditimit të KLSH-së, ka audituar pasqyrat financiare të Bashkisë Librazhd për vitin 2023, të cilat përfshijnë pasqyrat e pozicionit financiar, të performancës financiare, të ndryshimit të aktiveve, të fluksit të mjeteve monetare dhe shënimet shpjeguese. Auditimi ka përfshirë ekzaminimin, në bazë testimesh, të dokumenteve që mbështesin shumat dhe shpalosjet në pasqyrat financiare, ku u bë vlerësimi i parimeve kontabël të përdorura dhe vlerësimeve të bëra nga drejtuesit, si dhe vlerësimi i paraqitjes së përgjithshme të pasqyrave financiare.

*"Në opinionin tonë, pasi kemi marrë evidenca dhe dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit, pasqyrat financiare të subjektit Bashkia Librazhd janë evidentuar devijime nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi të përshkruara në paragrafin e "Bazës për Opinionin", që në gjykimin profesional të audituesit të pavarur janë materiale por jo të përhapura dhe justifikojnë dhënien e një **opinionit të modifikuar, me rezervë**", e shprehur kjo në bazën për opinionin.*

Baza për opinionin e modifikuar, me rezervë:

Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA¹⁶). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen Përgjegjësitë e Audituesit për Pasqyrat Financiare. Ne jemi të pavarur nga Njësia shpenzuese Bashkia Librazhd, në përputhje me kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare, si dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë. (ISA 700-ISSAI 1700).

Opinionin e dhënë e mbështesim në faktin se, pasqyra e pozicionit financiar, pasqyra e performancës financiare, pasqyra e ndryshimeve në kapital, pasqyra e flukseve e mjeteve monetare, si dhe shpjegimet janë përfshirë në deklaratat financiare, por gjatë auditimit kemi arritur në përfundimin se pasqyrat financiare përmbanin gabime materiale, por jo të përhapura (ISA 705-ISSAI 1705). Materialiteti i llogaritur nga audituesit e Kontrollit të Lartë të Shtetit bazuar në Manualin e Auditimit Financiar të KLSH-së për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2023 është 28,198 mijë lekë.

Përshkrimi i çështjeve:

Në dhënien e opinionit, ne kemi marrë në konsideratë faktin se:

- Llogaritë inventariale janë pasqyruar për vlerën kontabël pa u krahasuar me inventarin fizik.
- Nga auditimi ka rezultuar se llogaria 212 "Ndërtesa Konstruksione" dhe llogaria 213 "Rrugë rrjete vepra ujore", shtesat për rikonstruksionin e tyre nuk i janë bashkuar vlerës fillestare të objektit.
- Llogaria 468 "Debitorë të ndryshëm" është nënvlerësuar për vlerën 2,206,200 lekë, pasi në fund të vitit nuk janë kontabilizuar detyrimet e papaguara për qira shfrytëzimi të fondit pyjor dhe kullor.
- Nga auditimi ka rezultuar se gjendja e llogarisë 4342 "Të tjera operacione me shtetin (të drejta)", nuk kuadron me llogarinë 7206 "Financim i pritshëm nga buxheti" për vlerën 42,577,112 lekë.
- Nga 603 objekte inventari të pasurive të paluajtshme në vlerën 4,468,754,552 lekë, të pasqyruara në kontabilitet 19 objekte janë pajisur me titull pronësie dhe për 584 objekte inventari, nuk posedon titull pronësie.
- Nga auditimi ka rezultuar se në llogarinë 211 "Pyje, Plantacione" është kontabilizuar gabim 1 artikull kontabël në vlerën 4,662,464 lekë, që nuk i përket klasifikimit të kësaj llogarie kontabël, por i përket klasifikimit kontabël të llogarisë 202 "Studime e kërkime".

II. HYRJA

Mbështetur në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksonimin e KLSH”, në zbatim të Programit të Auditimit Tematik nr. 854/4 prot., datë 24.06.2024 i ndryshuar, miratuar nga Kryetari i KLSH, nga data 01.07.2024 deri në datë 02.08.2024, në subjektin Bashkia Librazhd, për periudhën nga 01.01.2023 deri me 31.12.2023, u krye auditimi me objekt “*Mbi auditimin financiar Tematik*” nga grupi i auditimit me përbërje:

1. P. Gj. *përgjegjës grupi*
2. E. M. *auditues,*

1.OBJEKTIVAT, FUSHËVEPRIMI DHE METODOLOGJIA

Objektivat e auditimit

Auditimi Financiar në Bashkinë Librazhd kishte si objektiva kryesore:

-Vlerësimin nëse aktivitetet, transaksionet financiare dhe informacionet janë në të gjitha aspektet materiale ose jo, në përputhje me kuadrin ligjor e rregullator mbi bazën e të cilit subjekti që auditohet ushtron veprimtarinë e tij;

-Vlerësimin e zbatimit të kuadrit ligjor në fuqi, duke vlerësuar risqet e anomalive materiale në pasqyrat financiare dhe nivelin e pohimeve, nëpërmjet të kuptuarit të njësisë dhe mjedisit të saj, duke krijuar kështu bazën për hartimin dhe implementimin e përgjigjeve kundrejt risqeve të vlerësuara dhe gabimeve materiale (ISSAI 1315)³;

-Dhënien e opinionit mbi pasqyrat financiare dhe procedurat e prokurimit duke kryer vlerësimin e risqeve, nivelin e materialitetit dhe identifikimit të gabimeve, bazuar në standardet ISSAI 1700;

-Dhënien e opinionit dhe hartimin e Raportit të Auditimit mbi bazën e vlerësimeve të gjetjeve dhe dhënien e rekomandimeve për përmirësim, mbështetur mbi evidenca të besueshme, të mjaftueshme dhe përkatëse.

Qëllimi i auditimit.

Objektivi i auditimit financiar në Bashkinë Librazhd, është dhënia e opinionit me siguri të arsyeshme, për periudhën nën auditim 2023, mbi transaksionet financiare dhe ngjarjet ekonomike nëse janë raportuar drejt dhe saktë në pasqyrat financiare të subjektit të audituar, kjo referuar kuadrin ligjor të raportimit financiar në fuqi.

Identifikimi i çështjes.

Raporti i Auditimit, synon të identifikojë përmbushjen e rolit të njësisë vendore dhe përgjegjësisë të saj, mbi transaksionet financiare dhe ngjarjet ekonomike nëse janë raportuar drejt dhe saktë në pasqyrat financiare.

Çështjet mbi të cilat është shtrirë auditimi:

-Mbi planifikimin dhe zbatimin e planit të buxhetit, burimi i krijimi të të ardhurave, vlerësimi i mbledhjes së tyre.

-Vlerësimi i raportimit financiar për vitin 2023.

Përgjegjësitë e strukturave drejtuese

Strukturat drejtuese të Bashkisë Librazhd, janë përgjegjëse për paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me ligjin për kontabilitetin. Ato janë përgjegjëse për aktivitetin financiar, në përputhje me kriteret e përputhshmërisë duke përfshirë, por pa u kufizuar në ligjin e buxhetit dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, ligjin e prokurimeve së bashku me aktet nënligjore në zbatim të tij, ligjin për menaxhimin financiar dhe kontrollin dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, ligjin për auditin e brendshëm dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, etj.

Përgjegjësitë e audituesve.

Përgjegjësia e grupit të auditimit është të shprehë konkluzionin dhe një opinion mbi çështjet që janë nën auditim. Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit sipas INTOSAI-t, të cilat kërkojnë që audituesit të respektojnë kërkesat etike, si dhe të planifikojnë dhe kryejnë auditimin me qëllim arritjen e një sigurie të arsyeshme në dhënien e opinionit, mbështetur në evidencat e grumbulluara të auditimit.

Përgjegjësia jonë (e audituesve të KLSH-së), është që nëpërmjet auditimit të realizuar të krijohen bindjet, si dhe të shprehet opinionin i grupit të auditimit mbi aspektet që duhet të vlerësojë:

- Nëse shpenzimet janë realizuar në përputhje me ligjin e Buxhetit të Shtetit, me aktet përkatëse ligjore e nënligjore dhe me parimet e ligjit për menaxhimin financiar dhe kontrollin;
- Nëse janë zbatuar parimet e përgjithshme të sistemit të menaxhimit financiar në sektorin publik dhe të sjelljes së zyrtarëve të sektorit publik;
- Nëse janë zbatuar kërkesat e përcaktuara në ligjet dhe aktet normative përkatëse, si Ligji organik i buxhetit apo Ligji i prokurimit publik, etj.;
- Nëse janë reflektuar shkeljet e institucionit të audituar, të evidentuara në auditimet e mëparshme;
- Interesin publik ose pritshmërinë publike (p.sh. shkelje të identifikuar nga media, ankesat, etj.).
- fusha specifike të cilat janë objekt i fokusit për zbatimin e ligjit, etj.;

Në përputhje me ISSAI 1320 dhe ISSAI 1450, objektivi i audituesit është që të aplikojë konceptin e materialitetit në mënyrë korrekte gjatë planifikimit dhe kryerjes së auditimit. Auditimi përfshin kryerjen e procedurave për të marrë evidencat auditimi rreth praktikave administrative e financiare, rreth shumave dhe raportimit të shifrave në Pasqyrat Financiare. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i audituesit, duke përfshirë këtu edhe vlerësimin e rreziqeve nga gabimi material, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Gjatë procesit të vlerësimit të riskut, audituesit vlerësojnë nivelin e kontrollit të brendshëm përkatës në Bashkinë Librazhd, në mënyrë që të programoheshin drejt procedurat e auditimit, të cilat janë të përshtatshme për kushtet e subjektit, por jo për qëllim të shprehjes së opinionit mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të subjektit.

Kriteret e vlerësimit.

Grupi i auditimit për të vlerësuar aktivitetin e Bashkisë Librazhd është mbështetur në kuadrin ligjor, nënligjor dhe rregullator të listuar më poshtë. Ky kuadër ligjor ka shërbyer si bazë për burimin e kriterëve që ka hartuar grupi i auditimit kundrejt të cilave janë vlerësuar aktivitetet e Bashkisë Peqin. Burimet e kriterëve të vlerësimit janë:

Ligji organik i KLSH-së nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “*Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*”;

✓ Ligji nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “*Për financat e vetëqeverisjes vendore*”;

✓ Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 “*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*”, i ndryshuar;

✓ Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008 “*Për menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë*”, i ndryshuar;

✓ Ligji nr. 139/2015 “*Për vetëqeverisjen vendore*”, i ndryshuar;

- Ligji nr. 7961, datë 12.07.1995 “*Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë*”, i ndryshuar;

- Ligjin nr.20/2020 datë 05.03.2020 “*Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë*”;

- Ligjin nr.7850, datë 29.7.1994 “*Për Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë*”, i ndryshuar

- VKM nr. 510, datë 10.06.2015 “*Për miratimin e procedurave për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve, personelit, aktiviteteve dhe çdo dokumentacion tjetër zyrtar në njësitë e qeverisjes vendore, të prekura nga riorganizimi administrativo-territorial*”;

- VKM nr.500 datë 14.08.2001 “*Për inventarizimin e pronave të paluajtshme Shtetërore dhe transferimin e pronave në Njësitë e Qeverisjes Vendor*”

- ✓ Udhëzimi i MF nr. 5, datë 27.12.2014 “Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura”;
- ✓ Udhëzimi MF nr. 21, datë 25.10.2016 “Për nëpunësit zbatues të të gjitha niveleve”;
- ✓ Udhëzimin e MF nr. 22, datë 30.07.2018 “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore”;
- Udhëzimi i MF nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit e të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme”, i ndryshuar me Udhëzimin e MFE nr.05 datë 21.02.2022;
- ✓ UMF nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar;
- Udhëzim i KM nr. 1, datë 04.06.2014 “Për mënyrën e ekzekutimit të detyrimeve monetare të njësive të qeverisjes së përgjithshme në llogari të thesarit”;
- Udhëzimin nr.15 datë 30.06.2003 “Për mënyrën e paraqitjes nga njësitë e qeverisjes vendore të kërkesave për transferimin në pronësi të tyre të pronave të paluajtshme publike”
 - Rregullore e brendshme “Mbi Procedurat e auditimit në KLSH”;
 - Rregullore e brendshme “Mbi organizimin dhe funksionimin administrativ KLSH-së”;
 - Rregullore e brendshme e organizimit dhe funksionimit të Këshillit Bashkiak dhe aparatit administrativ të Bashkisë.
 - Vendimet e Këshillit Bashkiak dhe shprehja e ligjshmërisë nga Prefekti i Qarkut;
 - Legjislacioni bazë dhe dytësor, dispozitat e tjera, si dhe kriteret përkatëse që janë përdorur dhe ju jemi referuar për kryerjen e vlerësimeve gjatë auditimit.

Standardet e auditimit

- ✓ ISSAI 100 “Parimet themelore të auditimit të sektorit publik”, i cili përcakton parimet themelore për auditimin e sektorit publik në përgjithësi.
- ✓ ISSAI 2000-2899 “Udhëzues të Auditimit Financiar”.
- ✓ ISSAI 2300 “Planifikimi i auditimit të pasqyrave financiare”.
- ✓ INTOSAI GOV 9100 “Udhëzues mbi Standardet e Kontrollit të Brendshëm për Sektorin Publik”.
- ✓ INTOSAI GOV 9110 “Udhëzues mbi raportimin e efektivitetit të kontrolleve të brendshëm”.

Standardet Kombëtare të Kontabilitetit; Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA) të Federatës Ndërkombëtare të kontabilistëve IFAC; Manuali i Auditimit Financiar dhe i Përputhshmërisë të KLSH-së; Manuali i Auditimit të Brendshëm, etj. Standardet Ndërkombëtare të Auditimit mbi Raportimin e Audituesit të Pavarur, (IFAC); Praktika të mira të fushës, si manualet e Gjykatës Evropiane të Audituesve, Kërkesat e Udhërrëfyesit të IDI^t, etj.; Kodit Etik dhe Rregullores së Procedurave të Auditimit të KLSH.

Metodat e auditimit.

Auditim i njëpasnjëshëm dhe me zgjedhje periudhash. Qasja audituese e KLSH-së është metodologji e bazuar në vlerësimin dhe menaxhimin e riskut të auditimit në subjektin që auditohet, e cila shërben për kryerjen e auditimit me efikasitet dhe efektivitet, duke u fokusuar në natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit në fushat materiale dhe që vlerësohen me nivel të lartë risku. Nën gjykimin profesional të audituesve të pavarur, për përzgjedhjen e kampioneve për ekzaminim, në zërat e shpenzimeve, u morën në konsideratë dy elementë:

- Risku i lidhur me shpenzimin specifik; dhe
- Pështetja specifike që një zë shpenzimesh zë ndaj totalit të shpenzimeve të subjektit.

Ndjekja dhe zbatimi i hapave të mësipërm do të sjellin natyrshëm përcaktimin e elementëve kryesorë që do të ndiqen gjatë procesit të zbatimit të projektit të auditimit, nëpërmjet sigurimit të gjurmës së projektit të auditimit. Gjurma e auditimit është dokumentimi i procesit të realizimit të Projektit të Auditimit. Evidentimi i zbatimit të procedurave të auditimit nëpërmjet dokumentimit përfshin të gjitha fazat e kryerjes së Projektit të Auditimit që nga Planifikimi i

Auditimit, Puna në Terren, Raportimi i Auditimit, Ndjekja e Rekomandimeve dhe Publikimi i Auditimit. Theksojmë se nga ana jonë do të auditohen pothuajse të gjitha fondet, si më poshtë:

▪ Kontrolli aritmetik

Duke konsideruar faktin se në thelb, kontabiliteti konsiston në regjistrimin e fakteve në një formë numerike, si dhe në paraqitjen sintetike të tyre, por midis regjistrimit fillestar të fakteve dhe paraqitjes së tyre në formë sintetike (që është edhe qëllimi i kontabilitetit), bëhen një seri veprimesh të cilat kanë të bëjnë me evidentimin në llogari, mbartjet, klasifikimin dhe rigrupimin. Kontrolli aritmetik u krye me qëllim që të sigurohemi nëse veprimet e llogaritjes dhe të hedhjeve në llogaritë përkatëse, që përfundojnë me nxjerrjen e gjendjeve sintetike, nuk përmbajnë asnjë gabim (*Ditari i kontabilizimit të urdhër shpenzimeve*).

▪ Kontrolli me anë të pjesëve justifikuese

Edhe pse kontabilizimet nuk përmbajnë gabime aritmetike, ato mund të jenë të gabuara, nëse regjistrimet e bëra nuk korrespondojnë me realitetin. Nga kontrolli me zgjedhje i pjesëve justifikuese (*Urdhër shpenzimeve*) u konstatua se shifrat e kaluara kanë pasur justifikim të mjaftueshëm dokumentar, sipas kërkesave të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “*Mbi menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*”, i ndryshuar.

▪ Inspektimi fizik dhe kontrolli i gjendjeve ekzistuese

Konsistoi në ekzaminimin e aktiveve, llogarive, librave kontabël etj. Kontrolli kontabël i ushtruar ekzaminoi përputhjen ndërmjet regjistrimit kontabël dhe pjesëve justifikuese përkatëse, por mbi ekzistencën reale të aktiveve në subjekt u konstatuan probleme. Gjithashtu, për të verifikuar kryerjen e saktë të inventarizimit fizik dhe përputhjet e tij me atë kontabël u krye mbikëqyrje fizike e magazinës.

▪ Kontrolli i vlerësimeve

Kontrolli i vlerësimeve përcaktoi nëse vlerat që u atribuohen gjendjeve ekzistuese janë të sakta, nëse pasuritë duhet të qëndrojnë në bilanc me vlerat që u janë vendosur atyre.

▪ Konfirmimi nga të tretët

Transaksionet e përzgjedhura për t’ju nënshtruar testeve të detajeve, u kryqëzuan me informacionin e gjeneruar nga Thesari dhe rakordimit periodike me ente dhe institucione të tjera shtetërore.

▪ Kontrolli sipas një treguesi

Përdorimi i treguesve statistikorë me qëllim që të kërkohen fakte ose të dhëna “jashtë normales”, të cilat përbëjnë tregues të parregullsisve kontabël. Mund të përmendim nëse ka: mungesë të pjesëve justifikuese, gabimet e shpeshta në datat, numrat, referencat e brendshme, regjistrime pak të lexueshme, shifra të renditura keq, korrigjime të shumta të shifrave, etj.

▪ Intervista

U kryen intervista me specialistët e Bashkisë Librazhd me qëllim për të kuptuar dhe vlerësuar më mirë problematikat e konstatuara.

▪ Raporte dhe Informacione

U shqyrtuan raporte, informacione dhe dokumentacion lidhur me çështjet nën auditim.

▪ Praktikat e ndjekura në kryerjen e auditimit

Mbështetur në ISSAI 1315, objektivi i audituesit është identifikimi dhe vlerësimi i risqeve e anomalive materiale në pasqyrat financiare si edhe nivelin e pohimeve, nëpërmjet të kuptuarit të njësisë dhe mjedisit të saj, duke përfshirë kontrollin e brendshëm të njësisë dhe duke krijuar kështu bazën për hartimin dhe implementimin e përgjigjeve kundrejt risqeve të vlerësuar të gabimeve materiale.

Në këtë kontekst merr rëndësi vlerësimi i materialitetit në përputhje me ISSAI 1320 dhe ISSAI 1450, i cili përcakton nivelin e gabimit që audituesi konsideron të mundshëm për të influencuar

te përdoruesit e pasqyrave financiare. Nisur nga gjykimi profesional i audituesit dhe ndjeshmëria e zonave të llogarisë, grupi i auditimit përcaktoi materialitetin në masën 2% për të gjitha zonat e llogarisë të planifikuara për t'u audituar, ku si bazë për llogaritjen e tij janë marrë shpenzimet për pagat (600), shpenzimet operative (602) dhe investimet (231). Pas përcaktimit të nivelit të materialitetit, grupi i auditimit ka kryer vlerësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm në institucion sa i takon: (a) hartimit; (b) implementimit; dhe (c) funksionimit të 5 komponentëve të kontrollit të brendshëm. Vlerësimi i kontrollit të brendshëm është bazuar në kryerjen e testeve të kontrolleve. Gjatë kryerjes së testeve të kontrolleve është arritur në përfundimin që sistemet e kontrollit të brendshëm paraqesin risk të moderuar deri të lartë.

Metodologjia e aplikuar gjatë planifikimit, konsiston në auditimin e të dhënave të siguruara nga vetë subjekti. Kemi ndërmarrë procedurat për vlerësimin e riskut (analiza), me qëllim sigurimin e nivelit të kërkuar të njohjes së riskut të brendshëm dhe riskut të kontrollit të subjektit. Informacion të vlefshëm administruam dhe nga procedurat e ndjekura nga vetë subjekti për vlerësimin e riskut, duke iu nënshtruar skepticizmit profesional nga ana e audituesve. Gjatë vlerësimeve u mbështetëm në Modelin e Riskut që aplikon KLSH-ja¹.

Nisur sa më sipër, jemi përpjekur të ruajmë nivelin e pranuar të Riskut të Auditimit prej 5%, duke shtuar nivelin e procedurave analitike (ISSAI 1520) dhe testeve thelbësore të kryera.

Në këtë kontekst, procedurat e ndjekura nga grupi i auditimit konsistojnë në analizat e marrëdhënieve ndërmjet informacionit financiar dhe jo financiar; inspektimeve që konsistojnë në regjistrimin e dokumenteve në regjistra/ditarë/partitarë ose në trajtë elektronike por edhe në inspektime fizike; në observime, të cilat kanë të bëjnë me analizën e proceseve ose procedurave të kryera nga të tjerë, me qëllim sigurimin e informacionit rreth performancës së proceseve/procedurave, por kjo mbetet e limituar deri në kohën kur ka ndodhur observimi; dhe së fundmi, kërkimi/hetimi që konsiston në kërkimin e informacionit të personat kompetentë dhe të mirë informuar brenda dhe/ose jashtë njësisë shpenzuese.

Dokumentimi i auditimit.

Mbështetur në kërkesat e Manualeve të Auditimit si edhe në Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit ISSAI 1230 "Dokumentimi i auditimit", nga audituesit u përgatit dokumentacioni i auditimit, i mjaftueshëm për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit, të kryera në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat ligjore dhe rregullatore të zbatueshme. Rezultatet e këtyre procedurave dhe evidencat e marra gjatë auditimit, si dhe çështje të tjera të rëndësishme që dolën gjatë auditimit, janë reflektuar në përfundimet e arritura në drejtim të tyre sipas gjykimit dhe skepticizmit profesional që audituesit ushtruan në arritjen e këtyre konkluzioneve. Ky dokumentacion është i përshtatshëm dhe i rëndësishëm për të konfirmuar dhe mbështetur opinionet dhe raportin e audituesve dhe ka shërbyer si një burim informacioni për përgatitjen e tyre.

Raporti Auditimit i dërgohet subjektit Bashkia Librazhd, pasi nga subjekti i audituar me shkresën nr. 4269, datë 10.09.2024 (*prot KLSH nr. 854/13, datë 11.09.2024*), është kthyer Projekt Raporti i Auditimit pa observacione, i cili është dërguar në subjekt me shkresën nr. 854/9, datë 09.08.2024.

III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT

1. Informacion i përgjithshëm.

Bashkia Librazhd është e organizuar dhe funksionon në bazë ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore" dhe ligjit nr. 68/2017, datë 27.04.2017 "Për financat e vetëqeverisjes Vendore", Rregulloren e funksionimit të Bashkisë dhe akteve të nxjerra nga Këshilli Bashkiak Librazhd.

¹ Risku i Auditimit = Risku i qenësishëm * Risku i kontrollit * Risku i Zbulimit

Bashkia Librazhdi kufizohet në veri me Bashkinë Bulqizë, në lindje me Republikën e Maqedonisë, në jug me Bashkinë Përrenjas dhe në perëndim me Bashkitë Elbasan dhe Tiranë. Kryeqendra e Bashkisë është qyteti i Librazhdit.

Sipas Censurit të vitit 2011, Librazhdi ka një popullsi prej 31,892 banorësh. Ndërkohë që sipas Regjistrimit Civil, kjo bashki numëron 44,181 banorë. Bashkia e re shtrihet në një sipërfaqe prej 793.36 km². Sipas regjistrimit civil, densiteti i popullsisë është 55.68 banorë/km² sipas ndërsa sipas censurit, densiteti është 40 banorë/km².

Kjo bashki përbëhet nga 7 njësi administrative, të cilat janë: Librazhd, Qendër Librazhd, Hotolisht, Lunik, Stërblevë, Polis dhe Orenjë. Të gjitha njësitë administrative janë aktualisht pjesë e rrethit të Librazhdit dhe qarkut të Elbasanit. Bashkia e re ka nën administrimin e saj një qytet dhe 52 fshatra.

Bashkia e re e Librazhdit ka potencial për zhvillimin e turizmit malor, por një gjë e tillë ka qenë jashtë vëmendjes së drejtuesve vendorë deri më sot. Mbrojtja e parkut kombëtar Shebenik-Jabllanicë dhe përfshirja e tij në guidat e turizmit malor në vend do të krijonte një perspektivë të re zhvillimi për Librazhdin dhe banorët e këtyre zonave.

Paralelisht me resurset natyrore, zona e Librazhdit shquhet për folklorin e pasur, kostumet popullore të veçanta dhe zanatin e ndërtimit të shtëpive. Kjo zonë ka kultivuar gjithashtu mjeshhtërinë e përpunimit të gurit dhe të drurit.

Misioni i Bashkisë Librazhd është të sigurojë qeverisjen në një nivel sa më afër qytetarëve, duke garantuar vetë-qeverisjen në përputhje me kërkesat e Kartës Evropiane të Autonomisë Vendore. Synimi kryesor është plotësimi sa më i mirë i nevojave dhe kërkesave të komuniteteve përkatëse, nëpërmjet arritjes së një niveli sa më të lartë shërbimesh, në dobi të një zhvillimi të balancuar me qëllim përfundimtar standarde të larta të cilësisë së jetesës në territorin nën administrim.

Vetëqeverisja vendore në Republikën e Shqipërisë siguron qeverisjen e efektshme, efikase dhe në një nivel sa më afër qytetarëve nëpërmjet:

- a) njohjes së ekzistencës së identiteteve dhe vlerave të ndryshme të bashkësive;
- b) respektimit të të drejtave dhe lirive themelore të shtetasve, të sanksionuara në Kushtetutë ose në ligje të tjera;
- c) zgjedhjes së llojeve të ndryshme të shërbimeve dhe lehtësive të tjera publike vendore në dobi të bashkësisë;
- ç) ushtrimit efektiv të funksioneve, kompetencave dhe realizimit të detyrave nga organet e vetëqeverisjes vendore;
- d) realizimit të shërbimeve në forma të përshtatshme, bazuar në nevojat e anëtarëve të bashkësisë;
- dh) nxitjes efektive të pjesëmarrjes gjithëpërfshirëse të bashkësisë në qeverisjen vendore;
- e) realizimit të shërbimeve, në përputhje me standardet e kërkuara me ligj ose akte të tjera normative.

Bashkia Librazhd, si të gjitha njësitë e tjera të vetëqeverisjes vendore ka kuadrin legjislativ dhe operues, bazë e të cilave janë ligji nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” dhe ligji nr.68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” i ndryshuar, krahas akteve të tjera ligjore, nënligjore dhe rregullatorë.

Rëndësia e auditimit financiar të Bashkisë Librazhd për periudhën e aktivitetit 2023, krahas detyrimit kushtetues dhe ligjor që konsiston në kontrollin e përdorimit dhe mbrojtjes së fondeve shtetërore nga organet e pushtetit vendor, pra njësitë e vetëqeverisjes vendore janë subjekt i kontrollit nga Kontrolli i Lartë i Shtetit, sipas legjislacionit në fuqi, qëndron në të bërit sa më transparente të veprimtarisë menaxhuese dhe administruese, për të rritur përgjegjshmërinë dhe llogaridhënien e të zgjedhurve dhe administratës publike, në funksion të rritjes së mirëqenies së qytetarëve.

2. Përshkrimi i auditimit, sipas drejtimeve të auditimit

2.1. Auditim mbi vlerësimin e raportimit financiar, për të arritur në opinionin në se pasqyrat financiare, japin një paraqitje të vërtetë e të drejtë të pozicionit financiar, performancës financiare dhe fluksit të parasë, bazuar në kuadrin rregullator në fuqi.

Nxjerrja e pasqyrave financiare për vitin 2023.

Për vitin 2023, Në përputhje me kërkesat e UMFE nr. 08, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njëjësive të Qeverisjes së Përgjithshme” i ndryshuar, janë përgatitur pasqyrat financiare, dërguar Degës së Thesarit me shkresën nr. 665 prot. datë 12.02.2024, protokolluar në Degën e Thesarit me nr. 665, datë 12.02.2024, të përbëra si vijon:

Format nr. 1 –Pasqyra e pozicionit financiar.

Format nr. 2 –Pasqyra e performancës financiare (Klasifikimi sipas natyrës ekonomike).

Format nr. 3 – Pasqyra e flukseve monetare (Caush-Flou).

Format nr. 4 –Pasqyra e ndryshimeve në aktivet neto/fondet neto.

Format nr. 5 –Pyetësor dhe shënimet shpjeguese.

Format nr. 6 –Investimet dhe burimet e financimit.

Format nr. 7/a –Gjendja dhe ndryshimi i aktiveve afatgjata (kosto historike).

Format nr. 7/b –Gjendja dhe ndryshimi i aktiveve afatgjata (vlera neto).

Format nr. 8 –Numri i punonjësve dhe fondi i pagave.

Pasqyrat financiare janë të hartuara e firmosur nga Drejtori i Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar A. A. dhe Kryetari i Bashkisë.

Mbajtja e kontabilitetit v. 2023.

Në këtë bashki, kontabiliteti është organizuar dhe mbahet në mënyrë manuale.

Gjendja e llogarive të evidentuara në bilanc në fund të periudhës raportuese ushtrimore viti 2023, të pozicionit financiar Bashkia Librazhd; Format nr.1, paraqitet në pasqyrat e mëposhtme:

Nga procesi i auditimit mbi referencat e llogarive të aktivitetit dhe pasivitetit, në lidhje me verifikimin e vlerave të pasqyruara në llogaritë e pasqyrave të pozicionit financiar të periudhës raportuese ushtrimore 2023, të saktësisë dhe besueshmërisë së tyre paraqiten si në vijim;

Aktivet neto janë të barabarta me Aktivet-Pasivet= 2,187,596,004 lekë.

Aktivet 2,397,248,198 lekë.

Pasivet 209,652,194 lekë.

Aktivet afatshkurtra

Aktivet afatshkurtra më datë 31.12.2023 paraqiten në vlerën 456,162,263 lekë dhe përbëhen nga:

Llogaritë e Klasës 5 “Mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre” në shumën 223,010,201 lekë,

Llogaritë e Klasës 3 “Gjendje inventari qarkullues” në shumën 70,958,892 lekë,

Llogaritë e Klasës 4 “Llogari të arkëtueshme” në shumën 160,157,421 lekë,

“Të tjera aktive afatshkurtra” në shumën 2,035,749 lekë.

Llogaritë e Klasës 5 “Mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre” përbëhet nga:

Llogaritë kontabël	Emërtimi i llogarive	Viti 2023	Viti 2022	Diferenca 2023-2022
520	Disponibilitete në thesar	222,891,593	266,771,097	(43,879,504)
532	Vlera të tjera	118,608	117,258	1,350
Totali		223,010,201	266,888,355	(43,878,154)

Vlera e llogarisë 520 “Disponibilitete në thesar” në shumën 222,891,593 lekë, sipas aktrakordimit me Thesarin datë 22.01.2024, përbëhet nga : gjendja e Llogaria 85 "Rezultati i vitit ushtrimor" në pasqyrën 1 “Pasqyra e pozicionit financiar” paraqitet në vlerën 175,551,177 lekë (të ardhura të trashëguara të paçelura 10,972,721 lekë, grandit papërdorur në vlerën 140,532,250 lekë, të ardhura të çelura dhe te papërdorura në vlerën 23,481,765 lekë dhe të ardhura jashtë limitit sponsorizim në vlerën 564,441 lekë) dhe gjendja e llogarisë 466 "Mjete

në ruajtje" në shumën 47,340,416 lekë, të cilat rakordojnë me rubrikën V "Teprica ne fillim te vitit ushtrimor" dhe rubrikën VI " Teprica e Likuiditeteve ne fund te vitit ushtrimor".

Vlera e llogarisë 532 "Vlera të tjera", në shumën 118,608 lekë përfaqëson vlerën e blloqeve të biletave të tregut gjendje në arkë me 31.12.2023.

Llogaritë e klasës 5, kanë funksionuar duke u debituar për shtesat në kredi të llogarive përkatëse për të ardhurat dhe grande të ndryshme, si dhe duke u kredituar për paksimet në debi të llogarive përkatëse të klasës 4.

Llogaritë e Klasës 3 "Gjendje inventari qarkullues", përbëhet nga:

Llogaritë kontabël	Emërtimi i llogarive	Viti 2023	Viti 2022	Diferenca 2023-2022
31	Materiale	13,643,293	16,179,295	(2,536,002)
32	Inventar i imët	57,315,599	53,856,951	3,458,648
	Totali	70,958,892	70,036,246	922,646

Llogaritë e Klasës 3, sipas Pasqyrës së Pozicionit Financiar të Bashkisë Librazhd në 31.12.2023 paraqiten në vlerën 70,958,892 lekë dhe përbëhen nga llogaria kontabël 31 "Materiale" në vlerën 13,643,293 lekë dhe nga llogaria 32 "Inventar i imët" në vlerën 57,315,599 lekë. Diferencat me vitin e mëparshëm përfaqësojnë lëvizjen e inventarit në shumën (922,646) lekë e cila kuadron me llogarinë 63 "Ndryshimi gjendjes së inventarit" në shumën 922,646 lekë.

Llogaria 312 "Materiale", ka vlerën 13,643,293 lekë, krahasuar me vitin e mëparshëm vjen me ulje në vlerën 2,536,002 lekë.

Llogaria 32 "Inventarë i imët", ka vlerën 57,315,599 lekë, krahasuar me vitin e mëparshëm vjen në rritje për vlerën 3,458,648 lekë.

Llogaritë e klasës 3 kanë funksionuar duke u debituar për shtesat në kredi të llogarisë 63 "Ndryshimi i gjendjeve të inventarit" dhe duke u kredituar për daljet e inventarit në debi të llogarisë 63 "Ndryshimi i gjendjeve të inventarit".

Llogaritë e Klasës 4 "Llogari të arkëtueshme" & "Të tjera aktive afatshkurtra" përbëhet nga:

Llogaritë kontabël	Emërtimi i llogarive	Viti 2023	Viti 2022	Diferenca 2023-2022
	Llogari të arkëtueshme	160,157,421	163,164,365	(3,006,944)
468	Debitorë te ndryshëm	115,544,560	116,726,663	(1,182,103)
4342	Te tjera operacione me shtetin(te drejta)	44,612,861	46,437,702	1,824,841)
	Të tjera aktive afatshkurtra	2,035,749	9,977,393	(7,941,644)
486	Shpenzime të periudhave të ardhshme	2,035,749	9,977,393	(7,941,644)

Llogaritë 468 "Debitorë të ndryshëm", në fund të vitit 2023 paraqitet në vlerën 115,544,560 lekë. Vlera e debitorëve ne vitin 2023 në krahasim me vitin 2022 ka pësuar një ulje prej 1,182,103 lekë. Analiza e gjendjes së llog. "Debitorë të ndryshëm" paraqiten në pasqyrën Aneks nr 1, bashkëlidhur.

Konstatimi: Nga auditimi rezultoi se nga verifikimi i analitikeve të llogarisë 468 "Debitorë të ndryshëm" e cila në fund të vitit 2023 paraqitet në vlerën 115,544,560 lekë, nuk janë përfshirë detyrimet për qira për shfrytëzim të fondit pyjor dhe kullosor për vlerën 2,206,200 lekë, me ndikim në informacionin kontabël që ofrojnë pasqyrat financiare në lidhje me plotësinë e vlerave të llogarive, në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr. 08, datë 09.03.2018 "Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme" i ndryshuar Kreu II pika 5.

Llogaria 4342 "Të tjera operacione me shtetin (të drejta)", në fund të vitit 2023 paraqitet në vlerën 44,612,861 lekë, e cila përfaqësojnë llogaritë e Klasës së 4 të Pasivit të Pasqyrës

Financiare të Pozicionit Financiar dhe nuk kuadron me Llogarinë 7206 “Financim i pritshëm nga buxheti” të Pasqyrës së Performancës Financiare e cila paraqitet në shumën 2,035,749 lekë.

Në mënyrë analitike paraqitet:

Emërtimi i llogarive	Vlera
Llogari 401-408 “Furnitor e llogari të lidhura me to”	16,567,853
Paga personeli llog. 42	20,115,974
Tatim mbi të ardhurat llog. 431	1,159,748
Sigurime shoqërore llog.435	4,009,234
Sigurime shëndetësore llog.436	2,760,052
Totali	44,612,861

Konstatimi: Gjendja e llogarisë 4342 “Të tjera operacione me shtetin (të drejta)”, në fund të vitit 2023 paraqitet në vlerën 44,612,861 lekë, e cila përfaqëson llogaritë e Klasës së 4 të Pasivit të Pasqyrës Financiare të Pozicionit Financiar dhe nuk kuadron me Llogarinë 7206 “Financim i pritshëm nga buxheti” të Pasqyrës së Performancës Financiare e cila paraqitet në shumën 2,035,749 lekë, në kundërshtim me udhëzimin e MFE nr. 08, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësisve të Qeverisjes së Përgjithshme”, Kreu III. “Procedurat për përgatitjen, paraqitjen dhe konsolidimin e pasqyrave financiare në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” i ndryshuar, pika 32.

Llogaria 486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme” në fund të vitit 2023 paraqitet në vlerën 2,035,749 lekë, vlera e kësaj llogarie, përfaqëson detyrime për shpenzime të kryera, por të pa financuara në vitin ushtrimor. Gjatë vitit 2023 ka patur një pakësim të kësaj llogarie, pasi janë likuiduar një pjesë e konsiderueshme e këtyre detyrimeve në vlerën 7,941,644 lekë.

Aktivët Afatgjatë jomateriale (AAJM)

Llogaritë e Klasës 20 “Aktivët Afatgjatë Jo materiale”, përbëhen nga llog.202 “Studime dhe kërkime”, në aktiv të bilancit paraqitet në vlerën neto në mbyllje të vitit 2022 në shumën prej 15,322,571 lekë dhe në mbyllje të vitit 2023 në vlerën 18,426,216 lekë. Ndërsa sipas Formatit 7/b “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjatë (kosto historike)” gjëndja paraqitet në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 26,959,038 lekë dhe në mbyllje të vitit 2023 në vlerën prej 32,361,069 lekë, ku shtesa prej 5,402,031 lekë i përket projekteve të blera gjatë vitit 2023. Sipas të dhënave kontabël, kjo llogari është e analizuar për 34 artikuj kontabël.

Aktivët e afatgjatë materiale (AAM)

Llogaria 210 “Toka, troje Terrene” paraqitet me vlerë neto si në mbyllje të vitit 2022 dhe në mbyllje të vitit 2023 në shumën totale prej 18,475,912 lekë. Ndërsa sipas Formatit 7/b “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjatë (kosto historike)” si në mbyllje të vitit 2022 dhe në mbyllje të vitit 2023 në të njëjtën vlerë prej 18,475,912 lekë. Sipas të dhënave kontabël, kjo llogari është e analizuar për 14 artikuj kontabël.

Llogaria 211 “Pyje, Plantacione” paraqitet me vlerë neto si në mbyllje të vitit 2022 dhe në mbyllje të vitit 2023 në vlerën 4,662,464 lekë. Ndërsa sipas Formatit nr.7/B “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjatë (kosto historike)” si në mbyllje të vitit 2022 dhe në mbyllje të vitit 2023 paraqitet në vlerë të njëjtë prej 4,662,464 lekë.

Konstatimi: Nga auditimi ka rezultuar se referuar analizës së inventarit kontabël të kësaj llogarie konstatohet se, në të është kontabilizuar vlera prej 4,662,464 lekë që i përket (Projekti Bankës Botërore për sistemimin e Pyjeve, Kullotave e plantacioneve) që nuk i përket klasifikimit të kësaj llogarie kontabël, por i përket klasifikimit kontabël të llogarisë 202 “Studime e kërkime”, me ndikim në informacionin kontabël që ofrojnë pasqyrat financiare në lidhje me plotësinë e vlerave të Aktiveve Afatgjatë Materiale, të numrit për efekt të inventarit fizik dhe të llogaritjes së

amortizimit. Këto veprime janë në kundërshtim me UMF nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar pikat 26, 28, 30, 74 dhe 85, Udhëzimin e MFE nr. 08, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësisve të Qeverisjes së Përgjithshme” i ndryshuar, Kreu II pika 5, 36 dhe Kreu III pika 30

Llogaria 212 “Ndërtesa konstruksione” paraqitet me vlerë neto në mbyllje të vitit 2023 në shumën totale prej 653,344,802 lekë. Ndërsa sipas Formatit 7/b “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)” në mbyllje të vitit 2022 në vlerën prej 934,289,736 lekë dhe në vitin 2023 në vlerën 941,277,988 lekë. Pra kemi rritje në vlerën 6,988,252 lekë, që përbëhet shtesa me pagesë nga rritja e AAGJM për:

Objekti “Rikonstruksion i shkallëve hyrëse të Bashkisë Librazhd”, në vlerën 859,633 lekë.

Objekti “Kapanoni FOODHUP”, në vlerën 1,992,580 lekë.

Objekti “Hidroizolim i shkollave e institucione Bashkia Librazhd”, në vlerën 3,705,103 lekë.

Mbikëqyrje e shkollave në vlerën 430,936 lekë.

Sipas të dhënave kontabël, kjo llogari është e analizuar për 211 artikuj kontabël.

Konstatimi: Nga auditimi u konstatua se gjendja kontabël (kosto historike) e llogarisë 212 “Ndërtesa konstruksione” është e analizuar për 211 objekte (aktive) në vlerën 941,277,988 lekë, nga verifikimi i analitikëve të kësaj llogarie rezulton se shtesat për rikonstruksionin e tyre nuk i janë bashkuar vlerës fillestare të aktivitetit por janë trajtuar si aktive më vete. Trajtimi i tyre si aktive më vete ka ndikim në informacionin kontabël, që ofrojnë pasqyrat financiare në lidhje me plotësinë e vlerave të Aktiveve Afatgjata Materiale, të numrit për efekt të inventarit fizik të tyre dhe të llogaritjes së amortizimit. Këto veprime janë në kundërshtim me UMF nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar pikat 26, 28, 30, 74 dhe 85, UMFE nr. 08, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësisve të Qeverisjes së Përgjithshme” i ndryshuar, Kreu II pika 5, dhe Kreu III pika 30.

Llogaria 213 “Rrugë rrjete vepra ujore” paraqitet me vlerë neto në mbyllje të vitit 2023, në shumën totale prej 1,165,596,731 lekë.

Ndërsa sipas Formatit 7/b “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)” në mbyllje të vitit 2023 në vlerën prej 3,509,000,652 lekë dhe në vitin 2022 në vlerën 3,397,109,919 lekë. Pra kemi rritje në vlerën 111,890,733 lekë, që përbëhet shtesa me pagesë nga rritja e AAGJM, për rikonstruksion mbikëqyrje dhe ndërtime për objekte si më poshtë:

Objekti “Zgjerim trotuari rruga Arbëria”, në vlerën 5,915,053 lekë.

Objekti “Rehabilitim i shesheve midis pallateve lagja Sheh”, në vlerën 6,695,528 lekë.

Objekti “Rikonstruksion i tregut të qytetit”, në vlerën 2,974,194 lekë.

Objekti “Blerje tuba për kanalet vaditëse”, në vlerën 1,908,792 lekë.

Objekti “Riparime të pjesshme të kanaleve vaditëse”, në vlerën 3,950,505 lekë dhe mbikëqyrje kanal vaditës në vlerën 92,160 lekë.

Objekti “Ndërtim Centrali parku Qendrore faza e 2”, në vlerën 13,467,178 lekë dhe kolaudim në vlerën 57,000 lekë.

Objekti “Rikonstruksion rrugë rurale dhe vepra arti Bashkia Librazhd 2023”, në vlerën 14,117,638 lekë dhe mbikëqyrje në vlerën 329,198 lekë.

Objekti “Furnizim vendosje barriera mbrojtëse qytetit”, në vlerën 3,594,120 lekë.

Objekti “Ndërtim këndi sportiv shkolla e mesme Orenjë”, në vlerën 4,622,977 lekë.

Objekti “Ndërtim ure beli në Zallin e madh Orenjë”, në vlerën 4,835,226 lekë.

Objekti “Ndërtim ujësjellësi Polis-Gostimë”, në vlerën 49,223,226 lekë.

Mbikëqyrje “Ndërtim Bazamenti Përroi Rinas”, në vlerën 108,000 lekë.

Sipas të dhënave kontabël, kjo llogari është e analizuar për 378 artikuj kontabël.

Konstatimi: Nga auditimi u konstatua se gjendja kontabël (kosto historike) e llogarisë 213 “Rrugë rrjete vepra ujore” është e analizuar për 378 objekte (aktive) në vlerën 3,509,651 lekë, nga verifikimi i analitikëve të kësaj llogarie rezulton se shtesat për rikonstruksionin, mbikëqyrjen dhe kolaudimin e tyre nuk i janë bashkuar vlerës fillestare të aktivitetit por janë trajtuar si aktive më vete. Trajtimi i tyre si aktive më vete ka ndikim në informacionin kontabël, që ofrojnë pasqyrat financiare në lidhje me plotësinë e vlerave të Aktiveve Afatgjata Materiale, të numrit për efekt të inventarit fizik të tyre dhe të llogaritjes së amortizimit. Këto veprime janë në kundërshtim me UMF nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar pikat 26, 28, 30, 74 dhe 85, UMFE nr. 08, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme” i ndryshuar, Kreu II pika 5, dhe Kreu III pika 30.

Llogaria 214 “Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune” paraqitet me vlerë neto në mbyllje të vitit 2023 në shumën totale prej 20,596,450 lekë.

Ndërsa sipas Formatit 7/a “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)” në mbyllje të vitit 2023 në vlerën prej 43,544,650 lekë dhe në vitin 2022 në vlerën 26,203,611 lekë, për gjatë vitit 2023 janë shtuar nga blerjet me pagesë në vlerën 17,341,039 lekë, për objektet “Instalim kamera sigurie në rrugë kryesore”, në vlerën 14,636,280 lekë, “Blerje dhe instalim kaldaje për shkollën 9-vjeçare “ Marrakë Plane”, në vlerën 1,162,512 lekë dhe blerje makineri e pajisje në vlerën 1,542,247 lekë.

Llogaria 215 “Mjete transporti”. Kjo llogari paraqet vlerën e mjeteve të transportit në pronësi të Bashkisë më datë 31.12.2023 në shumën 31,569,033 lekë, (në vlerë neto).

Ndërsa sipas Formatit 7/b “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)” në mbyllje të vitit 2023, në vlerën prej 92,727,989 lekë dhe në vitin 2022 në vlerën 87,442,951 lekë, kemi rritje për vlerën 5,285,038 lekë për Blerje makinë tipi Foristradë SVU Tucson në vlerën 3,468,000 lekë, blerje pjesë ndërrimi, riparime dhe goma, në vlerën 1,817,037 lekë.

Konstatimi: Nga auditimi ka rezultuar se shtesat për blerje pjesë ndërrimi, riparimin dhe blerje gomash, nuk janë bashkuar vlerës së mjetit për ta reflektuar si shtesë të inventarit kontabël të mjeteve të transportit kjo ka sjellë që inventari kontabël i llogarisë 215 “Mjete transporti”, të paraqitet më pak në vlerën 1,017,038 lekë, me ndikim në informacionin kontabël që ofrojnë pasqyrat financiare në lidhje me plotësinë e vlerave të Aktiveve Afatgjata Materiale, të numrit për efekt të inventarit fizik të tyre dhe të llogaritjes së amortizimit. Këto veprime janë në kundërshtim me UMF nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar pikat 26, 28, 30, 74 dhe 85, UMFE nr. 08, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme” i ndryshuar, Kreu II pika 5, dhe Kreu III pika 30.

Llogaria kontabël 218 “Inventar ekonomik”. Kjo llogari përfaqëson inventarin ekonomik në përdorim nga shkollat, kopshtet, çerdhet, njësitë administrative të Bashkisë. Sipas pasqyrave financiare gjendja e llogarisë 218 “Inventar ekonomik” në vlerën neto paraqitet në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 30,685,023 lekë dhe në mbyllje të vitit 2023 në vlerën 28,414,326 lekë. Ndërsa sipas Formatit nr.7/B “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)” paraqitet në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 78,192,249 lekë dhe në mbyllje të vitit 2023 në vlerën kontabël 82,058,557 lekë. Në këto gjendje përfshihet shtesa me pagesë në vlerën prej 3,866,308 lekë të pajisjeve, për të cilat ishin ndjekur procedurat financiare e ligjore për evidentimin e tyre. Ndërsa vlera e amortizimit e përlllogaritur është në shumën 53,644,231 lekë.

Inventarizimi i aktiveve për vitin 2023 Bashkia Librazhd.

Në lidhje me zbatimin e dispozitave ligjore për kryerjen e procedurave të inventarizimit të aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara dhe qarkulluese rezultoi se:

Bazuar në ligjin 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, ligjin nr. 10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, Udhëzimin nr.30, datë 27.12.2011 të Ministrisë së Financave “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar si dhe në zbatim të Urdhrit të Kryetarit të Bashkisë nr. 1114 datë 30.11.2023 “Për inventarizimin e aktiveve afatgjatë, afatshkurtër e materiale për periudhën 01.01.2023-31.12.2023”, është ngritur komisioni për të kryer inventarizimin fizik të aktiveve në përdorim, si dhe për të krahasuar gjendjen konkrete të aktiveve me gjendjen kontabël, për Bashkinë Librazhd komisioni i përbërë nga M. G. Kryetar, E. C., J. V., antarë, Nj/A Qendër R. Ç. Kryetar, A. Gj. dhe A. H., antarë, Nj/A Lunik A. K. Kryetarë, R. A. dhe Xh. B. antarë, Nj/A Orenjë Z. D. Kryetarë, B. K. dhe E. N., antarë, Nj/A Hotolisht F. M. Kryetar, A. P. dhe A. H. antarë, Nj/A Sterblevë A. K. Kryetar, J. V. dhe S. T. antarë dhe Nj/A Polis P. B. Kryetar, E. P. dhe D. B. antarë. Edhe pse ka dalë urdhri i mësipërm nga komisionet e inventarizimit nuk është hartuar dokumentacion mbi procesin e inventarizimit nuk janë mbajtur procesverbale me personat përgjegjës për inventarin e kryer si dhe nuk është hartuar raport përmbledhës për procesin e inventarizimit, veprime në kundërshtim me UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar, Kreu IV, pika 73, pika 74.

Konstatimi: Ka rezultuar se llogaritë e aktiveve afatgjatë e afatshkurtër materiale për periudhën 01.01.2022-31.12.2022, janë raportuar për gjendjen e tyre kontabël pa krahasuar me inventarin fizik pasi gjatë vitit nuk është kryer procesi i inventarizimit, në kundërshtim me UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar, Kreu IV, pika 73, pika 74, të UMFE nr. 08, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësisive të Qeverisjes së Përgjithshme” i ndryshuar, Kreu III, pika 30.

Llogaria 219 “Amortizimi i AAGJM & AAJM: Kjo llogari sipas pasqyrave financiare të Bashkisë Librazhd në fund të vitit 2023, paraqitet në vlerën (2,783,023,345) lekë. Krahasuar me vitin 2022 llogaria 219 “Amortizimi i aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara” paraqitet me shtesë prej (322,865,578) lekë.

Konstatime: Mbi kontabilizimin e Aktiveve afatgjata materiale, pa titull pronësie.

Nga auditimi ka rezultuar se, nga 603 objekte inventari të pasurive të paluajtshme me kosto historike në vlerën 4,468,754,552 lekë, në Bashkinë Librazhd 19 objekte inventari janë të pajisur me titull pronësie dhe 504 objekte inventari, nuk posedon titull pronësie, në kundërshtim me VKM nr. 510, datë 14.08.2001 “Për inventarizimin dhe hipotekimin e të gjitha pronave të paluajtshme dhe të luajtshme”, Kreu VI “Transferimi i pasurive dhe regjistrimi i pasurive të paluajtshme”, pika 1 dhe 2. Për rrjedhojë edhe kontabilizimi i aktiveve afatgjata materiale, nuk është mbështetur në dokumentacionin e duhur, në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 me ndryshime, Kapitulli III, pika 35.

Mbi rivlerësimin e aktiveve materiale afatgjata.

Nga auditimi ka rezultuar se vlera e aktiveve e paraqitur në Pasqyrën e Pozicionit Financiar, nuk paraqet “vlerën reale” të tyre, pasi nga ana e Bashkisë Librazhd, nuk është ndërmarrë asnjë procedurë rivlerësimi ndaj tyre, bazuar në SKK 5 “Aktivet afatgjata materiale dhe aktivet afatgjata jomateriale”, Paragrafi “Trajtimet kontabël për aktivet afatgjata materiale”, pika 23-32 “Modeli i rivlerësimit”. Vlerat fillestare, apo kostot historike të këtyre aktiveve rezultojnë sipas çmimeve të blerjes si dhe kostove të tjera të drejtpërdrejta, në periudhat përkatëse të krijimit, të

cilat referuar inventarit të llogarisë 212 “Ndërtesa dhe konstruksione” për 27 objekte (ndërtesa qendra shëndetësore, shkolla, etj) variojnë nga 1,000 lekë deri në 99,000 lekë. Kjo situatë ka sjellë që vlera e aktiveve të nënvlerësohet. Mosveprimet në lidhje me vlerësimin e aktiveve janë në kundërshtim me Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018, Kapitulli IV “Përgatitja dhe rregullat e plotësimit të pasqyrave financiare vjetore të konsoliduara”, pika 105 “Hapat që ndiqen për konsolidimin e pasqyrës së pozicionit financiar”.

PASIVET (DETYRIMET)

Pasivet Afatshkurtra

Llogaritë e klasës 4, në pasiv të Pasqyrës së Pozicionit Financiar, janë llogari të pagueshme ato paraqesin detyrimet e Bashkisë Librazhd më 31.12.2023, kundrejt furnitorëve, pagat e punonjësve të muajit dhjetor 2023, detyrimet kundrejt tatimeve, sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore të muajit dhjetor 2023, kreditorë për mjete në ruajtje të cilat kryesisht kanë të bëjnë me garancitë e kontratave, kreditorë të ndryshëm etj., si më poshtë:

Llogaria 401-408 “Furnitorë e llogari të lidhura me to”, në fund të vitit 2023 është në vlerën 16,567,853 lekë, paraqet gjendjen e faturave të pa likuiduara nga Bashkia Librazhd më 31.12.2023.

Sipas analizës së gjendjes së kësaj llogarie rezulton se ajo përbëhet nga 32 fatura të palikujduara për mallra dhe shërbime kundrejt 32 furnitorëve në vlerën 15,567,853 lekë, të dhënat në pasqyrën Aneks nr. 2, bashkëlidhur.

Llogaria 42, “Detyrime ndaj personelit”, sipas pasqyrave financiare të paraqitura pranë Bashkisë Librazhd, paraqitet në vlerën 20,115,974 lekë dhe përfaqëson vlerën e pagave të muajit dhjetor për t’u paguar në muajin janar të vitit pasardhës.

Llogaria 431, “Detyrime ndaj shteti për tatim taksa”, paraqitet në vlerën 1,159,748 lekë dhe përfaqëson vlerën për t’u paguar për taksa e tatime ndaj shtetit për muajin dhjetor.

Llogaria 435, “Sigurime shoqërore” dhe llogaria 436 “Sigurime shëndetësore” paraqet vlerën e pa paguar për sigurime shoqërore e shëndetësore për pagat e muajit dhjetor 2023 që paguhet në muajin janar 2024 dhe janë përkatësisht në vlerat 4,009,234 lekë dhe 2,760,052 lekë.

Llogaria 466 “Kreditorë për mjete nën ruajtje”, përfshin garancitë e ngurtësuara për investime të kryera. Gjendja e kësaj llogarie paraqitet në mbyllje të vitit 2023 në vlerën 47,340,416 lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 39,305,272 lekë. Për këtë gjendje të llogarisë 466 “Kreditorë për mjete nën ruajtje”, është bërë raportimi në degën e Thesarit Librazhd në mënyrë analitike, lëvizjet e kësaj llogarie paraqiten në Formatin nr. 3 Pasqyra e flukseve monetare ku gjatë vitit 2023 janë ngurtësuar fonde për garanci punimesh në vlerën 20,956,740 lekë dhe janë likuiduar për objekte të marra në dorëzim garanci punimesh në vlerën 12,921,596 lekë, të analizuara paraqiten në pasqyrën Aneks nr. 3, bashkëlidhur.

Konstatimi: Nga auditimi i pasqyrave financiare viti 2023, rezulton se llogaria 466 “Kreditorë për mjetet në ruajtje” është për vlerën kontabël 47,340,416 lekë e rakorduar me Degën e Thesarit. Nga analiza e kësaj llogarie, konstatohet se janë të ngurtësuar fonde për vlerën 26,383,676 lekë të cilat i përkasin ngurtësimeve të viteve 2021 e përpara, duke ju kaluar afati i garancisë, për të cilat Bashkia nuk ka kryer asnjë veprim sipas kushteve të kontratës për c’bllokimin e këtyre fondeve dhe përdorimin e tyre për interes publik. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me udhëzimin e MFE nr. 08, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, i ndryshuar Kap. III, pikat 29, 30, 39, 50 dhe UKM nr. 3, datë 15.02.2011 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar, Kap. II, pika 10

Llogaria 467 “Kreditorë të ndryshëm”, paraqiten faturat e pa likuiduara shërbime të cilat për vitin 2023 paraqiten në shumën 2,035,749 lekë, të analizuara paraqiten në pasqyrën Aneks nr. 4, bashkëlidhur.

Llogaria 4341 “Operacione me shtetin (detyrime)”, paraqiten paraqitet në mbyllje të vitit 2023 në vlerën 115,663,168 lekë, vlera të cilat rakordojnë me gjendjet e llogarisë kundërparti 468 “Debitorë të ndryshëm” në aktiv të bilancit.

Analizë: Formati nr.2 “Pasqyra e performancës financiare” paraqet llogaritë e të ardhurave dhe shpenzimeve me klasifikim sipas natyrës ekonomike.

Analiza e llogarive të të ardhurave për vitin 2023, të cilat në total janë në vlerën 1,184,388,923 lekë, si dhe referuar akt-rakordimit me Degën e Thesarin Librazhd paraqitet më poshtë:

Gjendja e llogarisë sintetike 70 “Të ardhurat nga nga taksat dhe tatimet “ paraqitet në bilanc për vitin 2023 në vlerën 74,537,529 lekë, i cili kuadron me Aktrakordimin me Thesarin në këtë zë të ardhurash sipas kodifikimit të Thesarit.

-Gjendja e llogarisë analitike 7000 “*Tatim mbi të ardhurat personale*” pasqyrohet në bilanc për vitin 2023 në vlerën 12,206,635 lekë e cila e cila rakordon me të njëjtin zë në aktrakordimin me thesarin.

- Gjendja e llogarisë analitike 7002 “*Tatim mbi Biznesin e vogël*” pasqyrohet në bilanc për vitin 2023 në vlerën 90,464 lekë e cila rakordon me të njëjtin zë në aktrakordimin me thesarin.

- Gjendja e llogarisë 7020 “*Tatim mbi pasurinë e paluajtshme*” pasqyrohet në bilanc për vitin 2023 në vlerën 18,646,617 lekë e cila rakordon me të njëjtin zë në aktrakordimin me thesarin.

- Gjendja e llogarisë 7029 “*Të tjera tatime mbi pasurinë*” pasqyrohet në bilanc për vitin 2023 në vlerën 955,998 lekë e cila rakordon me të njëjtin zë në akt akordimin me thesarin.

- Gjendja e llogarisë 7033 “*Taksë mbi përdorimin e mallrave e lejim veprimtarie*” pasqyrohet në bilanc për vitin 2023 në vlerën 13,471,341 lekë e cila rakordon me të njëjtin zë në akt akordimin me thesarin.

- Gjendja e llogarisë 7035 “*Taksa vendore mbi përdorimin e mallrave e lejim veprimtarie*” pasqyrohet në bilanc për vitin 2023 në vlerën 29,135,619 lekë e cila përfshin taksa e pastrimit, gjelbërimit, ndriçimit, zënie hapësire publike, qiratë për truallin etj.

- Gjendja e llogarisë 705 “*Taksa rrugës*” pasqyrohet në bilanc për vitin 2023 në vlerën 4,605 lekë.

- Gjendja e llogarisë 708 “*të tjera tatim e taksa kombëtare*” pasqyrohet në bilanc për vitin 2023 në vlerën 26,250 lekë.

- Gjendja e llogarisë 71 “Të ardhurat jo tatimore” paraqitet në bilancin e 2023 në vlerën 68,578,515 lekë, i cila kuadron me Akt rakordimin me Thesarin në këtë zë të ardhurash sipas kodifikimit të Thesarit.

Gjendja e llogarisë 7109 “*Të ardhura te tjera jo tatimore nga ndërmarrjet dhe pronësia*” paraqitet në bilancin e 2023 në vlerën 35,484,149 lekë, e cila përfshin taksën e ndikimit në infrastrukturë, taksën e tokës, qiratë nga kullotat dhe nga pyjet i cili kuadron me Akt akordimin me Thesarin në këtë zë të ardhurash sipas kodifikimit të Thesarit.

Gjendja e llogarisë 7110 “*Tarifa administrative dhe rregullatorë*” paraqitet në bilancin e 2023 në vlerën 22,515,452 lekë.

Gjendja e llogarisë 7111 “*Të ardhura sekondare e pagesa shërbimesh*” paraqitet në bilancin e 2023 në vlerën 8,500,976 lekë.

Gjendja e llogarisë 7113 “*Të ardhura nga shitja e mallrave e shërbimeve*” paraqitet në bilancin e 2023 në vlerën 147,600 lekë.

Gjendja e llogarisë 7115 “*Gjoha kamatëvonesa sekuestrime e zhdëmtime*” paraqitet në bilancin e 2023 në vlerën 1,841,590 lekë.

Gjendja e llogarisë 719 “*Të tjera të ardhura jo tatimore*” paraqitet në bilancin e 2023 në vlerën 88,748 lekë.

Grande korente të brendshme, në vlerën 1,041,272,879 lekë.

Analiza e shpenzimeve në vitin 2023 , të cilat në total janë në vlerën 1,008,837,746 lekë paraqitet më poshtë:

Gjendja e llogarisë 600 *‘Paga, shpërblime e të tjera personeli’* për vitin 2023, paraqitet në bilanc në vlerën 271,965,318 lekë.

Gjendja e llogarisë 601 *‘Kontribute për sigurime’* për vitin 2023, paraqitet në bilanc në vlerën 44,624,664 lekë.

Gjendja e llogarisë 602 *‘Blerje mallra e shërbime’* paraqitet në bilanc për vitin 2023 në vlerën 125,207,137 lekë.

Gjendja e llogarisë së fondeve 604 *‘Transferime korente te brendshme’* paraqitet në bilanc për vitin 2023 në vlerën 20,079,057 lekë.

Gjendja e llogarisë së fondeve 606 *‘Transferime për Buxhetet familjare e Individë’* paraqitet në bilanc për vitin 2023 në vlerën 547,884,216 lekë.

Për vitin 2021 totali i te ardhurave në vlerë është 1,184,388,923 lekë dhe totali shpenzimeve është 1,008,837,746 lekë. Diferenca e tyre në vlerën 175,551,177 lekë rakordon me gjendjen e llog. 85 *‘Rezultatin e ushtrimit’*.

Pasqyra e flukseve monetare (F3)

Pasqyra e Flukseve Monetare, paraqet rrjedhën e likuiditeteve dhe gjendjen më datë 31.12.2023.

Nr Rubrike	PERMBAJTJA	Periudha Raportuese	Periudha Paraardhëse
(b)	(c)	(1)	(2)
I	Veprimtaritë e shfrytëzimit	28,085,262	164,049,295
II	Veprimtaritë e investimeve	32,438,589	14,235,578
III	Transferta e te tjera	-33,982,093	-9,743,151
VI	Teprica e Likuiditeteve ne fund te vitit ushtrimor	223,010,201	266,888,355

Nga kontrollet e kryera rezultoi se teprica e llogarisë së likuiditeteve më datë 31.12.2023, e paraqitur në këtë pasqyrë rezulton në shumën 223,010,201 lekë dhe kuadron me tepricën e likuiditeteve të paraqitur në Pasqyrën e Pozicionit Financiar, në Aktiv "Mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre" e cila paraqitet në shumën 223,010,201 lekë.

Ligjshmëria dhe saktësia e veprimeve dhe ngjarjeve të kryera nëpërmjet arkës, bankës dhe magazinës.

Veprimet me arkë kryhen vetëm për rastet e arkëtimit të taksave dhe tarifave vendore në njësitë administrative dhe pagesat e kopshteve dhe çerdheve, transaksionet financiare të kryera nëpërmjet bankës janë regjistruar në mënyrë kronologjike në ditarin e bankës në bazë të urdhërshpenzimeve të cilat ishin të nënshkruara nga nëpunësi autorizues dhe zbatues të konfirmuar nga nëpunësi i Thesarit dhe të vulosura nga të dy palët.

Përpilimi i urdhërshpenzimeve ishte i bazuar në dokumentet vërtetues dhe autorizues sipas natyrës së shpenzimit si urdhër prokurimi, procesverbale, oferta, kontrata, fatura e furnitorit, preventiva, situacione, fletëhyrje, listpagesa, deklaratimet e tatimit mbi të ardhurat, formularët e përlllogaritjeve të kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore si nga punëdhënësi dhe nga punonjësi etj. Vlerat e shënuara në urdhërshpenzim përputhen me vlerat e këtyre dokumenteve financiare që mbështesin këtë shpenzim.

Kontabilizimi i veprimeve ekonomike nëpërmjet bankës është bërë sipas natyrës së shpenzimeve.

-Mbajtja e kontabilitetit për hyrjet dhe daljet e materialeve bëhej në ditarin e magazinës, në formë dokumentare, regjistrim kontabël bëhej sipas dokumentacionit bazë si fletë-hyrjeve dhe fletë-daljeve të magazinës dhe faturave të shitësit.

Për veprimet dhe mosveprimet e trajtuara më sipër mban përgjegjësi znj A. A.me detyrë Ish Drejtor i Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar NZ, (Hartuesi i llogarive kontabël).

III. GJETJE REKOMANDIME.

A. MASA ORGANIZATIVE.

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi konstatohet se gjendja e llogarisë 4342 “*Të tjera operacione me shtetin (të drejta)*”, në fund të vitit 2023 paraqitet në vlerën 44,612,861 lekë, e cila përfaqëson llogaritë e Klasës së 4 të Pasivit të Pasqyrës Financiare të Pozicionit Financiar dhe nuk kuadron me Llogarinë 7206 “*Financim i pritshëm nga buxheti*” të Pasqyrës së Performancës Financiare e cila paraqitet në shumën 2,035,749 lekë, në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr. 08, datë 09.03.2018 “*Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme*”, Kreu III. “*Procedurat për përgatitjen, paraqitjen dhe konsolidimin e pasqyrave financiare në njësitë e qeverisjes së përgjithshme*” i ndryshuar, pika 32. (Më hollësisht trajtuar në pikën 1, faqe 13-22 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

1.1. Rekomandimi: Drejtoria e Financës, Bashkia Librazhd, të marrë masa për paraqitjen e saktë të vlerës së llogarisë 7206 “*Financim i pritshëm nga buxheti*” të Pasqyrës së Performancës Financiare, e cila paraqitet e nënvlerësuar për vlerën 42,577,112 lekë, për të dhënë një informacion kontabël të besueshëm.

Me mbylljen e pasqyrave financiare viti 2024

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi ka rezultuar se llogaritë e aktiveve afatgjatë e afatshkurtër materiale për periudhën 01.01.2022 - 31.12.2022, janë raportuar për gjendjen e tyre kontabël pa krahasuar me inventarin fizik pasi gjatë vitit nuk është kryer procesi i inventarizimit, në kundërshtim me Udhëzimin e MF nr. 30, datë 27.12.2011 “*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*”, i ndryshuar, Kreu IV, pika 73, pika 74, të Udhëzimit të MFE nr. 08, datë 09.03.2018 “*Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme*” i ndryshuar, Kreu III, pika 30. (Më hollësisht trajtuar në pikën 1, faqe 13-22 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

2.1.Rekomandimi: Bashkia Librazhd, Drejtoria e Financës dhe NA të monitorojë procesin për inventarizimin fizik në fund të periudhës me qëllim krahasimin e gjendjes kontabël me gjendjen fizike dhe për diferencat e konstatuara të bëjë sistemimet në kontabilitet dhe të nxjerrë përgjegjësitë për mungesat e konstatuara.

Brenda periudhës 31.12.2024

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi ka rezultuar se sipas Formatit nr.7/B “*Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)*” llogaria 211 “*Pyje, Plantacione*” paraqitet në vlerën 4,662,464 lekë dhe llogaria 202 “*Studime e kërkime*” në vlerën 32,361,069 lekë. Referuar analizës së inventarit kontabël të këtyre llogarive konstatohet se, në llogarinë 211 “*Pyje, Plantacione*” është kontabilizuar gabim vlera prej 4,662,464 lekë për Projektin Bankës Botërore për sistemimin e Pyjeve, Kullotave e plantacioneve, që nuk i përket klasifikimit të kësaj llogarie kontabël, por i përket klasifikimit kontabël të llogarisë 202 “*Studime e kërkime*”, me ndikim në informacionin kontabël që ofrojnë pasqyrat financiare në lidhje me plotësinë e vlerave të Aktiveve Afatgjata Materiale, të numrit për efekt të inventarit fizik dhe të llogaritjes së amortizimit. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin e MF nr. 30 datë 27.12.2011 “*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*” i ndryshuar pikat 26, 28, 30, 74 dhe 85, Udhëzimin e MFE nr. 08, datë 09.03.2018 “*Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme*” i ndryshuar, Kreu II pika 5, 36 dhe Kreu III pika 30. (Më hollësisht trajtuar në pikën 1, faqe 13-22 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

3.1 Rekomandimi: Drejtoria e Financës, Bashkia Librazhd, bazuar në dokumentet financiare e ligjore të saktësojë aktivet e hyra në vite për të verifikuar, saktësuar e analizuar vlerat e

paraqitura në pasqyrat financiare dhe të bëjë sistemimet përkatëse në llogaritë 211 “Pyje, Plantacione” dhe llogarinë 202 “Studime e kërkime”.

Me mbylljen e pasqyrave financiare viti 2024

4. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se gjendja kontabël (kosto historike) e llogarisë 212 “Ndërtesa konstruksione” është e analizuar për 211 objekte (aktive) në vlerën 941,277,988 lekë dhe llogarisë 213 “Rrugë rrjete vepra ujore” është e analizuar për 378 objekte (aktive) në vlerën 3,509,000,652 lekë. Nga verifikimi analitik të këtyre llogarive rezulton se shtesat për rikonstruksionin e tyre nuk i janë bashkuar vlerës fillestare të aktivit por janë trajtuar si aktive më vete. Trajtimi i tyre si aktive më vete ka ndikim në informacionin kontabël, që ofrojnë pasqyrat financiare në lidhje me plotësinë e vlerave të Aktiveve Afatgjata Materiale, të numrit për efekt të inventarit fizik të tyre dhe të llogaritjes së amortizimit. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin e MF nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar, pikat 26, 28, 30, 74 dhe 85, Udhëzimin e MFE nr. 08, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njërive të Qeverisjes së Përgjithshme”, i ndryshuar, Kreu II pika 5, dhe Kreu III pika 30. (Më hollësisht trajtuar në pikën 1, faqe 13-22 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

4.1 Rekomandimi: Drejtoria e Financës, Bashkia Librazhd, të marrë masa për saktësimin e inventarit kontabël të llogarive 212 “Ndërtesa konstruksione” dhe 213 “Rrugë rrjete vepra ujore”, të saktësojë vlerat e këtyre objekteve duke shtuar shpenzime për rikonstruksionin dhe mirëmbajtjen e tyre në vite.

Me mbylljen e pasqyrave financiare viti 2024

5. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi ka rezultuar se, nga 603 objekte inventari të pasurive të paluajtshme me kosto historike në vlerën 4,468,754,552 lekë, Bashkia Librazhd për 19 objekte disponon çertifikatë pronësie dhe për 584 objekte inventari, nuk posedon titull pronësie, në kundërshtim me VKM nr. 510, datë 14.08.2001 “Për inventarizimin dhe hipotekimin e të gjitha pronave të paluajtshme dhe të luajtshme”, Kreu VI “Transferimi i pasurive dhe regjistrimi i pasurive të paluajtshme”, pika 1 dhe 2. Për rrjedhojë edhe kontabilizimi i aktiveve afatgjata materiale, nuk është mbështetur në dokumentacionin e duhur, në kundërshtim me Udhëzimin e MF nr. 30, datë 27.12.2011 me ndryshime, Kapitulli III, pika 35. (Më hollësisht trajtuar në pikën 1, faqe 13-22 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

5.1. Rekomandimi: Bashkia Librazhd, të marrë masa të menjëhershme, që nëpërmjet strukturave të saj, të përgatisë dosjet me dokumentacionin e duhur për regjistrim në ASHK dhe nëpërmjet Drejtorisë së Financës të përlllogaritë kostot për kryerjen e këtij shërbimi, buxhetimin dhe burimet e financimit, me qëllim pajisjen sa më parë të pasurive të paluajtshme me titull pronësie.

Në vijimësi

6. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi ka rezultuar se vlera e aktiveve e paraqitur në Pasqyrën e Pozicionit Financiar, nuk paraqet “vlerën reale” të tyre, pasi nga ana e Bashkisë Librazhd, nuk është ndërmarrë asnjë procedurë rivlerësimi ndaj tyre, bazuar në SKK 5 “Aktivet afatgjata materiale dhe aktivet afatgjata jomateriale”, Paragrafi “Trajtimet kontabël për aktivet afatgjata materiale”, pika 23-32 “Modeli i rivlerësimit”. Vlerat fillestare, apo kostot historike të këtyre aktiveve rezultojnë sipas çmimeve të blerjes si dhe kostove të tjera të drejtpërdrejta, në periudhat përkatëse të krijimit, të cilat referuar inventarit të llogarisë 212 “Ndërtesa dhe konstruksione” për 27 objekte (ndërtesa qendra shëndetësore, shkolla, etj.) variojnë nga 1,000 lekë deri në 99,000 lekë. Kjo situatë ka sjellë që vlera e aktiveve të nënvlerësohet. Mosveprimet në lidhje me vlerësimin e aktiveve janë në kundërshtim me Udhëzimin e MF nr. 8, datë 09.03.2018, Kapitulli IV “Përgatitja dhe rregullat e plotësimit të pasqyrave financiare vjetore të konsoliduara”, pika

105 “Hapat që ndiqen për konsolidimin e pasqyrës së pozicionit financiar”. (Më hollësisht trajtuar në pikën 1, faqe 13-22 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

6.1. Rekomandimi: Bashkia Librazhd të marrë masa të menjëhershme, për kryerjen e procedurave ligjore për rivlerësimin e aktiveve, pasqyrimin e tyre në kontabilitet me vlerë reale (referuar tregut), si dhe kryerjen e veprimeve kontabël referuar rezultatit (rritje apo ulje nga rivlerësimi), respektivisht në llogaritë përkatëse 21 “Aktive afatgjata materiale” dhe llogarisë 109 “Diferenca nga rivlerësimi”.

Në vijimësi

7. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i pasqyrave financiare viti 2023, rezulton se llogaria 466 “Kreditorë për mjetet në ruajtje” është për vlerën kontabël 47,340,416 lekë e rakorduar me Degën e Thesarit. Nga analiza e kësaj llogarie, konstatohet se janë të ngurtësuar fonde për vlerën 26,383,676 lekë të cilat i përkasin ngurtësimeve të viteve 2021 e përpara, duke ju kaluar afati i garancisë, për të cilat Bashkia nuk ka kryer asnjë veprim sipas kushteve të kontratës për c’bllokimin e këtyre fondeve dhe përdorimin e tyre për interes publik. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr. 08, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, i ndryshuar Kap. III, pikat 29, 30, 39, 50 dhe UKM nr. 3, datë 15.02.2011 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar, Kap. II, pika 10. Më hollësisht trajtuar në pikën 1, faqe 13-22 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

7.1. Rekomandimi: Drejtoria e Financës në Bashkinë Librazhd, për garancitë të cilat i përkasin ngurtësimeve të viteve 2021 e më parë (vlera 26,383,676 lekë), për të cilat nuk ka dokumentacion për përfitimin e tyre nga subjektet ose që janë në kushtet e parashkrimit, të procedojë sipas kërkesave ligjore pranë Degës së Thesarit, për rimarrjen e fondeve të ngurtësuar dhe përdorimin e tyre në interes publik.

Në vijimësi

C. MASA PËR ELIMIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E TË ARDHURAVE TË MUNGUARA.

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi rezultoi se në kredi të llogarisë 468 “Debitorë të ndryshëm”, nuk janë përfshirë detyrimet për qira për shfrytëzim të fondit pyjor dhe kullor për vlerën 2,206,200 lekë, me ndikim në informacionin kontabël që ofrojnë pasqyrat financiare në lidhje me plotësinë e vlerave të llogarive, në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr. 08, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësisve të Qeverisjes së Përgjithshme” i ndryshuar Kreu II pika 5. (Më hollësisht trajtuar në pikën 1, faqe 13-22 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

1.1. Rekomandimi: Drejtoria e Financës, Bashkia Librazhd, të kontabilizojë në llogarinë 468 “Debitorë të ndryshëm”, vlerën prej 2,206,200 lekë si e ardhur e munguar për detyrimet që kanë subjektet për qira për shfrytëzim të fondit pyjor dhe kullor, me qëllim paraqitjen e raportimit financiar sipas situatës reale të saj si dhe duke ndjekur të gjitha rrugët ligjore me qëllim arkëtimin e të ardhurave të munguara.

Menjëherë e në vijimësi

D. MASA PËR ARKËTIMIN E DETYRIMEVE PËR DEBITORËT.

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi dhe analiza e llog. 468 “Debitorë të ndryshëm” rezulton se në fund të vitit 2022 paraqitet në shumën 116,726,663 lekë, ndërsa për vitin 2023 në shumën prej 115,544,560 lekë. Gjatë vitit 2023 kemi ulje të debitorëve në vlerën 1,182,103 lekë, rezulton se nuk janë marrë masat e duhura për uljen e detyrimeve debitore dhe rritjen e performancës në

arkëtimin e tyre. Veprime të cilat nuk janë në përputhje me Udhëzimi e MFE nr.8, datë 9.3.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme" kreu III pika 32, Kreu II pika 2/a, b, pika 22, me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar, kreu II, neni 12, pika 3/g/gj. (Më hollësisht trajtuar në pikën 1, faqe 14-31, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

1.1. Rekomandimi: Drejtoria e Financës, Bashkia Librazhd, të ndjekë të gjitha rrugët administrative dhe ligjore për arkëtimin e debitorëve në fund të periudhës në vlerën 115,544,560 lekë.

Menjëherë e në vijimësi

E. MASA DISIPLINORE

Për punonjësit e ngarkuar me përgjegjësi në Raportin Përfundimtar të Auditimit, *nuk rekomandohet dhënia e masë disiplinore*, pasi masat janë ezauruar në auditimin e kryer për të njëjtën periudhë, sipas programit të auditimit nr. 32/1, datë 10.01.2024, të shprehura në **Vendimin e Kryetarit të KLSH nr. 83 datë 08.05.2024.**

Për sa më sipër paraqitet ky Raport Përfundimtar Auditimi.

KONTROLI I LARTË I SHTETIT



RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMI (TEMATIK)

“BASHKIA KRUIJË”

(Për pasqyrat pasqyrave financiare 2023)

Tiranë, Tetor 2024

Nr.	Përmbajtja	Faqe
I.	PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	4 - 6
1.	Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit....	
2.	Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve.....	
3.	Konkluzioni i përgjithshëm dhe Opinioni i auditimit.....	
II.	HYRJA	6 - 12
1.	Objektivat dhe qëllimi	
2.	Identifikimi i çështjes.....	
3.	Përgjegjësitë e strukturave drejtuese	
4.	Përgjegjësitë e audituesve.....	
5.	Kriteret e vlerësimit.....	
5.	Standardet e auditimit.....	
7.	Metodat e auditimit.....	
8.	Dokumentimi i auditimit.....	
III	PËRSHKRIMI AUDITIMIT	12 – 21
1.	Informacion i përgjithshëm mbi subjektin	12 – 13
2.	Përshkrimi i auditimit, sipas drejtimeve të auditimit	13 – 21
2.1	<i>Auditim mbi vlerësimin e raportimit financiar, për të arritur në opinionin në se pasqyrat financiare për vitin 2023, japin një paraqitje të vërtetë e të drejtë të pozicionit financiar, performancës financiare dhe fluksit të parasë, bazuar në kuadrin rregullator në fuqi.</i>	13 – 21
IV	GJETJE DHE REKOMANDIME	21-23
V	ANEKSE	23-29

SHKURTIME

KLSH	Kontrolli i Lartë i Shtetit.
MFK	Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli.
NA	Nëpunës Autorizues.
NZ	Nëpunës Zbatues.
AQT	Aktive të Qëndrueshme të Trupëzuara.
UMF	Udhëzim i Ministrisë së Financave
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave.
VKB	Vendim i Këshillit Bashkiak.
ISSAI	Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit.
INOTSAI	Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve Supreme të Auditimit.
ISA	Standardet Ndërkombëtare të Auditimit
IFAC	Federatës Ndërkombëtarë të Kontabilistëve
IPSAS	Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit të Sektorit Publik
NJA	Njësi Administrative.

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

a. Përshkrim i shkurtër për subjektin nën auditim.

Bashkia Krujë, si të gjitha njësitë e tjera të vetëqeverisjes vendore ka kuadrin legjislativ dhe operues, bazë e të cilave janë ligji nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” dhe ligji nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” i ndryshuar, krahas akteve të tjera ligjore, nënligjore dhe rregullatorë.

Rëndësia e auditimit financiar të Bashkisë Krujë për periudhën e aktivitetit 2023, krahas detyrimit kushtetues dhe ligjor që konsiston në kontrollin e përdorimit dhe mbrojtjes së fondeve shtetërore nga organet e pushtetit vendor, pra njësitë e vetëqeverisjes vendore janë subjekt i kontrollit nga Kontrolli i Lartë i Shtetit, sipas legjislacionit në fuqi, qëndron në të bërit sa më transparente të veprimtarisë menaxhuese dhe administruese, për të rritur përgjegjshmërinë dhe llogaridhënien e të zgjedhurve dhe administratës publike, në funksion të rritjes së mirëqenies së qytetarëve.

Buxheti i Bashkisë Krujë si të gjithë njësitë e qeverisjes vendore financohet nga të ardhurat e veta të krijuara në mënyrë të pavarur, nga transferta e pakushtëzuar e akorduar nga buxheti i shtetit për realizimin e funksioneve të veta dhe të përbashkëta, nga transfertat e kushtëzuara të akorduara nga buxheti i shtetit për realizimin e funksioneve të deleguara, nga transferta specifike për realizimin e funksioneve të reja, nga ndarja e taksave ndërkombëtare, donacione e burime të tjera të parashikuara në ligj.

b. Rëndësia e institucionit dhe auditimit të tij.

Auditimi i këtij institucioni çdo vit është detyrim ligjor në bazë të ligjit nr. 68/2017 datë 27.04.2017 “Për financat e qeverisjes vendore” nenit 50 “Auditi i jashtëm” pikat 1 dhe 2 në të cilat përcaktohet: “1. Veprimtaria financiare dhe zbatimi i buxhetit vjetor të njësisve të vetëqeverisjes vendore u nënshtrohen çdo vit auditimit të jashtëm. 2. Auditimi i jashtëm realizohet nga Kontrolli i Lartë i Shtetit ose auditues të tjerë ligjorë”. Gjithashtu ky auditim merr rëndësi të veçantë për arsye se, Bashkia Krujë si çdo njësi vendore administron, menaxhon dhe shpenzon fonde publike, pjesë e buxhetit të Bashkisë të miratuar nga Këshilli Bashkiak me burim financimi nga të ardhurat e realizuara nga taksapaguesit qytetarë dhe fondet e transferuara nga Buxheti i Shtetit.

c. Qëllimi i auditimit.

Qëllimi i këtij auditimi është dhënia e opinionit mbi pasqyrat financiare, për periudhën 01.01.2023 - 31.12.2023. Për të gjitha problematikat e konstatuara janë dhënë rekomandime për përmirësime me synim ndërmarrjen e masave dhe veprimeve korigjuese nga Bashkia Krujë. Në përmbushje të qëllimit të auditimit, janë shqyrtuar çështjet:

-Mbi vlerësimin e raportimit financiar, për të arritur në opinionin në se pasqyrat financiare për vitin 2023, japin një paraqitje të vërtetë e të drejtë të pozicionit financiar, performancës financiare dhe fluksit të parasë, bazuar në kuadrin rregullator në fuqi.

d. Metodologjia e përdorur dhe metodat e mbledhjes dhe analizimit të të dhënave.

Metodologjia e përdorur për kryerjen e këtij auditimi është mikse, sasiore dhe cilësore. Auditimi është kryer mbi bazë risku. Grupi i auditimit ka audituar transaksionet e likuidimeve nëpërmjet bankës dhe auditimin e blerjeve dhe investimeve për procedurat, ku vlera e investimit apo e blerjes është e konsiderueshme dhe paraqitja e tyre në pasqyrat financiare. Metodot e auditimit janë bazuar tek kombinimi i testeve të ndryshme të auditimit. Në varësi të çështjeve të auditimit dhe vlerësimit të audituesve, janë përdorur veçmas ose të kombinuara metodat dhe teknikat e mëposhtme verifikimi i transaksioneve, shqyrtimi i raporteve dhe dokumentacionit mbi kontabilizimin e veprimeve në llogarit përkatëse.

3. Nr. i gjetjeve dhe rekomandimeve. Në raportin përfundimtar janë formuluar 11 gjetje dhe rekomandime për masa organizative, 1 gjetje dhe rekomandime mungesë të ardhurash në shumën 63,154 mijë lekë dhe 1 gjetje dhe rekomandime për arkëtim debitorësh në vlerën 833,117 mijë lekë.

f. Paraqitja e gjetjeve kryesore. Disa nga problematikat e konstatuara lidhen me:

-Pasqyrimin e llogarive në pasqyrat financiare.

- Llogaria 468 “*Debitorë të ndryshëm*” është nënvlerësuar për vlerën 63,154,513 lekë, pasi në fund të vitit nuk janë kontabilizuar detyrimet e papaguara për taksën e ndikimit në infrastrukturë nga lejet e legalizimeve.

- Nga auditimi ka rezultuar se gjendja e llogarisë 4342 “*Të tjera operacione me shtetin (të drejta)*” e paraqitur në bilanc në vlerën 87,032,453, nuk kuadron me Llogarinë 7206 “*Financim i pritshëm nga buxheti*” që paraqitet në vlerën 813,698,481 lekë.

Llogaritë 212 “*Ndërtesa e Konstruksione*” dhe 213 “*Rrugë, rrjete, vepra ujore*”, nuk janë të analizuara, nuk ka një regjistër kontabël ku të specifikohen analitikët e këtyre zërave, si dhe nuk ka informacioni për secilin aktiv.

- Nga auditimi ka rezultuar se për Aktivevet Aftat Gjata Materiale, të pasqyrave financiare Bashkia Krujë, nuk posedon titull pronësie

- Nga auditimi është konstatuar se në llogaritë 431, “*Detyrime ndaj shteti për tatim taksa*”, e pasqyruar në bilanc për vlerën 2,595,717 lekë dhe 435, “*Sigurime shoqërore*” e pasqyruar për vlerën 9,771,380 lekë mbarten vlera për detyrime për tatim taksa në vlerën 1,167,003 lekë dhe sigurime shoqërore në vlerën 1,974,004 lekë që nuk janë të muajit dhjetor por detyrime të papaguara të periudhave të mëparshme.

-Nga analiza e llogarisë 466 “*Kreditorë për mjetet në ruajtje*”, konstatohet se janë të ngurtësuar fonde për vlerën 71,697,460 lekë të cilat i përkasin ngurtësimeve të viteve 2021 e përpara, duke ju kaluar afati i garancisë, për të cilat Bashkia nuk ka kryer asnjë veprim sipas kushteve të kontratës për c’bllokimin e këtyre fondeve dhe sistemimin e kësaj llogarie.

h. Paraqitja e rekomandimeve kryesore.

- Në hartimin e pasqyrave financiare:

-Drejtorja e Financës, Bashkia Krujë, të kontabilizojë vlerën prej 63,154,513 lekë si e ardhur e munguar për detyrimet që kanë subjektet për taksën e ndikimit në infrastrukturë nga lejet legalizimeve, si dhe të ndjekë të gjitha rrugët administrative dhe ligjore për saktësimin dhe arkëtimin e debitorëve, në vlerën 833,117,807 lekë.

-Drejtorja e Financës, Bashkia Krujë, të marrë masa për paraqitjen e saktë të vlerave të llogarive sipas pozicioneve për të dhënë një informacion kontabël të besueshëm.

-Drejtorja e Financës në Bashkinë Krujë, të marrin masa për mbylljen e procesit të inventarizimit të aktiveve të veta, të analizojë dhe të kryejë zbërthimin e dokumentacionit financiar e ligjor për nxjerrjen e të dhënave për aktivet e hyra në vite për të verifikuar, saktësuar e analizuar vlerat e paraqitura në pasqyrat financiare e në rast pasaktësish të bëhen sistemimet e nevojshme në kontabilitet e në inventarin fizik.

-Bashkia Krujë, të marrë masa të menjëhershme, që nëpërmjet strukturave të saj, të përgatisë dosjet me dokumentacionin e duhur për regjistrim në ASHK dhe nëpërmjet Drejtorisë së Financës të përlllogaritë kostot për kryerjen e këtij shërbimi, buxhetimin dhe burimet e financimit, me qëllim pajisjen sa më parë të pasurive të paluajtshme me titull pronësie.

-Drejtorja e Financës, Bashkia Krujë, të marrë masa për paraqitjen e saktë të vlerave të llogarive sipas pozicioneve për të dhënë një informacion kontabël të besueshëm.

-Drejtorja e Financës në Bashkinë Krujë, për garancitë të cilat i përkasin ngurtësimeve të viteve 2021 e më parë (vlera 71,697,460 lekë), për të cilat nuk ka dokumentacion për përfitimin e tyre nga subjektet ose që janë në kushtet e parashkrimit, të procedojë sipas kërkesave ligjore pranë Degës së Thesarit, për rimarrjen e fondeve të ngurtësuar dhe përdorimin e tyre në interes publik.

I.1. KONKLUZIONI DHE OPINIONI I AUDITIMIT

a. Opinioni i auditimit mbi pasqyrat financiare:

Grupi i auditimit të KLSH-së, ka audituar pasqyrat financiare të Bashkisë Krujë për vitin 2023, të cilat përfshijnë pasqyrat e pozicionit financiar, të performancës financiare, të ndryshimit të aktiveve, të fluksit të mjeteve monetare dhe shënimet shpjeguese. Auditimi ka përfshirë ekzaminimin, në bazë testimesh, të dokumenteve që mbështesin shumat dhe shpalosjet në pasqyrat financiare, ku u bë vlerësimi i parimeve kontabël të përdorura dhe vlerësimeve të bëra nga drejtuesit, si dhe vlerësimi i paraqitjes së përgjithshme të pasqyrave financiare.

*"Në opinionin tonë, pasi kemi marrë evidenca dhe dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit, pasqyrat financiare të subjektit Bashkia Krujë janë evidentuar devijime nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi të përshkruara në paragrafin e "Bazës për Opinionin", që në gjykimin profesional të audituesit të pavarur janë materiale por jo të përhapura dhe justifikojnë dhënien e një **opinionit të modifikuar, me rezervë**", e shprehur kjo në bazën për opinionin.*

Baza për opinionin e modifikuar, me rezervë:

Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA¹⁶). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen Përgjegjësitë e Audituesit për Pasqyrat Financiare. Ne jemi të pavarur nga Njësia shpenzuese Bashkia Krujë, në përputhje me kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare, si dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë. (ISA 700-ISSAI 1700).

Opinionin e dhënë e mbështesim në faktin se, pasqyra e pozicionit financiar, pasqyra e performancës financiare, pasqyra e ndryshimeve në kapital, pasqyra e flukseve e mjeteve monetare, si dhe shpjegimet janë përfshirë në deklaratat financiare, por gjatë auditimit kemi arritur në përfundimin se pasqyrat financiare përmbanin gabime materiale, por jo të përhapura (ISA 705-ISSAI 1705). Materialiteti i llogaritur nga audituesit e Kontrollit të Lartë të Shtetit bazuar në Manualin e Auditimit Financiar të KLSH-së për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2023 është 54,750 mijë lekë.

Në dhënien e opinionit, ne kemi marrë në konsideratë faktin se:

- Nga auditimi ka rezultuar se llogaria 212 "Ndërtesa Konstruksione" dhe llogaria 213 "Rrugë rrjete vepra ujore", nuk janë të analizuar nuk ka një regjistër kontabël ku të specifikohen analitikët e këtyre zërave, si dhe nuk ka informacioni për secilin aktiv.

- Llogaria 468 "Debitorë të ndryshëm" është nënvlerësuar për vlerën 63,154,513 lekë, pasi në fund të vitit nuk janë kontabilizuar detyrimet e papaguara për taksën e ndikimit në infrastrukturë nga lejet e legalizimeve.

- Nga auditimi ka rezultuar se gjendja e llogarisë 4342 "Të tjera operacione me shtetin (të drejta)", nuk kuadron me Llogarinë 7206 "Financim i pritshëm nga buxheti" e cila është paraqitur më shumë në vlerën 726,666,028 lekë.

-Në llogaritë 431, "Detyrime ndaj shteti për tatim taksa", e pasqyruar në bilanc për vlerën 2,595,717 lekë dhe 435, "Sigurime shoqërore" e pasqyruar për vlerën 9,771,380 lekë mbarten vlera për detyrime për tatim taksa në vlerën 1,167,003 lekë dhe sigurime shoqërore në vlerën 1,974,004 lekë që nuk janë të muajit dhjetor por detyrime të papaguara të periudhave të mëparshme.

II. HYRJA

Mbështetur në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksonimin e KLSH”, në zbatim të Programit të Auditimit Tematik nr. 854/4 prot., datë 24.06.2024 i ndryshuar, miratuar nga Kryetari i KLSH, nga data 01.07.2024 deri në datë 02.08.2024, në subjektin Bashkia Krujë, për periudhën nga 01.01.2023 deri me 31.12.2023, u krye auditimi me objekt “*Mbi auditimin financiar Tematik*” nga grupi i auditimit me përbërje:

1. P. Gj. përgjegjës grupi
2. E. M. auditues,

1.OBJEKTIVAT, FUSHËVEPRIMI DHE METODOLOGJIA

Objektivat e auditimit

Auditimi Financiar në Bashkinë Krujë kishte si objektiva kryesore:

- Vlerësimin nëse aktivitetet, transaksionet financiare dhe informacionet janë në të gjitha aspektet materiale ose jo, në përputhje me kuadrin ligjor e rregullator mbi bazën e të cilit subjekti që auditohet ushtron veprimtarinë e tij;
- Vlerësimin e zbatimit të kuadrit ligjor në fuqi, duke vlerësuar risqet e anomalive materiale në pasqyrat financiare dhe nivelin e pohimeve, nëpërmjet të kuptuarit të njësisë dhe mjedisit të saj, duke krijuar kështu bazën për hartimin dhe implementimin e përgjigjeve kundrejt risqeve të vlerësuara dhe gabimeve materiale (ISSAI 1315)³;
- Dhënien e opinionit mbi pasqyrat financiare dhe procedurat e prokurimit duke kryer vlerësimin e risqeve, nivelin e materialitetit dhe identifikimit të gabimeve, bazuar në standardet ISSAI 1700;
- Dhënien e opinionit dhe hartimin e Raportit të Auditimit mbi bazën e vlerësimeve të gjetjeve dhe dhënien e rekomandimeve për përmirësim, mbështetur mbi evidenca të besueshme, të mjaftueshme dhe përkatëse.

Qëllimi i auditimit.

Objektivi i auditimit financiar në Bashkinë Krujë, është dhënia e opinionit me siguri të arsyeshme, për periudhën nën auditim 2023, mbi transaksionet financiare dhe ngjarjet ekonomike nëse janë raportuar drejt dhe saktë në pasqyrat financiare të subjektit të audituar, kjo referuar kuadrin ligjor të raportimit financiar në fuqi.

Identifikimi i çështjes.

Raporti i Auditimit, synon të identifikojë përmbushjen e rolit të njësisë vendore dhe përgjegjësitë të saj, mbi transaksionet financiare dhe ngjarjet ekonomike nëse janë raportuar drejt dhe saktë në pasqyrat financiare.

Çështjet mbi të cilat është shtrirë auditimi:

- Mbi planifikimin dhe zbatimin e planit të buxhetit, burimi i krijimi të të ardhurave, vlerësimi i mbledhjes së tyre.
- Vlerësimi i raportimit financiar për vitin 2023.

Përgjegjësitë e strukturave drejtuese

Strukturat drejtuese të Bashkisë Krujë, janë përgjegjëse për paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me ligjin për kontabilitetin. Ato janë përgjegjëse për aktivitetin financiar, në përputhje me kriteret e përputhshmërisë duke përfshirë, por pa u kufizuar në ligjin e buxhetit dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, ligjin e prokurimeve së bashku me aktet nënligjore në zbatim të tij, ligjin për menaxhimin financiar dhe kontrollin dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, ligjin për auditin e brendshëm dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, etj.

Përgjegjësitë e audituesve.

Përgjegjësia e grupit të auditimit është të shprehë konkluzionin dhe një opinion mbi çështjet që janë nën auditim. Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit sipas INTOSAI-t, të cilat kërkojnë që audituesit të respektojnë kërkesat etike, si dhe të planifikojnë dhe kryejnë auditimin me qëllim arritjen e një sigurie të arsyeshme në dhënien e opinionit, mbështetur në evidencat e grumbulluara të auditimit.

Përgjegjësia jonë (e audituesve të KLSH-së), është që nëpërmjet auditimit të realizuar të krijohen bindjet, si dhe të shprehet opinionin i grupit të auditimit mbi aspektet që duhet të vlerësojë:

- Nëse shpenzimet janë realizuar në përputhje me ligjin e Buxhetit të Shtetit, me aktet përkatëse ligjore e nënligjore dhe me parimet e ligjit për menaxhimin financiar dhe kontrollin;
- Nëse janë zbatuar parimet e përgjithshme të sistemit të menaxhimit financiar në sektorin publik dhe të sjelljes së zyrtarëve të sektorit publik;
- Nëse janë zbatuar kërkesat e përcaktuara në ligjet dhe aktet normative përkatëse, si Ligji organik i buxhetit apo Ligji i prokurimit publik, etj.;
- Nëse janë reflektuar shkeljet e institucionit të audituar, të evidentuara në auditimet e mëparshme;
- Interesin publik ose pritshmërinë publike (p.sh. shkelje të identifikuar nga media, ankesat, etj.).
- fusha specifike të cilat janë objekt i fokusit për zbatimin e ligjit, etj.;

Në përputhje me ISSAI 1320 dhe ISSAI 1450, objektivi i audituesit është që të aplikojë konceptin e materialitetit në mënyrë korrekte gjatë planifikimit dhe kryerjes së auditimit. Auditimi përfshin kryerjen e procedurave për të marrë evidenca auditimi rreth praktikave administrative e financiare, rreth shumave dhe raportimit të shifrave në Pasqyrat Financiare. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i audituesit, duke përfshirë këtu edhe vlerësimin e rreziqeve nga gabimi material, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Gjatë procesit të vlerësimit të riskut, audituesit vlerësojnë nivelin e kontrollit të brendshëm përkatës në Bashkinë Krujë, në mënyrë që të programoheshin drejt procedurat e auditimit, të cilat janë të përshtatshme për kushtet e subjektit, por jo për qëllim të shprehjes së opinionit mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të subjektit.

Kriteret e vlerësimit.

Grupi i auditimit për të vlerësuar aktivitetin e Bashkisë Krujë është mbështetur në kuadrin ligjor, nënligjor dhe rregullativ të listuar më poshtë. Ky kuadër ligjor ka shërbyer si bazë për burimin e kriterëve që ka hartuar grupi i auditimit kundrejt të cilave janë vlerësuar aktivitetet e Bashkisë Peqin. Burimet e kriterëve të vlerësimit janë:

- ✓ Ligji organik i KLSH-së nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “*Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*”;
- ✓ Ligji nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “*Për financat e vetëqeverisjes vendore*”;
- ✓ Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 “*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*”, i ndryshuar;
- ✓ Ligji nr. 139/2015 “*Për vetëqeverisjen vendore*”, i ndryshuar;
- ✓ Ligji nr. 9632, datë 30.10.2006 “*Për Sistemin e Taksave Vendore*” i ndryshuar;
- Ligjin nr.20/2020 datë 05.03.2020 “*Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë*”;
- Ligjin nr.7850, datë 29.7.1994 “*Për Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë*”, i ndryshuar
- VKM nr. 510, datë 10.06.2015 “*Për miratimin e procedurave për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve, personelit, aktiviteteve dhe çdo dokumentacion tjetër zyrtar në njësitë e qeverisjes vendore, të prekura nga riorganizimi administrativo-territorial*”;
- VKM nr.500 datë 14.08.2001 “*Për inventarizimin e pronave të paluajtshme Shtetërore dhe transferimin e pronave në Njësitë e Qeverisjes Vendor*”
- VKM nr. 54, datë 5.2.2014 “*Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës e të mënyrës së dhënies*

me qira, enfi-teozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, i ndryshuar

- Udhëzimi i MF nr. 24, datë 02.9.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;

✓ Udhëzimi i MF nr. 5, datë 27.12.2014 “Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura”;

✓ Udhëzimi MF nr. 21, datë 25.10.2016 “Për nëpunësit zbatues të të gjitha niveleve”;

- Udhëzimi i MF nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit e të pasqyrave financiare vjetore të njësisve të Qeverisjes së Përgjithshme”, i ndryshuar me Udhëzimin e MFE nr.05 datë 21.02.2022;

✓ UMF nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar;

-Udhëzimi i KM nr. 1, datë 04.06.2014 “Për mënyrën e ekzekutimit të detyrimeve monetare të njësisve të qeverisjes së përgjithshme në llogari të thesarit”;

- Udhëzimin nr.15 datë 30.06.2003 “Për mënyrën e paraqitjes nga njësitë e qeverisjes vendore të kërkesave për transferimin në pronësi të tyre të pronave të paluajtshme publike”

▪ Rregullore e brendshme “Mbi Procedurat e auditimit në KLSH”;

▪ Rregullore e brendshme “Mbi organizimin dhe funksionimin administrativ KLSH-së”;

▪ Rregullore e brendshme e organizimit dhe funksionimit të Këshillit Bashkiak dhe aparatit administrativ të Bashkisë.

▪ Vendimet e Këshillit Bashkiak dhe shprehja e ligjshmërisë nga Prefekti i Qarkut;

▪ Legjislacioni bazë dhe dytësor, dispozitat e tjera, si dhe kriteret përkatëse që janë përdorur dhe ju jemi referuar për kryerjen e vlerësimeve gjatë auditimit.

Standardet e auditimit

✓ ISSAI 100 “Parimet themelore të auditimit të sektorit publik”, i cili përcakton parimet themelore për auditimin e sektorit publik në përgjithësi.

✓ ISSAI 2000-2899 “Udhëzues të Auditimit Financiar”.

✓ ISSAI 2300 “Planifikimi i auditimit të pasqyrave financiare”.

✓ INTOSAI GOV 9100 “Udhëzues mbi Standardet e Kontrollit të Brendshëm për Sektorin Publik”.

✓ INTOSAI GOV 9110 “Udhëzues mbi raportimin e efektivitetit të kontrolleve të brendshëm”.

Standardet Kombëtare të Kontabilitetit; Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA) të Federatës Ndërkombëtare të kontabilistëve IFAC; Manuali i Auditimit Financiar dhe i Përputhshmërisë të KLSH-së; Manuali i Auditimit të Brendshëm, etj. Standardet Ndërkombëtare të Auditimit mbi Raportimin e Audituesit të Pavarur, (IFAC); Praktika të mira të fushës, si manualet e Gjykatës Evropiane të Audituesve, Kërkesat e Udhërrëfyesit të IDI^t, etj.; Kodit Etik dhe Rregullores së Procedurave të Auditimit të KLSH.

Metodat e auditimit.

Auditimi i njëpasnjëshëm dhe me zgjedhje periudhash. Qasja audituese e KLSH-së është metodologji e bazuar në vlerësimin dhe menaxhimin e riskut të auditimit në subjektin që auditohet, e cila shërben për kryerjen e auditimit me efikasitet dhe efektivitet, duke u fokusuar në natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit në fushat materiale dhe që vlerësohen me nivel të lartë risku. Nën gjykimin profesional të audituesve të pavarur, për përzgjedhjen e kampioneve për ekzaminim, në zërat e shpenzimeve, u morën në konsideratë dy elementë:

- Risku i lidhur me shpenzimin specifik; dhe

- Pështetja specifike që një zë shpenzimesh zë ndaj totalit të shpenzimeve të subjektit.

Ndjekja dhe zbatimi i hapave të mësipërm do të sjellin natyrshëm përcaktimin e elementëve kryesorë që do të ndiqen gjatë procesit të zbatimit të projektit të auditimit, nëpërmjet sigurimit të gjurmës së projektit të auditimit. Gjurma e auditimit është dokumentimi i procesit të realizimit të Projektit të Auditimit. Evidentimi i zbatimit të procedurave të auditimit nëpërmjet

dokumentimit përfshin të gjitha fazat e kryerjes së Projektit të Auditimit që nga Planifikimi i Auditimit, Puna në Terren, Raportimi i Auditimit, Ndjekja e Rekomandimeve dhe Publikimi i Auditimit. Theksojmë se nga ana jonë do të auditohen pothuajse të gjitha fondet, si më poshtë:

▪ Kontrolli aritmetik

Duke konsideruar faktin se në thelb, kontabiliteti konsiston në regjistrimin e fakteve në një formë numerike, si dhe në paraqitjen sintetike të tyre, por midis regjistrimit fillestar të fakteve dhe paraqitjes së tyre në formë sintetike (që është edhe qëllimi i kontabilitetit), bëhen një seri veprimesh të cilat kanë të bëjnë me evidentimin në llogari, mbartjet, klasifikimin dhe rigrupimin. Kontrolli aritmetik u krye me qëllim që të sigurohemi nëse veprimet e llogaritjes dhe të hedhjeve në llogaritë përkatëse, që përfundojnë me nxjerrjen e gjendjeve sintetike, nuk përmbajnë asnjë gabim (*Ditari i kontabilizimit të urdhër shpenzimeve*).

▪ Kontrolli me anë të pjesëve justifikuese

Edhe pse kontabilizimet nuk përmbajnë gabime aritmetike, ato mund të jenë të gabuara, nëse regjistrimet e bëra nuk korrespondojnë me realitetin. Nga kontrolli me zgjedhje i pjesëve justifikuese (*Urdhër shpenzimeve*) u konstatua se shifrat e kaluara kanë pasur justifikim të mjaftueshëm dokumentar, sipas kërkesave të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “*Mbi menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*”, i ndryshuar.

▪ Inspektimi fizik dhe kontrolli i gjendjeve ekzistuese

Konsistoi në ekzaminimin e aktiveve, llogarive, librave kontabël etj. Kontrolli kontabël i ushtruar ekzaminoi përputhjen ndërmjet regjistrimit kontabël dhe pjesëve justifikuese përkatëse, por mbi ekzistencën reale të aktiveve në subjekt u konstatuan probleme. Gjithashtu, për të verifikuar kryerjen e saktë të inventarizimit fizik dhe përputhjet e tij me atë kontabël u krye mbikëqyrje fizike e magazinës.

▪ Kontrolli i vlerësimeve

Kontrolli i vlerësimeve përcaktoi nëse vlerat që u atribuohen gjendjeve ekzistuese janë të sakta, nëse pasuritë duhet të qëndrojnë në bilanc me vlerat që u janë vendosur atyre.

▪ Konfirmimi nga të tretët

Transaksionet e përzgjedhura për t’ju nënshtruar testeve të detajeve, u kryqëzuan me informacionin e gjeneruar nga Thesari dhe rakordimit periodike me ente dhe institucione të tjera shtetërore.

▪ Kontrolli sipas një treguesi

Përdorimi i treguesve statistikorë me qëllim që të kërkohen fakte ose të dhëna “jashtë normales”, të cilat përbëjnë tregues të parregullsive kontabël. Mund të përmendim nëse ka: mungesë të pjesëve justifikuese, gabimet e shpeshta në datat, numrat, referencat e brendshme, regjistrime pak të lexueshme, shifra të renditura keq, korrigjime të shumta të shifrave, etj.

▪ Intervista

U kryen intervista me specialistët e Bashkisë Krujë me qëllim për të kuptuar dhe vlerësuar më mirë problematikat e konstatuara.

▪ Raporte dhe Informacione

U shqyrtuan raporte, informacione dhe dokumentacion lidhur me çështjet nën auditim.

▪ Praktikat e ndjekura në kryerjen e auditimit

Mbështetur në ISSAI 1315, objektivi i audituesit është identifikimi dhe vlerësimi i risqeve e anomalive materiale në pasqyrat financiare si edhe nivelin e pohimeve, nëpërmjet të kuptuarit të njësisë dhe mjedisit të saj, duke përfshirë kontrollin e brendshëm të njësisë dhe duke krijuar kështu bazën për hartimin dhe implementimin e përgjigjeve kundrejt risqeve të vlerësuar të gabimeve materiale.

Në këtë kontekst merr rëndësi vlerësimi i materialitetit në përputhje me ISSAI 1320 dhe ISSAI 1450, i cili përcakton nivelin e gabimit që audituesi konsideron të mundshëm për të influencuar te përdoruesit e pasqyrave financiare. Nisur nga gjykimi profesional i audituesit dhe ndjeshmëria e zonave të llogarisë, grupi i auditimit përcaktoi materialitetin në masën 2% për të gjitha zonat e llogarisë të planifikuara për t'u audituar, ku si bazë për llogaritjen e tij janë marrë shpenzimet për pagat (600), shpenzimet operative (602) dhe investimet (231). Pas përcaktimit të nivelit të materialitetit, grupi i auditimit ka kryer vlerësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm në institucion sa i takon: (a) hartimit; (b) implementimit; dhe (c) funksionimit të 5 komponentëve të kontrollit të brendshëm. Vlerësimi i kontrollit të brendshëm është bazuar në kryerjen e testeve të kontrolleve. Gjatë kryerjes së testeve të kontrolleve është arritur në përfundimin që sistemet e kontrollit të brendshëm paraqesin risk të moderuar deri të lartë.

Metodologjia e aplikuar gjatë planifikimit, konsiston në auditimin e të dhënave të siguruara nga vetë subjekti. Kemi ndërmarrë procedurat për vlerësimin e riskut (analiza), me qëllim sigurimin e nivelit të kërkuar të njohjes së riskut të brendshëm dhe riskut të kontrollit të subjektit. Informacion të vlefshëm administruam dhe nga procedurat e ndjekura nga vetë subjekti për vlerësimin e riskut, duke iu nënshtruar skepticizmit profesional nga ana e audituesve. Gjatë vlerësimeve u mbështetëm në Modelin e Riskut që aplikon KLSH-ja¹.

Nisur sa më sipër, jemi përpjekur të ruajmë nivelin e pranuar të Riskut të Auditimit prej 5%, duke shtuar nivelin e procedurave analitike (ISSAI 1520) dhe testeve thelbësore të kryera.

Në këtë kontekst, procedurat e ndjekura nga grupi i auditimit konsistojnë në analizat e marrëdhënieve ndërmjet informacionit financiar dhe jo financiar; inspektimeve që konsistojnë në regjistrimin e dokumenteve në regjistra/ditarë/partitarë ose në trajtë elektronike por edhe në inspektime fizike; në observime, të cilat kanë të bëjnë me analizën e proceseve ose procedurave të kryera nga të tjerë, me qëllim sigurimin e informacionit rreth performancës së proceseve/procedurave, por kjo mbetet e limituar deri në kohën kur ka ndodhur observimi; dhe së fundmi, kërkimi/hetimi që konsiston në kërkimin e informacionit të personat kompetentë dhe të mirëinformuar brenda dhe/ose jashtë njësisë shpenzuese.

Dokumentimi i auditimit.

Mbështetur në kërkesat e Manualeve të Auditimit si edhe në Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit ISSAI 1230 "Dokumentimi i auditimit", nga audituesit u përgatit dokumentacioni i auditimit, i mjaftueshëm për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit, të kryera në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat ligjore dhe rregullatore të zbatueshme. Rezultatet e këtyre procedurave dhe evidencat e marra gjatë auditimit, si dhe çështje të tjera të rëndësishme që dolën gjatë auditimit, janë reflektuar në përfundimet e arritura në drejtim të tyre sipas gjykimit dhe skepticizmit profesional që audituesit ushtruan në arritjen e këtyre konkluzioneve. Ky dokumentacion është i përshtatshëm dhe i rëndësishëm për të konfirmuar dhe mbështetur opinionet dhe raportin e audituesve dhe ka shërbyer si një burim informacioni për përgatitjen e tyre.

Raporti Auditimit i dërgohet subjektit Bashkia Krujë, pasi nga subjekti i audituar me shkresën nr. 4050/4, datë 16.09.2024 (*prot KLSH nr. 854/15, datë 19.09.2024*), është kthyer Projekt Raporti i Auditimit pa observacione, i cili është dërguar në subjekt me shkresën nr. 854/11, datë 09.08.2024.

¹ Risku i Auditimit = Risku i qenësishëm * Risku i kontrollit * Risku i Zbulimit

III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT

1. Informacion i përgjithshëm.

Bashkia Krujë përbëhet nga 6 njësi administrative, të cilat janë: Krujë, Fushë-Krujë, Bubq, Nikël, Thumanë dhe Cudhi. Në bashkinë e re gjenden dy qytete dhe 50 fshatra. Të gjitha njësitë janë pjesë e Rrethit Krujë të Qarkut Durrës. Struktura organizative aktuale është miratuar me VKB nr. 14, datë 17.02.2023.

Emri i Njësive	Qytetet dhe fshatrat në përbërje të tyre
Krujë	Qyteti: Krujë, Fshatrat: Barkanesh, Picërragë, Brret.
Fushë Krujë	Qyteti: Fushë Krujë, Fshatrat: Fushë Krujë, Arrameras 1, Luz 1, Hasan, Larushk 1, Halil, Zgërdhesh, Zallë, Luz 2, Larushk 2, Arrameras 2
Bubq	Fshatrat: Bubq, Bilaj, Budull, Mazhë e madhe, Mazhë e vogël, Mallkuç, Murqinë
Nikël	Fshatrat: Nikël, Tapizë, Qerekë, Rinas, Virjon, Buran, Mukaj, Kurcaj, Zezë
Thumanë	Fshatrat: Kodër-Thumanë, Borizanë, Derven, Gramëz, Thumanë, Bushnesh, Dukagjin i Ri, Sukth-Vendas, Miliska, Derven Kodër
Cudhi	Fshatrat: Cudhi-Zall, Nojë, Mafsheq, Shqezë, Shkretë, Cudhi-Kant, Kroj Madh, Bruz-Zall, Bruz-Mal, Rranxë

Misioni i Bashkisë Krujë është të sigurojë qeverisjen në një nivel sa më afër qytetarëve, duke garantuar vetë-qeverisjen në përputhje me kërkesat e Kartës Evropiane të Autonomisë Vendore. Synimi kryesor është plotësimi sa më i mirë i nevojave dhe kërkesave të komuniteteve përkatëse, nëpërmjet arritjes së një niveli sa më të lartë shërbimesh, në dobi të një zhvillimi të balancuar me qëllim përfundimtar standarde të larta të cilësisë së jetesës në territorin nën administrim. Vetëqeverisja vendore në Republikën e Shqipërisë siguron qeverisjen e efektshme, efikase dhe në një nivel sa më afër qytetarëve nëpërmjet:

- a) njohjes së ekzistencës së identiteteve dhe vlerave të ndryshme të bashkësive;
- b) respektimit të të drejtave dhe lirive themelore të shtetasve, të sanksionuara në Kushtetutë ose në ligje të tjera;
- c) zgjedhjes së llojeve të ndryshme të shërbimeve dhe lehtësive të tjera publike vendore në dobi të bashkësisë;
- ç) ushtrimit efektiv të funksioneve, kompetencave dhe realizimit të detyrave nga organet e vetëqeverisjes vendore;
- d) realizimit të shërbimeve në formë të përshatshme, bazuar në nevojat e anëtarëve të bashkësisë;
- dh) nxitjes efektive të pjesëmarrjes gjithëpërfshirëse të bashkësisë në qeverisjen vendore;
- e) realizimit të shërbimeve, në përputhje me standardet e kërkuara me ligj ose akte të tjera normative.

Bashkia Krujë, si të gjitha njësitë e tjera të vetëqeverisjes vendore ka kuadrin legjislativ dhe operues, bazë e të cilave janë ligji nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” dhe ligji nr.68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” i ndryshuar, krahas akteve të tjera ligjore, nënligjore dhe rregullatorë.

Rëndësia e auditimit financiar të Bashkisë Krujë për periudhën e aktivitetit 2023, krahas detyrimit kushtetues dhe ligjor që konsiston në kontrollin e përdorimit dhe mbrojtjes së fondeve shtetërore nga organet e pushtetit vendor, pra njësitë e vetëqeverisjes vendore janë subjekt i kontrollit nga Kontrolli i Lartë i Shtetit, sipas legjislacionit në fuqi, qëndron në të bërit sa më transparente të veprimtarisë menaxhuese dhe administruese, për të rritur përgjegjshmërinë dhe llogaridhënien e të zgjedhurve dhe administratës publike, në funksion të rritjes së mirëqenies së qytetarëve.

2. Përshkrimi i auditimit, sipas drejtimeve të auditimit

2.1. Auditim mbi vlerësimin e raportimit financiar, për të arritur në opinionin në se pasqyrat financiare, japin një paraqitje të vërtetë e të drejtë të pozicionit financiar, performancës financiare dhe fluksit të parasë, bazuar në kuadrin rregullator në fuqi.

Nxjerrja e pasqyrave financiare për vitin 2023.

Për vitin 2023, Në përputhje me kërkesat e MFE nr. 08, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme” i ndryshuar, janë përgatitur pasqyrat financiare, dërguar Degës së Thesarit me shkresën nr. 1967 prot., datë 29.03.2024, të përbëra si vijon:

Format nr. 1 –Pasqyra e pozicionit financiar.

Format nr. 2 –Pasqyra e performancës financiare (Klasifikimi sipas natyrës ekonomike).

Format nr. 3 – Pasqyra e flukseve monetare (Caush-Flou).

Format nr. 4 –Pasqyra e ndryshimeve në aktivet neto/fondet neto.

Format nr. 5 –Pyetësor dhe shënimet shpjeguese.

Format nr. 6 –Investimet dhe burimet e financimit.

Format nr. 7/a –Gjendja dhe ndryshimi i aktiveve afatgjata (kosto historike).

Format nr. 7/b –Gjendja dhe ndryshimi i aktiveve afatgjata (vlera neto).

Format nr. 8 –Numri i punonjësve dhe fondi i pagave.

Pasqyrat financiare janë të firmosura nga z. E.F. si nëpunës zbatues dhe Kryetar i Bashkisë, Nëpunës autorizues.

Mbajtja e kontabilitetit v. 2023.

Në këtë bashki, kontabiliteti është organizuar dhe mbahet në mënyrë manuale. Janë hapur ditarët përkatës për bankën, ditari i arkës, magazinën, ditari i veprimeve të ndryshme etj.

Gjendja e llogarive të evidentuara në bilanc në fund të periudhës raportuese ushtrimore viti 2023, të pozicionit financiar Bashkia Krujë; Formati nr.1, paraqitet në pasqyrat e mëposhtme:

Nga procesi i auditimit mbi referencat e llogarive të aktivitetit dhe pasivitetit, në lidhje me verifikimin e vlerave të pasqyruara në llogaritë e pasqyrave të pozicionit financiar të periudhës raportuese ushtrimore 2023, të saktësisë dhe besueshmërisë së tyre paraqiten si në vijim;

Aktivet neto janë të barabarta me Aktivet-Pasivet=	8,169,041,925 lekë.
Aktivet	9,198,482,941 lekë.
Pasivet	1,029,441,016 lekë.
Aktivet neto	8,169,041,925 lekë.

Aktivet afatshkurtra

Aktivet afatshkurtra më datë 31.12.2023 paraqiten në vlerën **2,013,122,716 lekë** dhe përbëhen nga:

Llogaritë e Klasës 5 “Mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre” në shumën 1,000,709,250 lekë.

Llogaritë e Klasës 3 “Gjendje inventari qarkullues” në shumën 92,263,206 lekë.

Llogaritë e Klasës 4 “Llogari të arkëtueshme” në shumën 920,150,260 lekë.

Llogaritë e Klasës 5 “Mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre” përbëhet nga:

Llogaritë kontabël	Emërtimi i llogarive	Viti 2023	Viti 2022	Diferenca 2023-2022
520	Disponibilitete në thesar	1,000,709,250	1,464,672,480	(463,963,230)
Totali		1,007,709,250	1,464,672,480	(463,963,230)

Vlera e llogarisë 520 “Disponibilitete në thesar” në shumën 1,000,709,250 lekë, sipas aktrakordimit me Thesarin datë 31.01.2024, përbëhet nga: gjendja e Llogaria 85 "Rezultati i vitit ushtrimor" në pasqyrën 1 “Pasqyra e pozicionit financiar” paraqitet në vlerën 891,478,493 lekë

(fonde të trashëguara kapitulli 01,05 dhe 06 në vlerën 494,650,143 lekë dhe fonde të trashëguar të rindërtimit në vlerën 396,828,351 lekë) dhe gjendja e llogarisë 466 "Mjete në ruajtje" në shumën 109,230,756 lekë, të cilat rakordojnë me rubrikën VI "Teprica e Likuiditeteve në fund të vitit ushtrimor" në Formatin nr.3 "Pasqyra e flukseve monetare (CASH-FLOË)".

Llogaritë e klasës 5, kanë funksionuar duke u debituar për shtesat në kredi të llogarive përkatëse për të ardhurat dhe grante të ndryshme, si dhe duke u kredituar për pakësimet në debi të llogarive përkatëse të klasës 4.

Llogaritë e Klasës 3 "Gjendje inventari qarkullues", përbëhet nga:

Llogaritë kontabël	Emërtimi i llogarive	Viti 2023	Viti 2022	Diferenca 2023-2022
31	Materiale	11,182,737	7,195,888	3,986,849
32	Inventar i imet	81,080,469	74,454,047	6,626,422
	Totali	92,263,206	81,649,935	10,613,271

Llogaritë e Klasës 3, sipas Pasqyrës së Pozicionit Financiar të Bashkisë Krujë në 31.12.2023 paraqitet në vlerën 92,263,206 lekë dhe përbëhet nga llogaria kontabël 31 "Materiale" në vlerën 11,182,737 lekë dhe llogaria kontabël 32 "Inventar i imët" në vlerën 81,080,469 lekë. Diferencat me vitin e mëparshëm përfaqëson lëvizjen e inventarit në shumën -10,613,271 lekë e cila kuadron me llogarinë 63 "Ndryshimi gjendjes së inventarit" në shumën -10,613,271 lekë.

Llogaria 31 "Materiale", është pasqyruar për vlerën 11,182,737 lekë që përfaqësojnë gjendjen e materialeve në magazine, krahasuar me vitin paraardhës pasqyrohet me rritje në vlerën 3,986,849 lekë.

Llogaria 32 "Inventarë i imët", ka vlerën 81,080,469 lekë që përfaqësojnë inventarin e imët, e cila e krahasuar me vitin paraardhës pasqyrohet me rritje në vlerën 6,626,422 lekë.

Llogaritë e klasës 3 kanë funksionuar duke u debituar për shtesat në kredi të llog. 63 "Ndryshimi i gjendjeve të inventarit" dhe duke u kredituar për daljet e inventarit në debi të llogarisë 63 "Ndryshimi i gjendjeve të inventarit".

Llogaritë e Klasës 4 "Llogari të arkëtueshme" & "Të tjera aktive afatshkurtra" përbëhet nga:

Llogaritë kontabël	Emertimi i llogarive	Viti 2023	Viti 2022	Diferenca 2023-2022
	Llogari të arkëtueshme	920,150,260	767,730,132	152,420,128
468	Debitorë te ndryshëm	833,117,807	702,662,238	130,455,569
4342	Te tjera operacione me shtetin(të drejta)	87,032,453	65,067,894	21,964,559

Llogaria 468 "Debitorë të ndryshëm", në fund të vitit 2023 paraqitet në vlerën 833,117,807 lekë.

Vlera e debitorëve në vitin 2023 në krahasim me vitin 2022 ka pësuar një rritje prej 130,455,569 lekë, kryesisht debitorët e taksave në vlerën 102,213,589 lekë të cilët (në fund të vitit 2022 janë për vlerën 613,515,626 lekë dhe në fund të vitit 2023 janë për vlerën 715,729,215 lekë) dhe debitorët e IMT në vlerën 28,241,980 lekë të cilët (në fund të vitit 2022 janë për vlerën 23,652,600 lekë dhe në fund të vitit 2023 janë për vlerën 51,894,580 lekë).

Analiza e gjendjes së llogarisë. 468 "Debitorë të ndryshëm", krahasuar me vitin paraardhës paraqiten në pasqyrën Aneks nr 1, bashkëlidhur.

Konstatimi: Nga auditimi rezultoi se llogaria 468 "Debitorë të ndryshëm", në fund të vitit 2023 paraqitet në vlerën 833,117,807 lekë. Nga verifikimi i kryer rezultoi se në kredi të llogarisë 468 "Debitorë të ndryshëm", nuk janë përfshirë detyrimet për taksën e ndikimit në infrastrukturë nga lejet e legalizimeve për vlerën 63,154,513 lekë, me ndikim në informacionin kontabël që ofrojnë

pasqyrat financiare në lidhje me plotësinë e vlerave të llogarive, në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr. 08, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njëjësive të Qeverisjes së Përgjithshme” i ndryshuar, Kreu II pika 5.

Llogaria 4342 “Të tjera operacione me shtetin (të drejta)”, në fund të vitit 2023 paraqitet në vlerën 87,032,453 lekë, e cila përfaqësojnë llogaritë e Klasës së 4 të Pasivit të Pasqyrës Financiare të Pozicionit Financiar dhe nuk kuadron me Llogarinë 7206 “Financim i pritshëm nga buxheti” të Pasqyrës së Performancës Financiare e cila paraqitet në shumën 818,698,481 lekë.

Në mënyrë analitike paraqitet:

Emërtimi i llogarive	Vlera
Llogari 401-408 “Furnitor e llogari të lidhura me to”	8,165,823
Paga personeli llog. 42	26,515,461
Tatim mbi të ardhurat llog. 431	2,595,717
Sigurime shoqërore llog.435	9,771,380
Sigurime shëndetësore llog.436	1,072,747
Kreditorë të ndryshëm llog. 467	38,911,325
Totali	87,032,453

Konstatimi: Llogaria 4342 “Operacione me shtetin (të drejta)”, në fund të vitit 2023 paraqitet në vlerën 87,032,453 lekë, e cila përfaqëson llogaritë e klasës 4 të Pasivit për paga, sigurime , tatime dhe furnitorë të ndryshëm, e cila nuk kuadron me Llogarinë 7206 “Financim i pritshëm nga buxheti” të Pasqyrës së Performancës Financiare, e cila paraqitet në shumën 813,698,481 lekë, në kundërshtim me udhëzimin e MFE nr. 08, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njëjësive të Qeverisjes së Përgjithshme”, Kreu III. “Procedurat për përgatitjen, paraqitjen dhe konsolidimin e pasqyrave financiare në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” i ndryshuar, pika 32.

Aktivët Afatgjatë jo materiale (AAJM)

Llogaritë e Klasës 20 “Aktivët Afatgjatë Jo materiale”, përbëhen nga llog.202 “Studime dhe kërkime”, në aktiv të bilancit paraqitet në vlerën neto si në mbyllje të vitit 2022 dhe vitit 2023 në vlerën 136,740,204 lekë. Ndërsa sipas Formatit 7/b “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjatë (kosto historike)” gjendja paraqitet si në mbyllje të vitit 2022 dhe vitit 2023 në vlerën prej 136,740,204 lekë. Sipas të dhënave kontabël, kjo llogari është e analizuar për 69 artikuj kontabël.

Aktivët e afatgjatë materiale (AAM)

Llogaria 210 “Toka,troje Terrene” paraqitet me vlerë neto dhe kosto historike si në mbyllje të vitit 2022 dhe vitit 2023 në vlerën 40,397,698 lekë. Sipas të dhënave kontabël, kjo llogari është e analizuar për 21 artikuj kontabël.

Llogaria 211 “Pyje, Plantacione” paraqitet me vlerë neto dhe kosto historike si në mbyllje të vitit 2022 dhe vitit 2023 në vlerën 19,804,270 lekë, Sipas të dhënave kontabël, kjo llogari është e analizuar për 6 artikuj kontabël.

Llogaria 212 “Ndërtesa konstruksione” paraqitet me vlerë neto në mbyllje të vitit 2022, paraqiten në vlerën 1,854,020,506 lekë dhe në mbyllje të vitit 2023 në vlerën 1,896,390,277 lekë. Ndërsa sipas Formatit 7/b “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjatë (kosto historike)” në mbyllje të vitit 2022 në vlerën prej 2,336,186,067 lekë dhe në vitin 2023 në vlerën 2,472,322,344 lekë. Pra kemi rritje në vlerën 136,136,277 lekë, që përbëhet shtesa me pagesë nga rritja e AAGJM për objektet si më poshtë:

-Objekti “Rehabilitim i sallës së koncerteve” në vlerën 30,243,512 lekë dhe mbikëqyrje punimesh në vlerën 83,184 lekë.

-Objekti “Shkolla Hajdar Zogu” në vlerën 102,994,662 lekë dhe mbikëqyrje punimesh në vlerën 1,086,919 lekë.

-Objekti “Blerje shtylla ndriçimi publik për Bashkinë Kruje Arteo 2018” në vlerën 1,728,000 lekë.

Llog 213 “Rrugë rrjete vepra ujore” paraqitet me vlerë neto në mbyllje të vitit 2022, paraqiten në vlerën 2,920,240,937 lekë dhe në mbyllje të vitit 2023 në vlerën 2,797,007,624 lekë. Ndërsa sipas Formatit 7/b “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)” në mbyllje të vitit 2022 në vlerën prej 3,517,359,110 lekë dhe në vitin 2023 në vlerën 3,540,722,066 lekë. Pra kemi rritje në vlerën 23,362,956 lekë, që përbëhet shtesa me pagesë nga rritja e AAGJM për objektet si më poshtë:

-Objekti “Sistemim asfaltim i sheshit para Kishës dhe rrugëve lidhëse Gramez” në vlerën 5,155,292 lekë, mbikëqyrje në vlerën 152,670 lekë dhe kolaudim në vlerën 10,710 lekë

-Objekti “Ndërtim kolektori lagja grumbullimi F Kruje” në vlerën 1,152,048 lekë dhe mbikëqyrje në vlerën 35,849 lekë

-Objekti “Sistemim asfaltim i rrugës te lagjes Ziri Magaze” në vlerën 4,730,113 lekë, mbikëqyrje në vlerën 160,438 lekë dhe kolaudim në vlerën 15,840 lekë

-Objekti “Sistemim asfaltim rrugës Gramez Sukth Vendas” në vlerën 10,799,514 lekë, mbikëqyrje në vlerën 307,687 lekë dhe kolaudim në vlerën 33,068 lekë

-Objekti “Sistemim asfaltim rrugës hyrëse e rrugës vjetër të Tiranës” në vlerën 744,000 lekë, mbikëqyrje në vlerën 19,051 lekë dhe kolaudim në vlerën 5,598 lekë

Llog 214 “Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune” paraqitet me vlerë neto në mbyllje të vitit 2022, paraqiten në vlerën 28,404,237 lekë dhe në mbyllje të vitit 2023 në vlerën 23,882,790 lekë. Ndërsa sipas Formatit 7/b “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)” në mbyllje të vitit 2022 në vlerën prej 81,284,811 lekë dhe në vitin 2023 në vlerën 83,408,811 lekë. Pra kemi rritje në vlerën 2,124,000 lekë, që përbëhet shtesa me pagesë nga rritja e AAGJM për Blerje kontejnerë metalike për Bashkinë Krujë, në vlerën 2,124,000 lekë.

Llogaria 215 “Mjete transporti” paraqitet me vlerë neto në mbyllje të vitit 2022, në vlerën 31,836,370 lekë dhe në mbyllje të vitit 2023 në vlerën 25,469,096 lekë. Ndërsa sipas Formatit 7/b “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)” si në mbyllje të vitit 2023 dhe në vitin 2022 në vlerën 98,559,422 lekë. Sipas të dhënave kontabël, kjo llogari është e analizuar për 29 artikuj kontabël.

Llogaria kontabël 218 “Inventar ekonomik”. Kjo llogari përfaqëson inventarin ekonomik në përdorim nga shkollat, kopshtet, çerdhet, njësitë administrative të Bashkisë. Sipas pasqyrave financiare gjendja e llogarisë 218 “*Inventar ekonomik*” në vlerën neto paraqitet në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 121,332,564 lekë dhe në mbyllje të vitit 2023 në vlerën 105,844,962 lekë. Ndërsa sipas Formatit nr.7/B “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)” paraqitet në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 198,133,434 lekë dhe në mbyllje të vitit 2023 në vlerën kontabël 207,623,726 lekë.

Pra kemi rritje në vlerën 9,490,292 lekë, që përbëhet shtesa me pagesë nga rritja e AAGJM për -Blerje mobileje për Nj/Administrative në vlerën 4,511,484 lekë, Blerje kompjuterë në vlerën 2.079,480 lekë dhe Pajisje kompjuterësh donacion në vlerën 2,899,328 lekë.

Në lidhje me zbatimin e dispozitave ligjore për kryerjen e procedurave të inventarizimit të aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara dhe qarkulluese rezultoi se:

Bazuar në ligjin 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, ligjin nr. 10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, UMFE nr.30, datë 27.12.2011 të Ministrisë së Financave “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar si dhe në zbatim të Urdhrit

të Kryetarit të Bashkisë nr. 578, datë 30.10.2023 “Për ngritjen e komisionit të posaçëm për inventarizimin dhe vlerësimin e aktiveve”, është ngritur komisioni, me 7 anëtarë G. K. Kryetar dhe E. R., A. K., Z. I., A. Ç., A. Gj., N. L. antarë. Nga komisioni i inventarizimit është hartuar raport mbi kryerjen e inventarizimit fizik dhe vlerësimin e aktiveve, nr. 10157 Prot., datë 06.12.2023, drejtuar Kryetarit të Bashkisë, për përfundimin e procesit të inventarizimit dhe vlerësimin e aktiveve në administratën e Bashkisë dhe Nj/A Fush-Krujë, Bubq, Nikël, Thumanë, Cudhi dhe institucionet arsimore, ku ka rezultuar që janë evidentuar materiale të cilat si rezultat i përdorimit për një periudhë të gjatë janë vlerësuar për jashtë përdorimit llogaria 32 “Inventar i imët” për vlerën 16,820,729 lekë, llogaria 214 “Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune”, për vlerën 19,674,518 lekë dhe llogaria 218 “Inventar ekonomik”, për vlerën 20,862,382 lekë gjithsej për vlerën 57,357,629 lekë. Nga Bashkia Krujë për vitin 2023 nuk ka procedurë për nxjerrjen jashtë përdorimit për materialet evidentuara si të tilla.

Konstatimi: Nga auditimi u konstatua se për vitin 2023, nuk është kryer inventari fizik pasi llogaritë 212 “Ndërtesa e Konstruksione” dhe 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore”, nuk janë të analizuar, nuk ka një regjistër kontabël ku të specifikohen analitikët e këtyre zërave, si dhe nuk ka informacioni për secilin aktiv në lidhje me datën e hyrjes ose marrjes në dorëzim, përshkrimin e aktivitetit, vlerën e blerjes, datën e daljes në përdorim, datë e skadencës, personin përgjegjës, kohën e shërbimeve të mirëmbajtjes, vlerën e akumuluar të shpenzimeve të mirëmbajtjes, datën e daljes nga pronësia, etj. Në këto kushte nuk mund të ketë informacion të saktë në lidhje me gjendjen kontabël, e cila do të krahasohet dhe me gjendjen faktike kur bëhet inventarizimi fizik çdo vit për të vërtetuar dhe sistemuar vlerën e tyre në kontabilitet, sa më sipër nuk japin arsye që të kemi siguri mbi vlerat në pasqyrat e pozicionit financiar për sa i përket këtyre llogarive, për pasojë të mos japim dot një opinion mbi plotësinë, saktësinë dhe përkatësinë e këtyre vlerave në kontabilitet, veprime në kundërshtim me kërkesat e Udhëzimit të MF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” (me ndryshime) pikat 26, 28, 30, Kreu IV, pika 75 dhe Udhëzimit të MFE nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” i ndryshuar, Kreu II, “Parimet dhe rregullat e organizimit dhe të mbajtjes së kontabilitetit publik në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, pika 5.

Llogaria 219 “Amortizimi i AAGJM & AAJM: Kjo llogari sipas pasqyrave financiare të Bashkisë Krujë në fund të vitit 2023, paraqitet në vlerën (1,554,041,621) lekë. Krahasuar me vitin 2022 llogaria 219 “Amortizimi i aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara” paraqitet me shtesë prej (278,353,390) lekë. “Amortizimi i AQ të Trupëzuara dhe të Patrupëzuara” është llogaritur sipas normave ligjore të miratuara në përputhje me UMF nr.8, datë 9.3.2018”Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”pika 36. Përllogaritja është bërë mbi vlerën neto në çelje të periudhës ushtrimore për çdo grup aktivesh sipas klasifikimit 212 “Ndërtesa Konstruksione”; 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore”; 214 “Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune” dhe 218 “Inventar Ekonomik”. Nuk u bë i mundur sondazhi i përllogaritjes së amortizimit për aktive të veçanta në llogari të ndryshme, pasi mungonin të dhënat për çdo aktiv, pasi përllogaritja e amortizimit ishte bërë në grup aktivesh sipas llojit, duke aplikuar normat e amortizimit të miratuara, pra amortizimi është llogaritur për grup aktivesh në total dhe jo zë për zë sipas aktiveve.

Konstatime: Nga auditimi ka rezultuar se për Aktivevet Aftat Gjata Materiale, të pasqyrave financiare Bashkia Krujë, nuk posedon titull pronësie, në kundërshtim me VKM nr. 510, datë 14.08.2001 “Për inventarizimin dhe hipotekimin e të gjitha pronave të paluajtshme dhe të luajtshme”, Kreu VI “Transferimi i pasurive dhe regjistrimi i pasurive të paluajtshme”, pika 1 dhe 2. Për rrjedhojë edhe kontabilizimi i aktiveve afatgjata materiale, nuk është mbështetur në

dokumentacionin e duhur, në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 me ndryshime, Kapitulli III, pika 35.

Llogaria 231 “AAGJM Investime në proces” paraqitet në mbyllje të vitit 2022, në vlerën 1,542,248,174 lekë dhe në mbyllje të vitit 2023 në vlerën 2,137,423,304 lekë, të cilat përfaqësojnë investime për kontrata të cilat nuk kanë përfunduar brenda vitit ushtrimorë 2023, paraqiten në pasqyrën Aneks nr. 6, bashkëlidhur.

PASIVET (DETYRIMET)

Pasivet Afatshkurtra

Llog e klasës 4, në pasiv të Pasqyrës së Pozicionit Financiar, janë llogari të pagueshme ato paraqesin detyrimet e Bashkisë Krujë më 31.12.2023, kundrejt furnitorëve, pagat e punonjësve të muajit dhjetor 2023, detyrimet kundrejt tatimeve, sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore të muajit dhjetor 2023, kreditorë për mjete në ruajtje të cilat kryesisht kanë të bëjnë me garancitë e kontratave, kreditorë të ndryshëm, debitorë etj., si më poshtë:

Llogaritë		Viti 2023	Viti 2022	Diferenca/ndryshimi
401-408	Furnitorë e llogari të lidhura me to	8,165,823	10,291,303	(2,125,480)
42	Detyrime ndaj personelit	26,515,461	24,431,517	2,083,944
431	Detyrime ndaj shtetit tatim taksa	2,595,717	2,634,745	(39,028)
435	Sigurime shoqërore	9,771,380	9,217,740	553,640
436	Sigurime shëndetësore	1,072,747	995,853	76,894
466	Kreditorë për mjete në ruajtje	109,230,756	79,488,357	29,742,399
467	Kreditorë të ndryshëm	38,911,325	17,496,736	21,414,589
4341	Operacione me shtetin (detyrime)	833,177,807	702,662,238	130,515,569
	Gjendja më fund të periudhës	1,029,441,016	847,218,489	182,222,527

Llogaria 401-408 “Furnitorë e llogari të lidhura me to”, paraqiten detyrimet për fatura të palikujduara të cilat për vitin 2023 paraqiten në vlerën 8,165,823 lekë, në mënyrë analitike paraqiten në pasqyrën Aneks nr.2, bashkëlidhur.

Llogaria 42, “Detyrime ndaj personelit”, sipas pasqyrave financiare, paraqitet në vlerën 26,515,461 lekë dhe përfaqëson vlerën e pagave të muajit dhjetor për t’u paguar në muajin janar të vitit pasardhës.

Llogaria 431, “Detyrime ndaj shteti për tatim taksa”, paraqitet në vlerën 2,595,717 lekë dhe përfaqëson vlerën për t’u paguar për taksa e tatime ndaj shtetit për muajin dhjetor.

Llogaria 435, “Sigurime shoqërore” dhe llogaria 436 “Sigurime shëndetësore” paraqet vlerën e pa paguar për sigurime shoqërore e shëndetësore për pagat e muajit dhjetor 2023 që paguhet në muajin janar 2024 dhe janë perkatsisht në vlerat 9,771,380 lekë dhe 1,072,747 lekë.

Konstatimi: Nga auditimi është konstatuar se në llogaritë 431, “Detyrime ndaj shteti për tatim taksa”, e pasqyruar në bilanc për vlerën 2,595,717 lekë dhe 435, “Sigurime shoqërore” e pasqyruar për vlerën 9,771,380 lekë mbarten vlera për detyrime për tatim taksa në vlerën 1,167,003 lekë dhe sigurime shoqërore në vlerën 1,974,004 lekë që nuk janë të muajit dhjetor por detyrime të papaguara të periudhave të mëparshme me ndikim në informacionin kontabël që ofrojnë pasqyrat financiare në lidhje me plotësinë e vlerave të llogarive, në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr. 08, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njëjësive të Qeverisjes së Përgjithshme” i ndryshuar, Kreu II pika 5.

Llogaria 466 “Kreditore për mjete nën ruajtje”, përfshin garancitë e ngurtësuar për investime të kryera. Gjendja e kësaj llogarije paraqitet në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 79,488,357 lekë dhe në mbyllje të vitit 2023 në vlerën 109,230,756 lekë. Për këtë gjendje të llogarisë 466 “Kreditore për mjete nën ruajtje”, është bërë raportimi në degën e Thesarit Krujë në mënyrë analitike, lëvizjet e kësaj llogarie paraqiten në Formatin nr. 3 Pasqyra e flukseve monetare ku gjatë vitit 2023 janë ngurtësuar fonde për garanci punimesh në vlerën 37,533,296 lekë dhe janë likuiduar për objekte të marra në dorëzim garanci punimesh në vlerën 7,790,897 lekë.

Konstatimi: Nga auditimi i pasqyrave financiare viti 2023, rezulton se llogaria 466 “Kreditore për mjetet në ruajtje” është për vlerën kontabël 109,230,756 lekë e rakorduar me Degën e Thesarit. Nga analiza e kësaj llogarie, konstatohet se janë të ngurtësuar fonde për vlerën 71,697,460 lekë të cilat i përkasin ngurtësimeve të viteve 2021 e përpara, duke ju kaluar afati i garancisë, për të cilat Bashkia nuk ka kryer asnjë veprim sipas kushteve të kontratës për c’bllokimin e këtyre fondeve dhe sistemimin e kësaj llogarie. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me udhëzimin e MFE nr. 08, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, i ndryshuar Kap. III, pikat 29, 30, 39, 50 dhe UKM nr. 3, datë 15.02.2011 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar, Kap. II, pika 10

Llogaria 467 “Kreditore të ndryshëm”, paraqiten detyrimet për fatura të palikujduara dhe vendime gjykatë të cilat për vitin 2023 paraqiten në vlerën 38,911,325 lekë, në mënyrë analitike paraqiten në pasqyrën Aneks nr 3, bashkëlidhur.

FONDI I KONSOLIDUAR në mbyllje të vitit ushtrimor 2023 paraqitet në vlerën 8,169,041,925 lekë, ndërsa në mbyllje të vitit ushtrimor 2022 paraqitet në vlerën 8,164,259,018 lekë. Diferenca prej 4,782,907 lekë është rritja e fondeve nga viti 2022 në vitin 2023.

Referenca e llogarive	EMERTIMI	Viti 2023	Viti 2022
A	AKTIVET	9,198,482,941	9,011,477,507
B	PASIVET	1,029,441,016	847,218,489
C	AKTIVET NETO/ FONDET (A-B)	8,169,041,925	8,164,259,018
D	FONDI I KONSOLIDUAR :	8,169,041,925	8,164,259,018
101	Teprica(Fondi I akumuluar)/Deficiti I akumuluar	5,140,140,128	5,236,826,721
12	Rezultatet e mbartura		
85	Rezultati I Veprimtarise Ushtrimore	891,478,493	1,385,184,123
„111	Rezerva		
115	Nga Fondet e veta te investimeve		
15	Shuma te parashikuiara per rreziqe e Zhvleresime		
105	Teprica e Granteve kapitale Te Brendshme	2,137,423,304	1,542,248,174
106	Teprica e Granteve kapitale Te Huaja		
107	Vlera e mjeteve te caktuara ne perdorim		
109	Rezerva nga Rivlersimi I Aktiveve Afatgjata		
	Te Tjera		
E	TOTALI I PASIVEVE (B+C)	9,198,482,941	9,011,477,507

Fondi i konsoliduar është i barabartë me fondet neto. Gjendja e Fondit të konsoliduar rezulton nga diferenca e shumës së aktiveve në vlerën 9,198,482,941 lekë me pasivet (detyrimet) në vlerën 1,029,441,016 lekë.

Analizë: Formati nr.2 “Pasqyra e performancës financiare” paraqet llogaritë e të ardhurave dhe shpenzimeve me klasifikim sipas natyrës ekonomike.

Analiza e llogarive të të ardhurave për vitin 2023, të cilat në total janë në vlerën 3,618,369,736 lekë, si dhe referuar akt-rakordimit me Degën e Thesarin Krujë paraqitet më poshtë:

Gjendja e llogarisë sintetike 70 “Të ardhurat nga nga taksat dhe tatimet” paraqitet në bilanc për vitin 2023 në vlerën 137,126,400 lekë, i cili kuadron me Aktrakordin me Thesarin në këtë zë të ardhurash sipas kodifikimit të Thesarit.

-Gjendja e llogarisë analitike 7002 “*Tatim mbi biznesin e vogël*” pasqyrohet në bilanc për vitin 2023 në vlerën 964,795 lekë e cila e cila rakordon me të njëjtin zë në aktrakordin me thesarin.

- Gjendja e llogarisë 7020 “*Tatim mbi pasurinë*” pasqyrohet në bilanc për vitin 2023 në vlerën 61,781,043 lekë e cila përfshin *taksën mbi ndërtesën dhe tokën*, e cila rakordon me të njëjtin zë në aktrakordin me thesarin.

-Gjendja e llogarisë analitike 7021 “*Tatim mbi shitjen e pasurisë së paluajtshme*” pasqyrohet në bilanc për vitin 2023 në vlerën 611,540 lekë e cila e cila rakordon me të njëjtin zë në aktrakordin me thesarin.

-Gjendja e llogarisë analitike 7029 “*Të tjera tatime mbi pasurinë*” pasqyrohet në bilanc për vitin 2023 në vlerën 5,745,258 lekë e cila e cila rakordon me të njëjtin zë në aktrakordin me thesarin.

-Gjendja e llogarisë analitike 7035 “*Taksë vendore mbi përdorimin e mallrave dhe lejim veprimtarie*” pasqyrohet në bilanc për vitin 2023 në vlerën 68,023,764 lekë e cila e cila rakordon me të njëjtin zë në aktrakordin me thesarin.

Gjendja e llogarisë sintetike 71 “Të ardhura jo tatimore” pasqyrohet në bilanc për vitin 2023 në vlerën 142,005,761 lekë e cila e cila rakordon me të njëjtin zë në aktrakordin me thesarin.

-Gjendja e llogarisë analitike 7109 “*Të tjera nga ndërmarrja dhe pronësia*” pasqyrohet në bilanc për vitin 2023 në vlerën 400,000 lekë e cila e cila rakordon me të njëjtin zë në aktrakordin me thesarin.

-Gjendja e llogarisë analitike 7110 “*Tarifë administrative dhe rregullatorë*” pasqyrohet në bilanc për vitin 2023 në vlerën 64,118,160 lekë e cila e cila rakordon me të njëjtin zë në aktrakordin me thesarin.

-Gjendja e llogarisë analitike 7111 “*Të ardhura sekondare e pagesa shërbimesh*” pasqyrohet në bilanc për vitin 2023 në vlerën 4,708,145 lekë e cila e cila rakordon me të njëjtin zë në aktrakordin me thesarin.

-Gjendja e llogarisë analitike 7113 “*Të ardhura nga shitja e mallrave dhe shërbimeve*” pasqyrohet në bilanc për vitin 2023 në vlerën 610,772 lekë e cila e cila rakordon me të njëjtin zë në aktrakordin me thesarin.

-Gjendja e llogarisë analitike 7115 “*Gjoha kamatëvonesa, sekuestrime zhdëmtime*” pasqyrohet në bilanc për vitin 2023 në vlerën 72,168,684 lekë e cila e cila rakordon me të njëjtin zë në aktrakordin me thesarin.

-Gjendja e llogarisë analitike 7200 “*Nga buxheti për NJQV*” pasqyrohet në bilanc për vitin 2023 në vlerën 2,446,417,166 lekë.

-Gjendja e llogarisë analitike 7204 “*Pjesëmarrje e institucioneve në tatime nacionale*” pasqyrohet në bilanc për vitin 2023 në vlerën 70,539,598 lekë.

-Gjendja e llogarisë analitike 7206 “*Financim i pritshëm nga buxheti*” pasqyrohet në bilanc për vitin 2023 në vlerën 818,698,481 lekë.

-Gjendja e llogarisë analitike 7207 “*Sponsorizime nga të tretët*” pasqyrohet në bilanc për vitin 2023 në vlerën 3,582,330 lekë.

Analiza e shpenzimeve në vitin 2023 , të cilat në total janë në vlerën 2,726,891,243 lekë paraqitet më poshtë:

Gjendja e llogarisë 600 “*Paga, shpërblime e të tjera personeli*” për vitin 2023, paraqitet në bilanc në vlerën 374,755,234 lekë.

Gjendja e llogarisë 601 “*Kontribute për sigurime*” për vitin 2023, paraqitet në bilanc në vlerën 61,911,651 lekë.

Gjendja e llogarisë 602 “*Blerje mallra e shërbime*” paraqitet në bilanc për vitin 2023 në vlerën 245,774,578 lekë.

Gjendja e llogarisë së fondeve 604 “Transferime korente te brendshme” paraqitet në bilanc për vitin 2023 në vlerën 31,990,784 lekë.

Gjendja e llogarisë së fondeve 606 “Transferime për Buxhetet familjare e Individe” paraqitet në bilanc për vitin 2023 në vlerën 1,259,724,018 lekë.

Ndryshim i gjendjes ë inventarit në vlerën (10,613,271) lekë.

Shpenzime të tjera në vlerën 763,348,249 lekë.

Për vitin 2023 totali i te ardhurave në vlerë është 3,618,369,736 lekë dhe totali shpenzimeve është 2,726,891,243 lekë. Diferenca e tyre në vlerën 891,478,493 lekë rakordon me gjendjen e llog.85 “Rezultatit e ushtrimit”

Pasqyra e flukseve monetare (F3)

Pasqyra e Flukseve Monetare, paraqet rrjedhën e likuiditeteve dhe gjendjen më datë 31.12.2023. Nga kontrollt e kryera rezultoi se teprica e llogarisë së likuiditeteve më datë 31.12.2023, e paraqitur në këtë pasqyrë rezulton në shumën 1,000,709,250 lekë dhe kuadron me tepricën e likuiditeteve të paraqitur në Pasqyrën e Pozicionit Financiar, në Aktiv llogarinë 520 “Mjetet monetare dhe ekujalentët e tyre” e cila paraqitet në shumën 1,000,709,250 lekë.

Transaksionet financiare të kryera nëpërmjet bankës janë regjistruar në mënyrë kronologjike në ditarin e bankës në bazë të urdhër-shpenzimeve të cilat ishin të nënshkruara nga nëpunësi autorizues dhe zbatues të konfirmuar nga nëpunësi i Thesarit dhe të vulosura nga të dy palët.

Përpilimi i urdhër-shpenzimeve ishte i bazuar në dokumentet vërtetues dhe autorizues sipas natyrës së shpenzimit si urdhër prokurimi, procesverbale, oferta, kontrata, fatura e furnitorit, preventiva, situacione, fletëhyrje, listpagesa, deklaratimet e tatimit mbi të ardhurat, formularët e përlllogaritjeve të kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore si nga punëdhënësi dhe nga punonjësi etj. Vlerat e shënuara në urdhër-shpenzim përputhen me vlerat e këtyre dokumenteve financiare që mbështesin këtë shpenzim.

Kontabilizimi i veprimeve ekonomike nëpërmjet bankës është bërë sipas natyrës së shpenzimeve.

-Mbajtja e kontabilitetit për hyrjet dhe daljet e materialeve bëhej në ditarin e magazinës, në formë dokumentare, regjistrim kontabël bëhej sipas dokumentacionit bazë si fletë-hyrjeve dhe fletë-daljeve të magazinës dhe faturave të shitësit.

Për veprimet dhe mosveprimet e trajtuara më sipër mban përgjegjësi NZ z. E.F. me detyrë Drejtor Financës, (Hartuesi i llogarive kontabël).

III. GJETJE REKOMANDIME.

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi konstatohet se gjendja e llogarisë 4342 “Operacione me shtetin (të drejta)”, në fund të vitit 2023 paraqitet në vlerën 87,032,453 lekë, e cila përfaqëson llogaritë e klasës 4 të Pasivit për paga, sigurime, tatime dhe furnitorë të ndryshëm, e cila nuk kuadron me Llogarinë 7206 “Financim i pritshëm nga buxheti” të Pasqyrës së Performancës Financiare, e cila paraqitet në shumën 813,698,481 lekë, në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr. 08, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësisve të Qeverisjes së Përgjithshme”, Kreu III. “Procedurat për përgatitjen, paraqitjen dhe konsolidimin e pasqyrave financiare në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” i ndryshuar, pika 32 (*Më hollësisht trajtuar në pikën 1, faqe 13-21 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

1.1.Rekomandimi: Drejtoria e Financës, Bashkia Krujë, të marrë masa për paraqitjen e saktë të vlerës së llogarisë 7206 “Financim i pritshëm nga buxheti” të Pasqyrës së Performancës Financiare, e cila paraqitet e mbivlersuar për vlerën 726,666,028 lekë, për të dhënë një informacion kontabël të besueshëm.

Me mbylljen e pasqyrave financiare viti 2024

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se për vitin 2023, nuk është kryer inventari fizik pasi llogaritë 212 “Ndërtesa e Konstruksione” dhe 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore”, nuk janë të analizuar, nuk ka një regjistër kontabël ku të specifikohen analitikët e këtyre zërave, si dhe nuk ka informacioni për secilin aktiv në lidhje me datën e hyrjes ose marrjes në dorëzim, përshkrimin e aktivitetit, vlerën e blerjes, datën e daljes në përdorim, datë e skadencës, personin përgjegjës, kohën e shërbimeve të mirëmbajtjes, vlerën e akumuluar të shpenzimeve të mirëmbajtjes, datën e daljes nga pronësia, etj. Në këto kushte nuk mund të ketë informacion të saktë në lidhje me gjendjen kontabël, e cila do të krahasohet dhe me gjendjen faktike kur bëhet inventarizimi fizik çdo vit për të vërtetuar dhe sistemuar vlerën e tyre në kontabilitet, sa më sipër nuk japin arsye që të kemi siguri mbi vlerat në pasqyrat e pozicionit financiar për sa i përket këtyre llogarive, për pasojë të mos japim dot një opinion mbi plotësinë, saktësinë dhe përkatësinë e këtyre vlerave në kontabilitet, veprime në kundërshtim me kërkesat e Udhëzimit të MF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” (me ndryshime) pikat 26, 28, 30, Kreu IV, pika 75 dhe Udhëzimit të MFE nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” i ndryshuar, Kreu II, “Parimet dhe rregullat e organizimit dhe të mbajtjes së kontabilitetit publik në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, pika 5.

Më hollësisht trajtuar në pikën 1, faqe 13-21 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

2.1.Rekomandimi: Drejtoria e Financës në Bashkinë Krujë, të marrin masa për mbylljen e procesit të inventarizimit të aktiveve të veta, të analizojë dhe të kryejë zbërthimin e dokumentacionit financiar e ligjor për nxjerrjen e të dhënave për aktivet e hyra në vite për të verifikuar, saktësuar e analizuar vlerat e paraqitura në pasqyrat financiare e në rast pasaktësisht të bëhen sistemimet e nevojshme në kontabilitet e në inventarin fizik.

Me mbylljen e pasqyrave financiare viti 2024

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi ka rezultuar se për Aktivet Aftat Gjata Materiale, të pasqyrave financiare Bashkia Krujë, nuk posedon titull pronësie, në kundërshtim me VKM nr. 510, datë 14.08.2001 “Për inventarizimin dhe hipotekimin e të gjitha pronave të paluajtshme dhe të luajtshme”, Kreu VI “Transferimi i pasurive dhe regjistrimi i pasurive të paluajtshme”, pika 1 dhe 2. Për rrjedhojë edhe kontabilizimi i aktiveve afatgjata materiale, nuk është mbështetur në dokumentacionin e duhur, në kundërshtim me Udhëzimit të MF nr. 30, datë 27.12.2011 me ndryshime, Kapitulli III, pika 35.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 1, faqe 13-21 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

3.1.Rekomandimi: Bashkia Krujë, të marrë masa të menjëhershme, që nëpërmjet strukturave të saj, të përgatisë dosjet me dokumentacionin e duhur për regjistrim në ASHK dhe nëpërmjet Drejtorisë së Financës të përlllogaritë kostot për kryerjen e këtij shërbimi, buxhetimin dhe burimet e financimit, me qëllim pajisjen sa më parë të pasurive të paluajtshme me titull pronësie.
Në vijimësi

4. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi është konstatuar se në llogaritë 431, “Detyrime ndaj shteti për tatim taksa”, e pasqyruar në bilanc për vlerën 2,595,717 lekë dhe 435, “Sigurime shoqërore” e pasqyruar për vlerën 9,771,380 lekë mbarten vlera për detyrime për tatim taksa në vlerën 1,167,003 lekë dhe sigurime shoqërore në vlerën 1,974,004 lekë që nuk janë të muajit dhjetor por detyrime të papaguara të periudhave të mëparshme me ndikim në informacionin kontabël që ofrojnë pasqyrat financiare në lidhje me plotësinë e vlerave të llogarive, në kundërshtim me Udhëzimit të MFE nr. 08, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësitë të Qeverisjes së Përgjithshme” i ndryshuar, Kreu II pika 5.

Më hollësisht trajtuar në pikën 1, faqe 13-21 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

4.1.Rekomandimi: Drejtoria e Financës, Bashkia Krujë, të marrë masa për paraqitjen e saktë të vlerave të llogarive 431 “Detyrime ndaj shteti për tatim taksa”, duke paksuar ë vlerën 1,167,003 lekë dhe llogarinë 435 “Sigurime shoqërore”, duke e paksuar për vlerën 1,974,004 lekë, që janë vlera të mbartura nga periudha të kaluara, për të dhënë një informacion kontabël të besueshëm.

Me mbylljen e pasqyrave financiare viti 2024

5.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i pasqyrave financiare viti 2023, rezulton se llogaria 466 “Kreditorë për mjetet në ruajtje” është për vlerën kontabël 109,230,756 lekë e rakorduar me Degën e Thesarit. Nga analiza e kësaj llogarie, konstatohet se janë të ngurtësuar fonde për vlerën 71,697,460 lekë të cilat i përkasin ngurtësimeve të viteve 2021 e përpara, duke ju kaluar afati i garancisë, për të cilat Bashkia nuk ka kryer asnjë veprim sipas kushteve të kontratës për c’bllokimin e këtyre fondeve dhe sistemimin e kësaj llogarie. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr. 08, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, i ndryshuar Kap. III, pikat 29, 30, 39, 50 dhe UKM nr. 3, datë 15.02.2011 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar, Kap. II, pika 10 (Më hollësisht trajtuar në pikën 1, faqe 13-21 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

5.1 Rekomandimi: Drejtoria e Financës në Bashkinë Krujë, për garancitë të cilat i përkasin ngurtësimeve të viteve 2021 e më parë (vlera 71,697,460 lekë), për të cilat nuk ka dokumentacion për përfitimin e tyre nga subjektet ose që janë në kushtet e parashkrimit, të procedojë sipas kërkesave ligjore pranë Degës së Thesarit, për rimarrjen e fondeve të ngurtësuar dhe përdorimin e tyre në interes publik.

Në vijimësi

C. MASA PËR ELIMIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E TË ARDHURAVE TË MUNGUARA.

1.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi rezultoi se në kredi të llogarisë 468 “Debitorë të ndryshëm”, nuk janë përfshirë detyrimet për taksën e ndikimit në infrastrukturë nga lejet e legalizimeve për vlerën 63,154,513 lekë, me ndikim në informacionin kontabël që ofrojnë pasqyrat financiare në lidhje me plotësinë e vlerave të llogarive, në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr. 08, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njërive të Qeverisjes së Përgjithshme” i ndryshuar, Kreu II pika 5. (Më hollësisht trajtuar në pikën 1, faqe 13-21 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

1.1.Rekomandimi: Drejtoria e Financës, Bashkia Krujë, të kontabilizojë vlerën prej 63,154,513 lekë si e ardhur e munguar për detyrimet që kanë subjektet për taksën e ndikimit në infrastrukturë nga lejet legalizimeve, me qëllim paraqitjen e raportimit financiar sipas situatës reale të saj si dhe duke ndjekur të gjitha rrugët ligjore me qëllim arkëtimin e të ardhurave të munguara.

Menjëherë e në vijimësi

D. MASA PËR ARKËTIMIN E DETYRIMEVE PËR DEBITORËT.

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi dhe analiza e llog. 468 “Debitorë të ndryshëm” rezulton se në fund të vitit 2022 paraqitet në shumën 702,662,238 lekë, ndërsa për vitin 2023 në shumën prej 833,117,807 lekë. Gjatë vitit 2023 shtesa prej 130,455,569 lekë vjen si rezultat i rritjes së debitorëve për taksa e tarifa vendore në vlerën 102,213,589 lekë dhe gjobat e IMTV në vlerën 28,241,980 lekë, rezulton se nuk janë marrë masat e duhura për uljen e detyrimeve debitorë dhe

rritjen e performancës në arkëtimin e taksave dhe tarifave vendore dhe gjobave. Veprime të cilat nuk janë në përputhje me Udhëzimi e MFE nr.8, datë 9.3.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme" kreu III pika 32, Kreu II pika 2/a, b, pika 22, me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar, kreu II, neni 12, pika 3/g/gj.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 1, faqe 14-31, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

1.1. Rekomandimi: Drejtoria e Financës, Bashkia Krujë, të ndjekë të gjitha rrugët administrative dhe ligjore për arkëtimin e debitorëve në fund të periudhës në vlerën 833,117,807 lekë.

Menjëherë e në vijimësi

D. MASA DISIPLINORE

Për punonjësit e ngarkuar me përgjegjësi në Raportin Përfundimtar të Auditimit, *nuk rekomandohet dhënia e masë disiplinore*, pasi masat janë ezauruar në auditimin e kryer për të njëjtën periudhë, sipas programit të auditimit nr. 35/1, datë 10.01.2024, të shprehura në **Vendimin e Kryetarit të KLSH nr. 76 datë 29.04.2024.**

Për sa më sipër paraqitet ky Raport Përfundimtar Auditimi Tematik.

KONTROLI I LARTË I SHTETIT



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në subjektin “Bashkia Berat”

RAPORTI PËRFUNDIMTAR AUDITIMI (TEMATIK)

“BASHKIA BERAT”
(Për pasqyrat pasqyrave financiare 2023)

Tiranë, Tetor 2024

Përmbajtja

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	3
I.1. Konkluzioni dhe Opinioni i Auditimit.	7
II. HYRJA	8
OBJEKTIVAT, FUSHËVEPRIMI DHE METODOLOGJIA.	8
1. Objektivat dhe qëllimi.	8
2. Identifikimi i çështjes.....	8
3. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese.....	9
4. Përgjegjësitë e audituesve.	9
5. Kriteret e vlerësimit	10
6. Standardet e auditimit	10
7. Metodatat e auditimit	11
8. Dokumentimi i auditimit.....	12
III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT	12
1. Informacion i përgjithshëm mbi subjektin “Bashkia Berat”	12
2. Auditim mbi vlerësimin e raportimit financiar, për të arritur në opinionin në se pasqyrat financiare për vitin 2023, japin një paraqitje të vërtetë e të drejtë të pozicionit financiar, performancës financiare dhe fluksit të parasë, bazuar në kuadrin rregullator në fuqi.....	13
IV. REKOMANDIME	28
V. ANEKSET	33
VI. LISTA E DOKUMENTEVE TË AUDITIMIT	Error! Bookmark not defined.

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

a. Përshkrim i shkurtër i institucionit:

Bashkia Berat, si të gjitha njësitë e tjera të vetëqeverisjes vendore ka kuadrin legjislativ dhe operues, bazë e të cilave janë ligji nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” dhe ligji nr.68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” i ndryshuar, krahas akteve të tjera ligjore, nënligjore dhe rregullatorë.

Rëndësia e auditimit financiar të Bashkisë Berat për periudhën e aktivitetit 2023, krahas detyrimit kushtetues dhe ligjor që konsiston në kontrollin e përdorimit dhe mbrojtjes së fondeve shtetërore nga organet e pushtetit vendor, pra njësitë e vetëqeverisjes vendore janë subjekt i kontrollit nga Kontrolli i Lartë i Shtetit, sipas legjislacionit në fuqi, qëndron në të bërit sa më transparente të veprimtarisë menaxhuese dhe administruese, për të rritur përgjegjshmërinë dhe llogaridhënien e të zgjedhurve dhe administratës publike, në funksion të rritjes së mirëqenies së qytetarëve.

b. Rëndësia e institucionit dhe e auditimit të tij.

Rëndësia e auditimit financiar të Bashkisë Berat për periudhën e aktivitetit 2023, krahas detyrimit kushtetues dhe ligjor që konsiston në kontrollin e përdorimit dhe mbrojtjes së fondeve shtetërore nga organet e pushtetit vendor, pra njësitë e vetëqeverisjes vendore janë subjekt i kontrollit nga Kontrolli i Lartë i Shtetit, sipas legjislacionit në fuqi, qëndron në të bërit sa më transparente të veprimtarisë menaxhuese, administruese dhe raportimit financiar, për të rritur përgjegjshmërinë dhe llogaridhënien e të zgjedhurve dhe administratës publike, në funksion të rritjes së mirëqenies së qytetarëve.

c. Qëllimi i auditimit ku përcaktohet dhe periudha nën auditim, paraqitja e objektivave të cilat janë të njëjta me drejtimit e auditimit të tij:

Për auditimin financiar, qëllimi është të vlerësohet nëse rezultatet dhe gjendja financiare e raportuar e subjektit që auditohet, si dhe përdorimi i burimeve është paraqitur saktë dhe në përputhje me rregullat e raportimit financiar, si në fushën e të ardhurave dhe atë të shpenzimeve. Qëllimi i auditimit të pasqyrave financiare është që ti bëhet e njohur nivelit drejtues të bashkisë, si dhe rritja e shkallës së besimit të përdoruesve të pasqyrave financiare, nëpërmjet shprehjes së një opinionit nga ana jonë nëse pasqyrat financiare janë përgatitur në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kornizën e zbatueshme të raportimit financiar, si një mekanizëm kontrolli për të siguruar përgjegjshmërinë në menaxhimin financiar.

Në përmbushje të qëllimit të auditimit, janë shqyrtuar çështjet e mëposhtme:

- Auditim mbi vlerësimin e raportimit financiar, për të arritur në opinionin në se pasqyrat financiare për vitin 2023,

d. Metodologjia e përdorur dhe metodat e mbledhjes dhe analizimit të të dhënave.

Është përdorur metoda e auditimit mbi bazë risku dhe me zgjedhje periudhash. Qasja audituese e KLSH-së është metodologji e bazuar në vlerësimin dhe menaxhimin e riskut të auditimit në subjektin që auditohet, e cila shërben për kryerjen e auditimit me efikasitet dhe efektivitet, duke u fokusuar në natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit në fushat materiale dhe që vlerësohen me nivel të lartë risku. Nën gjykimin profesional të audituesve të pavarur, bëhet përzgjedhja e kampioneve për ekzaminim në zërat e shpenzimeve dhe regjistrimit në pasqyrat financiare.

Vlerësimi bazuar në riskun dhe materialitetit. Nisur nga gjykimi dhe ndjeshmëria e zonave të llogarisë, duke ditur që materialiteti shpreh nivelin maksimal të devijimit, që audituesit e vlerëson si të mundshëm për të influencuar te përdoruesit e informacionit financiar, kemi përcaktuar materialitetit në masën 2% për të gjitha zonat e llogarisë të planifikuara për t’u audituar. Në

dhënien e opinionit kemi marrë parasysh nivelin e materialitetit prej 3,848 mijë lekë, i cili është llogaritur mbi zërin e shpenzimeve.

Për arritjen e konkluzionit vlerësues, janë përdorur teknikat e auditimi si: Kontrolli aritmetik. Kontrolli me anë të pjesëve justifikuese, Inspektimi fizik dhe kontrolli i gjendjeve ekzistuese, Kontrolli i vlerësimit, Konfirmim nga të tretët. Kontrolli sipas një treguesi, Verifikimi i transaksioneve Intervistimi, Raporte dhe informacione, Pyetësorët për vlerësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm.

e. Paraqitja e gjetjeve kryesore.

Nr. i gjetjeve dhe rekomandimeve. Në raportin përfundimtar janë formuluar 5 gjetje dhe rekomandime për masa organizative, 1 gjetje dhe rekomandime mungesë të ardhurash në shumën 581,285 mijë lekë dhe 1 gjetje dhe rekomandime për arkëtim debitorësh në vlerën 451,332 mijë lekë. *Gjetjet më të rëndësishme shpjegohen shkurtimisht sipas drejtimeve më poshtë:*

-Nga auditimi mbi verifikimin e marrjes së dokumentacioneve financiarë dhe regjistrimet kontabël të kryera nga Bashkia Berat si dhe në Njësitë vartëse, rezulton se; Drejtoria e Menaxhimit Financiar dhe të Ardhurave në Bashkia Berat dhe sektorët e financës në njësitë vartëse, regjistrimet e veprimeve kontabël, kryhen me program excel dhe jo me “Bartës informatik”, të cilët janë programe informatike të pamanipulueshme dhe të printueshme në çdo kohë. Veprimet e kryera nuk paraqesin besueshmëri duke bartur risk në vetvete pasi janë të ndryshueshme në çdo kohë, gjithashtu ndikojnë në pasaktësi të veprimeve kontabël e rrjedhimisht në rezultate jo korrekt. Kjo gjë çon dhe në mos kuadrim të drejtë dhe të saktë si dhe vonesa në kohë për gjetjen, korrektimin dhe sistemimin e gabimeve matematikore. Mungesa e programimit kompjuterik në hedhjen e të dhënave në shërbimin kontabël, ndikon në ngadalësimin e marrjes dhe përpunimit të informacioneve financiare, besueshmërinë e të dhënave, cilësinë dhe saktësinë e evidencave kontabël dhe të pasqyrave financiare.

-Nga auditimi i pasqyrave financiare të periudhës ushtrimore raportuese 2023 u konstatua se; në disa llogari nuk paraqesin në mënyrë të drejtë në pozicionin financiar gjendjen reale në datën 31.12.2023 konkretisht llog.(210); llog.(211); llog.(212); llog (520), si më poshtë vijon;

1. Llog.(210) “Toka, troje, terrene” nuk paraqet gjendjen reale sepse nga ana e Drejtorisë së Menaxhimit Financiar dhe të Ardhurave nuk janë hedh në kartelat e kontabilitetit asnjë prej vlerave të; a) trojeve nën objekt të objekteve si godina e re e Bashkisë dhe trualli përreth saj, ndërtesat e shkollave që ka në administrim, ndërtesat e shkollave dhe të zyrave në NjA, etj, sipas regjistrimit të aktiveve të pasqyruar në llogarinë 212 “Ndërtim e konstruksione”.

b) truallit të godinave të regjistruar në ASHK në pronësi të Bashkisë,

c) trojeve të cilat me VKM kanë kaluar në pronësi të Bashkisë Berat, si dhe nuk është kryer inventarizimi dhe vlerësimi i tyre, për të cilën duhej bërë sistemimi dhe kalimi në administrim në llogarinë përkatëse. Nga Bashkia Berat nuk janë reflektuar gjithashtu ndryshimet në këtë llogari sipas Vendimit të Këshillit të Ministrave VKM nr. 90 datë 22.02.2023, “Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurisë së paluajtshme, pronë private, që preket nga realizimi i projektit “Zgjerimi i varrezave publike ‘Burdullias’, Bashkia Berat”, për ndryshimet përkatëse në llogarinë 210, pasi me këtë akt ligjor ka kaluar për llogari të këtij projekti konkretisht: *Sipërfaqja tokë bujqësore (arë) në korridorin me gjerësi përgjithësisht 38 (tridhjetë e tetë) metra, në total 2,420 m² me nr. pasurie 4/149 në zonën kadastrale 8501 me vlerë 491,260 lekë.*

2. Llog 211 “Pyje, Kullota, Plantacione”, e cila pasqyron gjendjen e llogarisë për Bashkinë Berat dhe për 5 njësitë e varësisë në fund të 2022 paraqitet në vlerën 1,515,800 lekë, ndërsa në vitin 2023 paraqitet në vlerën 2,269,400 lekë ku në të cilën nuk është pasqyruar dhe sipërfaqja e pyjeve

dhe kullotave të kaluara me VKM Nr. 433 dt. 08.06.2016 “Për transferimin në pronësi të Bashkive të Pyjeve dhe të Kullotave Publike, sipas listave të inventarit dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish Komunave/Bashkive”, pika 3, shtojca me nr.1, e cila përmban, listën e inventarit të pyjeve dhe kullotave që transferohen në pronësi të Bashkisë Berat, me numrin rendor 1 (një) deri 1,149 (njëmijë e njëqind e dyzetë e nëntë). Lista përkatëse rezulton të jetë në 5,541 Hektarë e përbërë prej pyje, djerrë, kullotë, bimësi pyjore, vepra ujore, të cilat nuk janë evidentuar në Pasqyrat Financiare të Bashkisë Berat të vitit 2023 për këto aktive nuk ka dokumentacion pronësor dhe nuk është kryer verifikim fizik për vitin 2023.

3. Llog.(212) “Ndërtime e Konstruksione” nuk paraqet gjendjen reale sepse nuk disponohet asnjë lloj dokument pronësie për 1,153 objekte me sipërfaqe trualli nën objekt të objekteve prej 42,322,305 m² të trashëguara nga ish Komunat një numër të konsiderueshëm objektesh të cilat janë në verifikim për regjistrimin e tyre. Kjo vjen për arsye se një pjesë e objekteve janë të trashëguara dhe të mbartura nga njësitë që u shkrinë (ish/komunat) në periudhat raportuese para vitit 2015 të pa shoqëruar me kartela objekti. Në këto kushte duke qenë se ka mospërputhje në administrimin për çdo objekt të “Ndërtesave e Konstruksioneve” nga Bashkia Berat nga Sektori i Regjistrimit të Pronave, duhet që të bëhet hedhja në kontabilitet e objekteve dhe sipërfaqeve të regjistruara saktësimi objekteve, dokumentimi me kartelë objekti, inventarizim fizik i objektit, si dhe rivlerësim me normat për secilin objekt. Për sa më sipër Llog. 212 “Ndërtime e konstruksione” nuk paraqet një pamje reale për pasqyrat financiare të vitit 2023.

5. Llog.(520) “Disponibilitete në thesar” paraqitet në pasqyrat financiare në fund të vitit 2022 në shumën 301,168,981 lekë ndërsa në fund të vitit 2023 në shumën 311,912,376 lekë, shumë e cila ka kundërparti llog. 466 (kreditorë në ruajtje) e cila paraqitet në shumën 115,148,164 dhe llog. 85 (teprica e periudhës) e cila paraqitet në shumën 192,537,074 lekë Në ekstraktin e sistemit të Thesari llog. 520 paraqitet me vlerën 0 lekë edhe pse llog. 466 dhe llog. 85 paraqiten po në vlerë të njëjtë me të dhënat e paraqitura nga Bashkia Berat, pra ka një mosrakordim të llog. 520, në të dhënat e PF të Bashkia Berat me të dhënat e sistemit të Thesarit,

- Në llogarinë 26 “Pjesëmarrje në kapitalet e veta” paraqitet në vlerën 79,075,000 lekë me një nënvlerësim të llogarisë 26 Pjesëmarrje në kapitalet e veta” në vlerën 797,785,000 lekë, kjo pasi referuar ekstraktit historik Bashkia Berat zotëron 65.32 % të aksioneve në pjesëmarrje të Bashkisë Berat në “Ujësjiellës Kanalizime Berat SHA, ose 572,787 lekë/aksion dhe kapital në vlerë monetare prej 572,787,000 lekë.

-Nga auditimi dhe analiza e llog. 468 “Debitorë të ndryshëm” rezulton se në fund të vitit 2022 paraqitet në shumën 411,883,421 lekë, ndërsa për vitin 2023 në shumën prej 451,332,346 lekë. Gjatë vitit 2023 shtesa prej 39,448,925 lekë vjen si rezultat i rritjes së debitorëve për taksa e tarifa vendore të Bashkisë Berat dhe Njësive vartëse. Nga ana e drejtimit të Bashkisë Berat rezulton se nuk janë marrë masat e duhura për uljen e detyrimeve debitore dhe rritjen e performancës në arkëtimin e taksave dhe tarifave vendore.

Në këtë llogari rezulton se nuk janë përfshirë debitorët e tjerë që rrjedhin nga taksa e ndikimit në infrastrukturë, në vlerën nga e cila, shuma e gjeneruar gjatë vitit 2023 paraqitet në vlerën 6,142,563 lekë nga është arkëtuar shuma prej 259,553 dhe mbetet pa likuiduar vlera e detyrimit në shumën **5,883,010 lekë** për 186 persona në total. Ndërkohë që shuma totale progresive është për 1229 persona në vlerën e detyrimit total prej 35,470,263 lekë. Gjithashtu nuk janë përfshirë detyrimet nga subjektet të cilat kanë lidhur kontrata me AKBN-në për marrjen me qira për shfrytëzimin e fondit pyjor/kullor. Këto kontrata kanë detyrime të cilat deri më datë 31.12.2022 paraqiten në vlerën **126,595,000 lekë** për 7 subjekte të konstatuara e cila nuk është pasqyruar në llogarinë

përkatëse. Vlerë kjo e konstatuar nga auditimi i mëparshëm i përputhshmërisë në këtë Bashki. Pra shuma totale e debitorëve në Pasqyrat Financiare duhet të ishte **581,285,629 lekë**.

-Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion për kryerjen e procedurave të inventarizimit për vitin 2023 rezulton se; nga Bashkia Berat nëpunësi zbatues i njësisë publike, i caktuar nga titullari i njësisë publike, nuk ka hartuar regjistër kontabël të përditësuar të aktiveve që zotëron apo ka në administrim Bashkia Berat dhe njësitë në varësi, sipas formatit të Ministrisë së Financave.

-Nga auditimi i pasqyrave financiare dhe procedurave të inventarizimit të aktiveve për vitin 2023 në lidhje me zërin (Tokë, truall, pyje, kullota etj) të cilat paraqiten në kontabilitetin e Bashkia Berat, rezulton se; Nga Nëpunësi i Autorizuar në cilësinë e titullarit të njësisë publike dhe nga Drejtori Ekonomik në cilësinë e Nëpunësit Zbatues nuk janë marrë masat e duhura për ngritjen e komisioneve përkatës për verifikimin dhe vlerësimin e zërit troje, pyje e kullota për Bashkia Berat dhe njësitë në varësi.

f. Paraqitja e rekomandimeve kryesore:

Me qëllim zgjidhjen e problematikave të konstatuara nga gjetjet, janë dhënë disa rekomandime si vijon:

- Kryetari i Bashkisë Berat të marrë masa për pajisjen e Drejtorisë së Menaxhimit Financiar dhe të Ardhurave dhe Njësive Vartëse, me programe kompjuterike financiare për mbajtjen e kontabilitetit me qëllim shmangien e risqeve të mundshme të informacionit kontabël.

- Kryetari i Bashkisë Berat, të marrë masat e duhura që;

- Të ngrejë grup pune i cili të verifikoj, vlerësoj, dhe saktësoj të gjitha aktivet e llogarive të klasës 2 dhe të dokumentoj këto aktive sipas kuadrit ligjor për regjistrimin e pasurisë.
- Të ngrejë një grup pune me specialistë të fushës për kryerjen e inventarizimit dhe vlerësimin e aktiveve të llog. 212 “Ndërtesa Konstrukione” për NJA dhe nëpërmjet Drejtorisë së Menaxhimit Financiar dhe të Ardhurave të kryejë zbërthimin e dokumentacionit të trashëguar nga ish-Komunat për nxjerrjen e të dhënave për aktivet e hyra e veprimet me to në vite për të verifikuar, saktësuar e analizuar vlerat e paraqitura në bilancin e vitit 2015 e në rast pasaktësish të bëhen sistemimet e nevojshme në kontabilitet dhe në inventarin fizik.
- Të marrë masat e duhura për regjistrimin e pasurive të paluajtshme në Agjencinë Shtetërore të Kadastrës, me qëllim dokumentimin me akte pronësie të aktiveve kapitale në pasqyrat financiare të Njësive.
- Drejtoria e Menaxhimit Financiar dhe të Ardhurave të verifikojë të dhënat e aktiveve monetare në Thesar dhe të raportojë saktë gjendjen dhe situatën financiare të Bashkisë Berat.

- Bashkia Berat, Drejtoria e Menaxhimit Financiar dhe të Ardhurave të marrë masa për sistemimin në kontabilitet dhe regjistrimin e pjesëmarrjes 65.32% në kapitalin e aksioneve tek “Ujësjetllës Kanalizime Berat ShA me vlerë 572,787,000 lekë, në debi të llogarisë 26 “Pjesëmarrje në kapitalet e veta” dhe kredi të llogarisë financiare të klasës 5, për pjesëmarrjen me kapitalin e vet.

- Bashkia Berat, Drejtoria e Menaxhimit Financiar dhe të Ardhurave, të marrë masa për plotësimin e regjistrit të aktiveve që ka në pronësi, duke plotësuar të gjitha kërkesat e formatit të aprovuar për të ulur riskun e shpërdorimeve materiale të pasurisë së njësisë dhe për një menaxhimin sa më të mirë të tyre.

- Nga Bashkia Berat, Drejtoria e Menaxhimit Financiar dhe të Ardhurave, të kryhet analiza e situatës së aktiveve të Njësive, të vlerësohen këto asete, të plotësohen me dokumentacion pronësor, si dhe të kryhen reflektimet përkatëse në pasqyrat financiare, me qëllim vlerësimin e pronës dhe identifikimin e saj.

- Bashkia Berat, Drejtoria e Financës dhe Buxhetit, të marrë masat e duhura për paraqitjen reale të llogarisë 401-408, duke kontabilizuar vlerën **3,358,283 lekë** të debitorëve të taksës së ndikimit në infrastrukturë si dhe vlerën pre **126,595,000 lekë** për 7 subjekte nga qiraja për shfrytëzimin e fondit pyjor/kullor, me qëllim paraqitjen e raportimit financiar sipas situatës reale të saj.

Bashkia Berat, Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore, të marrë masa për nxjerrjen e njoftimit të vlerësimit tatimor për debitorët të cilët vijnë nga taksat dhe tarifavat vendore, duke ndjekur të gjitha rrugët për arkëtimin e detyrimeve në vlerën totale **581,285,629 lekë** me qëllim rritjen e performancës në arkëtimin e detyrimeve nga tatim-taksat vendore.

I.1. Konkluzioni dhe Opinioni i Auditimit.

OPINIONI I AUDITIMIT

Për auditimin e pasqyrave financiare:

Ne kemi audituar pasqyrat financiare përmbledhëse vjetore të konsoliduara të Bashkisë Berat për periudhën ushtrimore 01.01.2023-31.12.2023, ku përfshihet pasqyra e pozicionit financiar, performancës financiare, pasqyra e flukseve monetare, ndryshimeve në aktivet neto/fondet neto etj., në bazë testimesh, të dokumenteve që mbështesin shumatat dhe shpalosjet në to, ku u bë vlerësimi i parimeve kontabël të përdorura dhe vlerësimeve të bëra nga drejtuesit, si dhe vlerësimi i paraqitjes së përgjithshme të tyre si dhe shënimet dhe relacioni për llogaritë që shoqëronin këto pasqyra. *“Sipas opinionit tonë, pasi kemi marrë evidenca dhe dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit, shprehim një opinion të **opinion të kundërt¹** për llogaritë vjetore të subjektit Bashkia Berat, duke arritur në përfundimin se anomali të apo rastet e mospërputhshmërisë, individualisht ose së bashku, janë materiale dhe të përhapura, në llogaritë vjetore të vitit 2023”, të shprehura në bazën për opinion.*

Baza për opinionin e kundërt:

Në dhënien e opinionit, ne kemi marrë në konsideratë faktin se disa llogari, megjithëse nuk janë krijuar në periudhën ushtrimore të viteve objekt auditimi, nuk kanë pasur lëvizje në debi ose në kredi, përgjegjësi kjo e raportuesit për saktësinë dhe vërtetësinë e këtyre llogarive, e konkretisht;

- *Mos saktësimin e llogarive të klasës 2 dhe mos dokumentimi i aktiveve sipas kuadrit ligjor për regjistrimin e pasurisë;*

- *Mos plotësimin e regjistrit të aktiveve që ka në pronësi, sipas të gjitha kërkesat e formatit të aprovuar nga Ministria e Financave;*

- *Mos plotësimin me dokumentacion pronësor të të gjitha asetëve, si dhe mos reflektimet përkatëse në pasqyrat financiare, me qëllim vlerësimin e pronës dhe identifikimin e saj;*

- *Mos marrjen e masave për sistemin në kontabilitet dhe regjistrimin e pjesëmarrjes 65.32% në kapitalin e aksioneve tek “Ujësjellës Kanalizime Berat ShA me vlerë 572,787,000 lekë,*

- *Në llog. 401-408, nuk janë përfshirë debitorët e tjerë që rrjedhin nga taksa e ndikimit në infrastrukturë, në vlerën nga e cila, shuma e gjeneruar gjatë vitit 2023 paraqitet në vlerën 6,142,563 lekë nga është arkëtuar shuma prej 259,553 dhe mbetet pa likuiduar vlera e detyrimit në shumën **5,883,010 lekë** për 186 persona në total. Ndërkohë që shuma totale progresive është për 1229*

¹ **Opinion i kundërt.** Audituesi duhet të shprehë një opinion të kundërt: 1. kur audituesi ka marrë dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit dhe arrin në përfundimin se anomali të apo rastet e mospërputhshmërisë, individualisht ose së bashku, janë materiale, të përhapura, në llogaritë vjetore apo transaksionet në fjalë; ose 2. kur audituesi nuk është në gjendje për të marrë dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit ku të bazojë opinionin, dhe efektet e mundshme mbi llogaritë vjetore apo transaksionet të kësaj pamundësie janë materiale të përhapura.

persona në vlerën e detyrimit total prej 35,470,263 lekë. Gjithashtu nuk janë përfshirë detyrimet nga subjektet të cilat kanë lidhur kontrata me AKBN-në për marrjen me qira për shfrytëzimin e fondit pyjor/kullor. Këto kontrata kanë detyrime të cilat deri më datë 31.12.2022 paraqiten në vlerën **126,595,000 lekë** për 7 subjekte të konstatuara e cila nuk është pasqyruar në llogarinë përkatëse. Vlerë kjo e konstatuar nga auditimi i mëparshëm i përputhshmërisë në këtë Bashki. Pra shuma totale e debitorëve në Pasqyrat Financiare duhet të ishte **581,285,629 lekë**,
-Mos marrjen e masave për rritjen e performancës në arkëtimin e detyrimeve nga tatim-taksat në vlerën totale 581,285,629 lekë.

II. HYRJA

Mbështetur në ligjin nr. 154/14, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e KLSH”, në zbatim të Projektit dhe Programit të Auditimit nr. 894/4prot., datë 24.06.2024 “Auditim financiar në Bashkinë Berat”, i ndryshuar, të miratuar nga Kryetari i KLSH, nga data 26.06.2024–01.08.2024, në subjektin Bashkia Berat për periudhën e veprimtarisë nga 01.01.2023–31.12.2023, u krye “Auditim Financiar” nga Grupi i Auditimit me përbërje:

1. P.Gj., Përgjegjës Grupi,
2. E. M., anëtarë;

OBJEKTIVAT, FUSHËVEPRIMI DHE METODOLOGJIA.

1. Objektivat dhe qëllimi.

Objekti i auditimit financiar është dhënia e opinionit me siguri të arsyeshme, nëse për vitin 2023, transaksionet financiare dhe ngjarjet ekonomike janë raportuar drejt dhe saktë në pasqyrat financiare të subjektit të audituar, në referencë të kuadrit ligjor të raportimit financiar në fuqi.

Për auditimin financiar, qëllimi është të vlerësohet nëse rezultatet dhe gjendja financiare e raportuar e subjektit që auditohet, si dhe përdorimi i burimeve është paraqitur saktë dhe në përputhje me rregullat e raportimit financiar, si në fushën e të ardhurave dhe atë të shpenzimeve. Qëllimi i auditimit të pasqyrave financiare është që ti bëhet e njohur nivelit drejtues të bashkisë, si dhe rritja e shkallës së besimit të përdoruesve të pasqyrave financiare, nëpërmjet shprehjes së një opinionit nga ana jonë nëse pasqyrat financiare janë përgatitur në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kornizën e zbatueshme të raportimit financiar, si një mekanizëm kontrolli për të siguruar përgjegjshmërinë në menaxhimin financiar.

Në këtë fazë të auditimit, hartohet Projekt Raporti i auditimit, i cili përfshin dhënien e opinionit mbi bazën e vlerësimeve dhe të gjetjeve, si dhe dhënien e rekomandimeve për përmirësimin e veprimtarisë së Bashkisë Berat.

2. Identifikimi i çështjes.

Të përcaktojë nivelin e duhur të materialitetit, duke i mundësuar kryerjen e saktë të auditimit (ISSAI 13), nëpërmjet një pune audituese sistematike me zgjedhje dhe mbi bazë risku, duke saktësuar përputhshmërinë ligjore të akteve normative me qëllim që auditimi t’i shërbej subjektit në marrjen e masave në përmirësimin e punës në të ardhmen dhe për të bërë të mundur evidentimin në kohë të mangësive dhe shkeljeve për përmirësimin e gjendjes.

Raporti i auditimit, synon të identifikojë përmirësimin e rolit të njësisë vendore dhe përgjegjësive të saj, që burojnë nga kuadri ligjor dhe dispozitat në fuqi, për përmirësimin e vazhdueshëm të punëve dhe shërbimeve në dobi të komunitetit, në funksion të zbatimit të strategjive që orientojnë zhvillimin e Bashkisë Berat, si dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së shërbimit ndaj komunitetit në plotësimin e kërkesave dhe nevojave të tyre.

Saktësia, rregullshmëria, ndodhja e transaksioneve kontabël dhe regjistrimi i tyre me korrektësi dhe në përputhje me kuadrin e raportimit financiar në fuqi.

Në bazë të kriterëve të vlerësimit e gjykimit profesional, audituesit kanë bërë vlerësimin e rezultateve të testeve të kontrollit, analizimin dhe klasifikimin e gabimeve të zbuluara, si dhe është bërë vlerësimi i evidencave të grumbulluara përsa i përket mjaftueshmërisë dhe përshtatshmërisë për qëllimet e auditimit. Procedurat e kryera, varen nga gjykimi profesional i audituesit, përfshirë vlerësimin e rrezikut material, për shkak të mashtrimit apo gabimit që do përdoren për procedura auditimi që janë me të përshtatshme për rrethanat.

Nisur nga procedurat e ndjekura për auditim besojmë se evidencat e mbledhura janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të dhënë opinionin tonë mbi veprimtarinë ekonomiko-financiare të Bashkisë Berat.

3. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese.

Kryetari i Bashkisë Berat (Administratori i Përgjithshëm), në cilësinë edhe të Nëpunësit Autorizues (NA) dhe Drejtori i Drejtorisë së Menaxhimit Financiar dhe të Ardhurave, në cilësinë e Nëpunësit Zbatues (NZ), janë përgjegjës për përgatitjen e pasqyrave financiare në përputhje me kuadrin normativ të zbatueshëm të raportimit financiar në sektorin publik dhe për mirëfunksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, i cili garanton përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare. Gjithashtu, në cilësinë edhe të NA si dhe NZ, janë përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Bashkisë Berat, bazuar në ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, konkretisht neni 34/6, neni 65/1 dhe neni 91, pika 1.3.

NA i njësisë së vetëqeverisjes vendore, në cilësinë e titullarit të kësaj njësie është përgjegjës për menaxhimin financiar aktivitetin e bashkisë.

Titullarët e njësive publike përgjigjen për vendosjen e përmbushjen e qëllimeve dhe të objektivave të njësive publike, nëpërmjet krijimit të një sistemi të përshtatshëm dhe efektiv të menaxhimit financiar dhe kontrollit, si dhe përdorimit të fondeve publike, në mënyrë të ligjshme, me ekonomi, efektivitet dhe efizienz.

Këshilli i njësive së qeverisjes vendore, me vendim të veçantë, miraton të ardhurat dhe fondet buxhetore vjetore për njësitë e qeverisjes vendore dhe fondet speciale të tyre, me qëllim kryerjen e shpenzimeve për ushtrimin e funksioneve që kanë, si dhe huamarrjen, për financimin e projekteve të investimeve.²

Strukturat drejtuese të subjekteve të audituara kanë përgjegjësi që t’i dorëzojnë dokumentet zyrtare, shkresore apo elektronike, si dhe informacionin e kërkuar, në kushtet, afatet dhe strukturën e vendosur prej grupit të auditimit të KLSH.

4. Përgjegjësitë e audituesve.

Përgjegjësia jonë është që të shprehim një opinion në lidhje me pasqyrat financiare Bashkisë Berat në raport me aktet ligjore dhe nënligjore për buxhetin, menaxhimin financiar dhe kontrollin e brendshëm. Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit ISSAI sipas INOTSAI, të cilat kërkojnë që audituesi të respektojë kërkesat etike dhe të planifikojë dhe kryejë auditimin me qëllim arritjen e një sigurie të arsyeshme në dhënien e opinionit, sipas evidencës së kërkuar dhe të vënë në dispozicion të auditimit.

Audituesit kanë zbatuar parimet e auditimit financiar: Etika dhe pavarësia, Kontrolli i cilësisë, Menaxhimi i grupit të auditimit dhe aftësive të tyre, si dhe Parimet lidhur me konceptet bazë të

² Ligji nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, neni 15.

auditimit.

Gjithashtu, janë zbatuar pohimet rreth klasave të transaksioneve dhe ngjarjeve për periudhën nën auditim, si Përkatësia, Plotësia, Saktësia dhe vlerësimi, Periudha, Klasifikimi dhe kuptueshmëria, Ligjshmëria dhe rregullsia, Ekzistenca, Të drejtat dhe detyrimet, Plotësia, Vlerësimi dhe alokimi, Transaksionet, të drejtat dhe detyrimet.

Në cilësinë e audituesit të jashtëm publik, kemi përgjegjësinë për garantimin e sigurisë së arsyeshme, nëse veprimtaria e Bashkisë Berat është zhvilluar në përputhje me kriteret e paracaktuara, si dhe për të konkluduar me një raport auditimi që përfshin një opinion. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet mundëson identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mund të ekzistojë. Përveç standardeve ISSAI, audituesit e KLSH kanë aplikuar gjykimin dhe skepticizmin profesional gjatë veprimtarisë audituese.

Audituesit kanë përgjegjësi në identifikimin e çështjeve më të rëndësishme lidhur me auditimin e veprimtarisë së subjektit, në raport me kriteret e paracaktuara të auditimit, të nxjerra nga aktet ligjore, nënligjore, si dhe ato rregullative mbi të cilat subjekti i audituar mbështetet në ushtrimin e veprimtarisë së tij, me përjashtim të rasteve kur kuadri ligjor nuk lejon vënien në dispozicion të tyre për publikun ose në raste të rralla kur vetë ne vendosim që këto çështje nuk duhet të përfshihen në raport për shkak të pasojave negative që publikimi i tyre mund të sjellë në publikun e gjerë.

Audituesit kanë përgjegjësi që të zbatojnë parimet që lidhen me procesin e auditimit, të sanksionuara në ISSAI/IFPP-100 “*Parimet themelore të auditimit të sektorit publik*”, paragrafi 44-51.

5. Kriteret e vlerësimit

Auditimi është bazuar në ligjin nr. 154/14, datë 27.11.14 “*Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*”, Manualin e Auditimit Financiar, në kërkesat e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit, si dhe në referenca të tjera ligjore sa më poshtë:

- Në fushën e mbajtjes Kontabilitetit dhe Hartimit të Pasqyrave Financiare: VKM nr. 248, date 10.4.1998 “*Për miratimin e planit kontabël publik, për organet e pushtetit lokal, institucionet shtetërore, qendrore dhe lokale, si dhe te njërive që varen prej tyre*” i ndryshuar me VKM nr. 25, datë 20.01.2001; VKM nr. 783, datë 22.11.2006 “*Për përcaktimi i standardeve dhe të rregullave kontabël*”; VKM nr. 510, datë 10.06.2015 “*Për miratimin e procedurave për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve, personelit, aktiviteteve dhe çdo dokumentacion tjetër zyrtar në njësitë e qeverisjes vendore, të prekura nga riorganizimi administrativo-territorial*”; Udhëzimi i MF nr. 08, datë 09.03.2018 “*Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit e të pasqyrave financiare vjetore të njërive të Qeverisjes së Përgjithshme*” i ndryshuar; Udhëzimi përbashkët i Ministrisë të Çështjeve Vendore dhe Ministrisë Financiare nr. 3237 datë 16.07.2015 “*Për procedurat afatet kohore standardet dhe kriteret e plotësimit të dokumentacionit të nevojshëm për riorganizimin administrativo-territorial*”, udhëzimi i MFE nr. 26, datë 27.9.2019.

6. Standardet e auditimit

- ISSAI 100 “*Parimet themelore të auditimit të sektorit publik*”, i cili përcakton parimet themelore për auditimin e sektorit publik në përgjithësi; ISSAI 2000-2899 “*Udhëzues të Auditimit Financiar*”; ISSAI 2300 “*Planifikimi i auditimit të pasqyrave financiare*”; INTOSAI GOV 9100 “*Udhëzues mbi Standardet e Kontrollit të Brendshëm për Sektorin Publik*” si dhe INTOSAI GOV 9110 “*Udhëzues mbi raportimin e efektivitetit të kontroleve të brendshëm*”; INTOSAI “*Për implementimin e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit*, etj.; Standardet Kombëtare të Kontabilitetit; Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA) të Federatës Ndërkombëtare të kontabilistëve IFAC; etj. Standardet Ndërkombëtare të Auditimit mbi Raportimin e Audituesit të

Pavarur, (IFAC); Praktika të mira të fushës, si manualët e Gjykatës Evropiane të Audituesve, Kërkesat e Udhërrëfyesit të IDI-t etj.; Kodit Etik dhe Rregullorja e Procedurave të Auditimit të KLSH.

7. Metodatat e auditimit

Është përdorur metoda e auditimit mbi bazë risku dhe me zgjedhje periudhash. Qasja audituese e KLSH-së është metodologjia e bazuar në vlerësimin dhe menaxhimin e riskut të auditimit në subjektin që auditohet, e cila shërben për kryerjen e auditimit me efikasitet dhe efektivitet, duke u fokusuar në natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit në fushat materiale dhe që vlerësohen me nivel të lartë risku. Në gjykimin profesional të audituesve të pavarur, bëhet përzgjedhja e kampioneve për ekzaminim në zërat e shpenzimeve.

*Vlerësimi bazuar në riskun dhe materialitetin*³. Nisur nga gjykimi dhe ndjeshmëria e zonave të llogarisë, duke ditur që materialiteti shpreh nivelin maksimal të devijimit, që audituesit e vlerëson si të mundshëm për të influencuar te përdoruesit e informacionit financiar, kemi përcaktuar materialitetin në masën 2% për të gjitha zonat e llogarisë të planifikuara për t'u audituar.

Për arritjen e konkluzionit vlerësues, janë përdorur teknikat e auditimit:

- *Kontrolli aritmetik*. Duke konsideruar faktin se kontabiliteti konsiston në thelb në regjistrimin e fakteve në një formë numerike, si dhe në paraqitjen sintetike të tyre, por midis regjistrimit fillestar të fakteve dhe paraqitjes së tyre në formë sintetike, që janë edhe qëllimi i tij, bëhen një seri veprimesh që kanë të bëjnë me evidentimin në llogari, mbartjet, klasifikimin dhe rigrupimin. Kontrolli aritmetik u krye me qëllim që të sigurohemi nëse veprimet e llogaritjes dhe të hedhjeve në llogaritë përkatëse, që përfundojnë me nxjerrjen e gjendjeve sintetike, nuk përmbajnë asnjë gabim. (Ditari i kontabilizimit të urdhër shpenzimeve)

- *Kontrolli me anë të pjesëve justifikuese*. Edhe pse kontabilizimet nuk përmbajnë asnjë gabim aritmetik, ai mund të jetë i gabuar, nëse regjistrimet e bëra nuk korrespondojnë me realitetin. Kontrolli me zgjedhje të pjesëve justifikuese (Urdhër shpenzimeve) konstatoi nëse shifrat e kaluara kanë pasur justifikim të mjaftueshëm dokumentar. UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “*Mbi menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*”.

- *Inspektimi fizik dhe kontrolli i gjendjeve ekzistuese*. Konsistoi në ekzaminimin e aktiveve, të llogarive, të librave kontabël etj. Kontrolli kontabël i ushtruar ekzaminon përputhjen ndërmjet regjistrimit kontabël dhe pjesëve justifikuese përkatëse, duke u siguruar edhe për ekzistencën reale të aktiveve në subjekt.

- *Kontrolli i vlerësimit*. Kontrolli i vlerësimeve përcaktoi nëse vlerat që u atribuohen gjendjeve ekzistuese janë të sakta, nëse pasuritë duhet të qëndrojnë në bilanc me vlerat që u janë vendosur atyre.

- *Konfirmim nga të tretët*. Nëse subjekti që auditohet ka të konfirmuara (Rakorduar) me të tretët informacionet që vërtetojnë ekzistencën e operacioneve, detyrimeve, të tepcave ose të çdo regjistrimi tjetër.

- *Kontrolli sipas një treguesi*. Përdorimi i treguesve statistikorë me qëllim që të kërkohen fakte ose të dhëna “*jashtë normales*”, që përbëjnë tregues të parregullsive kontabël. Mund të përmendim: mungesa e pjesëve justifikuese, gabimet e shpeshta në datat, numrat, referencat e

³ *ISSAI 1320 (ISA 320) trajtojnë përgjegjësinë e audituesit për të zbatuar konceptin e materialitetit në planifikimin dhe kryerjen e një auditimi të pasqyrave financiare, në funksion të zbulimit dhe korrigjimit të anomalive. Një trajtim i tillë i ngjashëm mund të perdoret edhe në rastet e auditimit të përputhshmërisë, ku natyrisht një rol të rëndësishëm ka gjykimi profesional i audituesit.*

brendshme, të emrave, regjistrime pak të lexueshme, shifra të renditura keq, korrigjime të shumta të shifrave etj.

- *Verifikimi i transaksioneve* - është marrë informacioni për një rrethanë ose transaksion nga dy burime duke kryer krahasueshmërinë e tyre.

- *Intervistimi* - është përdorur gjatë marrjes verbale të informacionit nëpërmjet pyetjeve drejtuar personelit kyç të subjektit që auditohet.

- *Raporte dhe informacione* - janë shfrytëzuar raporte, analiza dhe informacione të cilat lidhen me objektivat e auditimit dhe çështjet për trajtim.

8. Dokumentimi i auditimit.

Është mbështetur në kërkesat e Manualeve të Auditimit Financiar dhe atij të përputhshmërisë, si edhe në Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit: ISSAI 1230 “*Dokumentimi i Auditimit*”, i mjaftueshëm për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit të kryera në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullatore.

Nga audituesit është përgatitur dokumentacioni i auditimit, i mjaftueshëm për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit, të kryera në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat ligjore dhe rregullatorë të zbatueshme. Rezultatet e këtyre procedurave dhe evidencat e marra gjatë auditimit, si dhe çështje të tjera të rëndësishme që dolën gjatë auditimit, janë reflektuar në përfundimet e arritura në drejtim të tyre sipas gjykimit dhe skepticizmit profesional që audituesit kanë shfrytëzuar në arritjen e këtyre konkluzioneve. Ky dokumentacion është i përshtatshëm dhe i rëndësishëm për të konfirmuar dhe mbështetur opinionet dhe raportin e Audituesve dhe ka shërbyer si një burim informacioni për përgatitjen e tyre.

Raporti Auditimit i dërgohet subjektit Bashkia Berat, pasi nga subjekti i audituar nuk është kthyer Projekt Raporti i Auditimit me ose pa observacione me konfirmimin mbi marrjen e tij, i cili është dërguar në subjekt me shkresën nr. 854/12, datë 09.08.2024.

III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT.

1. Informacion i përgjithshëm mbi subjektin “Bashkia Berat”

Zona Gjeografike: Bashkia Berat kufizohet në veri me bashkitë Kuçovë dhe Berat (Ura Vajgurore), në lindje me bashkinë Gramsh dhe Berat, në jug me bashkinë Poliçan, ndërsa në perëndim me bashkinë Mallakastër. Qyteti shtrihet përgjatë lumit Osum dhe rrëzë malit Tomor.

Popullsia: Sipas Çensusit të vitit 2011, bashkia numëron 60.031 banorë, ndërsa sipas Regjistrit Civil ajo numëron një popullsi prej 98.875 banorë. Bashkia ka një sipërfaqe prej 379.98 km².

Të dhëna të tjera: Bashkia e Beratit, pas ndarjes së re territoriale, është një bashkim mes qytetit dhe katër ish-komunave në afërsitë të tij, duke gërshetuar kështu karakteristika nga më të larmishmet.

Qyteti i Beratit, për shkak të historisë së tij mijërvjeçare si zonë e banuar, mbart vlera historike dhe arkitektonike të rralla, duke u përfshirë kështu në vitin 2008 dhe në listën qyteteve muze të mbrojtur nga UNESCO. Qendra Historike e qytetit, ku bëjnë pjesë tre lagjet muze “Kala”, “Mangalem”, “Goricë” dhe Qendra Mesjetare, përfshijnë rreth 490 monumente kulture. Vlerat historike, por dhe bukuria natyrore e qytetit të shtrirë përgjatë lumit Osum dhe rrëzë malit Tomor, po tërheqin gjithmonë dhe më shumë turistë përgjatë të gjitha stinëve, duke nxitur shumë nga

banorët të kthejnë shtëpitë e tyre karakteristike në bujtina për turistët dhe duke shtuar të ardhurat nga turizmi.

Bashkia e Beratit pas ndarjes së re territoriale është një bashkim mes qytetit dhe katër ish-komunave në afërsitë të tij, pra në total ka 5 njësi administrative si vijon: Njësia administrative Berat (qyteti), njësia administrative Velabisht, Otlak, Sinjë, Roshnik.

Misioni i Bashkisë Berat është të sigurojë qeverisjen në një nivel sa më afër qytetarëve. duke garantuar vetë-qeverisjes në përputhje me kërkesat e Kartës Evropiane të Autonomisë Vendore.

Synimi kryesor është plotësimi sa më i mirë i nevojave dhe kërkesave të komuniteteve përkatëse, nëpërmjet arritjes së një niveli sa më të lartë shërbimesh, në dobi të një zhvillimi të balancuar me qëllim përfundimtar standarde të larta të cilësisë së jetesës në territorin nën administrim.

Rëndësia e auditimit financiar të Bashkisë Berat për periudhën e aktivitetit të vitit 2023, krahas detyrimit kushtetues dhe ligjor që konsiston në kontrollin e përdorimit dhe mbrojtjes së fondeve shtetërore nga organet e pushtetit vendor, pra njësitë e vetëqeverisjes vendore janë subjekt i kontrollit nga Kontrolli i Lartë i Shtetit, sipas legjislacionit në fuqi, qëndron në të bërit sa më transparente të veprimtarisë menaxhuese dhe administruese, për të rritur përgjegjshmërinë dhe llogaridhënien e të zgjedhurve dhe administratës publike, në funksion të rritjes së mirëqenies së qytetarëve dhe zbatimin e kuadrit rregullator ligjor të raportimit financiar.

2. Auditim mbi vlerësimin e raportimit financiar, për të arritur në opinionin në se pasqyrat financiare për vitin 2023, japin një paraqitje të vërtetë e të drejtë të pozicionit financiar, performancës financiare dhe fluksit të parasë, bazuar në kuadrin rregullator në fuqi.

2.1. Plotësia dhe saktësia në pasqyrimin e përmbajtjes së ngjarjeve ekonomike.

2.2. Plotësia e shënimeve në pasqyrat financiare për të dhënë një pamje të përgjithshme të pozicionit financiar, performancës financiare dhe fluksit të parasë të njësisë.

2.3. Rregullshmëria e veprimeve të kryera nëpërmjet bankës, arkës dhe magazinës.

2.4. Verifikimi i inventarëve të aktiveve afatgjata materiale sa prej tyre janë me certifikatë pronësie.

2.5 Opinion mbi pasqyrat financiare.

Në zbatim të pikës 1 të programit të auditimit “Nr. 894/4prot, datë 24.06.2024 u kërkua për shqyrtim dokumentacioni si më poshtë:

1. Dokumentacioni i pasqyrat financiare, shënimet shpjeguese dhe ditarët përkatës të vitit 2023, hartimi dhe miratimi i tyre,

2. Ditarët e kontabilitetit për vitin 2023, regjistrat e llogarive analitike,

3. Rakordimet me thesarin për vitin 2023,

4. Dokumentacioni i mbajtur për kryerjen e procesit të inventarizimit të aktiveve për vitin 2023,

5. Vendime dhe urdhra të Bashkisë Berat në lidhje me të dhënat e pasqyrave financiare.

- *Dokumentacioni i regjistrimit të llogarive kontabël.*

- *Dokumentacioni mbi hartimin dhe miratimin e pasqyrave financiare.*

- *Dokumentacioni i mbajtur mbi përlllogaritjen, njohjen, pagesën dhe regjistrimin e detyrimeve.*

- *Dokumentacioni i mbajtur mbi debitorët dhe kreditorët.*

- *Dokumentacioni i mbajtur mbi realizimin e procesit të inventarizimit.*

- *Baza ligjore për mbajtjen e kontabilitetit dhe hartimin e pasqyrave financiare është:*

Ligji nr. 25/2018, datë 10.05.2018, “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, Ligji nr. 68, datë

227.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, UMFE nr. 05, datë 21.02.2022 “Për disa

ndryshime në udhëzimin e MFE nr. 08, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes

e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësisve të Qeverisjes së Përgjithshme, Ligji nr. 9936,

datë 26.06.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar;

Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar; VKM nr. 783, datë 22.11.2006, “Për përcaktimin e standardeve dhe rregullave kontabël”; Udhëzimi i Ministrisë së Financave nr. 31, datë 13.12.2023, “Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 9, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” si dhe dispozita ligjore të tjera rregulluese.

- Nxjerrja e pasqyrave financiare për vitin 2023.

Për vitin 2023, Pasqyrat financiare janë të nënshkruar nga NA dhe NZ si dhe janë të dërguara në Degën e Thesarit Berat për vitin ushtrimor 2023 me shkresë përcjellëse nr. 2251 prot., datë 28.03.2024. Në cilësinë e Nëpunësit Autorizues është Kryetari Bashkisë Berat z. E. D. dhe në cilësinë e Nëpunësit Zbatues është Drejtori Drejtorisë së Menaxhimit Financiar dhe të Ardhurave zj. R. Sh. e cila ka hartuar dhe pasqyrat vjetore të konsoliduara të Bashkisë Berat.

- Hartimi i pasqyrave financiare:

- **Për vitin 2023**, Në përputhje me kërkesat e UMFE nr. 05, datë 21.02.2022 “Për disa ndryshime në udhëzimin e MFE nr. 08, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njërive të Qeverisjes së Përgjithshme”, janë përgatitur pasqyrat financiare, dërguar Degës së Thesarit Berat me shkresat:

- Nr. 2238 prot., datë 30.04.2024, PF 2023 të konsoliduara për 6 Njësitë Shpenzuese të Bashkisë Berat.

- Nr. 1735 prot., datë 29.03.2024, PF 2023 të Njësisë Shpenzuese Bashkia Berat qendra.

- Nr. 200 prot., datë 25.03.2024, PF 2023 të Njësisë Shpenzuese Agjencia e Shërbimeve Publike,

- Nr. 208 prot., datë 28.03.2024, PF 2023 të Njësisë Shpenzuese Drejtoria Arsimore Bashkia Berat,

- Nr. 40 prot., datë 18.03.2024, PF 2023 të Njësisë Shpenzuese Qendra Kulturore “Margarita Tutulani”.

- Nr. 89 prot., datë 07.03.2024, PF 2023 të Njësisë Shpenzuese Drejtoria e Bujqësisë, Ujërave, Pyjeve dhe Shërbimit Veterinar.

- Nr. 90 prot., datë 19.03.2024, PF 2023 të Njësisë Shpenzuese Qendra “Lira” të përbëra si vijon:

- Format nr. 1 –Pasqyra e pozicionit financiar.

- Format nr. 2 –Pasqyra e performancës financiare (Klasifikimi sipas natyrës ekonomike).

- Format nr. 3 – Pasqyra e flukseve monetare (Cash-Flow).

- Format nr. 4 –Pasqyra e ndryshimeve në aktivet neto/fondet neto.

- Format nr. 5 –Pyetësor dhe shënimet shpjeguese.

- Format nr. 6 –Investimet dhe burimet e financimit.

- Format nr. 7/a –Gjendja dhe ndryshimi i aktiveve afatgjata (kosto historike).

- Format nr. 7/b –Gjendja dhe ndryshimi i aktiveve afatgjata (vlera neto).

- Format nr. 8 –Numri i punonjësve dhe fondi i pagave.

- Pasqyrat financiare të konsoliduara dhe Pasqyrat financiare të Njësisë Shpenzuese Bashkia Berat qendra janë të firmosura nga Kryetari i Bashkisë z. E. D. (*Nëpunësi Autorizues*) si dhe hartuesi i llogarive zj. R. Sh. (*Nëpunësi zbatues*) *Pasqyrat financiare të konsoliduara përbëhen nga PF të Bashkisë Berat si dhe të njërive shpenzuese në varësi e konkretisht:*

- Pasqyrat financiare të Njësisë Shpenzuese Agjencia e Shërbimeve Publike janë të firmosura nga Drejtori i NJ.SH. (*Nëpunësi Autorizues*) si dhe hartuesi i llogarive zj. K. S. (*Nëpunësi zbatues*).

- Pasqyrat financiare të Njësisë Shpenzuese Drejtoria Arsimore Bashkia Berat janë të firmosura nga Drejtori i NJ.SH. (*Nëpunësi Autorizues*) si dhe hartuesi i llogarive zj. E. M. (*Nëpunësi zbatues*).

- Pasqyrat financiare të Njësisë Shpenzuese Qendra Kulturore “Margarita Tutulani” janë të firmosura nga Drejtori i NJ.SH. (*Nëpunësi Autorizues*) si dhe hartuesi i llogarive zj. M. Sh.

(Nëpunësi zbatues).

- Pasqyrat financiare të Njesisë Shpenzuese Drejtoria e Bujqësisë, Ujërave, Pyjeve dhe Shërbimit Veterinar janë të firmosura nga Drejtori i NJ.SH. (Nëpunësi Autorizues) si dhe hartuesi i llogarive zj. Th. H. (Nëpunësi zbatues).
- Pasqyrat financiare të Njesisë Shpenzuese Qendra "Lira" janë të firmosura nga Drejtori i NJ.SH. (Nëpunësi Autorizues) si dhe hartuesi i llogarive zj. L. B. (Nëpunësi zbatues).

Nr	Njësia Shpenzuese	Titullari i Nj. Shp. (Nëpunësi Autorizues)	Shkresa e depozitimit në Degën e Thesarit Berat		Hartuesi i PF 2023 (Nëpunësi Zbatues)
			Nr. Prot.	Datë	
	Bashkia Berat e konsoliduar	E. D.	2238	30/04/2024	R. Sh.
1	Bashkia Berat qendra	E.D.	1735	29/03/2024	R. Sh.
2	Agjencia e Shërbimeve Publike	B. Ç.	200	25/03/2024	K. S.
3	Drejtoria e Arsimit Bashkia Berat	K. H.	208	28/03/2024	E. M.
4	Qendra Kulturore " M. Tutulani"	A. Q.	40	18/03/2024	M. K.
5	Drejtoria e Bujqësisë, Ujërave, Pyjeve dhe Shërbimit Veterinar	A. Sh.	89	07/03/2024	Th.H.
6	Qendra "Lira"	A. K.	90	19/03/2024	L. B.

Burimi: Drejtoria e Menaxhimit Financiar dhe të Ardhurave, Bashkia Berat.

- Mënyra e mbajtjes së kontabilitetit dhe dokumentacionit bazë e justifikues si dhe sigurimi i informacionit kontabël, përgatitjen e llogarive për vlerësimin e gjendjes pasurore, financiare dhe rezultatit.

Për tu siguruar nëse, regjistrimet kontabël janë kryer në përputhshmëri ligjore dhe me saktësi u kryen testime në regjistrimet në ditarët kontabël në lidhje me:

- Mbështetjen në dokumente justifikuese, të verifikuara përsa i përket vlefshmërisë për t'u pranuar në kontabilitet (vlerësimi kontabël);
- Mos ndryshueshmëria e regjistrimeve tashmë të kryera dhe e mbartësve të tyre;
- Tërësinë e regjistrimeve në mënyrë kronologjike dhe sistematike deri në mbyllje të të ushtrimit vjetor.
- Nëse informacioni kontabël mundëson, në të gjithë ciklin e tij, kontrollin rrjedhës dhe të mëvonshëm nëpërmjet:
- Shqyrtimit të vlefshmërisë së një regjistrimi fillestar duke e krahasuar me dokumentin bazë justifikues;
- Kontrollit të vlefshmërisë të një regjistrimi të kryer me anë të një dokumenti duke e krahasuar këtë dokument me dokumentet bazë justifikuese mbi të cilat është përgatitur;
- Verifikimit të pajtueshmërisë së shumave të nxjerra nga regjistrimet kronologjike me regjistrimet në llogari (barazimi i lëvizjeve të ditarëve me ato të librit të llogarive) dhe verifikimit të pajtueshmërive të tjera aritmetike.

- Pohimet e testeve të kryera rreth mbajtjes së kontabilitetit të Aparatit Bashkisë.

Si rezultat i testeve të kryera pohojmë se:

- Kontabiliteti është mbajtur i plotë për të gjitha veprimet kontabël të rezultuara nga kryerja e veprimeve ekonomike, mbi bazën e dokumentacionit bazë dhe justifikues.
- Në këtë bashki, kontabiliteti është organizuar dhe mbahet në mënyrë informatike në program "Excel" dhe jo me program të veçantë.

- Janë zbatuar drejt parimet e përgjithshme për përgatitjen e llogarive vjetore dhe mbajtjen e kontabilitetit, sipas përcaktimeve të dispozitave ligjore për kontabilitetin.

- Azhurnimet e veprimeve ekonomike janë në mënyrë kronologjike dhe kontabilizimet e tyre janë kryer në ditarët e bankës, të arkës, magazinës, të pagave dhe janë mbajtur partitarët për llogaritë kreditore e debitorë. Nuk është mbajtur libri i madh apo libri centralizator për evidentimin e veprimeve kontabël të kryera, duke kaluar nga ditarët në fletë-kontabilizimet apo kartelat kontabël deri në bilancin vërtetues rezultuar nga prerja e artikujve kontabël.

Këto libra kontabël janë bartës të informacionit të regjistruar në mënyrë kronologjike dhe sistematike të efekteve të veprimeve të kryera, të marra nga dokumentat vërtetuese.

-Në tërësi organizimi i mbajtjes së kontabilitetit ka mundur nxjerrjen e gjendjeve të llogarive sipas klasave, nisur nga dokumentet bazë justifikuese, të cilat janë të dhëna bazë të hyra në kontabilitet.

- Plotësimi i dokumenteve bazë e justifikues është bërë në mënyrë të plotë, pasi përshkruajnë me vërtetësi veprimin ose ngjarjen, përmban te dhëna për shkakun e veprimit, datën dhe vendin e kryerjes, objektin, treguesit sasiorë dhe ato të vlerës, personat që kanë urdhëruar dhe ekzekutuar veprimin me te dhënat të nevojshme që i japin dokumentit forcën e një provë ligjore ose administrative. Kështu: Dokumentat vërtetues si Urdhër-shpenzimi, fletë hyrje-daljet, mandat arkëtimet e pagesat, janë të hartuara me të gjitha elementet që kërkon formati i miratuar. Këto dokumente shoqërohen nga dokumente autorizues si me urdhrat apo vendimet e organeve drejtuese, kontratat, dokumentat kryesore të procedurave të prokurimit, akt-marrëveshjet etj. Bashkëlidhur këtij dokumentacioni janë dokumentat vërtetues të shpenzimit si faturat, listëpagesat, situacionet e shpenzimeve, procesverbalet, shkresat etj.

- Informacioni kontabël është përgatitur mbi bazën e një kontabiliteti të quajtur të angazhimeve (ose në bazë të të drejtave të konstatuara), duke dhënë elementet e nevojshme për të vlerësuar gjendjen pasurore, gjendjen financiare dhe rezultatet e njësisë ekonomike.

- Baza e dhënies së opinionit së Raportimit Financiar. Pohimet mbi saktësinë e paraqitjes së zërave të pasqyrave financiare.

Për dhënien e opinionit mbi pasqyrat financiare, u analizuan treguesit e pasqyrave financiare të Bashkisë për aktivitetin ekonomik - financiar 01.01.2023 deri më datën 31.12.2023.

Pasqyrat financiare janë përgatitur nga Drejtoria e Financës. Gjatë fazës së ekzekutimit në terren, u kryen teste të detajeve dhe teste thelbësore, nga ku u konstatua se janë mbartur saktë tepricat e llogarive dhe se tepricat në çelje për vitin 2023 rakordojnë me tepricat në mbyllje të vitit 2022.

Nga verifikimi gjendjes së llogarive të bilancit të vitit ushtrimor 2023 rezulton se, llogaritë e Aktivit dhe të Pasivit kuadrojnë me formatet anekse pjesë e PF, si dhe llogaritë sintetike kuadrojnë me ato analitike;

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion u analizuan të dhënat e disa prej llogarive kontabël konkretisht si më poshtë:

- Inventarizimi i aktiveve për vitin 2023 Bashkia Berat;

Inventarizimi i aktiveve është një element i rëndësishëm kontrolli në kuadrin e menaxhimit të aktiveve të njësisë i cili kryhet për të vërtetuar saktësinë, cilësinë e gjendjes fizike të aktiveve në një kohë të caktuar si dhe përdorimin në mënyrën e duhur dhe me eficiencë të tyre. Çdo njësi publike duhet të kontrollojë të paktën një herë në vit ekzistencën dhe vlerësimin e aktiveve afatgjata materiale dhe jo materiale, aktiveve afatshkurtra, të detyrimeve dhe të drejtave, nëpërmjet inventarizimit të këtyre elementëve dhe dokumentacionit mbështetës.

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion u konstatua se;

Dokumentacioni kontabël i veprimtarisë financiare, klasifikimi, përpunimi, ruajtja dhe mbajtja e kontabilitetit kryhet nëpërmjet programit excel. Nëpërmjet këtij formati Bashkia Berat, Agjencia e Shërbimeve Publike, Drejtoria e Arsimit, Qendra Kulturore “M. Tutulani”, Drejtoria e Bujqësisë, Ujërave, Pyjeve dhe Shërbimit Veterinar dhe Qendra “Lira”, mbajnë, përpunojnë dhe ruajnë të dhënat kontabël po në të njëjtin format pra në mënyrë manuale, duke paraqitur mos besueshmëri dhe risk për përmbajtjen e tyre.

Bazuar në ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, ligjin nr. 10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, Udhëzimin nr.30, datë 27.12.2011 të Ministrisë së Financave “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar, në zbatim të Urdhërave të Titullarit/Drejtuesve të 6 Njësive Shpenzuese të Bashkisë “Për inventarizimin e aktiveve afatgjatë, afatshkurtër e materiale për periudhën viti 2023”, në secilën njësi shpenzuese është ngritur komisioni për të kryer inventarizimin fizik të aktiveve në përdorim, si dhe për të krahasuar gjendjen konkrete të aktiveve me gjendjen kontabël, me anëtarë për Bashkinë Berat dhe Njësitë e varësisë sipas tabelës më poshtë:

Komisionet e inventarizimit fizik të aktiveve në 6 Njësitë Shpenzuese.

Nr	Njësia Shpenzuese	Titullari i Nj. Shp.	Urdhëri i Titullarit të Nj. Shp.		Anëtarët e Komisionit
			Nr	Datë	
1	Bashkia Berat qendra	E.D.	713	20.11.2023	M. N. S. K. M. T. B. A. F. K.
2	Agjencia e Shërbimeve Publike	B. Ç.	205	11/12/2023	B. H. E. M. P.Xh. R. H. D. F.
3	Drejtoria e Arsimit Bashkia Berat	K. H.	4	1/4/2023	P. D. A. T. A. Q.
4	Qendra Kulturore " M. Tutulani"	A. Q.	15	12/23/2023	M.K. I.J. A. Q. L. H. A. G.
5	Drejtoria e Bujqësisë, Ujërave, Pyjeve dhe Shërbimit Veterinar	A. Sh.	73	05/12/2023	M.M. M.C. Xh. C. M. C. R. M.
6	Qendra "Lira"	A. K.	22	20/11/2023	L. B. B. T. N. M. P. Z. A. Z.

Burimi: Drejtoria e Menaxhimit Financiar dhe të Ardhurave, Bashkia Berat.

Me urdhrin e Titullarit/Drejtuesve të 6 Njësive Shpenzuese të Bashkisë “Për ngritjen e komisionit për vlerësimin e aktiveve afatshkurtra dhe afatgjata”, në secilën njësi shpenzuese është ngritur

komisioni përkatës për vlerësimin e aktiveve afatshkurtra dhe afatgjata. Ky komision ka bërë vlerësimin dhe verifikimin e aktiveve afatshkurtra dhe afatgjata të inventarizuara në fund të vitit 2023 dhe duke hartuar proces-verbalin e vlerësimit. Në proces-verbal, vlera e materialeve të nxjerra jashtë përdorimit në total është për vlerën 5,429,914 lekë (*inventar ekonomik në vlerën 2,627,304 lekë (kosto historike 2,627,304 lekë, me vlerë të mbetur 149,541 lekë) dhe për inventarin e imët në vlerën 2,802,610 lekë*).

Nga auditimi rezultoi që mbajtja e kontabilitetit dhe funksionimi i llogarive sintetike me llogaritë analitike, në Bashkinë Berat, mbahet në mënyrë manuale, që e bën me risk të lartë për sa i përket sigurisë në saktësinë e informacionit që marrim nga ky sistem kontabiliteti pasi përdoret programi excel për ruajtjen dhe përpunimin e të dhënave kontabël të Njesisë dhe njësive të vartësisë. Drejtoria e Menaxhimit Financiar dhe të Ardhurave në Bashkia Berat dhe Agjencia e Shërbimeve Publike, Drejtoria e Arsimit, Qendra Kulturore “M. Tutulani” e njësitë e varësisë Drejtoria e Bujqësisë, Ujërave, Pyjeve dhe Shërbimit Veterinar dhe Qendra “Lira”, regjistrimet e veprimeve kontabël, kryhen me program excel dhe jo me “Bartës informatik”, të cilët janë programe informatike të pamanipulueshme dhe të printueshme në çdo kohë. Veprimet e kryera në këtë mënyrë ndikojnë në mosbesueshmërinë dhe riskun që bartin në vetvete këto programe duke qenë të ndryshueshme në çdo kohë, të cilat gjithashtu ndikojnë në pasaktësi të veprimeve kontabël e rrjedhimisht në rezultate jo korrekte. Kjo gjë çon dhe në mos kuadrim të drejtë dhe të saktë si dhe vonesa në kohë për gjetjen, korrektimin dhe sistemimin e gabimeve matematikore. Mungesa e programimit kompjuterik në hedhjen e të dhënave në shërbimin kontabël, ndikon në ngadalësimin e marrjes dhe përpunimit të informacioneve financiare, si dhe në cilësinë dhe saktësinë e evidencave kontabël dhe të pasqyrave financiare për të cilat mban përgjegjësi nëpunësi Autorizues z. E.D., zj. R.SH., zj. K.S., zj. E.M., zj M.S., zj Th.H.e zj. L.B., në cilësinë e nëpunësit zbatues. Veprime të cilat nuk janë në përputhje me Ligjin nr. 25/2018, “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, nenin 3, pikat 14 e 15 ku citohen se;

“Dokument kontabël” është dokumenti bazë, dokumenti plotësues dhe regjistrat (librat) kontabël, që përgatiten në letër të shkruar ose në bartës informatikë...
“Bartës informatik” është çdo dokument kontabël i autorizuar nga organet përkatëse, i shkruar në mjete kompjuterike, sipas programeve informatike të pamanipulueshme dhe të printueshme në çdo kohë.”

me nenin 11 ku citohet se;

Qëllimi i pasqyrave financiare. 1. Pasqyrat financiare hartohen në mënyrë të qartë, në përputhje me këtë ligj dhe standardet e aplikueshme të raportimit financiar, si dhe paraqesin me vërtetësi dhe besueshmëri pozicionin financiar, performancën financiare, ndryshimet në kapital/aktivet neto dhe flukset e mjeteve monetare të njësive ekonomike. 2. Pasqyrat financiare në këtë ligj u referohen pasqyrave financiare individuale dhe pasqyrave financiare të konsoliduara.

Vlera e materialeve të nxjerra jashtë përdorimit:

Nr	Njësia Shpenzuese	Totali i Aktiveve të dala nga përdorimi v. 2023	Aktive Afatgjata (Ilog 218) Inventar ekonomik		Aktive Afatshkurta (Ilog 327)
		Kosto historike	Kosto historike	Vlera e mbetur	
1	Bashkia Berat qendra (Aparati + MZSH + Njësia Administrative)	4,691,754	2,627,304	149,541	2,064,450
2	Agjencia e Shërbimeve Publike	301,344	0	0	301,344

3	Drejtoria Arsimore Bashkia Berat	0	0	0	0
4	Qendra Kulturore " M. Tutulani "	0	0	0	0
5	Qendra "Lira"	188,610			188,610
6	Drejtoria e Bujqësisë	248,206	0	0	248,206
	Totali	5,429,914	2,627,304	149,541	2,802,610

Burimi: Drejtoria e Menaxhimit Financiar dhe të Ardhurave, Bashkia Berat.

Gjendja e llogarive të bilancit në fund të vitit 2023, paraqitet në Aneksin nr. 1, pika 1, "Pasqyra e pozicionit financiar viti 2023, Bashkia Berat, bilanci i konsoliduar".

Në lidhje me verifikimin e disa vlerave të pasqyruara në llogaritë e pasqyrave të pozicionit financiar të vitit ushtrimor 2023, të saktësisë dhe besueshmërisë së tyre, u audituan referencat e llogarive të aktivitetit dhe të pasivitetit, si në vijim.

-Llogaria 520 (Disponibilitete në thesar) paraqitet në pasqyrat financiare në fund të vitit 2022 në shumën 301,168,981 lekë ndërsa në fund të vitit 2023 në shumën 311,912,376 lekë, shumë e cila ka kundërpartit llog. 466 (kreditorë në ruajtje) e cila paraqitet në shumën 115,148,164 dhe llog. 85 (teprica e periudhës) e cila paraqitet në shumën 192,537,074 lekë Në ekstraktin e sistemit të Thesarit llog. 520 paraqitet me vlerën 0 lekë edhe pse llog. 466 dhe llog. 85 paraqiten po në vlerë të njëjtë me të dhënat e paraqitura nga Bashkia Berat, pra ka një mosrakordim të llog. 520, në të dhënat e PF të Bashkia Berat me të dhënat e sistemit të Thesarit, veprim i cili nuk është në respektim të kërkesave të UMF nr. 8, datë 9.03.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme", Kap. III, pikat 30, 50.

pika 30. "Çdo njësi e qeverisjes së përgjithshme kryen verifikimin fizik të aktiveve dhe elementeve të tjera, konform kritereve të përcaktuara në aktet ligjore e nënligjore, si dhe saktëson vërtetësinë e llogarive të drejtave e të detyrimeve ndaj të tretëve. Mbi këtë bazë, në kontabilitet, bëhen veprimet për sistemimin e diferencave të gjendjes fizike me gjendjen kontabël për llogari të vitit kontabël që mbyllet",

Pika 50. "Tepricat e llogarisë 520, "Disponibilitete në thesar" dhe të llogarisë 466, "Kreditorë për mjete në ruajtje" duhet të vërtetohen me akt rakordim me thesarin, një kopje e të cilit i bashkëngjitet llogarisë vjetore. Në akt rakordim, tepricat duhet të paraqiten të strukturuar sipas natyrës së të ardhurave të trashëguara (të ardhurat e papërdorura, si të çelura ashtu edhe ato të paçelura, mjetet në ruajtje, sponsorizimet dhe pjesën e grantit që trashëgohet)".

Llogaritë e klasës 5, kanë funksionuar duke u debituar për shtesat në kredi të llogarive përkatëse për të ardhurat dhe grande të ndryshme, si dhe duke u kredituar për pakësimet në debi të llogarive përkatëse të klasës 4.

Llogaritë e Klasës 3 "Gjendje inventari qarkullues", përbëhet nga:

Llogaritë kontabël	Emërtimi i llogarive	Viti 2023	Viti 2022	Diferenca 2023-2022
31	Materiale	51.518.679	38.271.771	(13,246,908)
32	Inventar i imet	96.903.382	99.403.488	2,500,106
35	Mallra	188.594	85.455	(103,139)
	Totali	148.610.655	137.760.714	(10,849,941)

Burimi: Drejtoria e Menaxhimit Financiar dhe të Ardhurave, Bashkia Berat.

Llogaritë e Klasës 3, sipas Pasqyrës së Pozicionit Financiar të Bashkisë Berat në 31.12.2023 paraqiten në vlerën 148,610,655 lekë dhe përbëhen nga llogaria kontabël 31 "Materiale" në vlerën 51,518,679 lekë, nga llogaria 32 "Inventar i imet" në vlerën 96,903,382 lekë dhe nga llogaria "Mallra" në vlerën 188,594 lekë. Diferencat me vitin e mëparshëm përfaqësojnë lëvizjen e

inventarit në shumën (10,849,941) lekë e cila kuadron me llogarinë 63 “Ndryshimi gjendjes së inventarit” në shumën 10,849,941 lekë.

Llogaria 31 “Materiale”, ka vlerën 51,518,679 lekë, krahasuar me vitin e mëparshëm vjen me ulje në vlerën 13,246,908 lekë.

Llogaria 32 “Inventarë i imët”, ka vlerën 96,903,382 lekë, krahasuar me vitin e mëparshëm vjen në rritje për vlerën 2,500,106 lekë.

Llogaritë e klasës 3 kanë funksionuar duke u debituar për shtesat në kredi të llogarisë 63 “Ndryshimi i gjendjeve të inventarit” dhe duke u kredituar për daljet e inventarit në debi të llogarisë 63 “Ndryshimi i gjendjeve të inventarit”.

Llogaritë e Klasës 4 “Llogari të arkëtueshme” & “Të tjera aktive afatshkurtra” përbëhet nga:

Llogaritë kontabël	Emërtimi i llogarive	Viti 2023	Viti 2022	Diferenca 2023-2022
	Llogari të arkëtueshme	583.385.140	469.744.117	113.641.023
468	Debitorë të ndryshëm	451.332.346	411.883.421	39.448.925
4342	Te tjera operacione me shtetin (te drejta)	132.052.794	57.860.696	74.192.098
	Të tjera aktive afatshkurtra	18.575.326	209.536.764	-190.961.438
486	Shpenzime të periudhave të ardhshme	18.575.326	209.536.764	-190.961.438

Burimi: Drejtoria e Menaxhimit Financiar dhe të Ardhurave, Bashkia Berat.

Llogaria 4342 “Të tjera operacione me shtetin (të drejta)”, në fund të vitit 2023 paraqitet në vlerën 132,052,794 lekë, e cila përfaqëson llogaritë e Klasës së 4 të Pasivit të Pasqyrës Financiare të Pozicionit Financiar dhe nuk kuadron me Llogarinë 7206 “Financim i pritshëm nga buxheti” të Pasqyrës së Performancës Financiare e cila paraqitet në shumën 124,729,162 lekë.

Në mënyrë analitike paraqitet:

Emërtimi i llogarive	Vlera
Llogari 401-408 “Furnitor e llogari të lidhura me to”	10,850,191
Paga personeli llog 42	36,972,645
Tatim mbi të ardhurat llog. 431	2,361,636
Sigurime shoqërore llog.435	1178
Sigurime shëndetësore llog.436	1,510,228
Totali	62,701,608

Burimi: Drejtoria e Menaxhimit Financiar dhe të Ardhurave, Bashkia Berat.

- Gjendja e llogarisë 4342 “Të tjera operacione me shtetin (të drejta)”, në fund të vitit 2023 paraqitet në vlerën 132.052.794 lekë, e cila përfaqëson llogaritë e Klasës së 4 të Pasivit të Pasqyrës Financiare të Pozicionit Financiar dhe nuk kuadron me Llogarinë 7206 “Financim i pritshëm nga buxheti” të Pasqyrës së Performancës Financiare e cila paraqitet në shumën 124,729,162, në kundërshtim me udhëzimin e MFE nr. 08, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësisve të Qeverisjes së Përgjithshme”, Kreu III. “Procedurat për përgatitjen, paraqitjen dhe konsolidimin e pasqyrave financiare në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” i ndryshuar, pika 32.

Llogaritë 468 “Debitorë të ndryshëm”, në fund të vitit 2023 paraqitet në vlerën 451,332,346 lekë. Vlera e debitorëve në vitin 2023 në krahasim me vitin 2022 ka pësuar një rritje prej 39,448,925 lekë. Analiza e gjendjes së llog. “Debitorë të ndryshëm” paraqiten në pasqyrën Aneksin nr. 1,

bashkëlidhur. Nga ana e drejtimit të Bashkisë Berat rezulton se nuk janë marrë masat e duhura për uljen e detyrimeve debitore dhe rritjen e performancës në arkëtimin e taksave dhe tarifave vendore. *Veprime jo në përputhje me Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar, kreu II, neni 12, pika 3/g/gj.*

-Llogari të Arkëtueshme Llogaria 468 "Debitorë të ndryshëm".

-Nga auditimi i pasqyrave financiare në lidhje me llogaritë 468 dhe 401-408, rezulton se; Llogaria 468 në fund të vitit 2022 paraqitet në shumën 411,883,421 lekë, ndërsa për vitin 2023 në shumën prej 451,332,346 lekë. Gjatë vitit 2023 shtesa prej 39,448,925 lekë vjen si rezultat i rritjes së debitorëve për taksa e tarifa vendore të Bashkisë Berat dhe Njësive vartëse. Nga ana e drejtimit të Bashkisë Berat rezulton se nuk janë marrë masat e duhura për uljen e detyrimeve debitore dhe rritjen e performancës në arkëtimin e taksave dhe tarifave vendore.

Nga analiza e llog. 468 "Debitorë të ndryshëm" rezulton se nuk janë përfshirë debitorët e tjerë që rrjedhin nga taksa e ndikimit në infrastrukturë, në vlerën nga e cila, shuma e gjeneruar gjatë vitit 2023 paraqitet në vlerën 6,142,563 lekë nga është arkëtuar shuma prej 259,553 dhe mbetet pa likuiduar vlera e detyrimit në shumën **5,883,010** lekë për 186 persona në total. Ndërkohë që shuma totale progresive është për 1229 persona në vlerën e detyrimit total prej 35,470,263 lekë. Gjithashtu nuk janë përfshirë detyrimet nga subjektet të cilat kanë lidhur kontrata me AKBN-në për marrjen me qira për shfrytëzimin e fondit pyjor/kullor. Këto kontrata kanë detyrime të cilat deri më datë 31.12.2022 paraqiten në vlerën 126,595,000 lekë për 7 subjekte të konstatuara e cila nuk është pasqyruar në llogarinë përkatëse. Vlerë kjo e konstatuar nga auditimi i mëparshëm i përputhshmërisë në këtë Bashki. Pra shuma totale e debitorëve në Pasqyrat Financiare duhet të ishte **581,285,629 lekë** (451,332,346+3,358,283+126,595,000). **Nga sa më sipër rezulton se llogaria 468 (debitorë të ndryshëm) nuk paraqet pamjen reale në raportimin financiar të Njesisë Berat.** *Veprime të cilat nuk janë në përputhje me Udhëzimi e MFE nr.8, datë 9.3.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme" kreu III pika 32, Kreu II pika 2/a, b, pika 22, me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar, kreu II, neni 12, pika 3/g/gj, Rregullore e brendshme e funksionimit të Bashkia Berat, miratuar me vendimin pa nr., pa nr. prot, datë 25.02.2019, Kreu VI, neni 36, pika 2.3.*

Taksa e ndikimit në infrastrukturë				
Viti	Persona	Vlera e taksës së ndikimit në infrastrukturë	Vlera e arkëtuar	Vlera e detyrimit
Deri më datë 31.12.2022	1229	48,995,273	13,525,010	35,470,263
2023	186	6,142,563	259,553	5,883,010
Totali/Progresiv	1415	55,137,836	13,784,563	41,353,273

Burimi i të dhënave: Bashkia Berat.

Nga të dhënat e tabelës më sipër pasqyrohet vlera e taksës së ndikimit në infrastrukturë nga e cila vlera e detyrimit progresiv ndër vite deri në fund të vitit 2022 paraqitet në shumën 35,470,263 lekë për 1,229 subjekte. Gjatë vitit 2023 janë shtuar 186 subjekte për vlerën 6,142,563 lekë nga të cilat janë arkëtuar 259,553 lekë dhe vlera e detyrimit të mbetur për vitin 2023 është në shumën 5,883,010 lekë e cila nuk është reflektuar në Pasqyrat financiare të vitit 2023.

-Llogaritë 401-408 "Furnitorë e llogari të lidhura me to" në fillim të vitit 2022 rezulton për vlerën 4,758,296 lekë dhe në fund të vitit 2023 është në vlerën 10,850,191 lekë ose me një rritje në vlerën 6,091,895 lekë.

-Aktivet Afatgjata Materiale.

Llog 210 “Toka, troje terrene” e cila pasqyron gjendjen e llogarisë për Bashkinë Berat dhe për 5 njësi të varësisë, në fund të 2023 rezulton në vlerën 33,763,064 lekë, në 2023 rezulton po në vlerën 33,763,064 lekë pra nuk ka as shtesa e as pakësime në këtë llogari, konkretisht si më poshtë;

Llog 210 “Toka, troje Terrene”

Lëvizjet e llogarisë	Njësitë Shpenzuese						
	Vlera në lekë	Bashkia qendra	Agjencia e Shërbimeve Publike	Drejtoria e Arsimit	Qendra Kulturore " M. Tutulani"	Drejtoria e Bujqësisë	Qendra "Lira"
Gjendja në 01.01.2023	33,763,064	33,502,064	-	-	2610	-	-
Shtesa gjatë vitit 2023 (D)	-	-	-	-	-	-	-
Pakësime gjatë vitit 2023 (K)	-	-	-	-	-	-	-
Gjendja në 31.12.2023(D)	33,763,064	33,502,064	-	-	2610	-	-

Burimi: Drejtoria e Menaxhimit Financiar dhe të Ardhurave, Bashkia Berat.

Llog analitike 210 “Toka, troje Terrene”

NR.	EMERTIMI	Gjendja me 31.12.2022	Shtesa viti 2023	Pakësime Viti 2023	Gjendja me 31.12.2023
	TOKA TROJE TERRENE	33,763,064	-	-	33,763,064
1	Bashkia Berat qendra	33,502,064	-	-	33,502,064
2	Agjencia e Shërbimeve Publike	-	-	-	-
3	Drejtoria e Arsimit	-	-	-	-
4	Qendra Kulturore " M. Tutulani"	2610	-	-	2610
5	Drejtoria e Bujqësisë, Ujërave, Pyjeve dhe Shërbimit Veterinar	-	-	-	-
6	Qendra "Lira"	-	-	-	-

Burimi: Drejtoria e Menaxhimit Financiar dhe të Ardhurave, Bashkia Berat.

Nga auditimi mbi dokumentacionin e vendosur në dispozicion nga Sektori i Regjistrimit të Pronave (SRP) të krahasuara me kartelat në kontabilitet të Drejtorisë së Menaxhimit Financiar dhe të Ardhurave për truallin nën objekt të objekteve të administruara në llog.(210) “Toka, troje terrene” u konstatua se; Bashkia Berat, sipas DRP ka në administrim gjithsej 1,169 objekte ndërtesa dhe konstruksione të ndryshme me sipërfaqe trualli nën këto objekte prej 42,360,207 m², nga të cilat dokument të pronësisë (çertifikatë, apo vërtetim hipotekor) disponohen vetëm për 16 objekte me sipërfaqe trualli nën këto objekt të objekteve prej 37,902 m², kurse për 1,153 objekte me sipërfaqe trualli nën objekt të objekteve prej 42,322,305 m² nuk disponohet asnjë lloj dokument pronësie. Nga këto, Drejtoria e Menaxhimit Financiar dhe të Ardhurave ka të administruara në kontabilitet 37,902 m² të truallit nën objekt të objekteve. Në këto kushte për mospërputhjet në administrimin për çdo truall të “Toka, troje, terrene” nga Bashkia Berat duhet që patjetër të kryejë sistemimin e llogarisë 210 “Toka, Troje, Terrene” duke bërë që në këtë llogari të paraqitet, vlera e trojeve të ndërtesave të pasqyruar në llogarinë 212 “Ndërtime e konstruksione”, vlera e trojeve të cilat me VKM të posaçme kanë kaluar në pronësi të Bashkisë Berat, vlera e truallit dhe ndërtesave të regjistruara në Agjencinë Shtetërore të Kadastrës (ASHK) Berat si dhe inventarizimi i trojeve me komision përkatës. Në këtë llogari nuk është pasqyruar VKM nr. 90 datë 22.02.2023, “Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të passurisë së paluajtshme, pronë private, që preket nga realizimi i projektit “Zgjerimi i varrezave publike ‘Burdullias’, Bashkia Berat”, për ndryshimet përkatëse në llogarinë 210, pasi me këtë akt ligjor ka kaluar për llogari të këtij projekti konkretisht: -Sipërfaqja tokë bujqësore (arë) në korridorin me gjerësi përgjithësisht 38 (tridhjetë e tetë) metra, në total 2,420 m² me nr. pasurie 4/149 në zonën kadastrale 8501 me vlerë 491,260 lekë; vlerë e cila duhet të pasqyrohet në PF.

Më poshtë po paraqesim të dhënat e marra nga drejtoria e pronave për Bashkinë Berat:

Nr	Emërtimi	Gjithsej		Të pa Regjistruara		Të Regjistruara	
		Nr. objekt	Sipërfaqe Trualli në m2	Nr. objekt	Sipërfaqe Trualli në m2	Nr. objekt	Sipërfaqe Trualli në m2
I	Bashkia Berat	1,169	42,360,207	1,153	42,322,305	16	37,902
	Shuma gjithsej	1,169	42,360,207	1,153	42,322,305	16	37,902

Shënim: Të dhëna të marra nga Sektori i Pronave, Bashkia Berat.

Nga auditimi mbi saktësinë e Llog 210 “Toka, troje terrene” rezulton se kjo llogari nuk paraqet një pamje reale për pasqyrat financiare të vitit 2023. Në këtë llogari nuk janë pasqyruar të dhënat në administrim për njësitë e tjera administrative.

Kontabilizimi i Aktiveve Afatgjata Materiale në llog.(210)“ Toka, troje terrene” dhe paraqitja e gjendjes së kësaj llogarie në PF është e paplotë, pasi mungojnë analizat për të.

Nga verifikimi dhe analiza e Llog. 210 “Toka, troje, terrene”, konstatohet se kjo llogari nuk paraqet gjendjen reale nga ana e Drejtorisë së Menaxhimit Financiar dhe të Ardhurave pasi, nuk janë hedh në kartelat e kontabilitetit asnjë prej vlerave të; a) trojeve nën objekt të objekteve si godina e re e Bashkisë dhe trualli përreth saj, ndërtesat e shkollave që ka në administrim, ndërtesat e shkollave dhe të zyrave në NjA, etj, sipas regjistrimit të aktiveve të pasqyruar në llogarinë 212 “Ndërtime e konstruksione”.

b) truallit të godinave të regjistruar në ASHK në pronësi të Bashkisë,

c) trojeve të cilat me VKM kanë kaluar në pronësi të Bashkisë Berat, si dhe nuk është kryer inventarizimi dhe vlerësimi i tyre, për të cilën duhej bërë sistemimi dhe kalimi në administrim në llogarinë përkatëse.

Llog 211 “Pyje, Kullota, Plantacione”, e cila pasqyron gjendjen e llogarisë për Bashkinë Berat dhe për 5 njësitë e varësisë në fund të 2022 paraqitet në vlerën 1,515,800 lekë, ndërsa në vitin 2023 paraqitet në vlerën 2,269,400 ku në të cilën nuk është pasqyruar dhe sipërfaqja e pyjeve dhe kullotave të kaluara me VKM Nr. 433 dt. 08.06.2016 “Për transferimin në pronësi të Bashkive të Pyjeve dhe të Kullotave Publike, sipas listave të inventarit dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish Komunave/Bashkive”, pika 3, shtojca me nr.1, e cila përmban, listën e inventarit të pyjeve dhe kullotave që transferohen në pronësi të Bashkisë Berat, me numrin rendor 1 (një) deri 1,149 (njëmijë e njëqind e dyzetë e nëntë). Lista përkatëse rezulton të jetë në 5,541 Hektarë e përbërë prej pyje, djerrë, kullotë, bimësi pyjore, vepra ujore, të cilat nuk janë evidentuar në Pasqyrat Financiare të Bashkisë Berat të vitit 2023 për këto aktive nuk ka dokumentacion pronësor dhe nuk është kryer verifikim fizik për vitin 2023.

Veprime për të cilat mban përgjegjësi z. R.SH. në cilësinë e nëpunësit zbatues dhe zj. M.S.Përgjegjës i Sektorit të Pronave.

Llog 211 “Pyje, Plantacione”;

Lëvizjet e llogarisë	Vlera në lekë	Njësitë Shpenzuese					
		Bashkia qendra	Agjencia e Shërbimeve Publike	Drejtoria e Arsimit	Qendra Kulturore " M. Tutulani"	Drejtoria e Bujqësisë	Qendra "Lira"
Gjendja në 01.01.2023	1,515,800	7280	-	-	-	787,800	-
Shtesa gjatë vitit 2023 (D)	753,600	-	753,600	-	-	-	-
Pakësime gjatë vitit 2023 (K)	-	-	-	-	-	-	-
Gjendja në 31.12.2023(D)	2,269,400	7280	753,600	-	-	787,800	-

Burimi: Drejtoria e Menaxhimit Financiar dhe të Ardhurave, Bashkia Berat.

Llog analitike 211 “Pyje, Plantacione”;

Nr.	Llog	Emërtimi	Gjendje në 31.12.2022	Sasia	Çmimi	Shtesa 2023	Gjendje me 31.12.2023
	211	Pyje, kullota, plantacione	1,515,800	10,381	5,602	753,600	2,269,400
1		Bashkia Berat qendra	7280	-	-	-	7280
2		Agjencia e Shërbimeve Publike	-	-	-	753,600	753,600
3		Drejtoria e Arsimit	-	-	-	-	-
4		Qendra Kulturore " M. Tutulani"	-	-	-	-	-
5		Drejtoria e Bujqësisë, Ujërave, Pyjeve dhe Shërbimit Veterinar	787,800	10,381	5,602	-	787,800
6		Qendra "Lira"	-	-	-	-	-

Burimi: Drejtoria e Menaxhimit Financiar dhe të Ardhurave, Bashkia Berat.

Llog. 212 “Ndërtim e konstruksione”, e cila pasqyron gjendjen e llogarisë për Bashkinë Berat dhe për 5 njësi të varësisë, në fund të vitit 2022 rezulton për vlerën 2,046,670,637 lekë dhe fund të vitit 2023 për vlerën 2,114,295,483 lekë ose me rritjen në vlerën neto 67,624,846 lekë në vlerë neto.

Llog analitike 212 “Ndërtesa konstruksione”;

Lëvizjet e llogarisë	Vlera në lekë	Njësitë Shpenzuese					
		Bashkia qendra	Agjencia e Shërbimeve Publike	Drejtoria e Arsimit	Qendra Kulturore " M. Tutulani"	Drejtoria e Bujqësisë	Qendra "Lira"
Gjendja në 01.01.2023	181,497,424	59,584,360	6,414,339	63,696,270	43,641,869	5,836,362	2,324,224
Shtesa gjatë vitit 2023 (D)	39,157,498	15,516,319	13,860,960	8,628,179	1,069,040	-	830
Pakësime gjatë vitit 2023 (K)	11,092,123	10,912,309	118,550	61,264	-	-	-
Gjendja në 31.12.2023(D)	209,562,799	64,188,370	20,156,749	72,263,185	44,710,909	5,836,362	2,407,224

Burimi: Drejtoria e Menaxhimit Financiar dhe të Ardhurave, Bashkia Berat.

Llog analitike 212 “Ndërtesa konstruksione”;

NR.	Ndertesat e konstruksione	Gjendja 31.12.2022	Shtesat per 2023	Pakesime 2023	Gjendja 31.12.2023
	TOTALI	2,046,670,637	67,624,846	-	2,114,295,483
1	Bashkia Berat qendra	1,064,392,176	34,453,299	-	1,098,845,475
2	Agjencia e Shërbimeve Publike	187,689,583	1,109,910	-	188,799,493
3	Drejtoria e Arsimit	685,580,103	32,061,637	-	717,641,740
4	Qendra Kulturore " M. Tutulani"	63,480,417	-	-	63,480,417
5	Drejtoria e Bujqësisë, Ujërave, Pyjeve dhe Shërbimit Veterinar	6,248,964	-	-	6,248,964
6	Qendra "Lira"	39,279,394	-	-	39,279,394

Burimi: Drejtoria e Menaxhimit Financiar dhe të Ardhurave, Bashkia Berat.

Shuma prej 67,624,846 lekë i përket 8 objekte të marra në dorëzim gjatë vitit 2023 të investimeve të mëparshme dhe objektet e kryera gjatë vitit 2023, të aparatit të Bashkisë Berat, Agjencisë së Shërbimeve Publike dhe të Drejtorisë së Arsimit duke zbritur amortizimin e akumuluar.

-Llog. 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore”, e cila pasqyron gjendjen e llogarisë për Bashkinë Berat, në fund të vitit 2022 paraqitet në vlerën 1,545,947,022 lekë, ndërsa në vitin 2023 gjendja paraqitet në vlerën 1,623,864,478 lekë. Kjo rritje vjen si rezultat i disa investimeve të bëra gjatë vitit ushtrimor dhe viteve përpara periudhës raportuese në rrugët e qytetit, fshatrave, etj, të cilat janë marrë në dorëzim dhe janë përfunduar gjatë vitit ushtrimor, konkretisht të dhënat dhe lëvizjet jepen si më poshtë;

Llog analitike 213 “Rrugë rrjete vepra ujore”;

NR.	“Rrugë rrjete vepra ujore”	Gjendja 31.12.2022	Shtesat per 2023	Pakesime 2023	Gjendja 31.12.2023
	TOTALI	1,545,947,022	146,536,331	68,618,875	1,623,864,478
1	Bashkia Berat qendra	183,454,545	58,627,984	68,618,875	173,463,654
2	Agjencia e Shërbimeve Publike	1,229,026,957	85,442,197	-	1,314,469,154
3	Drejtoria e Arsimit	-	-	-	-
4	Qendra Kulturore " M. Tutulani"	-	-	-	-
5	Drejtoria e Bujqësisë, Ujërave, Pyjeve dhe Shërbimit Veterinar	133,465,520	2,466,150	-	135,931,670
6	Qendra "Lira"	-	-	-	-

Referuar pasqyrës 7/a në këtë llogari gjatë vitit 2023 me ndryshime.

Ka të evidentuara në kontabilitet në llog.(212) nga ish Komunat një numër të konsiderueshëm objektesh të cilat janë në verifikim për regjistrimin e tyre. Kjo vjen për arsye se një pjesë e objekteve janë të trashëguara dhe të mbartura nga njësitë që u shkrinë (*ish/komunat*) në periudhat raportuese para vitit 2015 të pa shoqëruar me kartela objekti. Në këto kushte duke qenë se ka mospërputhje në administrimin për çdo objekt të “Ndërtesave e Konstruksioneve” nga Bashkia Berat, Drejtoria e Menaxhimit Financiar dhe të Ardhurave në bashkëpunim me Sektorin e Pronave, duhet që të bëhet hedhja në kontabilitet e objekteve dhe sipërfaqeve të regjistruara saktësimi objekteve, dokumentimi me kartelë objekti, inventarizim fizik i objektit, si dhe rivlerësim me normat për secilin objekt. Për sa më sipër Llog. 212 “Ndërtime e konstruksione” nuk paraqet një pamje reale për pasqyrat financiare të vitit 2023. Nga titullari i Bashkisë Berat, Sektori i Pronave dhe Drejtoria e Menaxhimit Financiar dhe të Ardhurave nuk janë marrë masat e duhura për përmbushjen e kuadrit rregullator ligjor të regjistrimit të pronave dhe evidentimit të saktë në llogaritë përkatëse me vlerën e drejtë të tyre.

-Bashkia Berat, në Qendrën Kombëtare të Biznesit, më 31.12.2022 paraqitet si aksionare me 65.32% të aksioneve të Ujësjetllës Kanalizime Berat SHA ndërsa Bashkia Berat paraqitet si aksionare me 34.68% të aksioneve të Ujësjetllës Kanalizime Berat SHA, me NUIS “J62903166T” e cila është shoqëri aksionare me objekt “Shërbimi i furnizimit me ujë të pijshëm i konsumatorëve dhe shitja e tij. Mirëmbajtja e sistemit të furnizimit me ujë të pijshëm. Prodhimi ose blerja e ujit për plotësimin e kërkesës së konsumatorëve. Shërbimi i grumbullimit, largimit dhe trajtimit të ujërave të ndotura. Mirëmbajtja e sistemeve të ujërave të ndotura, si dhe impianteve të pastrimit të tyre”. Shoqëria duhet të realizojë çdo lloj operacioni financiar apo tregtar që lidhen direkt apo indirekt me objektin e saj, brenda kufijve të parashikuara nga legjislacioni në fuqi”. Numri i aksioneve është 1,000 me vlerë nominale 876,860 dhe kapital në vlerë monetare prej 876,860,000 lekë. Referuar ekstraktit historik Bashkia Berat zotëron 572,787 lekë/aksion dhe kapital në vlerë monetare prej 572,787,000 lekë, ose 65.32 % të aksioneve në pjesëmarrje të Bashkisë Berat në “Ujësjetllës Kanalizime Berat SHA. Referuar bilancit kontabël 2020-2021, më konkretisht në llogarinë 26 “Pjesëmarrje në kapitalet e veta” paraqitet në vlerën 79,075,000 lekë me një nënvlerësim të llogarisë 26 Pjesëmarrje në kapitalet e veta” në vlerën 797,785,000 lekë. Mos kontabilizimi i aksioneve të ndërmarrjes Ujësjetllës Kanalizime Berat SHA në llogarinë 26 “Aktive afatgjata financiare” sjell një pamje jo reale të kësaj llogarie në informacionin kontabël dhe Pasqyrat Financiare. *Veprime të cilat nuk janë në përputhje me Ligjin nr. 9228, datë 29.4.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, Urdhrin e MF nr. 64, datë 22.7.2014 “Për shpallje*

të Standardeve Kombëtare të Kontabiliteti të Përmirësuar”, me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit nr. 5 “Aktivet afatgjata Materiale dhe Aktivët afatgjata Jo materiale”, pika 55,56 dhe 57. Veprime për të cilat mban përgjegjësi z. R.SH. në cilësinë e nëpunësit zbatues.

-Paga, shpërblime e të tjera personeli (llog. 600) dhe sigurimet shoqërore (llog 601).

-Nga auditimi i listë-pagesave u konstatua se listë-pagesat hartoheshin sipas standardeve të kontabilitetit, ku plotësoheshin pagat me të gjithë elementet dhe shtesa të ndryshme të përfituara deri tek shuma bruto. Po kështu pasqyroheshin llojet e ndalesave, raportet e përkohshëm, lejet e zakonshme e deri tek paga neto. Përmbledhëset janë të kuadruara me listë pagesat dhe me urdhër pagesat respektive, të nënshkruara nga specialisti i pagave, nëpunësi zbatues dhe nëpunësi autorizues.

-Nga verifikimi me zgjedhje i ushtruar në disa nga listë pagesat e muajve, janar, maj, dhjetor të vitit 2023 rezultoi se pagat, shtesat dhe ndalesat janë përlllogaritur drejt sipas tabelës së pagave. Gjithashtu liste pagesat janë të shoqëruara dhe me liste prezencat përkatëse. Përmbledhëset janë të kuadruara me listë pagesat dhe me urdhër pagesat respektive, të nënshkruara nga punonjësi i financës dhe nëpunësi i autorizuar i Bashkisë.

-Për të gjithë periudhën e audituar, janë përlllogaritur, ndaluar dhe xhiruar detyrimet për kontributin e sigurimeve shoqërore dhe tatimin mbi të ardhur, si dhe janë bërë sipas kohëzgjatjes orare të punës.

-Inventari Fizik

Në zbatim të ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar me ligjin nr.110/2015, datë 15.10.2015; Ligjit nr. 25/2018, datë 10.05.2018, “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare, pika (1), neni (15) “Inventari aktiveve e detyrimeve”; UMF nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, Kreu (IV) “Sistemi i kontrollit periodik të aktiveve, inventarizimi i aktiveve” pika (81) në njësinë publike vendore Bashkia Berat u verifikuan procedurat e ndjekura për kryerjen e inventarizimit fizik të pasurisë të administruara në llogaritë; “aktive afat shkurtra”; “gjendje inventar qarkullues”; “materiale”; “inventar i imët”; “Aktive afatgjata jo materiale” dhe “Aktive afatgjata materiale” për vitin 2023. Komisionet e inventarizimit në fillim të procesit kanë në dispozicion listën e aktiveve për tu inventarizuar e hartuar nga nëpunësi zbatues mbi bazën e të dhënave të pasqyruara nga regjistrat kontabël për secilën llogari kontabile të njësisë publike vendore.

Nga auditimi mbi dokumentacionin e vendosur në dispozicion për periudhën raportuese 2023 u konstatua se, për realizimin e procesit të inventarizimit fizik të “aktiveve afatgjata dhe afatshkurtra” (materiale e jomateriale) dhe “inventar qarkullues” të pasurisë, aseteve dhe vlerave materiale në përdorim të njësisë publike vendore Bashkia Berat, Titullari ka nxjerr urdhrin e brendshëm nr. 713, administruar me shkresën nr. 6033, datë 20.11.2023, “Për inventarizimin e aktiveve të njësisë për vitin 2023”, me komisionet përkatëse. Komisionet do të bëjnë verifikimin e ekzistencës dhe vlerësimit të aktiveve, detyrimeve dhe të kapitaleve të veta të institucionit, si dhe njësitë Agjencia e Shërbimeve Publike, Drejtoria e Arsimit, Qendra Kulturore “M. Tutulani”, Drejtoria e Bujqësisë, Ujërave, Pyjeve dhe Shërbimit Veterinar dhe Qendra “Lira”, për vitin 2023. Janë printuar kartelat me aktivet për secilin punonjës të Bashkia Berat, nga Drejtoria e Menaxhimit Financiar dhe të Ardhurave të cilat pasi është kryer verifikimi janë nënshkruar nga komisioni dhe punonjësi me përgjegjësi materiale. Nga verifikimi me zgjedhje nuk rezultojnë problematika për kryerjen e procesit të inventarizimit si për Bashkinë ashtu edhe për njësitë e varësisë. Përveç sa përmendet sa më sipër rezultoi se;

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion për kryerjen e procedurave të inventarizimit për vitin 2023 rezulton se; nga Bashkia Berat, nëpunësi zbatues i njësisë publike, i caktuar nga titullari i njësisë publike në cilësinë e nëpunësi zbatues, nuk ka hartuar regjistër kontabël të përditësuar të aktiveve që zotëron apo ka në administrim Bashkia Berat dhe njësiti në varësi, i cili në varësi të llojit të përmbajë kërkesat minimale si datën e hyrjes ose marrjes në dorëzim, përshkrimin e aktivitetit, vlerën e blerjes, datën e daljes në përdorim, datën e skadencës, vlerën e shpenzimeve kapitale të mëpasshme që sjellin rritje të vlerës së aktivitetit, vendndodhjen, personin përgjegjës, vlerën e akumuluar të amortizimit, kohën e shërbimeve të mirëmbajtjes, vlerën e akumuluar të shpenzimeve të mirëmbajtjes, datën e daljes nga pronësia etj. *Veprim për të cilin mban përgjegjësi zj. R.SH. në cilësinë e nëpunësit zbatues.*

Veprime të cilat nuk janë në përputhje me Ligjin nr. 25/2018, "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", pikat 26-33 në të cilin ndër të tjera citohet se;

Formati i regjistrit të aktiveve hartohet në vartësi të llojit të tyre afatgjatë apo afatshkurtër si dhe grupit përkatës brenda llojit. Kërkesat minimale që duhet të përmbajë regjistri i aktiveve në vartësi të llojit, përfshijnë: datën e hyrjes ose marrjes në dorëzim, përshkrimin e aktivitetit, vlerën e blerjes, datën e daljes në përdorim, datën e skadencës, vlerën e shpenzimeve kapitale të mëpasshme që sjellin rritje të vlerës së aktivitetit, vendndodhjen, personin përgjegjës, vlerën e akumuluar të amortizimit, kohën e shërbimeve të mirëmbajtjes, vlerën e akumuluar të shpenzimeve të mirëmbajtjes, datën e daljes nga pronësia.

-Nuk është kryer verifikim fizik për zërat e bilancit Tokë, truall, pyje, kullota, ndërtime, rrugë, rrjete, vepra ujore dhe mos paraqitje e dokumentuar e vlerave të tyre në Pasqyrat Financiare të Bashkia Berat. Nga auditimi i pasqyrave financiare dhe procedurave të inventarizimit të aktiveve për vitin 2023 në lidhje me zërin e llog.210 (Toka, troje, terrene) e cila paraqitet në shumën 33,763,064 lekë, në llog.211(pyje, kullota, plantacione) e cila paraqitet në shumën 2,269,400 lekë, në llog.213(rrugë, rrjete, vepra ujore) e cila paraqitet në shumën 1,544,786,609 lekë, rezulton se; Nga Nëpunësi i Autorizuar në cilësinë e titullarit të njësisë publike dhe nga Drejtori i Drejtorisë së Menaxhimit Financiar dhe të Ardhurave në cilësinë e Nëpunësit Zbatues nuk janë marrë masat e duhura për ngritjen e komisioneve përkatës për verifikimin dhe vlerësimin e zërit troje, ndërtesa, pyje e kullota për Bashkia Berat dhe njësiti në varësi. Për këto aktive nuk është kryer asnjëherë inventar fizik në lidhje me to, për të cilat nuk mund të gjykohej nëse vlera e pasqyruar në kontabilitet, është fizikisht apo jo e disponueshme dhe e përdorshme nga institucioni çka do të thotë se nuk mund të verifikohet dhe vlerësohet dokumentacioni mbështetës i tyre. E njëjta situatë konstatohet edhe në Njësitë e varësisë në varësi të Bashkia Berat pasi nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezultoi se nuk është kryer inventarizim për zërat e mësipërm të bilancit. Veprime të cilat nuk janë në përputhje me Ligjin nr. 25/2018, "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", neni 11 dhe neni 15, me ligjin nr.10296, datë 08/07/2010, "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin", i ndryshuar, neni 9 dhe 12, Udhëzimin e Ministrisë të Financave nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" i ndryshuar, kreu IV, pika 74, e cila citon se;

Çdo njësi publike duhet të kontrollojë të paktën një herë në vit ekzistencën dhe vlerësimin e aktiveve afatgjata materiale dhe jomateriale, aktiveve afatshkurtra, të detyrimeve dhe të drejtave, nëpërmjet inventarizimit të këtyre elementeve dhe dokumentacionit mbështetës.

Veprim për të cilin mban përgjegjësi N/A z. E.D. dhe N/Z zj. R.SH..

Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet ligjore e nënligjore të bëra në:

- 1) Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar,
- 2) Ligjin nr. 25/2018, datë 10.05.2018, "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare",
- 3) Ligjin nr. 68, datë 227.04.2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore",
- 4) Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 90 datë 22.02.2023, "Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurisë së paluajtshme, pronë private, që preket nga realizimi i projektit "Zgjerimi i varrezave publike 'Burdullias', Bashkia Berat",
- 5) Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 433 datë 08.06.2016, "Për transferimin në pronësi të Bashkive, të pyjeve dhe kullotave publike, sipas listës së inventarit dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish-Komunave", i ndryshuar,
- 6) Standardet Kombëtare të Kontabilitetit Publik,
- 7) Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr.8, datë 09.03.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme".
- 8) Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" i ndryshuar.

Për veprimet e mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:

- 1) Z. E.D., me detyrë Kryetar i Bashkisë Berat, në cilësinë e nëpunësit autorizues,
- 2) Zj. R.SH., me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Menaxhimit Financiar dhe të Ardhurave në cilësinë e nëpunësit zbatues,
- 3) Zj. M.S., me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Regjistrimit të Pronave.

IV. REKOMANDIME

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi verifikimin e marrjes së dokumentacioneve financiarë dhe regjistrimet kontabël të kryera nga Bashkia Berat si dhe në Njësitë vartëse, rezulton se; Drejtoria e Menaxhimit Financiar dhe të Ardhurave në Bashkia Berat dhe sektorët e financës në njësitë vartëse, regjistrimet e veprimeve kontabël, kryhen me program excel dhe jo me "Bartës informatik", të cilët janë programe informatike të pamanipulueshme dhe të printueshme në çdo kohë. Veprimet e kryera nuk paraqesin besueshmëri duke bartur risk në vetvete pasi janë të ndryshueshme në çdo kohë, gjithashtu ndikojnë në pasaktësi të veprimeve kontabël e rrjedhimisht në rezultate jo korrekt. Kjo gjë çon dhe në mos kuadrim të drejtë dhe të saktë si dhe vonesa në kohë për gjetjen, korrektimin dhe sistemimin e gabimeve matematikore. Mungesa e programimit kompjuterik në hedhjen e të dhënave në shërbimin kontabël, ndikon në ngadalësimin e marrjes dhe përpunimit të informacioneve financiare, besueshmërinë e të dhënave, cilësinë dhe saktësinë e evidencave kontabël dhe të pasqyrave financiare.

Veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 25/2018, "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", nenin 3 pikat 14 e 15 dhe nenin 11. (Më hollësisht trajtuar në pikën 1, faqe 14-31, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

1.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Berat të marrë masa për pajisjen e Drejtorisë së Menaxhimit Financiar dhe të Ardhurave dhe Njësive Vartëse, me programe kompjuterike financiare për mbajtjen e kontabilitetit me qëllim shmangien e risqeve të mundshme të informacionit kontabël.

Brenda 31.12.2024

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i pasqyrave financiare të periudhës ushtrimore raportuese 2023 u konstatua se; në disa llogari nuk paraqesin në mënyrë të drejtë në pozicionin financiar

gjendjen reale në datën 31.12.2023 konkretisht llog.(210); llog.(211); llog.(212); llog (520), si më poshtë vijon;

1. Llog.(210) *“Toka, troje, terrene”* nuk paraqet gjendjen reale sepse nga ana e Drejtorisë së Menaxhimit Financiar dhe të Ardhurave nuk janë hedh në kartelat e kontabilitetit asnjë prej vlerave të; a) trojeve nën objekt të objekteve si godina e re e Bashkisë dhe trualli përreth saj, ndërtesat e shkollave që ka në administrim, ndërtesat e shkollave dhe të zyrave në NjA, etj, sipas regjistrit të aktiveve të pasqyruar në llogarinë 212 *“Ndërtime e konstruksione”*.

b) truallit të godinave të regjistruar në ASHK në pronësi të Bashkisë,

c) trojeve të cilat me VKM kanë kaluar në pronësi të Bashkisë Berat, si dhe nuk është kryer inventarizimi dhe vlerësimi i tyre, për të cilën duhej bërë sistemimi dhe kalimi në administrim në llogarinë përkatëse. Nga Bashkia Berat nuk janë reflektuar gjithashtu ndryshimet në këtë llogari sipas Vendimit të Këshillit të Ministrave VKM nr. 90 datë 22.02.2023, **“Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurisë së paluajtshme, pronë private, që preket nga realizimi i projektit “Zgjerimi i varrezave publike ‘Burdullias’, Bashkia Berat”, për ndryshimet përkatëse në llogarinë 210, pasi me këtë akt ligjor ka kaluar për llogari të këtij projekti konkretisht: Sipërfaqja tokë bujqësore (arë) në korridorin me gjerësi përgjithësisht 38 (tridhjetë e tetë) metra, në total 2,420 m² me nr. pasurie 4/149 në zonën kadastrale 8501 me vlerë 491,260 lekë.**

2. Llog 211 *“Pyje, Kullota, Plantacione”*, e cila pasqyron gjendjen e llogarisë për Bashkinë Berat dhe për 5 njësitë e varësisë në fund të 2022 paraqitet në vlerën 1,515,800 lekë, ndërsa në vitin 2023 paraqitet në vlerën 2,269,400 lekë ku në të cilën nuk është pasqyruar dhe sipërfaqja e pyjeve dhe kullotave të kaluara me VKM Nr. 433 dt. 08.06.2016 *“Për transferimin në pronësi të Bashkive të Pyjeve dhe të Kullotave Publike, sipas listave të inventarit dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish Komunave/Bashkive”*, pika 3, shtojca me nr.1, e cila përmban, listën e inventarit të pyjeve dhe kullotave që transferohen në pronësi të Bashkisë Berat, me numrin rendor 1 (një) deri 1,149 (njëmijë e njëqind e dyzetë e nëntë). Lista përkatëse rezulton të jetë në 5,541 Hektarë e përbërë prej pyje, djerrë, kullotë, bimësi pyjore, vepra ujore, të cilat *nuk janë evidentuar në Pasqyrat Financiare të Bashkisë Berat të vitit 2023 për këto aktive nuk ka dokumentacion pronësor dhe nuk është kryer verifikim fizik për vitin 2023.*

3. Llog.(212) *“Ndërtime e Konstruksione”* nuk paraqet gjendjen reale sepse nuk disponohet asnjë lloj dokument pronësie për 1,153 objekte me sipërfaqe trualli nën objekt të objekteve prej 42,322,305 m² të trashëguara nga ish Komunitat një numër të konsiderueshëm objektesh të cilat janë në verifikim për regjistrimin e tyre. Kjo vjen për arsye se një pjesë e objekteve janë të trashëguara dhe të mbartura nga njësitë që u shkrinë (*ish/komunitat*) në periudhat raportuese para vitit 2015 të pa shoqëruar me kartela objekti. Në këto kushte duke qenë se ka mospërputhje në administrimin për çdo objekt të *“Ndërtesave e Konstruksioneve”* nga Bashkia Berat nga Sektori i Regjistrimit të Pronave, duhet që të bëhet hedhja në kontabilitet e objekteve dhe sipërfaqeve të regjistruara saktësimi objekteve, dokumentimi me kartelë objekti, inventarizim fizik i objektit, si dhe rivlerësim me normat për secilin objekt. Për sa më sipër *Llog. 212 “Ndërtime e konstruksione”* nuk paraqet një pamje reale për pasqyrat financiare të vitit 2023.

5. Llog.(520) *“Disponibilitete në thesar”* paraqitet në pasqyrat financiare në fund të vitit 2022 në shumën 301,168,981 lekë ndërsa në fund të vitit 2023 në shumën 311,912,376 lekë, shumë e cila ka kundërparti llog. 466 (*kreditorë në ruajtje*) e cila paraqitet në shumën 115,148,164 dhe llog. 85 (*teprica e periudhës*) e cila paraqitet në shumën 192,537,074 lekë Në ekstraktin e sistemit të Thesari llog. 520 paraqitet me vlerën 0 lekë edhe pse llog. 466 dhe llog. 85 paraqiten po në vlerë të njëjtë me të dhënat e paraqitura nga Bashkia Berat, pra ka një mosrakovim të llog. 520, në të

dhënat e PF të Bashkia Berat me të dhënat e sistemit të Thesarit, veprim i cili nuk është në respektim të kërkesave të Udhëzimit të MFE nr. 8, datë 9.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”, Kap. III, pikat 30, 50.

Veprimet janë në kundërshtim me Ligji nr. 68/2017 “Përfinancat e qeverisjes vendore”, neni 34, pika 1, VKM nr. 510, datë 10.06.2015 “Për inventarizimi dhe hipotekimin e të gjitha pronave të paluajtshme dhe të luajtshme”, Kreu (VI) “Transferimi pasurive dhe regjistrimi i pasurive të paluajtshme”, pika (1); (2), VKM Nr. 433 dt. 08.06.2016 “Për transferimin në pronësi të Bashkive të Pyjeve dhe të Kullotave Publike, sipas listave të inventarit dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish Komunave/Bashkive”, pika 35, shtojca me nr.33, Udhëzimit të MFE nr. 8, datë 9.3.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, Kreu II pika 5 dhe Kreu III pika 30, 50. (Më hollësisht trajtuar në pikën 1, faqe 14-31, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

2.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Berat, të marrë masat e duhura që:

a-Të ngrejë grup pune i cili të verifikoj, vlerësoj, dhe saktësoj të gjitha aktivet e llogarive të klasës 2 dhe të dokumentoj këto aktive sipas kuadrit ligjor për regjistrimin e pasurisë.

b-Të ngrejë një grup pune me specialistë të fushës për kryerjen e inventarizimit dhe vlerësimin e aktiveve të llog. 212 “Ndërtesa Konstruksione” për NJA dhe nëpërmjet Drejtorisë së Menaxhimit Financiar dhe të Ardhurave të kryejë zbërthimin e dokumentacionit të trashëguar nga ish-Komunat për nxjerrjen e të dhënave për aktivet e hyra e veprimet me to në vite për të verifikuar, saktësuar e analizuar vlerat e paraqitura në bilancin e vitit 2015 e në rast pasaktësish të bëhen sistemimet e nevojshme në kontabilitet dhe në inventarin fizik.

c- Të marrë masat e duhura për regjistrimin e pasurive të paluajtshme në Agjencinë Shtetërore të Kadastrës, me qëllim dokumentimin me akte pronësie të aktiveve kapitale në pasqyrat financiare të Njësisë.

d- Drejtoria e Menaxhimit Financiar dhe të Ardhurave të verifikojë të dhënat e aktiveve monetare në Thesar dhe të raportojë saktë gjendjen dhe situatën financiare të Bashkisë Berat.

Me mbylljen e PF të vitit 2024

3. Gjetje nga auditimi: Bashkia Berat, në Qendrën Kombëtare të Biznesit, më 31.12.2022 paraqitet si aksionare me 65.32% të aksioneve të Ujësjellës Kanalizime Berat SHA ndërsa Bashkia Berat paraqitet si aksionare me 34.68% të aksioneve të Ujësjellës Kanalizime Berat SHA, me NUIS “J62903166T” e cila është shoqëri aksionare me objekt “Shërbimi i furnizimit me ujë të pijshëm i konsumatorëve dhe shitja e tij. Mirëmbajtja e sistemit të furnizimit me ujë të pijshëm. Prodhimi ose blerja e ujit për plotësimin e kërkesës së konsumatorëve. Shërbimi i grumbullimit, largimit dhe trajtimit të ujërave të ndotura. Mirëmbajtja e sistemimeve të ujërave të ndotura, si dhe impianteve të pastrimit të tyre”. Shoqëria duhet të realizojë çdo lloj operacioni financiar apo tregtar që lidhen direkt apo indirekt me objektin e saj, brenda kufijve të parashikuara nga legjislacioni në fuqi”. Numri i aksioneve është 1,000 me vlerë nominale 876,860 dhe kapital në vlerë monetare prej 876,860,000 lekë. Referuar ekstraktit historik Bashkia Berat zotëron 572,787 lekë/aksion dhe kapital në vlerë monetare prej 572,787,000 lekë, ose 65.32 % të aksioneve në pjesëmarrje të Bashkisë Berat në “Ujësjellës Kanalizime Berat SHA. Referuar bilancit kontabël 2020-2021, më konkretisht në llogarinë 26 “Pjesëmarrje në kapitalet e veta” paraqitet në vlerën 79,075,000 lekë me një nënvlerësim të llogarisë 26 Pjesëmarrje në kapitalet e veta” në vlerën 797,785,000 lekë.

Veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 9228, datë 29.4.2004, “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, Urdhri e MF nr. 64, datë 22.7.2014 “Për shpallje të Standardeve Kombëtare të Kontabiliteti të Përmirësuar”, me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit nr. 5 “Aktivet afatgjata Materiale dhe Aktivet afatgjata Jo materiale”, pika 55,56 dhe 57. (Më hollësisht trajtuar në pikën 1, faqe 14-31, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

3.1 Rekomandim: Bashkia Berat, Drejtoria e Menaxhimit Financiar dhe të Ardhurave të marrë masa për sistemimin në kontabilitet dhe regjistrimin e pjesëmarrjes 65.32% në kapitalin e aksioneve tek “Ujësjiellës Kanalizime Berat ShA me vlerë 572,787,000 lekë, në debi të llogarisë 26 “Pjesëmarrje në kapitalet e veta” dhe kredi të llogarisë financiare të klasës 5, për pjesëmarrjen me kapitalin e vet.

Deri më datë 31.12.2024

4. Gjetje nga auditimi: Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion për kryerjen e procedurave të inventarizimit për vitin 2023 rezulton se; nga Bashkia Berat nëpunësi zbatues i njësisë publike, nuk ka hartuar regjistër kontabël të përditësuar të aktiveve që zotëron apo ka në administrim Bashkia Berat dhe njësitë në varësi, sipas formatit të Ministrisë së Financave, i cili, në varësi të llojit të përmbajtje kërkesat minimale si datën e hyrjes ose marrjes në dorëzim, përshkrimin e aktivitetit, vlerën e blerjes, datën e daljes në përdorim, datën e skadencës, vlerën e shpenzimeve kapitale të mëpasshme që sjellin rritje të vlerës së aktivitetit, vendndodhjen, personin përgjegjës, vlerën e akumuluar të amortizimit, kohën e shërbimeve të mirëmbajtjes, vlerën e akumuluar të shpenzimeve të mirëmbajtjes, datën e daljes nga pronësia etj.

Veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 25/2018, “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, Udhëzimin e MF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, pikat 26-33. (Më hollësisht trajtuar në pikën 1, faqe 14-31, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

4.1. Rekomandimi: Bashkia Berat, Drejtoria e Menaxhimit Financiar dhe të Ardhurave, të marrë masa për plotësimin e regjistrit të aktiveve që ka në pronësi, duke plotësuar të gjitha kërkesat e formatit të aprovuar për të ulur riskun e shpërdorimeve materiale të pasurisë së njësisë dhe për një menaxhimin sa më të mirë të tyre.

Deri më 31.12.2024

5. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i pasqyrave financiare dhe procedurave të inventarizimit të aktiveve për vitin 2023 në lidhje me zërin (Tokë, truall, pyje, kullota etj) të cilat paraqiten në kontabilitetin e Bashkia Berat, rezulton se; Nga Nëpunësi i Autorizuar në cilësinë e titullarit të njësisë publike dhe nga Drejtori i Drejtorisë së Menaxhimit Financiar dhe të Ardhurave në cilësinë e Nëpunësit Zbatues nuk janë marrë masat e duhura për ngritjen e komisioneve përkatës për verifikimin dhe vlerësimin e zërit troje, pyje e kullota për Bashkia Berat dhe njësitë në varësi. Për këto aktive nuk është kryer asnjëherë inventar fizik në lidhje me to, për të cilat nuk mund të gjykohet nëse vlera e pasqyruar në kontabilitet, është fizikisht apo jo e disponueshme dhe e përdorshme nga institucioni çka do të thotë se nuk mund të verifikohet dhe vlerësohet dokumentacioni mbështetës i tyre. E njëjta situatë konstatohet edhe në Njësitë e varësisë në varësi të Bashkia Berat pasi nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezultoi se nuk është kryer inventarizim për zërat e mësipërm të bilancit.

Veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 25/2018, “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, neni 11 dhe neni 15, me Ligjin nr.10296, datë 08/07/2010, “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar, neni 9 dhe 12, Udhëzimin e Ministrit të Financave nr. 30, datë

27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar, kreu IV, pika 74. (Më hollësisht trajtuar në pikën 1, faqe 14-31, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

5.1. Rekomandimi: Nga Bashkia Berat, Drejtoria e Menaxhimit Financiar dhe të Ardhurave, të kryhet analiza e situatës së aktiveve të Njësisë, të vlerësohen këto asete, të plotësohen me dokumentacion pronësor, si dhe të kryhen reflektimet përkatëse në pasqyrat financiare, me qëllim vlerësimin e pronës dhe identifikimin e saj.

Deri më 31.12.2024

B. MASA PËR ELIMIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E TË ARDHURAVE TË MUNGUARA.

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i pasqyrave financiare në lidhje llog. 468 “Debitorë të ndryshëm” konstatohet se, në këtë llogari nuk janë përfshirë debitorët e tjerë që rrjedhin nga taksa e ndikimit në infrastrukturë, në vlerën nga e cila, shuma e gjeneruar gjatë vitit 2023 paraqitet në vlerën 6,142,563 lekë nga është arkëtuar shuma prej 259,553 dhe mbetet pa likuiduar vlera e detyrimit në shumën **5,883,010 lekë** për 186 persona në total. Ndërkohë që shuma totale progresive është për 1,229 persona në vlerën e detyrimit total prej 35,470,263 lekë. Gjithashtu nuk janë përfshirë detyrimet nga subjektet të cilat kanë lidhur kontrata me AKBN-në për marrjen me qira për shfrytëzimin e fondit pyjor/kullosor. Këto kontrata kanë detyrime të cilat deri më datë 31.12.2023 paraqiten në vlerën **126,595,000 lekë** për 7 subjekte të konstatuara e cila nuk është pasqyruar në llogarinë përkatëse. Vlerë kjo e konstatuar nga auditimi i mëparshëm i përputhshmërisë në këtë Bashki. Pra shuma totale e debitorëve në Pasqyrat Financiare duhet të ishte **581,285,629 lekë** (451,332,346+3,358,283+126,595,000). **Nga sa më sipër rezulton se llogaria 468 (debitorë të ndryshëm) nuk paraqet pamjen reale në raportimin financiar të Njësisë Berat.**

Veprime në kundërshtim me Udhëzimi e MFE nr.8, datë 9.3.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” kreu III pika 32, Kreu II pika 2/a, b, pika 22, me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, kreu II, neni 12, pika 3/g/gj, Rregullore e brendshme e funksionimit të Bashkia Berat, miratuar me vendimin pa nr., pa nr. prot, datë 25.02.2019, Kreu VI, neni 36, pika 2.3. (Më hollësisht trajtuar në pikën 1, faqe 14-31, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

1.1. Rekomandimi: Bashkia Berat, Drejtoria e Financës dhe Buxhetit, të marrë masat e duhura për paraqitjen reale të llogarisë 468, duke kontabilizuar vlerën **581,285,629 lekë** me qëllim paraqitjen e raportimit financiar sipas situatës reale të saj si dhe duke ndjekur të gjitha rrugët ligjore me qëllim arkëtimin e të ardhurave të munguara.

Me mbylljen e PF të vitit 2024

C. MASA PËR ARKËTIMIN E DETYRIMEVE PËR DEBITORËT.

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi dhe analiza e llog. 468 “Debitorë të ndryshëm” rezulton se në fund të vitit 2022 paraqitet në shumën 411,883,421 lekë, ndërsa për vitin 2023 në shumën prej 451,332,346 lekë. Gjatë vitit 2023 shtesa prej 39,448,925 lekë vjen si rezultat i rritjes së debitorëve për taksa e tarifa vendore të Bashkisë Berat dhe Njësisive vartëse. Nga ana e drejtimit të Bashkisë Berat rezulton se nuk janë marrë masat e duhura për uljen e detyrimeve debitorë dhe rritjen e performancës në arkëtimin e taksave dhe tarifave vendore.

Veprime në kundërshtim me Udhëzimi e MFE nr.8, datë 9.3.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme" kreu III pika 32, Kreu II pika 2/a, b, pika 22, me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar, kreu II, neni 12, pika 3/g/gj, Rregullore e brendshme e funksionimit të Bashkia Berat, miratuar me vendimin pa nr., pa nr. prot, datë 25.02.2019, Kreu VI, neni 36, pika 2.3. (Më hollësisht trajtuar në pikën 1, faqe 14-31, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

1.1. Rekomandimi: Bashkia Berat, Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore, të marrë masa për nxjerrjen e njoftimit të vlerësimit tatimor për debitorët të cilët vijnë nga taksat dhe tarifave vendore, duke ndjekur të gjitha rrugët për arkëtimin e detyrimeve në vlerën totale **451,332,346 lekë** me qëllim rritjen e performancës në arkëtimin e detyrimeve nga tatim-taksat vendore.

Menjëherë dhe në vijimësi

D. MASA DISIPLINORE

Për punonjësit e ngarkuar me përgjegjësi në Raportin Përfundimtar të Auditimit, *nuk rekomandohet dhënia e masës disiplinore pasi*, masat janë ezauruar në auditimin e kryer për të njëjtën periudhë, sipas programit të auditimit nr. 31/1prot, datë 10.01.2024, të shprehura në **Vendimin e Kryetarit të KLSH nr. 86, datë 14.05.2024.**

Për sa më sipër paraqitet ky Raport Përfundimtar Auditimi.

KONTROLI I LARTË I SHTETIT



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në subjektin “Bashkia
Skrapar”

RAPORTI PËRFUNDIMTAR AUDITIMI (TEMATIK)

“BASHKIA SKRAPAR”

(Për pasqyrat pasqyrave financiare 2023)

Tiranë, Tetor 2024

Përmbajtja

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE.....	3
I.1. Konkluzioni dhe Opinioni i Auditimit.....	6
II. HYRJA.....	7
OBJEKTIVAT, FUSHËVEPRIMI DHE METODOLOGJIA.	7
1. Objektivat dhe qëllimi.	7
2. Identifikimi i çështjes.....	8
3. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese.....	8
4. Përgjegjësitë e audituesve.....	9
5. Kriteret e vlerësimit.....	9
6. Standardet e auditimit.....	10
7. Metodatat e auditimit.....	10
8. Dokumentimi i auditimit.	11
III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT.....	11
1. Informacion i përgjithshëm mbi subjektin “Bashkia Skrapar”	11
2. Auditim mbi vlerësimin e raportimit financiar, për të arritur në opinionin në se pasqyrat financiare për vitin 2023, japin një paraqitje të vërtetë e të drejtë të pozicionit financiar, performancës financiare dhe fluksit të parasë, bazuar në kuadrin rregullator në fuqi.....	13
IV. REKOMANDIME.....	24
V. ANEKSET.....	Error! Bookmark not defined.

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

a. Përshkrim i shkurtër i institucionit:

Bashkia Skrapar, si të gjitha njësitë e tjera të vetëqeverisjes vendore ka kuadrin legjislativ dhe operues, bazë e të cilave janë ligji nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” dhe ligji nr.68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” i ndryshuar, krahas akteve të tjera ligjore, nënligjore dhe rregullatorë.

Rëndësia e auditimit financiar të Bashkisë Skrapar për periudhën e aktivitetit 2023, krahas detyrimit kushtetues dhe ligjor që konsiston në kontrollin e përdorimit dhe mbrojtjes së fondeve shtetërore nga organet e pushtetit vendor, pra njësitë e vetëqeverisjes vendore janë subjekt i kontrollit nga Kontrolli i Lartë i Shtetit, sipas legjislacionit në fuqi, qëndron në të bërit sa më transparente të veprimtarisë menaxhuese dhe administruese, për të rritur përgjegjshmërinë dhe llogaridhënien e të zgjedhurve dhe administratës publike, në funksion të rritjes së mirëqenies së qytetarëve.

b. Rëndësia e institucionit dhe e auditimit të tij.

Rëndësia e auditimit financiar të Bashkisë Skrapar për periudhën e aktivitetit 2023, krahas detyrimit kushtetues dhe ligjor që konsiston në kontrollin e përdorimit dhe mbrojtjes së fondeve shtetërore nga organet e pushtetit vendor, pra njësitë e vetëqeverisjes vendore janë subjekt i kontrollit nga Kontrolli i Lartë i Shtetit, sipas legjislacionit në fuqi, qëndron në të bërit sa më transparente të veprimtarisë menaxhuese, administruese dhe raportimit financiar, për të rritur përgjegjshmërinë dhe llogaridhënien e të zgjedhurve dhe administratës publike, në funksion të rritjes së mirëqenies së qytetarëve.

c. Qëllimi i auditimit ku përcaktohet dhe periudha nën auditim, paraqitja e objektivave të cilat janë të njëjta me drejtimit e auditimit të tij:

Për auditimin financiar, qëllimi është të vlerësohet nëse rezultatet dhe gjendja financiare e raportuar e subjektit që auditohet, si dhe përdorimi i burimeve është paraqitur saktë dhe në përputhje me rregullat e raportimit financiar, si në fushën e të ardhurave dhe atë të shpenzimeve. Qëllimi i auditimit të pasqyrave financiare është që ti bëhet e njohur nivelit drejtues të bashkisë, si dhe rritja e shkallës së besimit të përdoruesve të pasqyrave financiare, nëpërmjet shprehjes së një opinionit nga ana jonë nëse pasqyrat financiare janë përgatitur në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kornizën e zbatueshme të raportimit financiar, si një mekanizëm kontrolli për të siguruar përgjegjshmërinë në menaxhimin financiar.

Në përmbushje të qëllimit të auditimit, janë shqyrtuar çështjet e mëposhtme:

- Auditim mbi vlerësimin e raportimit financiar, për të arritur në opinionin në se pasqyrat financiare për vitin 2023,

d. Metodologjia e përdorur dhe metodat e mbledhjes dhe analizimit të të dhënave.

Është përdorur metoda e auditimit mbi bazë risku dhe me zgjedhje periudhash. Qasja audituese e KLSH-së është metodologji e bazuar në vlerësimin dhe menaxhimin e riskut të auditimit në subjektin që auditohet, e cila shërben për kryerjen e auditimit me efikasitet dhe efektivitet, duke u fokusuar në natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit në fushat materiale dhe që vlerësohen me nivel të lartë risku. Nën gjykimin profesional të audituesve të pavarur, bëhet përzgjedhja e kampioneve për ekzaminim në zërat e shpenzimeve dhe regjistrimit në pasqyrat financiare.

Vlerësimi bazuar në riskun dhe materialitetit. Nisur nga gjykimi dhe ndjeshmëria e zonave të llogarisë, duke ditur që materialiteti shpreh nivelin maksimal të devijimit, që audituesit e vlerëson si të mundshëm për të influencuar te përdoruesit e informacionit financiar, kemi përcaktuar materialitetit në masën 2% për të gjitha zonat e llogarisë të planifikuara për t’u audituar. Në

dhënien e opinionit kemi marrë parasysh nivelin e materialitetit prej 3,848 mijë lekë, i cili është llogaritur mbi zërin e shpenzimeve.

Për arritjen e konkluzionit vlerësues, janë përdorur teknikat e auditimi si: Kontrolli aritmetik. Kontrolli me anë të pjesëve justifikuese, Inspektimi fizik dhe kontrolli i gjendjeve ekzistuese, Kontrolli i vlerësimit, Konfirmim nga të tretët. Kontrolli sipas një treguesi, Verifikimi i transaksioneve Intervistimi, Raporte dhe informacione, Pyetësorët për vlerësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm.

e. Paraqitja e gjetjeve kryesore.

Nr. i gjetjeve dhe rekomandimeve. Në raportin përfundimtar janë formuluar 7 gjetje dhe rekomandime për masa organizative, 1 gjetje dhe rekomandime mungesë të ardhurash në shumën 2,206 mijë lekë dhe 1 gjetje dhe rekomandime për arkëtim debitorësh në vlerën 115,544 mijë lekë. *Gjetjet më të rëndësishme shpjegohen shkurtimisht sipas drejtimeve më poshtë:*

-Nga auditimi mbi verifikimin e marrjes së dokumentacioneve financiarë dhe regjistrimet kontabël të kryera nga Bashkia Skrapar si dhe në Njësitë vartëse, rezulton se; Drejtoria Ekonomike në Bashkia Skrapar dhe sektorët e financës në njësitë vartëse, regjistrimet e veprimeve kontabël, kryhen me program excel dhe jo me “Bartës informatik”, të cilët janë programe informatike të pamanipulueshme dhe të printueshme në çdo kohë. Veprimet e kryera nuk paraqesin besueshmëri duke bartur risk në vetvete pasi janë të ndryshueshme në çdo kohë, gjithashtu ndikojnë në pasaktësi të veprimeve kontabël e rrjedhimisht në rezultate jo korrekt. Kjo gjë çon dhe në mos kuadrim të drejtë dhe të saktë si dhe vonesa në kohë për gjetjen, korrektimin dhe sistemimin e gabimeve matematikore. Mungesa e programimit kompjuterik në hedhjen e të dhënave në shërbimin kontabël, ndikon në ngadalësimin e marrjes dhe përpunimit të informacioneve financiare, besueshmërinë e të dhënave, cilësinë dhe saktësinë e evidencave kontabël dhe të pasqyrave financiare.

-Nga auditimi i pasqyrave financiare të periudhës ushtrimore raportuese 2023 u konstatua se; në disa llogari nuk paraqesin në mënyrë të drejtë në pozicionin financiar gjendjen reale në datën 31.12.2023 konkretisht llog.(210); llog.(211); llog.(212); llog (213); llog (520), si më poshtë vijon;

1. Llog.(210) “Toka, troje, terrene” nuk paraqet gjendjen reale sepse nga ana e Drejtorisë Ekonomike nuk janë hedh në kartelat e kontabilitetit asnjë prej vlerave të; a) trojeve nën objekt të objekteve si godina e re e Bashkisë dhe truallit përreth saj, ndërtesat e shkollave që ka në administrim, ndërtesat e shkollave dhe të zyrave në NjA, etj, sipas regjistrimit të aktiveve të pasqyruar në llogarinë 212 “Ndërtime e konstruksione”.

b) truallit të godinave të regjistruar në ASHK në pronësi të Bashkisë,

c) trojeve të cilat me VKM kanë kaluar në pronësi të Bashkisë Skrapar, si dhe nuk është kryer inventarizimi dhe vlerësimi i tyre, për të cilën duhej bërë sistemimi dhe kalimi në administrim në llogarinë përkatëse.

Nga Bashkia Skrapar nuk janë reflektuar gjithashtu ndryshimet në këtë llogari të Vendimit të Këshillit të Ministrave VKM nr. 803 datë 30.9.2015, të Këshillit të Ministrave, për të cilat është marrë Vendim i Këshillit të Ministrave datë 15.07.2021, në të cilën janë bërë disa ndryshime;

3. Llog.(212) “Ndërtime e Konstruksione” nuk paraqet gjendjen reale pasi nuk disponohet asnjë lloj dokument pronësie për objektet që ka në administrim, me sipërfaqe truallit nën objekt të objekteve të trashëguara nga ish Komunitat një numër të konsiderueshëm objektesh të cilat janë në verifikim për regjistrimin e tyre. Kjo vjen për arsye se një pjesë e objekteve janë të trashëguara dhe të mbartura nga njësitë që u shkrinë (ish/komunitat) në periudhat raportuese para vitit 2015 të pa shoqëruar me kartela objekti.

-Nga auditimi i pasqyrave financiare në lidhje me llogaritë 468 dhe 401-408, rezulton se; Nga ana e drejtimit të Bashkisë Skrapar rezulton se nuk janë marrë masat e duhura për uljen e detyrimeve debitore dhe rritjen e performancës në arkëtimin e taksave dhe tarifave vendore. Nga analiza e llog. 468 “Debitorë të ndryshëm” rezulton se vlera e marrë nga drejtoria e taksave dhe tarifave vendore në fund të vitit 2023 paraqitet në shumën 105,832,017 ndërsa në pasqyrat financiare paraqitet në vlerën 102,473,734 lekë me një diferencë 3,358,283 lekë. Shuma progresive e detyrimeve debitore të cilat vijnë nga taksat dhe tarifave vendore paraqitet në vlerën 85,608,954 lekë në fund të vitit 2023.

-Nga analizimi i llogarisë 4342 “Të tjera operacione me shtetin (të drejta)”, rezulton se në fund të vitit 2023 paraqitet në vlerën 16,917,426 lekë, e cila përfaqëson llogaritë e Klasës së 4 të Pasivit të Pasqyrës Financiare të Pozicionit Financiar dhe nuk kuadron me Llogarinë 7206 “Financim i pritshëm nga buxheti” të Pasqyrës së Performancës Financiare e cila paraqitet në shumën 0 lekë.

-Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion për kryerjen e procedurave të inventarizimit për vitin 2023 rezulton se; nga Bashkia Skrapar nëpunësi zbatues i njësisë publike, i caktuar nga titullari i njësisë publike, nuk ka hartuar regjistër kontabël të përditësuar të aktiveve që zotëron apo ka në administrim Bashkia Skrapar dhe njësitë në varësi, sipas formatit të Ministrisë së Financave.

-Nga auditimi i pasqyrave financiare dhe procedurave të inventarizimit të aktiveve për vitin 2023 në lidhje me zërin (Tokë, truall, pyje, kullota etj) të cilat paraqiten në kontabilitetin e Bashkia Skrapar, rezulton se; Nga Nëpunësi i Autorizuar në cilësinë e titullarit të njësisë publike dhe nga Drejtori Ekonomik në cilësinë e Nëpunësit Zbatues nuk janë marrë masat e duhura për ngritjen e komisioneve përkatës për verifikimin dhe vlerësimin e zërit troje, pyje e kullota për Bashkia Skrapar dhe njësitë në varësi.

f. Paraqitja e rekomandimeve kryesore:

Me qëllim zgjidhjen e problematikave të konstatuara nga gjetjet, janë dhënë disa rekomandime si vijon:

- Kryetari i Bashkisë Skrapar të marrë masa për pajisjen e Drejtorisë Ekonomike dhe Njësive Vartëse, me programe kompjuterike financiare për mbajtjen e kontabilitetit me qëllim shmangien e risqeve të mundshme të informacionit kontabël.

- Kryetari i Bashkisë Skrapar, të marrë masat e duhura që të ngrëjë grup pune i cili të verifikoj, vlerësoj, dhe saktësoj të gjitha aktivet e llogarive të klasës 2 dhe të dokumentoj këto aktive sipas kuadrit ligjor për regjistrimin e pasurisë. Të ngrëjë një grup pune me specialistë të fushës për kryerjen e inventarizimit dhe vlerësimin e aktiveve të llog. 212 “Ndërtesa Konstrukione” për NJA dhe nëpërmjet Drejtorisë Ekonomike të kryejë zbërthimin e dokumentacionit të trashëguar nga ish-Komunat për nxjerrjen e të dhënave për aktivet e hyra e veprimet me to në vite për të verifikuar, saktësuar e analizuar vlerat e paraqitura në bilancin e vitit 2015 e në rast pasaktësish të bëhen sistemimet e nevojshme në kontabilitet e në inventarin fizik.

- Drejtoria Ekonomike, Bashkia Skrapar të marrë masat e nevojshme për regjistrimin e saktë të llogarisë nr.7206 “Financim i pritshëm nga buxheti”.

- Drejtoria Ekonomike, të marrë masa për plotësimin e regjistrit të aktiveve që ka në pronësi, duke plotësuar të gjitha kërkesat e formatit të aprovuar për të ulur riskun e shpërdorimeve materiale të pasurisë së Njësies dhe për një menaxhimin sa më të mirë të tyre.

- Nga Bashkia Skrapar, Drejtoria Ekonomike, të kryhet analiza e situatës së aktiveve të Njësies, të vlerësohen këto asete, të plotësohen me dokumentacion pronësor, si dhe të kryhen reflektimet përkatëse në pasqyrat financiare, me qëllim vlerësimin e pronës dhe identifikimin e saj.

- Bashkia Skrapar, Drejtoria e Financës dhe Buxhetit, të marrë masat e duhura për paraqitjen reale të llogarisë 468, duke kontabilizuar vlerën 3,358,283 lekë me qëllim paraqitjen e raportimit financiar sipas situatës reale të saj.

Bashkia Skrapar, Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore, të marrë masa për nxjerrjen e njoftimit të vlerësimit tatimor për debitorët të cilët vijnë nga taksat dhe tarifat vendore, duke ndjekur të gjitha rrugët për arkëtimin e detyrimeve në vlerën totale 85,608,954 lekë.

-Kryetari i Bashkisë Skrapar, Drejtoria e Buxhetit dhe Financës të marrë masat e duhura për regjistrimin e pasurive të paluajtshme në Agjencinë Shtetërore të Kadastrës, me qëllim dokumentimin me akte pronësie të aktiveve kapitale në pasqyrat financiare të Njësisë.

I.1. Konkluzioni dhe Opinioni i Auditimit.

OPINIONI I AUDITIMIT

Për auditimin e pasqyrave financiare:

Ne kemi audituar, pasqyrat financiare përmbledhëse vjetore të konsoliduara të Bashkisë Skrapar për vitin e fundit ushtrimor 01.01.2023 - 31.12.2023, ku përfshihet pasqyra e pozicionit financiar, pasqyrën e performancës financiare, pasqyra e flukseve të mjeteve monetare, pasqyra e ndryshimeve në aktivet neto/fondet neto dhe shënimet shpjeguese që shoqërojnë këto pasqyra.

Auditimi ka përfshirë ekzaminimin, në bazë testimesh, të dokumenteve që mbështesin shumat dhe shpalosjet në pasqyrat financiare, ku u bë vlerësimi i parimeve kontabël të përdorura dhe vlerësimeve të bëra nga drejtuesit, si dhe vlerësimi i paraqitjes së përgjithshme të pasqyrave financiare.

"Në opinionin tonë, pasi kemi marrë evidenca dhe dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit, pasqyrat financiare të konsoliduara të subjektit Bashkia Skrapar janë evidentuar devijime nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi të përshkruara në paragrafin e "Bazës për Opinionin", që në gjykimin profesional të audituesit të pavarur janë materiale por jo të përhapura dhe justifikojnë dhënien e një *opinionit të modifikuar, me rezervë*, e shprehur kjo në bazën për opinionin.

Baza për opinionin e modifikuar me rezervë:

Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen Përgjegjësitë e Audituesit për Pasqyrat Financiare. Ne jemi të pavarur nga subjekti, në përputhje me kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë (ISA 700-ISSAI 1700).

Opinionin e dhënë e mbështesim në faktin se, pasqyra e pozicionit financiar, pasqyra e performancës financiare, pasqyra e ndryshimeve në kapital, pasqyra e flukseve e mjeteve monetare, si dhe shpjegimet janë përfshirë në deklaratat financiare, por gjatë auditimit kemi arritur në përfundimin se pasqyrat financiare përmbanin gabime materiale, por jo të përhapura (ISA 705-ISSAI 1705).

Gabimet materiale në pasqyrat financiare të mbyllura në 31 dhjetor 2023, paraqiten si më poshtë: Nga auditimi ka rezultuar se në disa raste, trajtuar hollësisht në Raportin Përfundimtar të Auditimit, nga Drejtoria e Financës janë kryer veprime mbi pasqyrimin e ngjarjeve ekonomike në kontabilitet në mënyrë jo të drejtë, kryesisht:

- *Mos saktësimin e llogarive të klasës 2 dhe mos dokumentimi i aktive sipas kuadrit ligjor për regjistrimin e pasurisë;*

- Mos regjistrimi i saktë të llogarisë nr.7206 “Financim i pritshëm nga buxheti”;

- Mos plotësimin e regjistrimit të aktiveve që ka në pronësi, sipas të gjitha kërkesat e formatit të aprovuar nga Ministria e Financave;

- Mos plotësimin me dokumentacion pronësor të të gjitha asetëve, si dhe mos reflektimet përkatëse në pasqyrat financiare, me qëllim vlerësimin e pronës dhe identifikimin e saj;

- Mos paraqitjen reale të llogarisë 401-408, duke mos kontabilizuar vlerën 3,358,283 lekë të debitorëve nga taksat dhe tarifatat vendore,

-Mos marrjen e masave për nxjerrjen e njoftimit të vlerësimit tatimor për debitorët të cilët vijnë nga taksat dhe tarifatat vendore, për arkëtimin e këtyre detyrimeve në vlerën totale 85,608,954 lekë.

- Llog. 210, 211, nuk paraqesin gjendjen reale pasi nga ana e Drejtorisë Ekonomike nuk janë hedh në kartelat e kontabilitetit asnjë prej vlerave të; a) trojeve nën objekt të objekteve si godina e re e Bashkisë dhe trualli përreth saj, ndërtesat e shkollave që ka në administrim, ndërtesat e shkollave dhe të zyrave në NjA, etj, sipas regjistrimit të aktiveve të pasqyruar në llogarinë 212 “Ndërtime e konstruksione”.b) truallit të godinave të regjistruar në ASHK në pronësi të Bashkisë,c) trojeve të cilat me VKM kanë kaluar në pronësi të Bashkisë Skrapar, si dhe nuk është kryer inventarizimi dhe vlerësimi i tyre nuk janë reflektuar gjithashtu ndryshimet në këtë llogari të Vendimit të Këshillit të Ministrave VKM nr. 803 datë 30.9.2015.

II. HYRJA

Mbështetur në ligjin nr.154/14, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e KLSH”, në zbatim të Projektit dhe Programit të Auditimit nr. 894/4prot., datë 24.06.2024 “Auditim financiar në Bashkinë Skrapar”, i ndryshuar, të miratuar nga Kryetari i KLSH, nga data 26.06.2024 – 31.07.2024, në subjektin Bashkia Skrapar për periudhën e veprimtarisë nga 01.01.2023 - 31.12.2023, u krye “Auditim Financiar” nga Grupi i Auditimit me përbërje:

1. P. Gj., Përgjegjës Grupi,
2. E. M., anëtar;

OBJEKTIVAT, FUSHËVEPRIMI DHE METODOLOGJIA.

1. Objektivat dhe qëllimi.

Objekti i auditimit financiar është dhënia e opinionit me siguri të arsyeshme, nëse për vitin 2023, transaksionet financiare dhe ngjarjet ekonomike janë raportuar drejt dhe saktë në pasqyrat financiare të subjektit të audituar, në referencë të kuadrit ligjor të raportimit financiar në fuqi.

Për auditimin financiar, qëllimi është të vlerësohet nëse rezultatet dhe gjendja financiare e raportuar e subjektit që auditohet, si dhe përdorimi i burimeve është paraqitur saktë dhe në përputhje me rregullat e raportimit financiar, si në fushën e të ardhurave dhe atë të shpenzimeve.

Qëllimi i auditimit të pasqyrave financiare është që ti bëhet e njohur nivelit drejtues të bashkisë, si dhe rritja e shkallës së besimit të përdoruesve të pasqyrave financiare, nëpërmjet shprehjes së një opinionit nga ana jonë nëse pasqyrat financiare janë përgatitur në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kornizën e zbatueshme të raportimit financiar, si një mekanizëm kontrolli për të siguruar përgjegjshmërinë në menaxhimin financiar.

Në këtë fazë të auditimit, hartohet Raporti Përfundimtar i auditimit, i cili përfshin dhënien e opinionit mbi bazën e vlerësimeve dhe të gjetjeve, si dhe dhënien e rekomandimeve për përmirësimin e veprimtarisë së Bashkisë Skrapar.

2. Identifikimi i çështjes.

Të përcaktojë nivelin e duhur të materialitetit, duke i mundur kryerjen e saktë të auditimit (ISSAI 13), nëpërmjet një pune audituese sistematike me zgjedhje dhe mbi bazë risku, duke saktësuar përputhshmërinë ligjore të akteve normative me qëllim që auditimi t'i shërbej subjektit në marrjen e masave në përmirësimin e punës në të ardhmen dhe për të bërë të mundur evidentimin në kohë të mangësive dhe shkeljeve për përmirësimin e gjendjes.

Raporti i auditimit, synon të identifikojë përmbushjen e rolit të njësisë vendore dhe përgjegjësive të saj, që burojnë nga kuadri ligjor dhe dispozitat në fuqi, për përmirësimin e vazhdueshëm të punëve dhe shërbimeve në dobi të komunitetit, në funksion të zbatimit të strategjive që orientojnë zhvillimin e Bashkisë Skrapar, si dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së shërbimit ndaj komunitetit në plotësimin e kërkesave dhe nevojave të tyre.

Saktësia, rregullshmëria, ndodhja e transaksioneve kontabël dhe regjistrimi i tyre me korrektësi dhe në përputhje me kuadrin e raportimit financiar në fuqi.

Në bazë të kriterëve të vlerësimit e gjykimit profesional, audituesit kanë bërë vlerësimin e rezultateve të testeve të kontrollit, analizimin dhe klasifikimin e gabimeve të zbuluara, si dhe është bërë vlerësimi i evidencave të grumbulluara përse i përket mjaftueshmërisë dhe përshtatshmërisë për qëllimet e auditimit. Procedurat e kryera, varen nga gjykimi profesional i audituesit, përfshirë vlerësimin e rrezikut material, për shkak të mashtrimit apo gabimit që do përdoren për procedura auditimi që janë me të përshtatshme për rrethanat.

Nisur nga procedurat e ndjekura për auditim besojmë se evidencat e mbledhura janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të dhënë opinionin tonë mbi veprimtarinë ekonomiko-financiare të Bashkisë Skrapar.

3. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese.

Kryetari i Bashkisë Skrapar (Administratori i Përgjithshëm), në cilësinë edhe të Nëpunësit Autorizues (NA) dhe Drejtori i Financës, në cilësinë e Nëpunësit Zbatues (NZ), janë përgjegjës për përgatitjen e pasqyrave financiare në përputhje me kuadrin normativ të zbatueshëm të raportimit financiar në sektorin publik dhe për mirëfunksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, i cili garanton përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare. Gjithashtu, në cilësinë edhe të NA si dhe NZ, janë përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Bashkisë Skrapar, bazuar në ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “*Për vetëqeverisjen vendore*”, konkretisht neni 34/6, neni 65/1 dhe neni 91, pika 1.3.

NA i njësisë së vetëqeverisjes vendore, në cilësinë e titullarit të kësaj njësie është përgjegjës për menaxhimin financiar aktivitetin e bashkisë.

Titullarët e njësive publike përgjigjen për vendosjen e përmbushjen e qëllimeve dhe të objektivave të njësive publike, nëpërmjet krijimit të një sistemi të përshtatshëm dhe efektiv të menaxhimit financiar dhe kontrollit, si dhe përdorimit të fondeve publike, në mënyrë të ligjshme, me ekonomi, efektivitet dhe efikasitet.

Këshilli i njësisë së qeverisjes vendore, me vendim të veçantë, miraton të ardhurat dhe fondet buxhetore vjetore për njësitë e qeverisjes vendore dhe fondet speciale të tyre, me qëllim kryerjen e shpenzimeve për ushtrimin e funksioneve që kanë, si dhe huamarrjen, për financimin e projekteve të investimeve.¹

Strukturat drejtuese të subjekteve të audituara kanë përgjegjësi që t'i dorëzojnë dokumentet zyrtare, shkresore apo elektronike, si dhe informacionin e kërkuar, në kushtet, afatet dhe strukturën e vendosur prej grupit të auditimit të KLSH.

¹ Ligji nr. 9936, datë 26.6.2008 “*Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë*” i ndryshuar, neni 15

4. Përgjegjësitë e audituesve.

Përgjegjësia jonë është që të shprehim një opinion në lidhje me pasqyrat financiare Bashkisë Skrapar në raport me aktet ligjore dhe nënligjore për buxhetin, menaxhimin financiar dhe kontrollin e brendshëm. Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit ISSAI sipas INOTSAI, të cilat kërkojnë që audituesi të respektojë kërkesat etike dhe të planifikojë dhe kryejë auditimin me qëllim arritjen e një sigurie të arsyeshme në dhënien e opinionit, sipas evidencës së kërkuar dhe të vënë në dispozicion të auditimit.

Audituesit kanë zbatuar parimet e auditimit financiar: Etika dhe pavarësia, Kontrolli i cilësisë, Menaxhimi i grupit të auditimit dhe aftësive të tyre, si dhe Parimet lidhur me konceptet bazë të auditimit.

Gjithashtu, janë zbatuar pohimet rreth klasave të transaksioneve dhe ngjarjeve për periudhën nën auditim, si Përkatësia, Plotësia, Saktësia dhe vlerësimi, Periudha, Klasifikimi dhe kuptueshmëria, Ligjshmëria dhe rregullsia, Ekzistenca, Të drejtat dhe detyrimet, Plotësia, Vlerësimi dhe alokimi, Transaksionet, të drejtat dhe detyrimet.

Në cilësinë e audituesit të jashtëm publik, kemi përgjegjësinë për garantimin e sigurisë së arsyeshme, nëse veprimtaria e Bashkisë Skrapar është zhvilluar në përputhje me kriteret e paracaktuara, si dhe për të konkluduar me një raport auditimi që përfshin një opinion. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet mundëson identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mund të ekzistojë. Përveç standardeve ISSAI, audituesit e KLSH kanë aplikuar gjykimin dhe skepticizmin profesional gjatë veprimtarisë audituese.

Audituesit kanë përgjegjësi në identifikimin e çështjeve më të rëndësishme lidhur me auditimin e veprimtarisë së subjektit, në raport me kriteret e paracaktuara të auditimit, të nxjerra nga aktet ligjore, nënligjore, si dhe ato rregullative mbi të cilat subjekti i audituar mbështetet në ushtrimin e veprimtarisë së tij, me përjashtim të rasteve kur kuadri ligjor nuk lejon vënien në dispozicion të tyre për publikun ose në raste të rralla kur vetë ne vendosim që këto çështje nuk duhet të përfshihen në raport për shkak të pasojave negative që publikimi i tyre mund të sjellë në publikun e gjerë.

Audituesit kanë përgjegjësi që të zbatojnë parimet që lidhen me procesin e auditimit, të sanksionuara në ISSAI/IFPP-100 “*Parimet themelore të auditimit të sektorit publik*”, paragrafi 44-51.

5. Kriteret e vlerësimit

Auditimi është bazuar në ligjin nr. 154/14, datë 27.11.14 “*Për Organizimin dhe Funkcionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*”, Manualin e Auditimit Financiar, në kërkesat e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit, si dhe në referenca të tjera ligjore sa më poshtë:

- Në fushën e mbajtjes Kontabilitetit dhe Hartimit të Pasqyrave Financiare; VKM nr. 248, date 10.4.1998 “*Për miratimin e planit kontabël publik, për organet e pushtetit lokal, institucionet shtetërore, qendrore dhe lokale, si dhe te njërive që varen prej tyre*” i ndryshuar me VKM nr. 25, datë 20.01.2001; VKM nr. 783, datë 22.11.2006 “*Për përcaktimi i standardeve dhe të rregullave kontabël*”; VKM nr. 510, datë 10.06.2015 “*Për miratimin e procedurave për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve, personelit, aktiviteteve dhe çdo dokumentacion tjetër zyrtar në njësitë e qeverisjes vendore, të prekura nga riorganizimi administrativo-territorial*”; Udhëzimi i MF nr. 08, datë 09.03.2018 “*Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit e të pasqyrave financiare vjetore të njërive të Qeverisjes së Përgjithshme*” i ndryshuar; Udhëzimi përbashkët i Ministrisë së Çështjeve Vendore dhe Ministrisë Financiare nr. 3237 datë 16.07.2015 “*Për procedurat afatet kohore standardet dhe kriteret e plotësimit të dokumentacionit të nevojshëm për riorganizimin administrativo-territorial*”, udhëzimi i MFE nr. 26, datë 27.9.2019 “*Procedura për*

menaxhimin e vështirësive financiare për njësitë e vetëqeverisjes vendore”.

6. Standardet e auditimit

- ISSAI 100 “*Parimet themelore të auditimit të sektorit publik*”, i cili përcakton parimet themelore për auditimin e sektorit publik në përgjithësi; ISSAI 2000-2899 “*Udhëzues të Auditimit Financiar*”; ISSAI 2300 “*Planifikimi i auditimit të pasqyrave financiare*”; INTOSAI GOV 9100 “*Udhëzues mbi Standardet e Kontrollit të Brendshëm për Sektorin Publik*” si dhe INTOSAI GOV 9110 “*Udhëzues mbi raportimin e efektivitetit të kontrolleve të brendshëm*”; etj.; Standardet Kombëtare të Kontabilitetit; Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA) të Federatës Ndërkombëtare të kontabilistëve IFAC; Manuali i Auditimit Financiar të KLSH-së; Standardet Ndërkombëtare të Auditimit mbi Raportimin e Audituesit të Pavarur, (IFAC); Praktika të mira të fushës, si manualet e Gjykatës Evropiane të Audituesve, Kërkesat e Udhërrëfyesit të IDI-t etj.; Kodit Etik dhe Rregullorja e Procedurave të Auditimit të KLSH.

7. Metodat e auditimit

Është përdorur metoda e auditimit mbi bazë risku dhe me zgjedhje periudhash. Qasja audituese e KLSH-së është metodologji e bazuar në vlerësimin dhe menaxhimin e riskut të auditimit në subjektin që auditohet, e cila shërben për kryerjen e auditimit me efikasitet dhe efektivitet, duke u fokusuar në natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit në fushat materiale dhe që vlerësohen me nivel të lartë risku. Nën gjykimin profesional të audituesve të pavarur, bëhet përzgjedhja e kampioneve për ekzaminim në zërat e shpenzimeve.

*Vlerësimi bazuar në riskun dhe materialitetit*². Nisur nga gjykimi dhe ndjeshmëria e zonave të llogarisë, duke ditur që materialiteti shpreh nivelin maksimal të devijimit, që audituesit e vlerëson si të mundshëm për të influencuar te përdoruesit e informacionit financiar, kemi përcaktuar materialitetin në masën 2% për të gjitha zonat e llogarisë të planifikuara për t’u audituar.

Për arritjen e konkluzionit vlerësues, janë përdorur teknikat e auditimit:

- *Kontrolli aritmetik*. Duke konsideruar faktin se kontabiliteti konsiston në thelb në regjistrimin e fakteve në një formë numerike, si dhe në paraqitjen sintetike të tyre, por midis regjistrimit fillestar të fakteve dhe paraqitjes së tyre në formë sintetike, që janë edhe qëllimi i tij, bëhen një seri veprimesh që kanë të bëjnë me evidentimin në llogari, mbartjet, klasifikimin dhe rigrupimin. Kontrolli aritmetik u krye me qëllim që të sigurohemi nëse veprimet e llogaritjes dhe të hedhjeve në llogaritë përkatëse, që përfundojnë me nxjerrjen e gjendjeve sintetike, nuk përmbajnë asnjë gabim. (Ditari i kontabilizimit të urdhër shpenzimeve)

- *Kontrolli me anë të pjesëve justifikuese*. Edhe pse kontabilizimet nuk përmbajnë asnjë gabim aritmetik, ai mund të jetë i gabuar, nëse regjistrimet e bëra nuk korrespondojnë me realitetin. Kontrolli me zgjedhje të pjesëve justifikuese (Urdhër shpenzimeve) konstatoi nëse shifrat e kaluara kanë pasur justifikim të mjaftueshëm dokumentar. UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “*Mbi menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*”.

- *Inspektimi fizik dhe kontrolli i gjendjeve ekzistuese*. Konsistoi në ekzaminimin e aktiveve, të llogarive, të librave kontabël etj. Kontrolli kontabël i ushtruar ekzaminon përputhjen ndërmjet regjistrimit kontabël dhe pjesëve justifikuese përkatëse, duke u siguruar edhe për ekzistencën reale të aktiveve në subjekt.

² *ISSAI 1320 (ISA 320) trajtojnë përgjegjësinë e audituesit për të zbatuar konceptin e materialitetit në planifikimin dhe kryerjen e një auditimi të pasqyrave financiare, në funksion të zbulimit dhe korrigjimit të anomalive. Një trajtim i tillë i ngjashëm mund të përdoret edhe në rastet e auditimit të përputhshmërisë, ku natyrisht një rol të rëndësishëm ka gjykimi profesional i audituesit.*

- *Kontrolli i vlerësimit*. Kontrolli i vlerësimeve përcaktoi nëse vlerat që u atribuohen gjendjeve ekzistuese janë të sakta, nëse pasuritë duhet të qëndrojnë në bilanc me vlerat që u janë vendosur atyre.

- *Konfirmim nga të tretët*. Nëse subjekti që auditohet ka të konfirmuara (Rakorduar) me të tretët informacionet që vërtetojnë ekzistencën e operacioneve, detyrimeve, të tepcave ose të çdo regjistrimi tjetër.

- *Kontrolli sipas një treguesi*. Përdorimi i treguesve statistikorë me qëllim që të kërkohen fakte ose të dhëna “*jashtë normales*”, që përbëjnë tregues të parregullsisë kontabël. Mund të përmendim: mungesa e pjesëve justifikuese, gabimet e shpeshta në datat, numrat, referencat e brendshme, të emrave, regjistrime pak të lexueshme, shifra të renditura keq, korrigjime të shumta të shifrave etj.

- *Verifikimi i transaksioneve* - është marrë informacioni për një rrethanë ose transaksion nga dy burime duke kryer krahasueshmërinë e tyre.

- *Intervistimi* - është përdorur gjatë marrjes verbale të informacionit nëpërmjet pyetjeve drejtuar personelit kyç të subjektit që auditohet.

- *Raporte dhe informacione* - janë shfrytëzuar raporte, analiza dhe informacione të cilat lidhen me objektivat e auditimit dhe çështjet për trajtim.

Pyetësorët për vlerësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm – grupi i auditimit ka përdorur pyetësorin e vetëvlerësimit të subjektit duke verifikuar çdo raportim të tij në lidhje me 5 komponentët e funksionimit të sistemit së kontrollit të brendshëm të subjektit.

8. Dokumentimi i auditimit.

Është mbështetur në kërkesat e Manualeve të Auditimit Financiar dhe atij të përputhshmërisë, si edhe në Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit: ISSAI 1230 “*Dokumentimi i Auditimit*”, i mjaftueshëm për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit të kryera në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullatore.

Nga audituesit është përgatitur dokumentacioni i auditimit, i mjaftueshëm për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit, të kryera në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat ligjore dhe rregullatorë të zbatueshme. Rezultatet e këtyre procedurave dhe evidencat e marra gjatë auditimit, si dhe çështje të tjera të rëndësishme që dolën gjatë auditimit, janë reflektuar në përfundimet e arritura në drejtim të tyre sipas gjykimit dhe skepticizmit profesional që audituesit kanë shfrytëzuar në arritjen e këtyre konkluzioneve. Ky dokumentacion është i përshtatshëm dhe i rëndësishëm për të konfirmuar dhe mbështetur opinionet dhe raportin e Audituesve dhe ka shërbyer si një burim informacioni për përgatitjen e tyre.

Raporti Auditimit i dërgohet subjektit Bashkia Skrapar, pasi nga subjekti i audituar me shkresën nr. 2073/4, datë 09.09.2024 (*prot KLSH nr. 854/14, datë 13.09.2024*), është kthyer Projekt Raporti i Auditimit pa observacione, i cili është dërguar në subjekt me shkresën nr. 854/10, datë 09.08.2024.

III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT.

1. Informacion i përgjithshëm mbi subjektin “Bashkia Skrapar”

Zona Gjeografike: Skrapari kufizohet në veri me bashkinë Gramsh, në perëndim me bashkitë Berat dhe Poliçan, në jug-perëndim me bashkinë Këlcyrë, në jug me bashkinë Përmet dhe në lindje me bashkitë Maliq e Korçë. Kryeqendra e Bashkisë është qyteti i Çorovodës.

Popullsia: Sipas Çensusit të vitit 2011, kjo bashki numëron 12,403 banorë, ndërsa sipas Regjistrit Civil ajo numëron një popullsi prej 19,072 banorë. Bashkia e re ka një sipërfaqe të konsiderueshme prej 831.44 km². Sipas çensusit, densiteti i popullsisë është 15 banorë/km² ndërsa sipas regjistrit civil densiteti është 22.93 banorë/km².

Të dhëna të tjera: Bashkia e re e Skraparit ka një reliev të thyer malor, i cili ka një territor shumë të gjerë dhe popullsi të ulët. Popullsia e zonës është pakësuar ndjeshëm gjatë dekadës së fundit nga largimet e banorëve drejt qyteteve të mëdha të Shqipërisë apo në emigrim. Vetë qyteti i Çorovodës humbi mbi 40 për qind të popullsisë mes viteve 2001 dhe 2011, ndërsa shumë nga komunat përbërëse kanë humbur mbi gjysmën e popullsisë.

Mungesa e perspektivës, kryesisht ajo e vendeve të punës, ka bërë që banorët e qytetit të vendosen për një të ardhme më të mirë për fëmijët e tyre drejt qyteteve të mëdha, ndërsa banorët e zonave të thella janë larguar drejt qytetit të Çorovodës, si rezultat i mungesës së rrugëve dhe mjekëve në fshatrat e tyre. Problematika kryesore e banorëve të Çorovodës ka qenë gjendja e vështirë e rrugës kombëtare Skrapar-Berat.

Skrapari si burim kryesor ka të ardhurat që vijnë nga blegtoria dhe bujqësia, prodhime mjaft të vlerësuara këto në tregjet e vendit, ndër më të njohurat djathi dhe rakia e Skraparit. Vitet e fundit Skraparit i është shtuar shpresa për zhvillimin nëpërmjet turizmit. Kanionet e Skraparit, po tërheqin çdo ditë e më shumë vëmendjen e vizitorëve të huaj dhe vendas.

Vetëqeverisja vendore në Republikën e Shqipërisë siguron qeverisjen e efektshme, efikase dhe në një nivel sa më afër qytetarëve nëpërmjet:

a) njohjes së ekzistencës së identiteteve dhe vlerave të ndryshme të bashkësive;

b) respektimit të të drejtave dhe lirive themelore të shtetasve, të sanksionuara në Kushtetutë ose në ligje të tjera;

c) zgjedhjes së llojeve të ndryshme të shërbimeve dhe lehtësive të tjera publike vendore në dobi të bashkësisë;

ç) ushtrimin efektiv të funksioneve, kompetencave dhe realizimit të detyrave nga organet e vetëqeverisjes vendore;

d) realizimit të shërbimeve në forma të përshtatshme, bazuar në nevojat e anëtarëve të bashkësisë;

dh) nxitjes efektive të pjesëmarrjes gjithëpërfshirëse të bashkësisë në qeverisjen vendore;

e) realizimit të shërbimeve, në përputhje me standardet e kërkuara me ligj ose akte të tjera normative.

Bashkia Skrapar, si të gjitha njësitë e tjera të vetëqeverisjes vendore ka kuadrin legjislativ dhe operues, bazë e të cilave janë ligji nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” dhe ligji nr.68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” i ndryshuar, krahas akteve të tjera ligjore, nënligjore dhe rregullatorë.

Rëndësia e auditimit financiar të Bashkisë Skrapar për periudhën e aktivitetit të vitit 2023, krahas detyrimit kushtetues dhe ligjor që konsiston në kontrollin e përdorimit dhe mbrojtjes së fondeve shtetërore nga organet e pushtetit vendor, pra njësitë e vetëqeverisjes vendore janë subjekt i kontrollit nga Kontrolli i Lartë i Shtetit, sipas legjislacionit në fuqi, qëndron në të bërit sa më transparente të veprimtarisë menaxhuese dhe administruese, për të rritur përgjegjshmërinë dhe llogaridhënien e të zgjedhurve dhe administratës publike, në funksion të rritjes së mirëqenies së qytetarëve dhe zbatimin e kuadrit rregullator ligjor të raportimit financiar.

2. Auditim mbi vlerësimin e raportimit financiar, për të arritur në opinionin në se pasqyrat financiare për vitin 2023, japin një paraqitje të vërtetë e të drejtë të pozicionit financiar, performancës financiare dhe fluksit të parasë, bazuar në kuadrin rregullator në fuqi.

- 2.1. Plotësia dhe saktësia në pasqyrimin e përmbajtjes së ngjarjeve ekonomike.
- 2.2. Plotësia e shënimeve në pasqyrat financiare për të dhënë një pamje të përgjithshme të pozicionit financiar, performancës financiare dhe fluksit të parasë të njësisë.
- 2.3. Rregullshmëria e veprimeve të kryera nëpërmjet bankës, arkës dhe magazinës.
- 2.4. Verifikim i inventarëve të aktiveve afatgjata materiale sa prej tyre janë me certifikatë pronësie.
- 2.5 Opinion mbi pasqyrat financiare.

Në zbatim të pikës 1 të programit të auditimit “Nr. 894/4prot, datë 24.06.2024 u kërkua për shqyrtim dokumentacioni si më poshtë:

1. Dokumentacioni i pasqyrat financiare, shënimet shpjeguese dhe ditarët përkatës të vitit 2023, hartimi dhe miratimi i tyre,
2. Ditarët e kontabilitetit për vitin 2023, regjistrat e llogarive analitike,
3. Rakordimet me thesarin për vitin 2023,
4. Dokumentacioni i mbajtur për kryerjen e procesit të inventarizimit të aktiveve për vitin 2023,
5. Vendime dhe urdhra të Bashkisë Skrapar në lidhje me të dhënat e pasqyrave financiare.

- *Dokumentacioni i regjistrimit të llogarive kontabël.*

- *Dokumentacioni mbi hartimin dhe miratimin e pasqyrave financiare.*

- *Dokumentacioni i mbajtur mbi përlllogaritjen, njohjen, pagesën dhe regjistrimin e detyrimeve.*

- *Dokumentacioni i mbajtur mbi debitorët dhe kreditorët.*

- *Dokumentacioni i mbajtur mbi realizimin e procesit të inventarizimit.*

- *Baza ligjore për mbajtjen e kontabilitetit dhe hartimin e pasqyrave financiare është:*

Ligji nr. 25/2018, datë 10.05.2018, “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, Ligji nr. 68, datë 227.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, UMFE nr. 05, datë 21.02.2022 “Për disa ndryshime në udhëzimin e MFE nr. 08, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësisë të Qeverisjes së Përgjithshme, Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar; Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar; VKM nr. 783, datë 22.11.2006, “Për përcaktimin e standardeve dhe rregullave kontabël”; Udhëzimi i Ministrisë së Financave nr. 31, datë 13.12.2023, “Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 9, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” si dhe dispozita ligjore të tjera rregulluese.

Nxjerrja e pasqyrave financiare për vitin 2023.

Për vitin 2023, Në përputhje me kërkesat e MFE nr. 08, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësisë të Qeverisjes së Përgjithshme” i ndryshuar, janë përgatitur pasqyrat financiare, dërguar Degës së Thesarit me shkresën nr. 993 prot., datë 28.03.2024, të përbëra si vijon:

Format nr. 1 –Pasqyra e pozicionit financiar.

Format nr. 2 –Pasqyra e performancës financiare (Klasifikimi sipas natyrës ekonomike).

Format nr. 3 – Pasqyra e flukseve monetare (Cash-Flow).

Format nr. 4 –Pasqyra e ndryshimeve në aktivet neto/fondet neto.

Format nr. 5 –Pyetësor dhe shënimet shpjeguese.

Format nr. 6 –Investimet dhe burimet e financimit.

Format nr. 7/a –Gjendja dhe ndryshimi i aktiveve afatgjata (kosto historike).

Format nr. 7/b –Gjendja dhe ndryshimi i aktiveve afatgjata (vlera neto).

Format nr. 8 –Numri i punonjësve dhe fondi i pagave.

Pasqyrat financiare janë të firmosura nga z. N.G.si nëpunës zbatues dhe Kryetar i Bashkisë z. A.M.si nëpunës autorizues.

Mbajtja e kontabilitetit v. 2023.

Në këtë bashki, kontabiliteti është organizuar dhe mbahet në mënyrë manuale. Janë hapur ditarët përkatës për bankën, ditari i arkës, magazinën, ditari i veprimeve të ndryshme etj, të cilat mbahen dhe përpunohen në format eksel.

Gjendja e llogarive të evidentuara në bilanc në fund të periudhës raportuese ushtrimore viti 2023, të pozicionit financiar Bashkia Skrapar; Formati nr.1, paraqitet në pasqyrat e mëposhtme:

Nga procesi i auditimit mbi referencat e llogarive të aktivitetit dhe pasivit, në lidhje me verifikimin e vlerave të pasqyruara në llogaritë e pasqyrave të pozicionit financiar të periudhës raportuese ushtrimore 2023, të saktësisë dhe besueshmërisë së tyre paraqiten si në vijim;

- Mënyra e mbajtjes së kontabilitetit dhe dokumentacionit bazë e justifikues si dhe sigurimi i informacionit kontabël, përgatitjen e llogarive për vlerësimin e gjendjes pasurore, financiare dhe rezultatit.

Për tu siguruar nëse, regjistrimet kontabël janë kryer në përputhshmëri ligjore dhe me saktësi u kryen teste në regjistrimet në ditarët kontabël në lidhje me:

- Mbështetjen në dokumente justifikuese, të verifikuara përsa i përket vlefshmërisë për t'u pranuar në kontabilitet (vlerësimi kontabël);
- Mos ndryshueshmëria e regjistrimeve tashmë të kryera dhe e mbartësve të tyre;
- Tërësinë e regjistrimeve në mënyrë kronologjike dhe sistematike deri në mbyllje të ushtrimit vjetor.
- Nëse informacioni kontabël mundëson, në të gjithë ciklin e tij, kontrollin rrjedhës dhe të mëvonshëm nëpërmjet:
- Shqyrtimit të vlefshmërisë së një regjistrimi fillestar duke e krahasuar me dokumentin bazë justifikues;
- Kontrollit të vlefshmërisë të një regjistrimi të kryer me anë të një dokumenti duke e krahasuar këtë dokument me dokumentet bazë justifikuese mbi të cilat është përgatitur;
- Verifikimit të pajtueshmërisë së shumave të nxjerra nga regjistrimet kronologjike me regjistrimet në llogari (barazimi i lëvizjeve të ditarëve me ato të librit të llogarive) dhe verifikimit të pajtueshmërive të tjera aritmetike.

- Pohimet e testeve të kryera rreth mbajtjes së kontabilitetit të Aparatit Bashkisë .

Si rezultat i testeve të kryera pohojmë se:

- Kontabiliteti është mbajtur i plotë për të gjitha veprimet kontabël të rezultuara nga kryerja e veprimeve ekonomike, mbi bazën e dokumentacionit bazë dhe justifikues.
- Në këtë bashki, kontabiliteti është organizuar dhe mbahet në mënyrë informatike në program “Excel” **dhe jo me program të veçantë.**
- Janë zbatuar drejt parimet e përgjithshme për përgatitjen e llogarive vjetore dhe mbajtjen e kontabilitetit, sipas përcaktimeve të dispozitave ligjore për kontabilitetin.
- Azhurnimet e veprimeve ekonomike janë në mënyrë kronologjike dhe kontabilizimet e tyre janë kryer në ditarët e bankës, të arkës, magazinës, të pagave dhe janë mbajtur partitarët për llogaritë kreditore e debitore. Nuk është mbajtur libri i madh apo libri centralizator për evidentimin e

veprimeve kontabël të kryera, duke kaluar nga ditarët në fletë-kontabilizimet apo kartelat kontabël deri në bilancin vërtetues rezultuar nga prerja e artikujve kontabël.

Këto libra kontabël janë bartës të informacionit të regjistruar në mënyrë kronologjike dhe sistematike të efekteve të veprimeve të kryera, të marra nga dokumentet vërtetuese.

-Në tërësi organizimi i mbajtjes së kontabilitetit ka mundësuar nxjerrjen e gjendjeve të llogarive sipas klasave, nisur nga dokumentet bazë justifikuese, të cilat janë të dhëna bazë të hyra në kontabilitet.

- Plotësimi i dokumenteve bazë e justifikues është bërë në mënyrë të plotë, pasi përshkruajnë me vërtetësi veprimin ose ngjarjen, përmban të dhëna për shkakun e veprimit, datën dhe vendin e kryerjes, objektin, treguesit sasiore dhe ato të vlerës, personat që kanë urdhëruar dhe ekzekutuar veprimin me të dhënat të nevojshme që i japin dokumentit forcën e një prove ligjore ose administrative. Kështu: Dokumentet vërtetues si Urdhër-shpenzimi, fletë hyrje-daljet, mandat arkëtimet e pagesat, janë të hartuara me të gjitha elementet që kërkon formati i miratuar. Këto dokumente shoqërohen nga dokumente autorizues si me urdhrat apo vendimet e organeve drejtuese, kontratat, dokumentet kryesore të procedurave të prokurimit, akt-marrëveshjet etj. Bashkëlidhur këtij dokumentacioni janë dokumentet vërtetues të shpenzimit si faturat, liste pagesat, situacionet e shpenzimeve, procesverbalet, shkresat etj.

- Informacioni kontabël është përgatitur mbi bazën e një kontabiliteti të quajtur të angazhimeve (ose në bazë të të drejtave të konstatuara), duke dhënë elementet e nevojshme për të vlerësuar gjendjen pasurore, gjendjen financiare dhe rezultatet e njësisë ekonomike.

- Baza e dhënies së opinionit së Raportimit Financiar. Pohimet mbi saktësinë e paraqitjes së zërave të pasqyrave financiare.

Për dhënien e opinionit mbi pasqyrat financiare, u analizuan treguesit e pasqyrave financiare të Bashkisë për aktivitetin ekonomik - financiar 01.01.2023 deri më datën 31.12.2023.

Pasqyrat financiare janë përgatitur nga Drejtoria e Financës. Gjatë fazës së ekzekutimit në terren, u kryen teste të detajeve dhe teste thelbësore, nga ku u konstatua se janë mbartur saktë tepricat e llogarive dhe se tepricat në çelje për vitin 2023 rakordojnë me tepricat në mbyllje të vitit 2022.

Nga verifikimi gjendjes së llogarive të bilancit të vitit ushtrimor 2023 rezulton se, llogaritë e Aktivit dhe të Pasivit kuadrojnë me formatet anekse pjesë e PF, si dhe llogaritë sintetike kuadrojnë me ato analitike;

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion u analizuan të dhënat përmbledhëse dhe analitike të disa prej llogarive kontabël të cilat janë pjesë përbërëse e Pasqyrave Financiare të Bashkisë Skrapar, konkretisht si më poshtë:

-Nga auditimi mbi verifikimin e marrjes së dokumentacioneve financiarë dhe regjistrimet kontabël të kryera nga Bashkia Skrapar si dhe në Njësitë vartëse, rezulton se; Drejtoria Ekonomike në Bashkia Skrapar dhe sektorët e financës në njësitë vartëse, regjistrimet e veprimeve kontabël, kryhen me program Excel dhe jo me “Bartës Informatik”, të cilët janë programe informatike të pa manipulueshme dhe të printueshme në çdo kohë. Veprimet e kryera nuk paraqesin besueshmëri duke bartur risk në vetvete pasi janë të ndryshueshme në çdo kohë, gjithashtu ndikojnë në pasaktësi të veprimeve kontabël e rrjedhimisht në rezultate jo korrekt. Kjo gjë çon dhe në mos kuadrim të drejtë dhe të saktë si dhe vonesa në kohë për gjetjen, korrektimin dhe sistemimin e gabimeve matematikore. Mungesa e programimit kompjuterik në hedhjen e të dhënave në shërbimin kontabël, ndikon në ngadalësimin e marrjes dhe përpunimit të informacioneve financiare, besueshmërinë e të dhënave, cilësinë dhe saktësinë e evidencave kontabël dhe të pasqyrave financiare, veprime këto jo në përputhje me ligjin nr. 25/2018, “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, nenin 3, pikat 14 e 15 ku citohen se;

“Dokument kontabël” është dokumenti bazë, dokumenti plotësues dhe regjistrat (librat) kontabël, që përgatiten në letër të shkruar ose në bartës informatikë...

“Bartës informatik” është çdo dokument kontabël i autorizuar nga organet përkatëse, i shkruar në mjete kompjuterike, sipas programeve informatike të pamanipulueshme dhe të printueshme në çdo kohë.”

me nenin 11 ku citohet se;

Qëllimi i pasqyrave financiare. 1. Pasqyrat financiare hartohen në mënyrë të qartë, në përputhje me këtë ligj dhe standardet e aplikueshme të raportimit financiar, si dhe paraqesin me vërtetësi dhe besueshmëri pozicionin financiar, performancën financiare, ndryshimet në kapital/aktivet neto dhe flukset e mjeteve monetare të njësisë ekonomike. 2. Pasqyrat financiare në këtë ligj u referohen pasqyrave financiare individuale dhe pasqyrave financiare të konsoliduara.

Gjendja e llogarive të bilancit në fund të vitit 2023, paraqitet në Aneksin nr. 1, pika 1, “Pasqyra e pozicionit financiar, viti 2023, Bashkia Skrapar”.

Burimi: Drejtoria Ekonomike, Bashkia Skrapar.

Në lidhje me verifikimin e disa vlerave të pasqyruara në llogaritë e pasqyrave të pozicionit financiar të vitit ushtrimor 2023, të saktësisë dhe besueshmërisë së tyre, u audituan referencat e llogarive të aktivitetit dhe të pasivitetit, si në vijim.

Aktivet neto janë të barabarta me Aktivet-Pasivet = 2,369,734,846 lekë.

Aktivet 2,533,051,706 lekë.

Pasivet 163,316,860 lekë.

Aktivet neto 2,369,734,846 lekë.

Aktivet afatshkurtra

Aktivet afatshkurtra më datë 31.12.2023 paraqiten në vlerën **253,352,211 lekë** dhe përbëhen nga:

Llogaritë e Klasës 5 “Mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre” në shumën 109,305,439 lekë.

Llogaritë e Klasës 3 “Gjendje inventari qarkullues” në shumën 24,655,612 lekë.

Llogaritë e Klasës 4 “Llogari të arkëtueshme” në shumën 119,391,160 lekë.

Llogaritë e Klasës 5 “Mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre” përbëhet nga:

Llogaritë kontabël	Emërtimi i llogarive	Viti 2023	Viti 2022	Diferenca 2023-2022
520	Disponibilitete në thesar	109,305,439	76.295.261	33,010,178
Totali		109,305,439	76.295.261	33,010,178

Vlera e llogarisë 520 “Disponibilitete në thesar” në shumën 109,305,439 lekë, sipas akt akordimit me Thesarin datë 31.01.2024, përbëhet nga: gjendja e Llogaria 85 "Rezultati i vitit ushtrimor" në pasqyrën 1 “Pasqyra e pozicionit financiar” paraqitet në vlerën 65,379,739 lekë dhe gjendja e llogarisë 466 "Mjete në ruajtje" në shumën 43,925,700 lekë, të cilat rakordojnë me rubrikën VI “Teprica e Likuiditeteve në fund të vitit ushtrimor” në Formatin nr.3 “Pasqyra e flukseve monetare (CASH-FLOU)”.

Llogaritë e klasës 5, kanë funksionuar duke u debituar për shtesat në kredi të llogarive përkatëse për të ardhurat dhe grande të ndryshme, si dhe duke u kredituar për pakësimet në debi të llogarive përkatëse të klasës 4.

Llogaritë e Klasës 3 “Gjendje inventari qarkullues”, përbëhet nga:

Llogaritë kontabël	Emërtimi i llogarive	Viti 2023	Viti 2022	Diferenca 2023-2022
31	Materiale	2,396,378	1,534,863	(861,515)
32	Inventar i imët	22,259,234	21,459,818	(799,416)
	Totali	24,655,612	22,994,681	(1,660,931)

Llogaritë e Klasës 3, sipas Pasqyrës së Pozicionit Financiar të Bashkisë Skrapar në 31.12.2023 paraqitet në vlerën 24,655,612 lekë dhe përbëhet nga llogaria kontabël 31 “Materiale” në vlerën 2,396,378 lekë dhe llogaria kontabël 32 “Inventar i imët” në vlerën 22,259,234 lekë. Diferencat me vitin e mëparshëm përfaqëson lëvizjen e inventarit në shumën -1,660,931 lekë e cila kuadron me llogarinë 63 “Ndryshimi gjendjes së inventarit” në shumën -1,660,931 lekë.

Llogaria 31 “Materiale”, është pasqyruar për vlerën 2,396,378 lekë që përfaqësojnë gjendjen e materialeve në magazine, krahasuar me vitin paraardhës pasqyrohet me rritje në vlerën 861,515 lekë.

Llogaria 32 “Inventarë i imët”, ka vlerën 22,259,234 lekë që përfaqësojnë inventarin e imët, e cila e krahasuar me vitin paraardhës pasqyrohet me rritje në vlerën 799,416 lekë.

Llogaritë e klasës 3 kanë funksionuar duke u debituar për shtesat në kredi të llog. 63 “Ndryshimi i gjendjeve të inventarit” dhe duke u kredituar për daljet e inventarit në debi të llogarisë 63 “Ndryshimi i gjendjeve të inventarit”.

Llogaritë e Klasës 4 “Llogari të arkëtueshme” përbëhet nga:

Llogaritë kontabël	Emërtimi i llogarive	Viti 2023	Viti 2022	Diferenca 2023-2022
	Llogari të arkëtueshme	119.391.160	119.320.010	(71,150)
468	Debitorë të ndryshëm	102.473.734	104.075.794	1,602,060
4342	Te tjera operacione me shtetin (te drejta)	16.917.426	15.244.216	(1,673,210)

Llogaritë 468 “Debitorë të ndryshëm”, në fund të vitit 2023 paraqitet në vlerën 102.473.734 lekë. Vlera e debitorëve në vitin 2023 në krahasim me vitin 2022 ka pësuar një ulje prej 1,602,060 lekë pra me rreth 1% të totalit të debitorëve të raportuar në fund të vitit 2022. Analiza e gjendjes së llog. “Debitorë të ndryshëm” paraqiten në listën analitike të PF të Bashkisë Skrapar. Nga ana e drejtimit të Bashkisë Skrapar rezulton se nuk janë marrë masat e duhura për uljen e detyrimeve debitore dhe rritjen e performancës në arkëtimin e taksave dhe tarifave vendore. *Veprime jo në përputhje me Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, kreu II, neni 12, pika 3/g/gj.*

Llogaria 4342 “Të tjera operacione me shtetin (te drejta)”, në fund të vitit 2023 paraqitet në vlerën 16,917,426 lekë, e cila përfaqësojnë llogaritë e Klasës së 4 të Pasivit të Pasqyrës Financiare të Pozicionit Financiar dhe nuk kuadron me Llogarinë 7206 “Financim i pritshëm nga buxheti” të Pasqyrës së Performancës Financiare e cila paraqitet në shumën 0 lekë.

Në mënyrë analitike paraqitet:

Emërtimi i llogarive	Vlera
Llogari 401-408 “Furnitor e llogari të lidhura me to”	1,345,943
Paga personeli llog 42	11,069,012
Tatim mbi të ardhurat llog. 431	719,787
Sigurime shoqërore llog.435	3,330,241
Sigurime shëndetësore llog.436	452,443

Totali	16,917,426
---------------	-------------------

Gjendja e llogarisë 4342 “Të tjera operacione me shtetin (të drejta)”, në fund të vitit 2023 paraqitet në vlerën 16,917,426 lekë, e cila përfaqëson llogaritë e Klasës së 4 të Pasivit të Pasqyrës Financiare të Pozicionit Financiar dhe nuk kuadron me Llogarinë 7206 “Financim i pritshëm nga buxheti” të Pasqyrës së Performancës Financiare e cila paraqitet në shumën 0 lekë në kundërshtim me udhëzimin e MFE nr. 08, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësisë të Qeverisjes së Përgjithshme”, Kreu III. “Procedurat për përgatitjen, paraqitjen dhe konsolidimin e pasqyrave financiare në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” i ndryshuar, pika 32.

-Llogari të Arkëtueshme Llogaria 468 “Debitorë të ndryshëm”.

-Nga auditimi i pasqyrave financiare në lidhje me llogaritë 468 dhe 401-408, rezulton se; Llogaria 468 në fund të vitit 2022 paraqitet në shumën 104,075,794 lekë, ndërsa për vitin 2023 në shumën prej 102,473,734 lekë. Gjatë vitit 2023 shtesa prej 3,295,891 lekë vjen si rezultat i rritjes së debitorëve për taksa e tarifa vendore të Bashkisë Skrapar dhe Njësive vartëse dhe janë bërë likuidime shuma prej 4,897,951. Nga ana e drejtimit të Bashkisë Skrapar rezulton se nuk janë marrë masat e duhura për uljen e detyrimeve debitore dhe rritjen e performancës në arkëtimin e taksave dhe tarifave vendore.

Nga analiza e llog. 468 “Debitorë të ndryshëm” rezulton se vlera e marrë nga drejtoria e taksave dhe tarifave vendore në fund të vitit 2023 paraqitet në shumën 105,832,017 ndërsa në pasqyrat financiare paraqitet në vlerën 102,473,734 lekë me një diferencë 3,358,283 lekë. Shuma progresive e detyrimeve debitore të cilat vijnë nga taksat dhe tarifave vendore paraqitet në vlerën 85,608,954 lekë në fund të vitit 2023 të cilat janë të ardhura të pa arkëtuara për buxhetin e Bashkisë Skrapar. **Nga sa më sipër rezulton se llogaria 468 (debitorë të ndryshëm) nuk paraqet pamjen reale në raportimin financiar të Njesisë Skrapar si rezultat i të dhënave jo të rakorduara me drejtorinë e Taksave dhe Tarifave Vendore.** Veprime të cilat nuk janë në përputhje me Udhëzimi e MFE nr.8, datë 9.3.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” kreu III pika 32, Kreu II pika 2/a, b, pika 22, me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, kreu II, neni 12, pika 3/g/gj, Rregullore e brendshme e funksionimit të Bashkia Skrapar, miratuar me vendimin pa nr., pa nr. prot, datë 25.02.2019, Kreu VI, neni 36, pika 2.3. Veprime për të cilat mban përgjegjësi drejtori i Taksave dhe tarifave vendore zj. H B dhe drejtori ekonomik z. N.G..

-Llogaritë 401-408 “Furnitorë e llogari të lidhura me to” në fillim të vitit 2022 rezulton për vlerën 1,671,676 lekë dhe në fund të vitit 2023 është në vlerën 1,345,943 lekë ose me një ulje në vlerën 325,733 lekë.

-Aktivet Afatgjata Materiale.

Llog 210 “Toka, troje terrene” e cila pasqyron gjendjen e llogarisë për Bashkinë Skrapar në fund të 2022 rezulton në vlerën 2,843,818 lekë, në 2023 rezulton po në vlerën 2,843,818 lekë pra nuk ka as shtesa e as pakësime në këtë llogari, konkretisht si më poshtë;

Llog 210 “Toka, troje Terrene”

Lëvizjet e llogarisë	Vlera në lekë
Gjendja në 01.01.2023	2,843,818
Shtesa gjatë vitit 2023 (D)	0
Pakësime gjatë vitit 2023 (K)	0
Gjendja në 31.12.2023(D)	2,843,818

Burimi: Drejtoria Ekonomike, Bashkia Skrapar.

Nga auditimi mbi dokumentacionin e vendosur në dispozicion nga Sektori i Regjistrimit të Pronave (SRP) të krahasuara me kartelat në kontabilitet të Drejtorisë Ekonomike për truallin nën objekt të objekteve të administruara në llog.(210) “Toka, troje terrene” u konstatua se; Bashkia Skrapar, sipas DRP ka në administrim gjithsej 94 objekte ndërtesa dhe konstruksione të ndryshme me sipërfaqe truall nën këto objekte prej 100,821 m², nga të cilat dokument të pronësisë (çertifikatë, apo vërtetim hipotekor) disponohen vetëm për 5 objekte me sipërfaqe truall nën këto objekt prej 1,867 m², kurse për 89 objekte me sipërfaqe truall nën objekt të objekteve prej 98,954 m² nuk disponohet asnjë lloj dokument pronësie. Nga këto, Drejtoria Ekonomike ka të administruara në kontabilitet zero m² të truallit nën objekt. Në këto kushte për mospërputhjet në administrimin për çdo truall të “Toka, troje, terrene” nga Bashkia Skrapar duhet që patjetër të kryejë sistemimin e llogarisë 210 “Toka, Troje, Terrene” duke bërë që në këtë llogari të paraqitet, vlera e trojeve të ndërtesave të pasqyruar në llogarinë 212 “Ndërtime e konstruksione”, vlera e trojeve të cilat me VKM të posaçme kanë kaluar në pronësi të Bashkisë Skrapar, vlera e truallit dhe ndërtesave të regjistruara në Agjencinë Shtetërore të Kadastrës (ASHK) Skrapar si dhe inventarizimi i trojeve me komision përkatës.

Nga Bashkia Skrapar nuk janë reflektuar gjithashtu ndryshimet në këtë llogari të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 803 datë 30.9.2015, , për të cilat është marrë Vendim i Këshillit të Ministrave datë 15.07.2021, në të cilën janë bërë këto ndryshime:, 3. Pika 3 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“3. Sipërfaqja e tokës shtetërore, që do të vendoset në dispozicion të përhershëm të shoqërisë TAP AG, sipas formës së përdorimit me vlerën përkatëse të kompensimit, të përcaktuar në pikën 2 për ndërtimin e infrastrukturës mbi tokë të projektit TAP, përfshihet në territorin administrativ të njësive të qeverisjes vendore, si më poshtë vijon:

a) Në territorin administrativ të Bashkisë Skrapar, të Qarkut të Skraparit, për:

i. sipërfaqen tokë bujqësore (arë dhe ledh) prej 4 185 (katër mijë e njëqind e tetëdhjetë e pesë) m², me vlerë të përgjithshme kompensimi prej 696 311.00 (gjashtëqind e nëntëdhjetë e gjashtë mijë e treqind e njëmbëdhjetë) lekësh, prej së cilës sipërfaqja e re pas përditësimeve kadastrale prej 2 883 (dy mijë e tetëqind e tetëdhjetë e tre) m², me vlerë kompensimi prej 407 267.00 (katërqind e shtatë mijë e dyqind e gjashtëdhjetë e shtatë) lekë;

ii. sipërfaqen rrugë automobilistike prej 305 (treqind e pesë) m², me vlerë të përgjithshme kompensimi prej 56 000.00 (pesëdhjetë e gjashtë mijë) lekësh, prej së cilës sipërfaqja e re pas përditësimeve kadastrale prej 250 (dyqind e pesëdhjetë) m² me kompensim shtesë 0 (zero) lekë duke qenë se përfshihet në minimumin e kompensimit prej 56 000.00 (pesëdhjetë e gjashtë mijë) lekësh të paguar.

Më poshtë po paraqesim tabelën trojeve dhe terreneve e sipërfaqet perkatese e detajuar sipas njësive administrative:

Emërtimi	Gjithsej		Të pa Regjistruara		Të Regjistruara	
	Nr.	Sipërfaqe	Nr.	Sipërfaqe	Nr.	Sipërfaqe
Bashkia Skrapar	10	4945	6	3.178	4	1.767
Njësiti administrative/varësie	84	95876	83	95.776	1	100
Qendër	20	14.324	20	14.324		
Bogovë	7	5710	7	5710		
Vëndreshë	8	3.074	8	3.074		
Çepan	13	15.914	13	15.914		
Gjerbës	7	10.468	7	10.468		
Zhepë	13	28.446	13	28.446		

Leshnje	7	8530	6	8430	1	100
Potom	9	9410	9	9410		
Shuma gjithsej	94	100.821	89	98.954	5	1.867

Shënim: Të dhëna të marra nga Drejtoria Ekonomike, Sektori i Pronave, Bashkia Skrapar.

Nga auditimi mbi saktësinë e Llog 210 “Toka, troje terrene” rezulton se kjo llogari nuk paraqet një pamje reale për pasqyrat financiare të vitit 2023.

Kontabilizimi i Aktiveve Afatgjata Materiale në llog.(210)“ *Toka, troje terrene*” dhe paraqitja e gjendjes së kësaj llogarie në PF është e paplotë, pasi mungojnë analizat për të.

Nga verifikimi dhe analiza e Llog. 210 “*Toka, troje, terrene*”, konstatohet se kjo llogari nuk paraqet gjendjen reale nga ana e Drejtorisë Ekonomike pasi, nuk janë hedh në kartelat e kontabilitetit asnjë prej vlerave të; a) trojeve nën objekt të objekteve si godina e re e Bashkisë dhe trualli përreth saj, ndërtesat e shkollave që ka në administrim, ndërtesat e shkollave dhe të zyrave në NjA, etj, sipas regjistrit të aktiveve të pasqyruar në llogarinë 212 “*Ndërtime e konstruksione*”. b) truallit të godinave të regjistruar në ASHK në pronësi të Bashkisë, c) trojeve të cilat me VKM kanë kaluar në pronësi të Bashkisë Skrapar, si dhe nuk është kryer inventarizimi dhe vlerësimi i tyre, për të cilën duhej bërë sistemimi dhe kalimi në administrim në llogarinë përkatëse.

-Llog. 211 “Pyje, kullota, plantacione”, nuk ka të pasqyruar vlerën e pyjeve dhe kullotave në pronësi të Bashkisë Skrapar, të transferuara me VKM nr. 433, datë 08.06.2016 “Për transferimin në pronësi të Bashkive të Pyjeve dhe të Kullotave Publike, sipas listave të inventarit dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish Komunave/Bashkive”, e ndryshuar, pika 6, shtojca me nr.4, e cila përmban,

- a) listën e inventarit të pyjeve dhe kullotave që transferohen në pronësi të Bashkisë Skrapar, me numër rendor nga 1(një) deri 892 (tetëqind e nëntëdhjetë e dy).
- b) godinën e DSHP-së.

Ilustruar për:

-Ekonominë Kullosore Therepel-Qeshibës, me sipërfaqe 290.5 Ha/2.905.000 m² * 83 lekë/m² = 241,115,000 lekë

-Ekonominë Pyjore Devri-Terrovë, me sipërfaqe 2852.3 Ha/28.523.000 m² * 100 lekë/m² = 2,852,300,000 lekë. Për këto sipërfaqe nuk është ngritur një grup pune me qëllim kryerjen e verifikimit fizik të tyre me qëllim përcaktimin e vlerës kontabël të llogarisë nr. 211. Nuk është kryer inventarizimi dhe vlerësimi i aseteve për dy llogaritë e mësipërme.

-Për llogaritë e mësipërme në Bashkinë Skrapar nuk ekziston një regjistër kontabël, ku të specifikohet analitiku i llogarisë, data e hyrjes ose marrjes në dorëzim, përshkrimi i aktivitetit, vlerën e blerjes, datën e daljes në përdorim, datë e skadencës, vlerën e shpenzimeve kapitale të mëpasshme që sjellin rritje të vlerës së aktivitetit, vendndodhjen, personin përgjegjës, vlerën e akumuluar të amortizimit, kohën e shërbimeve të mirëmbajtjes, vlerën e akumuluar të shpenzimeve të mirëmbajtjes, datën e daljes nga pronësia etj. Pra, si rezultat i moszbatimit të kuadrit rregullator ligjor për transferimin e aktiveve, llogaria nr. 210 “Toka, troje, terrene” dhe nr. 211 “Pyje Plantacione”, nuk paraqet situatën e vërtetë dhe të drejtë në fund të vitit 2023.

Veprime të cilat nuk janë në përputhje me Ligjin nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” i ndryshuar, Kap. III, neni 9, pika 1.2 “Të drejtën dhe përgjegjësinë e pronësisë”; Udhëzimi nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar, pikat 26, 27, 30 dhe 74, dhe Udhëzimi nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”, Kap III, pika 30, i ndryshuar. Për sa më sipër mbanë përgjegjësi, z. N.G., Drejtor i Financës.

Llog 211 “Pyje, Plantacione”;

Lëvizjet e llogarisë	Vlera në lekë
Gjendja në 01.01.2023	6,911,988
Shtesa gjatë vitit 2022(D)	0
Pakësime gjatë vitit 2023 (K)	0
Gjendja në 31.12.2023(D)	6,911,988

Llog. 212 “Ndërtime e konstruksione”, e cila pasqyron gjendjen e llogarisë për Bashkinë Skrapar dhe për 5 njësi të varësisë, në fund të vitit 2022 rezulton për vlerën 2,046,670,637 lekë dhe fund të vitit 2023 për vlerën 2,114,295,483 lekë ose me rritjen në vlerën neto 67,624,846 lekë në vlerë neto.

Llog 212 “Ndërtesa konstruksione”

Lëvizjet e llogarisë	Vlera në lekë
Gjendja në 01.01.2023	785,396,067
Shtesa gjatë vitit 2023 (D)	41,982,844
Pakësime gjatë vitit 2023 (K)	30,650
Gjendja në 31.12.2023(D)	827,348,261

Shuma prej 41,982,844 lekë i përket 5 objekte të marra në dorëzim gjatë vitit 2023 objekte të kryera gjatë vitit 2023, të aparatit të Bashkisë Skrapar, e cila i përket objekteve rikonstruksionesh dhe ndërtimi.

-Llog. 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore”, e cila pasqyron gjendjen e llogarisë për Bashkinë Skrapar, në fund të vitit 2022 paraqitet në vlerën 1,934,801,360 lekë, ndërsa në vitin 2023 gjendja paraqitet në vlerën 1,997,776,266 lekë me një rritje në shumën 62,974,906. Kjo rritje vjen si rezultat i 11 objekteve investimesh të bëra gjatë vitit ushtrimor dhe viteve përpara periudhës raportuese në vepra ujore dhe rrugë, të cilat janë marrë në dorëzim dhe janë përfunduar gjatë vitit ushtrimor, konkretisht të dhënat dhe lëvizjet jepen si më poshtë;

Llog 213 “Rrugë rrjete vepra ujore”

Lëvizjet e llogarisë	Vlera në lekë
Gjendja në 01.01.2023	1,934,801,360
Shtesa gjatë vitit 2023 (D)	62,974,906
Pakësime gjatë vitit 2023 (K)	0
Gjendja në 31.12.2023(D)	1,997,776,266

Ka të evidentuara në kontabilitet në llog.(212) nga ish Komunitat një numër të konsiderueshëm objekte të cilat janë në verifikim për regjistrimin e tyre. Kjo vjen për arsye se një pjesë e objekteve janë të trashëguara dhe të mbartura nga njësitë që u shkrinë (*ish/komunitat*) në periudhat raportuese para vitit 2015 të pa shoqëruar me kartela objekti. Në këto kushte duke qenë se ka mospërputhje në administrimin për çdo objekt të “*Ndërtesave e Konstruksioneve*” nga Bashkia Skrapar, Drejtoria e Menaxhimit Financiar dhe të Ardhurave në bashkëpunim me Sektorin e Pronave, duhet që të bëhet hedhja në kontabilitet e objekteve dhe sipërfaqeve të regjistruara saktësisht objekteve, dokumentimi me kartelë objekti, inventarizim fizik i objektit, si dhe rivlerësim me normat për secilin objekt. Për sa më sipër *Llog. 212 “Ndërtime e konstruksione”* nuk paraqet një pamje reale për pasqyrat financiare të vitit 2023. Nga titullari i Bashkisë Skrapar, Sektori i Pronave dhe Drejtoria Ekonomike nuk janë marrë masat e duhura për përmbushjen e kuadrit rregullator ligjor të regjistrimit të pronave dhe evidentimit të saktë në llogaritë përkatëse me vlerën e drejtë të tyre.

-Paga, shpërblime e të tjera personeli (llog. 600) dhe sigurimet shoqërore (llog 601).

-Nga auditimi i listë-pagesave u konstatua se listë-pagesat hartoheshin sipas standardeve të kontabilitetit, ku plotësoheshin pagat me të gjithë elementet dhe shtesa të ndryshme të përfituara deri tek shuma bruto. Po kështu pasqyroheshin llojet e ndalesave, raportet e përkohshëm, lejet e zakonshme e deri tek paga neto. Përmbledhëset janë të kuadruara me listë pagesat dhe me urdhër pagesat respektive, të nënshkruara nga specialisti i pagave, nëpunësi zbatues dhe nëpunësi autorizues.

-Nga verifikimi me zgjedhje i ushtruar në disa nga listë pagesat e muajve, janar, maj, dhjetor të vitit 2023 rezultoi se pagat, shtesat dhe ndalesat janë përlllogaritur drejt sipas tabelës së pagave. Gjithashtu liste pagesat janë të shoqëruara dhe me liste prezencat përkatëse. Përmbledhëset janë të kuadruara me listë pagesat dhe me urdhër pagesat respektive, të nënshkruara nga punonjësi i financës dhe nëpunësi i autorizuar i Bashkisë.

-Për të gjithë periudhën e audituar, janë përlllogaritur, ndaluar dhe xhiruar detyrimet për kontributin e sigurimeve shoqërore dhe tatimin mbi të ardhur, si dhe janë bërë sipas kohëzgjatjes orare të punës.

- Inventarizimi i aktiveve për vitin 2023 Bashkia Skrapar:

Inventarizimi i aktiveve është një element i rëndësishëm kontrolli në kuadrin e menaxhimit të aktiveve të njësisë i cili kryhet për të vërtetuar saktësinë, cilësinë e gjendjes fizike të aktiveve në një kohë të caktuar si dhe përdorimin në mënyrën e duhur dhe me eficiencë të tyre. Çdo njësi publike duhet të kontrollojë të paktën një herë në vit ekzistencën dhe vlerësimin e aktiveve afatgjata materiale dhe jo materiale, aktiveve afatshkurtra, të detyrimeve dhe të drejtave, nëpërmjet inventarizimit të këtyre elementëve dhe dokumentacionit mbështetës.

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion u konstatua se;

Dokumentacioni kontabël i veprimtarisë financiare, klasifikimi, përpunimi, ruajtja dhe mbajtja e kontabilitetit kryhet nëpërmjet programit exel. Nëpërmjet këtij formati Bashkia Skrapar dhe njësitë e varësisë mbajnë, përpunojnë dhe ruajnë të dhënat kontabël po në të njëjtin format pra në mënyrë manuale, duke paraqitur mosbesueshmëri dhe risk për përmbajtjen e tyre.

Bazuar në ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, ligjin nr. 10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, Udhëzimin nr.30, datë 27.12.2011 të Ministrisë së Financave “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar, në zbatim të Urdhrit të Kryetarit të Bashkisë Nr. 478 datë 13.11.2023 “Për inventarizimin e aktiveve afatgjatë, afatshkurtër e materiale për periudhën 2023”, është ngritur komisioni për të kryer inventarizimin fizik të aktiveve në përdorim, si dhe për të krahasuar gjendjen konkrete të aktiveve me gjendjen kontabël, me 3(tre) anëtarë, 1-I.O.Kryetare Komisioni, 2-A.K.anëtare dhe 3- A.G.anëtarë për Bashkinë Skrapar dhe Njësitë Administrative.

Me urdhrin e Kryetarit të Bashkisë nr.67, datë 22.02.2024. “Për ngritjen e komisionit për vlerësimin e aktiveve afatshkurtra dhe afatgjata”, është ngritur komisioni i përbërë prej 3 anëtarësh me përbërje z. N.G., z. E.Sh. dhe z. F.O. për vlerësimin e aktiveve afatshkurtra dhe afatgjata, ky komision ka bërë vlerësimin dhe verifikimin e aktiveve afatshkurtra dhe afatgjata të inventarizuara në fund të vitit 2023dhe duke hartuar proces-verbalin e vlerësimit.

Në proces-verbal, vlera e materialeve të nxjerra jashtë përdorimit në total është për vlerën 3,947,803 lekë, (*inventar ekonomik në vlerën 2,604,563 lekë dhe për inventarin e imët në vlerën 1,343,240lekë*).

Me urdhrin e Kryetarit të Bashkisë nr124, datë 03.04.2024 “Për ngritjen e komisionit të asgjësimit për aktivet e dala jashtë përdorimit”, është ngritur komisioni i asgjësimit për aktivet e dala jashtë

përdorimit, në përbërje prej 5 (pesë) anëtarësh, të cilët kanë bërë asgjësimin tyre për vlerën 3,947,803 lekë.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion për kryerjen e procedurave të inventarizimit për vitin 2023 rezulton se; nga Bashkia Skrapar, nëpunësi zbatues i njësisë publike, i caktuar nga titullari i njësisë publike në cilësinë e nëpunësi zbatues, nuk ka hartuar regjistër kontabël të përditësuar të aktiveve që zotëron apo ka në administrim Bashkia Skrapar dhe njësitë në varësi, i cili në varësi të llojit të përmbajtje kërkesat minimale si datën e hyrjes ose marrjes në dorëzim, përshkrimin e aktivitetit, vlerën e blerjes, datën e daljes në përdorim, datën e skadencës, vlerën e shpenzimeve kapitale të mëpasshme që sjellin rritje të vlerës së aktivitetit, vendndodhjen, personin përgjegjës, vlerën e akumuluar të amortizimit, kohën e shërbimeve të mirëmbajtjes, vlerën e akumuluar të shpenzimeve të mirëmbajtjes, datën e daljes nga pronësia etj. *Veprim për të cilin mban përgjegjësi z. N.G.në cilësinë e nëpunësit zbatues.*

Veprime të cilat nuk janë në përputhje me Ligjin nr. 25/2018, "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", pikat 26-33 në të cilin ndër të tjera citohet se;

Formati i regjistrit të aktiveve hartohet në vartësi të llojit të tyre afatgjatë apo afatshkurtër si dhe grupit përkatës brenda llojit. Kërkesat minimale që duhet të përmbajë regjistri i aktiveve në vartësi të llojit, përfshijnë: datën e hyrjes ose marrjes në dorëzim, përshkrimin e aktivitetit, vlerën e blerjes, datën e daljes në përdorim, datën e skadencës, vlerën e shpenzimeve kapitale të mëpasshme që sjellin rritje të vlerës së aktivitetit, vendndodhjen, personin përgjegjës, vlerën e akumuluar të amortizimit, kohën e shërbimeve të mirëmbajtjes, vlerën e akumuluar të shpenzimeve të mirëmbajtjes, datën e daljes nga pronësia.

-Nuk është kryer verifikim fizik për zërat e bilancit Tokë, truall, pyje, kullota, ndërtime, rrugë, rrjete, vepra ujore dhe mos paraqitje e dokumentuar e vlerave të tyre në Pasqyrat Financiare të Bashkia Skrapar. Nga auditimi i pasqyrave financiare dhe procedurave të inventarizimit të aktiveve për vitin 2023 në lidhje me zërin e llog.210 (Toka, troje, terrene) e cila paraqitet në shumën 2,843,818 lekë, në llog.211(pyje, kullota, plantacione) e cila paraqitet në shumën 6,911,988 lekë, në llog.213 (rrugë, rrjete, vepra ujore) e cila paraqitet në shumën 1,490,230,435 lekë, rezulton se; Nga Nëpunësi i Autorizuar në cilësinë e titullarit të njësisë publike dhe nga Drejtori Ekonomik në cilësinë e Nëpunësit Zbatues nuk janë marrë masat e duhura për ngritjen e komisioneve përkatës për verifikimin dhe vlerësimin e zërit troje, ndërtesa, pyje e kullota për Bashkia Skrapar dhe njësitë në varësi. Për këto aktive nuk është kryer asnjëherë inventar fizik në lidhje me to, për të cilat nuk mund të gjykohej nëse vlera e pasqyruar në kontabilitet, është fizikisht apo jo e disponueshme dhe e përdorshme nga institucioni çka do të thotë se nuk mund të verifikohet dhe vlerësohet dokumentacioni mbështetës i tyre. E njëjta situatë konstatohet edhe në Njësitë e varësisë në varësi të Bashkia Skrapar pasi nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezultoi se nuk është kryer inventarizim për zërat e mësipërm të bilancit. Veprime të cilat nuk janë në përputhje me Ligjin nr. 25/2018, "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", neni 11 dhe neni 15, me ligjin nr.10296, datë 08/07/2010, "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin", i ndryshuar, neni 9 dhe 12, Udhëzimin e Ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" i ndryshuar, kreu IV, pika 74, e cila citon se;

Çdo njësi publike duhet të kontrollojë të paktën një herë në vit ekzistencën dhe vlerësimin e aktiveve afatgjata materiale dhe jomateriale, aktiveve afatshkurtra, të detyrimeve dhe të drejtave, nëpërmjet inventarizimit të këtyre elementeve dhe dokumentacionit mbështetës.

Veprim për të cilin mban përgjegjësi N/A z. A.M.dhe N/Z z. N.G..

Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet ligjore e nënligjore të bëra në:

- 1) Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar,*
- 2) Ligjin nr. 25/2018, datë 10.05.2018, "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare",*
- 3) Ligjin nr. 68, datë 227.04.2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore",*
- 4) Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 90 datë 22.02.2023, "Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurisë së paluajtshme, pronë private, që preket nga realizimi i projektit "Zgjerimi i varrezave publike 'Burdullias', Bashkia Skrapar",*
- 5) Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 433 datë 08.06.2016, "Për transferimin në pronësi të Bashkive, të pyjeve dhe kullotave publike, sipas listës së inventarit dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish-Komunave", i ndryshuar,*
- 6) Standardet Kombëtare të Kontabilitetit Publik,*
- 7) Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr.8, datë 09.03.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme".*
- 8) Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" i ndryshuar.*

IV. REKOMANDIME

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi verifikimin e marrjes së dokumentacioneve financiarë dhe regjistrimet kontabël të kryera nga Bashkia Skrapar si dhe në Njësitë vartëse, rezulton se; Drejtoria Ekonomike në Bashkia Skrapar dhe sektorët e financës në njësitë vartëse, regjistrimet e veprimeve kontabël, kryhen me program excel dhe jo me "Bartës informatik", të cilët janë programe informatike të pamanipulueshme dhe të printueshme në çdo kohë. Veprimet e kryera nuk paraqesin besueshmëri duke bartur risk në vetvete pasi janë të ndryshueshme në çdo kohë, gjithashtu ndikojnë në pasaktësi të veprimeve kontabël e rrjedhimisht në rezultate jo korrekt. Kjo gjë çon dhe në mos kuadrim të drejtë dhe të saktë si dhe vonesa në kohë për gjetjen, korrektimin dhe sistemimin e gabimeve matematikore. Mungesa e programimit kompjuterik në hedhjen e të dhënave në shërbimin kontabël, ndikon në ngadalësimin e marrjes dhe përpunimit të informacioneve financiare, besueshmërinë e të dhënave, cilësinë dhe saktësinë e evidencave kontabël dhe të pasqyrave financiare. Veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 25/2018, "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", nenin 3 pikat 14 e 15 dhe nenin 11. (*Më hollësisht trajtuar në pikën 1, faqe 14-26, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

1.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Skrapar të marrë masa për pajisjen e Drejtorisë Ekonomike dhe Njërive Vartëse, me programe kompjuterike financiare për mbajtjen e kontabilitetit me qëllim shmangien e risqeve të mundshme të informacionit kontabël.

Brenda 31.12.2024

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i pasqyrave financiare të periudhës ushtrimore raportuese 2023 u konstatua se; disa llogari nuk paraqesin në mënyrë të drejtë në pozicionin financiar gjendjen reale në datën 31.12.2023 konkretisht llog.(210); llog.(211); llog.(212); llog (213); llog (520), si më poshtë vijon;

a. Llog.(210) *“Toka, troje, terrene”*, nuk paraqet gjendjen reale sepse nga ana e Drejtorisë Ekonomike nuk janë hedh në kartelat e kontabilitetit asnjë prej vlerave të; a) trojeve nën objekt të objekteve si godina e re e Bashkisë dhe truallit përreth saj, ndërtesat e shkollave që ka në administrim, ndërtesat e shkollave dhe të zyrave në NjA, etj, sipas regjistrimit të aktiveve të pasqyruar në llogarinë 212 *“Ndërtime e konstruksione”*.

b) truallit të godinave të regjistruar në ASHK në pronësi të Bashkisë,

c) trojeve të cilat me VKM kanë kaluar në pronësi të Bashkisë Skrapar, si dhe nuk është kryer inventarizimi dhe vlerësimi i tyre, për të cilën duhej bërë sistemimi dhe kalimi në administrim në llogarinë përkatëse.

b. Llog. (211), nuk ka të pasqyruar vlerën e pyjeve dhe kullotave në pronësi të Bashkisë Skrapar, të transferuara me VKM nr. 433, datë 08.06.2016 *“Për transferimin në pronësi të Bashkive të Pyjeve dhe të Kullotave Publike, sipas listave të inventarit dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish Komunave/Bashkive”*, e ndryshuar, pika 6, shtojca me nr.4.

Nga Bashkia Skrapar nuk janë reflektuar gjithashtu ndryshimet në këtë llogari të VKM nr. 803 datë 30.9.2015, të Këshillit të Ministrave, i ndryshuar, 3. Pika 3 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“3. Sipërfaqja e tokës shtetërore, që do të vendoset në dispozicion të përhershëm të shoqërisë TAP AG, sipas formës së përdorimit me vlerën përkatëse të kompensimit, të përcaktuar në pikën 2 për ndërtimin e infrastrukturës mbi tokë të projektit TAP, përfshihet në territorin administrativ të njësisë të qeverisjes vendore, si më poshtë vijon:

a) Në territorin administrativ të Bashkisë Skrapar, të Qarkut të Beratit, për:

i. sipërfaqen tokë bujqësore (arë dhe ledh) prej 4 185 m², me vlerë të përgjithshme kompensimi prej 696 311.00 lekë, prej së cilës sipërfaqja e re pas përditësimeve kadastrale prej 2 883 m², me vlerë kompensimi prej 407,267 lekë;

ii. sipërfaqen rrugë automobilistike prej 305 m², me vlerë të përgjithshme kompensimi prej 56,000 lekë, prej së cilës sipërfaqja e re pas përditësimeve kadastrale prej 250 m² me kompensim shtesë 0 lekë duke qenë se përfshihet në minimumin e kompensimit prej 56 000.00 lekësh të paguar.

c. Llog.(212) *“Ndërtime e Konstruksione”* nuk paraqet gjendjen reale sepse nuk disponohet asnjë lloj dokument pronësie për objektet që ka në administrim, me sipërfaqe truallit nën objekt të objekteve të trashëguara nga ish Komunitat një numër të konsiderueshëm objekteve të cilat janë në verifikim për regjistrimin e tyre. Kjo vjen për arsye se një pjesë e objekteve janë të trashëguara dhe të mbartura nga njësitë që u shkrinë (*ish/komunitat*) në periudhat raportuese para vitit 2015 të pa shoqëruar me kartela objekti. Në këto kushte duke qenë se ka mospërputhje në administrimin për çdo objekt të *“Ndërtesave e Konstruksioneve”* nga Bashkia Skrapar nga Sektori i Regjistrimit të Pronave, duhet që të bëhet hedhja në kontabilitet e objekteve dhe sipërfaqeve të regjistruara saktësimi objekteve, dokumentimi me kartelë objekti, inventarizim fizik i objektit, si dhe rivlerësim me normat për secilin objekt. Për sa më sipër Llog. 212 *“Ndërtime e konstruksione”* nuk paraqet një pamje reale për pasqyrat financiare të vitit 2023.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Ligji nr. 68/2017 *“Përfinancat e qeverisjes vendore”*, neni 34, pika 1, VKM nr. 510, datë 10.06.2015 *“Për inventarizimi dhe hipotekimin e të*

gjitha pronave të paluajtshme dhe të luajtshme”, Kreu (VI) “Transferimi pasurive dhe regjistrimi i pasurive të paluajtshme”, pika (1); (2), VKM Nr. 433 dt. 08.06.2016 “Për transferimin në pronësi të Bashkive të Pyjeve dhe të Kullotave Publike, sipas listave të inventarit dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish Komunave/Bashkive”, pika 35, shtojca me nr.33, Udhëzimin e MFE nr. 8, datë 9.3.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, Kreu II pika 5 dhe Kreu III pika 30, 50. (Më hollësisht trajtuar në pikën 1, faqe 14-26, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

2.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Skrapar, të marrë masat e duhura që;

a-Të ngrejë grup pune i cili të verifikojë, vlerësojë, dhe saktësojë të gjitha aktivet e llogarive të klasës 2 dhe të dokumentoj këto aktive sipas kuadrit ligjor për regjistrimin e pasurisë.

b-Të ngrejë një grup pune me specialistë të fushës për kryerjen e inventarizimit dhe vlerësimin e aktiveve të llog. 212 “Ndërtesa Konstruksione” për NJA dhe nëpërmjet Drejtorisë Ekonomike të kryejë zbrëthimin e dokumentacionit të trashëguar nga ish-Komunat për nxjerrjen e të dhënave për aktivet e hyra e veprimet me to në vite për të verifikuar, saktësuar e analizuar vlerat e paraqitura në bilancin e vitit 2015 e në rast pasaktësish të bëhen sistemimet e nevojshme në kontabilitet e në inventarin fizik.

c- Të marrë masat e duhura për regjistrimin e pasurive të paluajtshme në Agjencinë Shtetërore të Kadastrës, me qëllim dokumentimin me akte pronësie të aktiveve kapitale në pasqyrat financiare të Njesisë.

Me mbylljen e PF të vitit 2024

3. Gjetje nga auditimi: Nga analizimi i llogarisë 4342 “Të tjera operatione me shtetin (të drejta)”, rezulton se në fund të vitit 2023 paraqitet në vlerën 16,917,426 lekë, e cila përfaqëson llogaritë e Klasës së 4 të Pasivit të Pasqyrës Financiare të Pozicionit Financiar dhe nuk kuadron me Llogarinë 7206 “Financim i pritshëm nga buxheti” të Pasqyrës së Performancës Financiare e cila paraqitet në shumën 0 lekë, veprim në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr. 08, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësisë të Qeverisjes së Përgjithshme”, Kreu III. “Procedurat për përgatitjen, paraqitjen dhe konsolidimin e pasqyrave financiare në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” i ndryshuar, pika 32. (Më hollësisht trajtuar në pikën 1, faqe 14-26, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

3.1. Rekomandimi: Bashkia Skrapar, Drejtoria Ekonomike, të marrë masat e nevojshme për regjistrimin e saktë të llogarisë nr.7206 “Financim i pritshëm nga buxheti”.

Me mbylljen e PF të vitit 2024

4. Gjetje nga auditimi: Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion për kryerjen e procedurave të inventarizimit për vitin 2023 rezulton se; nga Bashkia Skrapar nëpunësi zbatues i njësisë publike, nuk ka hartuar regjistër kontabël të përditësuar të aktiveve që zotëron apo ka në administrim Bashkia Skrapar dhe njësitë në varësi, sipas formatit të Ministrisë së Financave i cili në varësi të llojit të përmbajtje kërkesat minimale, si datën e hyrjes ose marrjes në dorëzim, përshkrimin e aktivitetit, vlerën e blerjes, datën e daljes në përdorim, datën e skadencës, vlerën e shpenzimeve kapitale të mëpasshme që sjellin rritje të vlerës së aktivitetit, vendndodhjen, personin përgjegjës, vlerën e akumuluar të amortizimit, kohën e shërbimeve të mirëmbajtjes, vlerën e akumuluar të shpenzimeve të mirëmbajtjes, datën e daljes nga pronësia etj.

Veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 25/2018, “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, Udhëzimin nr. 30,

datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", pikat 26-33. (Më hollësisht trajtuar në pikën 1, faqe 14-26, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

4.1. Rekomandimi: Drejtoria Ekonomike, të marrë masa për plotësimin e regjistrimit të aktiveve që ka në pronësi, duke plotësuar të gjitha kërkesat e formatit të aprovuar për të ulur riskun e shpërdorimeve materiale të pasurisë së Njesisë dhe për një menaxhimin sa më të mirë të tyre.

Deri më datë 31.12.2024

5. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i pasqyrave financiare dhe procedurave të inventarizimit të aktiveve për vitin 2023 në lidhje me zërin (Tokë, truall, pyje, kullota etj) të cilat paraqiten në kontabilitetin e Bashkia Skrapar, rezulton se; Nga Njësia e Autorizuar në cilësinë e titullarit të njësisë publike dhe nga Drejtoria Ekonomike në cilësinë e Njësia Zbatues nuk janë marrë masa e duhura për ngritjen e komisioneve përkatës për verifikimin dhe vlerësimin e zërit troje, pyje e kullota për Bashkia Skrapar dhe njësitë në varësi. Për këto aktive nuk është kryer asnjëherë inventar fizik në lidhje me to, për të cilat nuk mund të gjykohet nëse vlera e pasqyruar në kontabilitet, është fizikisht apo jo e disponueshme dhe e përdorshme nga institucioni çka do të thotë se nuk mund të verifikohet dhe vlerësohet dokumentacioni mbështetës i tyre. E njëjta situatë konstatohet edhe në Njësia e varësisë në varësi të Bashkia Skrapar pasi nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezultoi se nuk është kryer inventarizim për zërat e mësipërm të bilancit.

Veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 25/2018, "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", neni 11 dhe nenin 15; Ligjin nr.10296, datë 08/07/2010, "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin", i ndryshuar, neni 9 dhe 12, Udhëzimin e Ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" i ndryshuar, kreu IV, pika 74. (Më hollësisht trajtuar në pikën 1, faqe 14-26, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

5.1. Rekomandimi: Nga Bashkia Skrapar, Drejtoria Ekonomike, të kryhet analiza e situatës së aktiveve të Njesisë, të vlerësohen këto asete, të plotësohen me dokumentacion pronësor, si dhe të kryhen reflektimet përkatëse në pasqyrat financiare, me qëllim vlerësimin e pronës dhe identifikimin e saj.

Deri më datë 31.12.2024

B. MASA PËR ELIMIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE NË MENAXHIMIN E TË ARDHURAVE NGA TAKSAT E TARIFAT VENDORE, ME EFEKT MUNGESË TË ARDHURASH

1. 1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i pasqyrave financiare në lidhje llog. 468 "Debitorë të ndryshëm" rezulton se, vlera e marrë nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore në fund të vitit 2023 paraqitet në shumën 105,832,017 ndërsa në pasqyrat financiare paraqitet në vlerën 102,473,734 lekë me një diferencë 3,358,283 lekë. Shuma progresive e detyrimeve debitorë të cilat vijnë nga taksat dhe tarifave vendore paraqitet në vlerën 85,608,954 lekë në fund të vitit 2023. **Nga sa më sipër rezulton se llogaria 468 (debitorë të ndryshëm) nuk paraqet pamjen reale në raportimin financiar të Njesisë Skrapar si rezultat i të dhënave jo të rakorduara me drejtorinë e Taksave dhe Tarifave Vendore.**

Veprime në kundërshtim me Udhëzimi e MFE nr.8, datë 9.3.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme" kreu III pika 32, Kreu II pika 2/a, b, pika 22, me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar, kreu II, neni 12, pika 3/g/gj, Rregullore e brendshme e funksionimit të Bashkia Skrapar, miratuar me vendimin pa nr., pa nr. prot, datë

25.02.2019, Kreu VI, neni 36, pika 2.3. (Më hollësisht trajtuar në pikën 1, faqe 14-26, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

1.1. Rekomandimi: Bashkia Skrapar, Drejtoria e Financës dhe Buxhetit, të marrë masat e duhura për paraqitjen reale të llogarisë 468, duke kontabilizuar vlerën 3,358,283 lekë me qëllim paraqitjen e raportimit financiar sipas situatës reale të saj si dhe duke ndjekur të gjitha rrugët ligjore me qëllim arkëtimin e të ardhurave të munguara.

Me mbylljen e PF të vitit 2024

C. MASA PËR ARKËTIMIN E DETYRIMEVE PËR TATIM TAKSAT VENDORE.

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i pasqyrave financiare në lidhje me llogaritë 468 dhe 401-408, rezulton se; Llogaria 468 në fund të vitit 2022 paraqitet në shumën 104,075,794 lekë, ndërsa për vitin 2023 në shumën prej 102,473,734 lekë. Gjatë vitit 2023 shtesa prej 3,295,891 lekë vjen si rezultat i rritjes së debitorëve për taksa e tarifa vendore të Bashkisë Skrapar dhe Njësive vartëse dhe janë bërë likuidime shuma prej 4,897,951. Nga ana e drejtimit të Bashkisë Skrapar rezulton se nuk janë marrë masat e duhura për uljen e detyrimeve debitore dhe rritjen e performancës në arkëtimin e taksave dhe tarifave vendore. Veprime në kundërshtim me Udhëzimi e MFE nr.8, datë 9.3.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme" kreu III pika 32, Kreu II pika 2/a, b, pika 22, me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar, kreu II, neni 12, pika 3/g/gj, Rregullore e brendshme e funksionimit të Bashkia Skrapar, miratuar me vendimin pa nr., pa nr. prot, datë 25.02.2019, Kreu VI, neni 36, pika 2.3. (Më hollësisht trajtuar në pikën 1, faqe 14-26, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

1.1. Rekomandimi: Bashkia Skrapar, Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore, të marrë masa për nxjerrjen e njoftimit të vlerësimit tatimor për debitorët të cilët vijnë nga taksat dhe tarifat vendore, duke ndjekur të gjitha rrugët për arkëtimin e detyrimeve në vlerën totale 102,473,734 lekë.

Menjëherë dhe në vijimësi

D. MASA DISIPLINORE

Për punonjësit e ngarkuar me përgjegjësi në Raportin Përfundimtar të Auditimit, *nuk rekomandohet dhënia e masës disiplinore pasi*, masat janë ezauruar në auditimin e kryer për të njëjtën periudhë, sipas programit të auditimit nr. 36/1prot, datë 10.01.2024, të shprehura në **Vendimin e Kryetarit të KLSH nr. 85, datë 13.05.2024.**

Për sa më sipër paraqitet ky Raport Përfundimtar Auditimi.

KONTROLLI I LARTË I SHTETI

